


# *daullja prej letre*

BIBLIOTEKA

BSH-31

M 98

BESNIK MUSTAJ



ARBI

Nga i njëjti autor në "ARBRI"  
Vera pa kthim, 1992  
Gjinkallat e vapës, 1994  
Një sagë e vogël, 1995

Kopertina  
VANGJUSH VALLA

© ARBRI për botimin në shqip  
Tiranë, 1996



*Daulija prej letre*

Jakup Cena doli nga zyra e madhe dhe e bukur e Enver Hoxhës me kokën fare të turbullt. Ai nuk e dallonte dot ç'i kishte bërë më shumë përshtypje. Nëse lëmë mënjanë kënaqësinë hutuese të çastit - ishte takimi i tij i parë me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë dhe Kryetar i Qeverisë, heroi legjendar i çlirimit, siç shpreheshin gazetatat tashmë - ai nuk ndihej as i gëzuar dhe as i trishtuar, as i sigurt se do t'ia dilte mbanë detyrës që sapo iu ngarkua dhe as dyshues për suksesin. Ai ndihej thjesht i ftohtë dhe bosh. Dhe nuk e kuptonte përse.

Enver Hoxha i kishte folur Jakup Cenës gjatë dhe gjithë pasion për punën e pazakonshme të komisionit që ai do të drejtonte dhe sidomos kishte ngulur këmbë në rëndësinë e skajshme që kishte kjo punë për të ardhmen e pushtetit të tyre, domethënë të pushtetit të popullit, por pa ia shpjeguar sadopak përmbajtjen e kësaj rëndësie. Dhe Jakup Cena nuk kishte marrë vesh asgjë. Por nuk kishte bërë asnjë pyetje. Jo nga hutimi. Ai e dinte nga të tjerët se Enver Hoxhës nuk i pëlqenin njerëzit që e detyronin të fliste më gjatë nga ç'e kishte parashikuar. Ai vetëm pyeti ankueshëm veten se përse nuk e sqaroi më gjatë Enveri. Jakup Cena nuk ishte i mësuar ende me detyra politike dhe aq më pak me përgjegjësi të ndërlikuara. Nuk ishte mësuar ende ta plotësonte të pathënën e eprorëve. Ai nuk kishte dashur të besonte dhe nuk mund ta besonte se Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, ai që kishte udhëhequr dhjetëra mijë partizanë në luftën fitimtare kundër fashizmit, nuk e kishte as vetë fort të qartë këtë rëndësi. Nga ana tjetër, mundësia e fundit që Jakup Cena do të pranonte ishte ajo e sekretit. Ai ishte tejet i bindur se Enver Hoxha nuk ia kishte fshehur një pjesë të së vërtetës. Ai nuk e shkoqiste dot se ç'kishte ndodhur në zyrën e madhe e të bukur midis tij dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë e Kryetar i Qeverisë.

Tek e përcillte në derë, Enver Hoxha, duke i dhënë fytyrës një hije të re serioziteti, jo dhe aq miqësore kësaj here, kishte përcaktuar:



-Duhet që gjithçka të marrë fund shpejt, kupton? Shumë shpejt. Siç po ecin ngjarjet, nuk kemi asnjë minutë për të humbur. Më kupton? Themelet e kështjellës sonë duhet t'i hedhim shpejt e të sigurta.

-Si urdhëron! - ishte përgjigjur ushtarakisht Jakup Cena, pa u menduar. Atij nuk i kishte pëlqyer ndryshimi i papritur i shokut Enver.

- Çfarë kupton ti me "shpejt"? - i ishte drejtuar Enveri me një ton edhe më të ftohtë.

Jakup Cena kishte mbledhur supet, i zënë ngushtë. Dhe kishte shtrënguar instinktivisht dhëmbët nga frika se do t'i shpëtonte ndonjë grumbull tingujsh pa kuptim, siç i ndodhte zakonisht në rrethana të tilla, kur nuk ishte plotësisht zot i vetes. Sekretari i Përgjithshëm i Partisë ishte bërë papritmas kërcënues. Dhe Jakup Cena e zuri për herë të parë veten në gabim. Ai nuk e kishte përligjur ashpërsimin e tjetrit. Nuk më takon mua ta gjykoj, tha me vete qortueshëm.

-Me një fjalë, shok i dashur, ti do të përfundosh para se të bjerë Berlina. Kjo është shpejtësia që na nevojitet. Vetëm kjo. Patjetër para se të bjerë Berlina, dhe ti do ta bësh, jam i bindur, - kishte vazhduar Enveri më fort i kënaqur me heshtjen e tjetrit. Në zërin e tij të plotë ishte davaritur kërcënimi.

-Si urdhëron! - kishte përsëritur mekanikisht Jakup Cena, duke marrë frymë i lehtësuar, si të ishte shmangur nga një rrezik i panjohur. Ai nuk ishte ende i aftë të mendonte për ato që i thuheshin. Shoku Enver ishte i bindur në aftësitë e tij, dhe kaq i mjaftonte. Por donte të dilte sa më parë nga ajo zyrë. Dhe përpiqej vetëm të mos harronte asgjë nga ç'dëgjonte. Do të kishte kohë t'i rendiste mirë e bukur në kokë të gjitha porosinë që po merrte.

Enver Hoxha e kishte mbajtur edhe një grimë herë në prag, duke i shpjeguar ultas, mbështetur lehtë te bërryli i tij me një afri të çuditshme miqësore, si t'i besonte një të fshehtë të madhe, se pagëzimi i ri i rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit hynte ndër përgatitjet e domosdoshme dhe urgjente të pushtetit të tyre për t'u njohur nga fuqitë e mëdha. Më kupton? kishte përsëritur disa herë kryetari i qeverisë. Ne nuk do të bëjmë daulle prej letre. Ne tani jemi shtet, nuk ka dyshim, por këtë duhet ta pranojnë sa më shpejt të tjerët, ata që na duan e ata që s'na duan. Shqipëria jonë, ashtu siç e duam ne, do të fillojë kështu të ketë marrëdhëniet e saj ndërkombëtare. Më kupton? Jakup Cena kishte vazhduar të miratonte mekanikisht, gjithnjë i paafte të gjente lidhjen midis rënies së afërme të Berlinit, njohjes nga aleatët të regjimit komunist shqiptar, që sapo

## *Daullja prej letre*

kishte dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare, dhe ndryshimit të emrave të rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit të tyre. Nuk shihte asnjë pikë të përbashkët. Megjithatë, në oborrin e ndërtesës së heshtur të Komitetit Qendror të Partisë ai tha me vete se detyra që po i ngarkohej ishte me siguri e rëndësishme së veçantë, përderisa e kishte thirrur vetë Enver Hoxha për t'ia komunikuar. Thuhej se ai vepronte kështu vetëm kur emëronte ministrat dhe gjeneralët. Ishte një përpjekje e kotë për ta përzënë dyshimin absurd se mos kryetari i shtetit po tallej me të. Ky dyshim iu shoqërua me një ndjenjë tjetër fajësie. Si guxonte të vinte në pyetje Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë? Rrëmuja e pakëndshme në kokë iu shtua nga krahasimi i përgjegjësive së vet të re me atë të ministrave dhe gjeneralëve. Është përgjegjësi ushtarake apo civile? pyeti ai veten dhe nëpër mend iu soll ajo puna e daulleve, që s'duhej të ishin prej letre. Pse daulle? Dhe si ishin daullet prej letre? Ç'kuptim kishte një paralajmërim i tillë? Kishte diçka të padukshme, që nuk shkonte.

2.

Pak më vonë, në vetminë e dhomës ku banonte qysh nga çlirimi i Tiranës, Jakup Cena e solli dhe e risolli shumë herë nëpër mend bisedën me Enver Hoxhën dhe nuk gjeti asnjë arsye që ta përligjte një tallje të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë me një komunist të thjeshtë e të devotshëm, siç ishte ai. Dhe të aftë për të kryer detyra të rëndësishme, siç ishte shprehur vetë Enveri. Ai u bind, sidoqoftë, se diçka e jashtëzakonshme kishte ndodhur në ndërgjegjen e tij përderisa arrinte ta mendonte mundësinë e talljes nga udhëheqësi i vendit, pa u tronditur si në fillim. Duhej të ishte me siguri diçka shumë serioze dhe fare e ndryshme, mendoi ai, kryesisht me dëshirën për t'u dhënë fund hamendjeve turbulluese. Por, ky përfundim nuk e ndihmoi dhe aq për ta nisur punën.

Arsyet për ta marrë me shpërfillje detyrën, iu shtuan në ditët që pasuan. Sidomos njëra e preku thellë në sedër. Jakup Cena mësoi nga një burim i sigurt se Enver Hoxha kishte kërkuar që kryetari i komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit të ishte "një shok besnik dhe trim, por jo shumë i ditur, më shumë entuziast sesa i zgjuar dhe pa rreth familjar".

Jakup Cenën nuk e shqetësonte dhe aq pyetja se përse nevojiteshin këto cilësi të kufizuara, thua se bëhej fjalë për një rojtar burgu, kur detyra ishte aq e rëndësishme. Ai, madje, nuk shkoi as deri te mendimi se detyra nuk ishte dhe aq e rëndësishme përderisa do ta

kryente një njeri aq i rëndomtë. Në fshatin e tij burra të tillë zgjidheshin për barinj, të aftë vetëm për të duruar trillet e motit e për t'u ndeshur me ujqërit. Jakup Cena ndihej i fyer thellë përse kishin vënë dorën pikërisht mbi atë si të përshtatshëm për kallëpin e ngushtë të caktuar. Dhe kush e kishte zgjedhur? Sigurisht që jo Enver Hoxha vetë. Ata nuk kishin patur rast të njiheshin gjatë luftës dhe as më pas. Jakup Cena nuk e kishte kurrsesi inatin me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë. Në fund të fundit ai vepronte në përputhje me nevojat e punës së vet. Dihet se udhëheqësit e politikës së madhe (Enver Hoxha kishte thënë së fundi se fitorja e luftës ishte më e lehtë se fitorja e politikës) përfitojnë edhe nga të mençurit, edhe nga budallenjtë. Jakup Cena nuk ngurronte t'i shërbente çështjes, për të cilën kishte vënë shumë herë në rrezik edhe jetën. Por jo si budalla. Ai u përpoq më kot të mësonte se kush e kishte damkosur si të tillë. Duhej të ishte me siguri ndonjëri nga të njohurit e tij. Ndonjëri që i ruante fshehurazi ndonjë mëri të vjetër. Ai sollti nëpër mend një nga një të gjithë shokët e tij, që kishin marrë tashmë poste të larta në ushtri apo në jetën civile. Asnjeri nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me kreun e shtetit dhe as me detyrën që i ishte ngarkuar Jakup Cenës. Dhe asnjeri nuk e kishte nëpërkëmbur kurrë për njeri të pagdhendur. Të paktën mesa dinte ai. Unë di shumë pak, mesa duket, u dorëzua Jakup Cena. Ky ishte fillimi i dyshimit të tij të tmerrshëm për veten. Për disa ditë me radhë Jakup Cena iu përvodh shokëve. Ai ishte i zënë me jetën e vet të shkuar. Donte me çdo kusht të bindej se nuk kishte dhënë prova të një zgjuarsie të mangët. Por u bind për të kundërtën, siç edhe u bind se ishte treguar gjithmonë besnik dhe trim. Zbuloi shumë raste kur kishte gabuar krejt si një budalla. Kush më paska njohur më mirë nga ç'e kisha njohur unë veten? pyeti Jakup Cena i mbushur me dëshpërim. Dhe përse nuk më kanë tërhequr kurrë vëmendjen ata që më hiqeshin si shokë të zemrës?!

Nuk i mbetej veç të fillonte punën që i kishin ngarkuar. Ishte hera e parë që ai do të kryente një detyrë pa gëzim. Po shkonte qysh në fillim kundër njëres nga cilësitë për të cilat ishte çmuar: entuziazmit. Ishte një ndryshim që vetëm ai vetë e ndiente dhe nuk e parashikonte dot se ç'ndikim do të kishte mbi rezultatin përfundimtar.

Të drejtën për ta ndërtuar komisionin që do të caktonte emrat e rinj, rrugët dhe sheshet e kryeqytetit, ia kishin lënë atij, dhe kjo ishte shenjë e mirë. Ishte një kompetencë e kënaqshme dhe që e forconte pushtetin e tij

## *Daullja prej letre*

të kryetarit. Me një shtysë të fshehtë hakmarrjeje pa adresë Jakup Cena zgjodhi ndër të njohurit e vet ata më pak të zgjuarit, më pak të diturit, familjarisht më të vetmuarit, por edhe më besnikët, më trimat e më verbërisht entuziastët. Ishin ndër të njohurit e tij që i donte sinqerisht dhe nuk synonte aspak t'i poshtëronte. Ai vazhdoi të mos e dinte se kundër kujt drejtohej hakmarrja e tij e fshehtë. Dinte vetëm se besnikëria dhe trimëria ishin dy cilësitë që përçmonte më tepër tashmë te një burrë. Dhe nënqeshte me vete me një kënaqësi të ligë tek dëgjonte në radio fjalimet e dendura të Enver Hoxhës, në të cilat besnikëria dhe trimëria shpallehin si virtytet më të lavdërueshme të popullit shqiptar. Jakup Cenës iu duk se kishte kuptuar diçka thelbësore nga fryma e historisë që po niste, të cilën, fatkeqësisht, nuk mund t'ia pohonte askujt: Kryetari i ri i Qeverisë pëlqente një popull të budallepsur. Turmat e trimave besnikë e duartrokisnin dhe e brohorisnin udhëheqësin me zjarr dhe Jakup Cena plotësonte me mend: një popull i budallepsur, por besnik dhe entuziast. Ai do të kishte dashur ta nxirrte nga vetja zbulimin, si një mënyrë për të dëshmuar se ai vetë ishte ndryshe, ishte më shumë i mençur sesa trim. Dhe sidomos nuk ishte verbërisht trim. Dhe as verbërisht entuziast. Nuk guxonte. Dhe kjo mungesë guximi i pëlqente, sikur e ngushëllonte disi: ai nuk ishte aq entuziast dhe trim sa ç'e kujtonin. Domethënë ishte edhe më pak i metë nga ç'e kujtonin dhe ata që e kishin zgjedhur gaboheshin, nuk e njihnin.

3.

Punën e mendonte të thjeshtë. Mori hartën e kryeqytetit, një hartë ushtarake, më e sakta, e përpiluar nga gjermanët gjatë pushtimit, mori edhe listën e dëshmorëve të zgjedhur nga Komiteti Qendror i Partisë për t'u nderuar veçanërisht dhe, i ndihmuar nga bashkëpunëtorët e tij besnikë e entuziastë, shpërndau brenda një nate emrat e rinj, që do të zëvendësonin të vjetrit mbi shenjat e rrugëve e të shesheve. Mund të thuhet se ishte një punë e këndshme. Jakup Cena dhe shokët e tij argëtoheshin si fëmijë duke sajuar grindje plot humor midis të vdekurve, që i rrëmbenin njëri-tjetrit postet e përjetësisë. Fitonin të rënë e fundit, natyrisht. Vetëm ata mbanin tashmë yllin e ndritshëm të dëshmorit. Nëse do të kishin mbijetuar, a do të renditeshin edhe ata ndër mendjengushtët trima e besnikë? pyeti Jakup Cena disa herë veten. Ishte një nga netët e para të pranverës, me një qiell të kthjellët e të lartë, plot me dritë hëne si re pluhuri lulemimozash. Pranvera e parë e lirisë, siç thuhej në shtyp

e në fjalimet e udhëheqësve, po hyn te bukur. Me siguri do të ishte thënë se edhe natyra gëzohej për jetën e re që po fillonte, sikur të mos ishte një dallgë e mallkuar karkalecësh, që dendësohej dita-ditës nëpër fushat e jugut e të bregdetit dhe rrezikonte t'i brente të mbjellat, që kishin nisur të mbinin. Jakup Cena donte tashmë ta përfundonte sa më shpejt detyrën, ta hiqte qafe, siç shfrynte ai me vete, edhe pse nuk e dinte me çfarë do të merrej në të ardhmen. Ta hiqte qafe, por pa bërë një daulle prej letre, u kujtua ai për porosinë e pakuptueshme të Enver Hoxhës. Në të vërtetë, ai vetëm tani po fillonte të mendonte se nuk kishte asnjë plan për të ardhmen e vet. Ndoshta do të regjistrohesh në një shkollë ushtarake, pse jo, ku nuk e pengonte mosha e shtyrë. Sapo i kishte kapërcyer të tridhjetat. Më parë do të kishte besuar se ishin meritat si partizan, që do t'ia çelnin dyert e kësaj shkolle. Tani e dinte se nevojiteshin të tjera kushte, të cilat, për fatin e mirë ose të keq, i plotësonte: ishte trim dhe besnik, por jo shumë i zgjuar.

Shokët që zgjodhi për në komisionin e rëndësishëm, i kishin këto cilësi edhe më të spikatura se ai. Ata nuk i bënë asnjë pyetje, nuk i dhanë asnjë këshillë. Nuk shfaqën, madje, as kureshtje. Vetëm ndiqnin me laps të mprehur urdhrat e tij, për të shkruar emrat e rinj mbi ata të vjetrit. Jakup Cena i shihte me njëfarë zilie. Do të kishte dashur shumë të kuptonte nëse në kokat e tyre kishte diçka tjetër veç heshtjes dhe entuziazmit. Edhe kjo dëshirë nxitej nga zilia. Pamja e tyre e qetë nuk linte shkas për hamendje. Me siguri që ata do të bënin më përpara se ai.

Në mëngjes gjithçka ishte gati. Para se ta dorëzonin dosjen për miratim, Jakup Cena i ftoi të gjithë shokët e komisionit për një kafe në Bar Sahati. Dhe i përgëzoi me një ton pompoz, ku përzihej përçmimi me mirënjohjen, i bindur se nuk do të takoheshin më për një punë të tillë të çuditshme, që nuk kishte asnjë lidhje me hallet e përditshme të njerëzve e të qeverisë. Kujt i prishnin punë emrat e vjetër të rrugëve? pyeti veten për të fundit herë Jakup Cena. Dhe sidomos aleatët, ç'hynin aty? Po rënia e Berlinit? Ai ishte kujdesur ta fshihte para anëtarëve të komisionit moskuptimin dhe mosvlerësimin për detyrën që u ishte ngarkuar, ashtu si edhe nënvlefësimin, nga frika se kjo do të shkonte në veshin e Enver Hoxhës. Me siguri që do të shkonte. Pasi kishte zbuluar njohjen e thellë që kishte Sekretari i Përgjithshëm i Partisë për atë vetë, Jakup Cena mund të besonte gjithçka. Në të vetmin rast kur i kishte shpëtuar një ironi, ishte gjatë kafesë së përgëzimit në Bar Sahati :

## *Daullja prej letre*

- Siç e shihni, ka edhe punë shumë të rëndësishme që kryhen lehtë, - u ishte drejtuar Jakup Cena bashkëpunëtorëve. Do të kishte dashur t'u thoshte se ka edhe punë shumë të rëndësishme, që u besohen njerëzve jo shumë të zgjuar e të ditur. Domethënë njerëzve të sojit tonë, do të shtonte me një buzëqeshje tallëse. Nuk mund të shkonte aq larg. Ishte nervoz dhe pa atë ndjenjën e lehtësimi që priste nga përfundimi i detyrës. Por nuk e dinte shkakun e bezdisjes që i gumëzhinte gjithandej nëpër rrënjët e flokëve, thua se dallga brejtëse e karkalecave, që kishte vërshuar drejt fushave, kishte prekur edhe lëkurën e kokës së tij. Sidoqoftë, detyrën e quante të kryer dhe nuk kishte bërë një daulle prej letre.

Ishte gabuar. Vetëm pak orë pas dorëzimit të dosjes, e thirrën me urgjencë në komitetin e partisë të Tiranës, ku vetë sekretari i parë, në prani të një vajze që mbante procesverbalin, e qortoi rëndë për cektësi politike në gjykimin e historisë. Jakup Cena e njihte drejtuesin e Partisë për kryeqytetin qysh nga fillimi i luftës, kishin kaluar bashkë edhe çaste të rrezikshme për jetën dhe nuk u besoi syve. Nuk e kishte parë kurrë aq të ashpërsuar. Por as ai nuk ishte më i qartë në vërejtjet e veta. Dinte vetëm të përsëriste, me një zë të ftohtë e të largët, se një cektësi e tillë politike në gjykimin e historisë ishte e palejueshme për një komunist. Toni i tij i pazakontë ia preu hovin Jakup Cenës për t'i kërkuar ndonjë shpjegim më të hollësishëm, më të kuptueshëm. Ai nuk kishte dëgjuar kurrë për gjykimin politik të historisë, nuk e përcaktonte dot ç'ishte, dhe aq më pak arrinte ta merrte me mend përse ishte fjala në rastin e tij.

- Më fal! - tha Jakup Cena, që nuk kishte çelur ende gojë dhe deshi të tërhiqej në çastin kur iu duk se sekretari i parë kishte përfunduar. Ai mendoi me kënaqësi se po mësonte me shpejtësi sjelljen nëpër zyra.

- C'të të fal?! - ndërroi ton tjetri. I ra pak zemërimi, por nuk u bë më miqësor. - Ku do të shkosh?! Merr dosjen dhe fillo nga e para! U morëm vesh?! Ti e di që nuk ke kohë për të humbur. Edhe vetë shoku Enver ta ka thënë. Nuk ke asnjë minutë për të humbur. Dhe përqendrohu mirë, mos na bëj daulle prej letre!

Jakup Cena vuri re për herë të parë mbi tryezën e sekretarit të parë dosjen me punën e tij. Dhe u befasua. Pra, ja ku fshihej gabimi i tij! Ai nuk u çudit. E kishte kryer me aq shpërfillje detyrën, sa duhej pritur gjithçka. Ai e pranoi vërejtjen heshturazi, me një ndjenjë të re respekti për shokët eprorë, që dinin ta tëharrnin aq mirë punën e keqe të të tjerëve. Por vazhdonte të mos e

kuptonte se ç'ishte cektësia politike në gjykimin e historisë, ç'ishte daullja prej letre, gjë që nuk e siguronte për ndreqjen e gabimit. Sidoqoftë, i pëlqeu që drejtuesi kryesor i partisë për kryeqytetin dhe anëtar i Byrosë Politike, po i drejtohej me një gjuhë të tillë të ndërlikuar. Pati dëshirën të besonte se ai nuk e merrte për njeri me zgjuarsin të kufizuar. Për pasojë, edhe Jakup Cena duhej të hiqej sikur midis tyre nuk kishte asgjë të mjegullt. Ndoshta duhej thënë diçka për ta mbështetur këtë sjellje. Nuk dinte çfarë dhe e përfshiu sekretarin e parë me një vështrim që nuk e deshi aq të çuditur. U përpoq të hetonte nëse në sytë e tjetrit kishte respekt apo zemërim.

Sytë e sekretarit të parë ishin të papërshkueshëm. Si sytë e një njeriu të fortë që ka frikë, tha Jakup Cena me vete. Atij iu bë se kapi fillin e enigmës: sekretarin e parë e kishte qortuar dikush dhe rëndë për punën e keqe të komisionit për emërtimin e ri të rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit. Me siguri vetë Enver Hoxha. Vetëm ai mund të shkaktonte një frikë të tillë përreth. Ja pse kishte ndryshuar sekretari i parë. Për të Jakup Cena nuk ishte më shoku besnik i kohëve të vështira të klandestinitetit, por njeriu që po i rrezikonte karrierën me ato daullet e çuditshme prej letre. Jakup Cena u përpoq të përfytyronte se çfarë ziente në shpirtin e tjetrit. Pa dyshim që shumë urrejtje. Ky soj të rrezikuarish janë shumë të pamëshirshëm, tha ai me vete fort i tronditur. Jakup Cena u hutua dhe e humbi guximin për të kundërshtuar, siç e kishte kaluar nëpër mend pak më parë. Shqiptoi edhe njëherë ndjesën, premtoi se gabimi nuk do të përsëritej, ai nuk do të bënte më daulle prej letre, dhe u largua kokulur. Nuk mendonte asgjë dhe nuk kishte asnjë parandjenjë. Dëshironte vetëm të gjente sa më parë një bar, që të kthente një gotë. Pati aq kthjelltësi sa të gjykonte se bari duhej të ishte larg selisë së komitetit të partisë.

4.

Jakup Cena nuk kishte më dyshim për rëndësinë e veçantë të detyrës që i kishin ngarkuar. Derisa ngjarja rrezikonte të shpërbënte edhe një njeri aq të fuqishëm dhe me merita të mëdha si sekretarin e parë të partisë për Tiranën, ajo fshihte një mister të parrokshëm nga mendja e tij pa përvojë në punët e thella të shtetit, një mister të mishëruar në shprehjen e pazbërthyeshme "daullet prej letre". Iu kujtua sërish mençuria e vet ashtu siç e shihnin të tjerët. E kufizuar. Me siguri ndaj më kanë zgjedhur të tillë, tha pa ndonjë brengë të madhe kësaj here. Sidoqoftë, Jakup Cena ishte i qartë për kryesoren: nuk kishte kohë

për të humbur. As edhe një minutë. Vetë Enver Hoxha ia kishte theksuar, duke i caktuar edhe afatin: rënia e Berlinit. Ai kështu kujtuar se për të lufta kishte mbaruar me përzënien e gjermanëve nga territori i Shqipërisë. Ai nuk e donte luftën dhe nuk e përfytyronte dot se si ajo mund ta ndërlikonte jetën e tij prej kaq larg.

Tashmë zuri t'i ndiqte lajmet në radio e në gazeta me një ankth që rritej, sa më shumë kalonin ditët. Por ai dëgjonte dhe lexonte vetëm ç'thuhej në shqip, ku doemos, e vërteta paraqitej e cunguar. Për herë të parë i pati zili intelektualët, që dinin gjuhë të huaja. Ata kishin një vesh më tepër. Dhe jo një vesh të zakonshëm. Mund të njihnin shumë të vërteta për të njëjtën ngjarje. Më saktë, mund të mblidhnin shumë copëza të një të vërtete. Aha! tha Jakup Cena. Ndaj edhe kishte nisur pastrimi i intelektualëve, mbyllja e tyre nëpër burgje pak javë pas hyrjes së qeverisë në Tiranën e çliruar. Duhej shurdhuar sa më shpejt ky vesh i tepërt. Ai mbeti një kohë në mëdyshje, në ishte në të mirën apo në të keqen e tij mungesa e gjuhës së huaj. Për një gjë ishte i sigurt: si gjermanishtfolës apo anglishtfolës nuk do t'ia kishin besuar kurrë një detyrë të tillë delikate. Ky arsytim pati dobinë e vet. Jakup Cena e përmbajti yshtjen për t'i kërkuar ndihmë ndonjërit nga ata njohësit fytyrëzbehtë të gjuhëve të huaja, që me siguri i kalonin mbrëmjet me veshin të ngjitur pas radiove, si burimi i fundit për t'ua ushqyer shpresën. Çfarë shpresojnë ata? u hodh Jakup Cena kërcënueshëm. Brenda tij ishte zgjuar rrëmbimthi ndërgjegjja e komunistit, që nuk mund t'ia lejonte të kishte të njëjtën shpresë me ata që tregoheshin me gisht tashmë si armiq të pushtetit popullor.

Ai filloi t'i merrte pak nga pak inat edhe shokët e tij të afërt, që ngazëlleshin për afrimin e fundit të Fyhrerit, njësoj si të ngazëlleshin për fundin e atij vetë, Jakup Cenës. Ishte një inat absurd dhe ai e kuptonte që ishte absurd, por nuk e mbyste dot, dhe duhej ta mbyllte mirë përbrenda, dhe kjo përbënte një torturë më vete. Iu krijua një lidhje e fshehtë, gjithesci afektive, me njeriun që kishte urreyer më shumë, gjë që e mbushi shpejt me një ndjenjë të pafund faji dhe përçmimi për veten. Ai u bë nervoz dhe u mbyll dita -ditës në vetvete. Jakup Cena, që kishte fjetur gjithë jetën si një qengj dhe kishte parë vetëm ëndrra të bukura dhe heroike, humbi gjumin. Në çastet e rralla e të shkurtra, kur kotej, i shfaqej vetja para një derc të madhe të hekurt, ku besonte se do të takonte Hitlerin. Por nuk i mjaftonte kurrë koha për të trokitur dhe për të pritur njeriun që do t'ia hapte e do ta shoqëronte në



kthinën ku do të bisedonte kokë më kokë me Fyhrerin për fatin e luftës e që ishte në të vërtetë fati i vetë atij tashmë, Jakup Cenës. Nuk e dinte ç'priste nga ajo bisedë. Druante se Hitleri do t'i kërkonte ta zvarriste përfundimin e punës për emërtimin e ri të rrugëve dhe shesheve të Tiranës, të bënte daulle prej letre, si një mënyrë për t'ia zgjatur pak jetën Berlinit. Zgjohej trembshëm dhe shante veten si tradhtar. Sytë i rrinin vazhdimisht të skuqur, edhe pse hoqi dorë prerazi nga konjaku, nga frika se mund t'i shpëtonte ndonjë fjalë e pamatur.

Ashtu si ditën e parë, ai nuk arrinte e nuk arrinte dot të zbulonte lidhjen midis fitores përfundimtare të aleatëve mbi nazizmin, njohjes ndërkombëtare të regjimit për të cilin ai kishte luftuar pa kursim dhe detyrës që i ishte ngarkuar për t'u vënë emrat e rinj rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit. Aq më tepër i ngatërroheshin mendimet nga përcaktimi i pashpallur, që i kishte bërë vetë Enver Hoxha njeriut që nevojitej si strumbullar i kësaj loje të madhe, djallëzore, që i kapërcente përfytyrimet e tij të thjeshta. Jakup Cena e dinte se besnikëria dhe trimëria nevojiteshin kudo. Pse jo shumë i zgjuar, xhanëm? Pyetja bëhej edhe më torturuese ngaqë nuk ia drejtonte askujt.

Ndërsa për gjykimin politik të historisë arriti të sqarohet disi nëpërmjet bisedash me disa nga shokët që kishin kryer shkollë më shumë se ai. Në mënyrë të pavullnetshme ai dyshonte tashmë në zgjuarsinë e vet dhe, për të mos e pranuar, për të mbrojtur sedrën, njohuritë e të tjerëve i lidhte vetëm me shkollimin e tyre. Unë thjesht nuk ka patur fatin e tyre, thoshte ankueshëm, pa u ngushëlluar. Pastaj e shkarkoi fajin mbi prindërit. Ata nuk kishin ditur ta nxinin të mësonte, ta donte shkollën, nuk e kishin kuptuar se djali i tyre i vetëm do të kishte nevojë për një karakter të guximshëm e besnik, por edhe për mendjen e ndriçuar. Gabimi politik i Jakup Cenës në gjykimin e historisë qëndronte në zëvendësimin në tërësi, pa bërë asnjë dallim, të emrave të rrugëve e shesheve të kryeqytetit. Jakup Cena nuk ishte bindur dhe aq në drejtësinë e shpjegimit, por kishte miratuar. I kishin thënë se komunistët nuk e fushnin në një thes gjithë të kaluarën shumëshekullore të kombit e ta hidhnin në lumin e harresës. Për shembull, Ismail Qemali, njeriu që kishte shpallur pavarësinë e atdheut nga pushtuesit otomanë dhe Nëna Mbretëreshë, gruaja që kishte bërë kokën e një mbreti të përzënë nga fronti, nuk mund të ishin njësoj. Ata vetëm do ta rishkruajnë historinë, duke marrë gjithë ç'ishte e lavdishme, domethënë përparimtare, që i kishte shërbyer

## *Daullja prej letre*

popullit, dhe duke fshirë njëherë e përgjithmonë gjurmët reaksionare që kishin lënë klasat e pasura dhe kleri. Koha e tyre ishte mbyllur. Duhej mbyllur edhe jehona e tyre. Do të krijoheshin kështu kujtesa e re e kombit, ajo që do të ushqente brezat e ardhshëm. Emrat e rrugëve dhe shesheve të Tiranës do të shënonin hartën e kësaj historie, që do të ishte edhe historia e vërtetë e shqiptarëve. I përmbytur nga dyshimi mbi zgjuarsinë e vet të kufizuar, Jakup Cena nuk kishte guxuar të pyeste se si do ta bënte ai vetë dallimin midis pjesës së shëndoshë dhe pjesës së molepsur të së kaluarës stërgjyshore të atdheut.

5.

Jakup Cenës iu krijua bindja se do të çmendej pa vonesë. Truri i tij nuk ishte mësuar të gumëzhinte parreshtur nga mendimet. Pak nga pak ai u vu me dëshirë në pritje të çastit kur do të ndjente t'i kalonte nëpër kokë diçka e ngjashme me një turrjelë të zjarrtë, që do t'ia bënte trurin rrëmujë. Dhe shpresonte që ky çast të arrinte para rënies së Berlinit. Ndryshe më mirë të mos ndodhte. Nuk do t'i hynte në punë. Kjo do të ishte mënyra e vetme që shpëtimin e vet nga procesi që do t'i bënin të tjerët, dhe nga përçmimi që do t'i jepte vetes, ai të mos e kërkonte te jetëgjatësia e Hitlerit. Ai e dëshironte, si edhe më parë, fundin e nazizmit. Por me kusht që ky të mos ishte edhe fundi i tij. I çmendur, ai do të ishte më në fund i lirë të shprehej, të zbrazte gjithë atë mizëri hamendjesh, që ia gërryenin nervat natë e ditë. Dhe të qetësohej njëherë e mirë. Të kthehej në jetën e vet prej njeriu pa kokëçarje të mëdha, domethënë pa nevojën e një zgjuarsie të madhe, e ku besnikëria e trimëria ishin virtyte të vërteta.

Jakup Cena e dinte ç'do të thoshte duke rendur rrugëve me një daulle prej letre të varur në qafë si i ndjekur nga hija e padukshme e djallit. Bum-bum-bum, do të gjëmonte daullja dhe vetëm ai do ta dëgjonte tek tregonte historinë e atyre që kishin bërë lavdinë e Shqipërisë: ishin pothuajse të gjithë bejlerë e pashallarë, priftërinj e hoxhallarë. Pastaj do t'i pyeste njerëzit, kalimtarët e rastësishëm, kushdo qoftë, nëse është e mundur që një be apo një pasha, një prift apo një hoxhë t'i ketë shërbyer popullit, të ketë ndihmuar në shpëtimin e Shqipërisë. Me siguri që më të shumtët do të donin t'i shmangeshin. Jo thjesht se pyetjen do t'ua drejtonte një i çmendur. Njerëzit po bëheshin shumë të mençur. E kishin kuptuar se heshtja është shpesh më e dobishme se fjala. Por Jakup Cena do t'i detyronte të shpreheshin. Dhe do të merrte dy lloj përgjigjesh. Krejt të kundërta, e dinte. Një

54897

palë e të pyeturve, më e madhja, do t'i thoshin se bejlerët e pashallarët, priftërinjtë e hoxhallarët vetëm e kishin shfrytëzuar popullin në jetë të jetëve, ia kishin pirë gjakun, ia kishin mbushur kokën me terrin e padijes dhe interesat e atdheut ua kishin shitur për pesë para të huajve. Këta pak muaj të jetës së qeverisë komuniste kishin mjaftuar që njerëzit të mësonin rregullin: për ta nuk kishte gjuhë tjetër veç asaj të radios e të gazetave. Me një fjalë, gjuha e fjalimeve të udhëheqësve. Jakup Cena vuri re i çuditur se para luftës nuk u hidhte kurrë ndonjë sy gazetave dhe as nuk i dëgjonte fjalimet e udhëheqësve. Nuk ia vlente, tha me vete. Ato ishin fletushkat e mbretit. Qëllimi i tyre ishte të gënjenin, të mashtrojnë popullin, ta mbanin nën zgjedhë si kaun e punës. Ky arsytim nuk ia fshiu dot çuditjen: të paktën, kureshtje si nuk kam patur?! A e përvetësonin edhe atëherë njerëzit gjuhën e gazetave? Pala tjetër e të pyeturve, doemos më të rrallët, por edhe më të çuditshmit, do t'i thoshin se kishte patur edhe bejlerë e pashallarë, priftërinj e hoxhallarë të ndershëm e patriotë. Si masë mbrojtëse, ndoshta, ndonjëri do të shtonte se të tillë nuk kishte patur shumë ndër klasat e pasura dhe klerikët. Por kishte patur. Bum-bum-bum, do të gjëmonte daullja prej letre për ata që kishin veshë ta dëgjonin.

Jakup Cena, i duruar, do t'i ndiqte të gjithë me të njëjtën nënqeshje ironike. Ai do të tregohej për herë të parë në jetën e vet i lig. Nami i tij tashmë do të ishte: shumë trim, shumë besnik dhe shumë i lig. E kishte të gatshme ndërhyrjen-kurth, që do t'i hutonte dhe do t'i mbushte me frikë bashkëbiseduesit. Me siguri do t'u prishej gjumi. Të parë ve, atyre që i shihnin si reaksionarë të gjithë bejlerët e pashallarët, priftërinjtë e hoxhallarët, do t'u përmendte Heroin tonë Kombëtar, Skënderbeun, dhe Ismail Qemalin, që shpalli pavarësinë nga pushtimi turk. A nuk kishin qenë ata bejlerë? Me pasuri të madhe e tituj fisnikërie, dhënë nga sulltanë otomanë. Pra, sipas tyre, tani që kishin pushtetin popullor, emra të tillë nuk do të na frymëzonin më dashuri për atdheun? Ku shkonin ata me një gjykim të tillë politik të historisë? Duhej ta varrosnim kujtimin e tyre? Dhe vetë shoku Enver, siç e tregonte edhe mbiemri i tij, a nuk rridhte nga një familje hoxhallarësh? A do të bëhej dot ai udhëheqësi ynë i lavdishëm në qoftë se prindërit do ta kishin edukuar me ndjenja reaksionare? Ha-ha-ha! qeshte me vete, paraprakisht i kënaqur, Jakup Cena. Të dytëve, atyre që shihnin edhe dritën në të kaluarën e klasës së të pasurve dhe të klerit, ai do t'u përplaste shembullin e mbretit, bir pashai e vetë bë, dhe të hoxhallarëve spiunë të Stambollit dhe të kishës katolike,

## *Daullja prej letre*

që kishte bekuar pushtimin e Shqipërisë nga fashistët italianë, dhe të kishës ortodokse, që u kishte shërbyer gjithë jetën si urë grekëve, këtyre fqinjëve grabitqarë. Jakup Cena priste me një lumturi djallëzore çastin kur, me daullen e vet prej letre, do të mund ta çrregullonte gjithë jetën e kryeqytetit, duke mbjellur në kokat e banorëve të të tij vetëdijen e fajit në gjykimin politik të historisë. Ai nuk e kishte më fort të qartë nëse kjo lojë do ta argëtonte apo do t'i shërbente për të shfryrë një duf të verbër, që nuk drejtohej kundër askujt dhe njëkohësisht kundër të gjithëve.

Jakup Cena nuk e dinte se si ishte çmenduria, çfarë shenjash paraprijëse kishte. Ai vetëm priste çastin kur do të ndjente t'ia përshkonte tëmthat diçka e ngjashme me një turrjelë të skuqur, që do t'ia bënte trurin rrëmuje, aq sa të çlirohej nga frika dhe të rendte lirisht rrugëve dhe shesheve të qytetit pa u merakosur nëse ato mbanin emrat e vjetër a të rinj, dhe pa ankthin e gjendjes së luftimeve rreth Berlinit. Eprorët e tij e deri vetë Enver Hoxha do të mësonin pa vonesë se Jakup Cena ishte çmendur. Por nuk do të kishin arsye të çuditëshin. Një njeri me një zgjuarsiri të kufizuar nuk kishte mushkëri për t'u zhytur aq thellë në historinë e turbullt të popullit të tij me detyrën e rëndësishme dhe delikate: të fikte qirinjtë e rrallë që digjeshin zbehtë kushedi prej sa kohësh, pa u rroposur nga furtunat e shekujve dhe të ndizte të tjerë mbi varre të rrafshuar, ku nuk ishte ndalur kurrë njeri për të vënë një tufë lule, ose edhe më keq, të ndizte qirinj pavdekësie nëpër brinja malesh e në lugina të rrjepura nga era, ku nuk kishte patur kurrë varre. Edhe pse jo fort i zgjuar, ai e kishte kuptuar se e kaluara do të ndryshonte krejt duke iu nënshtruar gjykimit të ri, atij të pakuptueshmit, politikut. Do të ishte një zhvarrosje hijesh edhe më e frikshme se hedhja në erë me dinamit e varrit të Nënës Mbretëreshë, që ishte kryer para disa javësh. Populli do të ngjante me një pemë të madhe, të cilës i ndërrojnë dheun ku ka hedhur me kohë rrënjët. Jakup Cenën e mbërthven të dridhurat. Shokët e detyruan të shkonte në spital dhe mjeku i tha se ishin ethe nga lodhja dhe gjumi i pamjaftueshëm. Ai i kërkoi të pushonte. Të qëndronte një periudhë larg punës. Më e mira do të ishte të shkonte në fshat, te prindërit. Jakup Cenës i kishte ndodhur të flinte keq e të lodhej edhe më parë dhe nuk e kishin zënë ethet. Ai nuk i besoi mjekut dhe nuk i ndoqi këshillat e tij. Ai e dinte shkakun: ishin frymët e të vdekurve të moçëm që hakmerreshin. Ata nuk mund të pranonin ta dorëzonin aq lehtë lavdinë, për të cilën kishin paguar shtrenjt.

6.

Çmenduria, që ishte i vetmi shpëtim për Jakup Cenën, po vononte. Ndërkohë, luftimet zhvilloheshin të furishme në rrethinat e Berlinit dhe Jakup Cenën e kishin thirrur dy herë në Komitetin Qendror të Partisë të raportonte mbi ecurinë e punës së komisionit që ai drejtonte. Dhe natyrisht, e kishin kritikuar rëndë për ngadalësi, ama duke shorehur gjithnjë besimin në aftësitë e tij për t'ia dalë mbanë. Nuk ia kishin kujtuar më cektësinë në gjykimin politik të historisë. Partia kishte besim të plotë. Dikur Jakup Cena do të ishte përkëdhelur thellë në sedër të dëgjonte nga shokët e Komitetit Qendror lavde të tilla për veten. Por tashmë arsyetonte ndryshe. Si zakonisht, pa i shpjeguar konkretisht se ku qëndronte kjo rëndësi. Zaten, as ai nuk ndiente më nevojë për këtë shpjegim. Nuk kishte, madje, as kureshtje.

Jakup Cenës nuk i shqitej përhitja e pemës që po shkulej për t'u mbjellë në një tokë tjetër. Ai nuk e kuptonte se nga i kishte mbirë në tru një përngjasim kaq i tmerrshëm. Pemës do të fillonin t'i thaheshin gjymtyrët më të rëndësishme, ato të padukshmet, rrënjët. Pastaj tharja do të shfaqej në majat e degëve, krejt si bimët e brejtura gjatë kësaj pranvere nga lukunia e karkalecëve, dhe njerëzit do të zinin t'i krasisin, me një shpresë të verbër t'i shpëtonin, pa i dalluar ku ishte gandi. Do të vinte një ditë që të mbetej vetëm trugu, gungaç, i paaftë për të nxjerrë lule, as gjethe, njësoj si në verë edhe në dimër. Jakup Cena vetëm e mbante në vete këtë përhitje si një ëndërr të ankthshme, fare i pavetëdijshëm për domethënien e saj. Por ai kuptonte se gjatë këtyre javëve truri i tij kishte ndryshuar shumë. Kishte ndryshuar krejt. Në kokën e tij nuk kishte më qetësi, gjë që e vuri re edhe Nela B., një shoqja e tij e luftës me të cilën takohej nganjëherë mbrëmjeve. Edhe ajo bënte një jetë të vetmuar si ai. Beqare dhe me prindërit larg, në një fshat të veriut. Nela punonte tashmë në Postë-Telegrafën qendrore, por ai nuk e dinte me çfarë merrej. Ai u kujtua se ajo nuk i kishte folur kurrë dhe as ai nuk e kishte pyetur për punën që bënte. Vitet e klandestinitetit i kishin lënë zakonin të mos pyeste për gjëra që nuk i përkisnin. Por këtë zakon nuk e kishte Nela B. Pas vërejtjes për ndryshimin, ajo iu drejtua:

-Është sekret detyra jote?

Jakup Cena u zu në befasi. Nuk e dinte. Nuk i kishin thënë se detyra e tij ishte sekret. Por nuk i kishin thënë as të kundërtën. Enver Hoxha e kishte porositur vetëm të mos bënte daille prej letre. Qetësia, me të cilën kishte ardhur në takimin me Nelën, iu turbullua. Ai u bë

## *Daullja prej letre*

nervoz.

-Ç'të duhet ty?-iu përgjigj.

Ajo qeshi lehtë, me një nënkuptim miqësor dhe nuk foli më. Jakup Cena e hetoi me bisht të syrit. Fytyra e saj nuk shprehte ndonjë dinakëri. Ai pyeti veten nëse mund të kishte besim te Nela. I nevojitej dikush që ta dëgjonte. Vetëm ta dëgjonte. Pa e gjykuar dhe pa e këshilluar. Ankthi kishte arritur në një pikë, që ai nuk e mbante dot më.

-Nela!-u hodh ai papritur, duke e shtrënguar fort në bërryl,-unë do të çmendem. Ai nuk e kuptoi përse zgjodhi pikërisht këtë lajm të pashembullt për ta tërhequr vajzën në vorbullën e vet.

-E di, -iu përgjigj ajo qetësisht, me sytë përdhe.

Jakup Cena u drodh. Nela dukej fare serioze. Ai nuk pati guxim ta pyeste se nga e dinte. Por iu fashit dëshira ta mbyllte mbrëmjen me të. Vetëm, në dhomën e tij të vogël e të ftohtë, rrëmuja në kokë iu shtua. Atij nuk i kujtohej t'i kishte folur ndokujt për shpëtimin me ndihmën e çmendurisë. Me çfarë merrej Nela në Postë-Telegrafë?

Si për t'ia shumëfishuar vuajtjen Jakup Cenës, ndërkohë ishte përhapur gjithandej fjala për ndërrimin e emrave të rrugëve dhe të shesheve të Tiranës. Dihej edhe se kjo punë do të vazhdohej pa vonesë në qytetet e në fshatrat e tjera anembanë vendit. Por kryesor mbetej kryeqyteti. Nuk do t'i lihej asnjë fole të kaluarës. Me siguri do të ngrihej një komision kombëtar, dhe kryetar i tij do të ishte Jakup Cena. Ishte një hamendje e pranueshme. Në qoftë se do t'ia dilte mbanë me përgjegjësinë e parë, natyrisht. Ai nuk e dinte nëse do t'i pëlqente të zgjidhej për vazhdimin. Nuk donte as të mendonte.

Jakup Cena nuk do ta kishte marrë kurrë me mend se një masë e tillë e pushtetit do të shkaktonte aq shumë trazirë në popull. Për shumë veta u harrua edhe reforma agrare, që sapo kishte filluar. U harruan shtetëzimet dhe konfiskimet. U harrua edhe paniku për dëmet që mund të shkaktonte reja e karkalecave. Jakup Cena nuk e kuptonte arsyen e një interesimi kaq të madh. Përditë para zyrës së tij nga mëngjesi në mbrëmje rrinte një varg i gjatë me njerëz ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë. Ishin të afërm dëshmorësh dhe ai duhej t'i priste një nga një e t'i dëgjonte pa e humbur durimin. Jakup Cena nuk kishte më kohë të lirë, gjë që për një periudhë e gëzoi. Truri i tij zihej dhe rraskapitej, aq sa të mos u mbetej vend përhitjeve të mbrapshta, që e prisnin në dhomë. Të gjithë vizitorët kërkonin të njëjtën gjë: një rrugë apo një shesh për të afërmin e vet, që kishte dhënë gjënë e tij më të shtrenjtë

për këtë pushtet, jetën. Pak nga pak Jakup Cena u bë i vetëdijshëm se në gjuhën e njerëzve po ndodhte një ndryshim thelbësor: gjithnjë e më rrallë dëgjonte të flitej për sakrificën e dëshmorëve në emër të çlirimit të atdheut. Sipas nënave, motrave, vëllezërve e kushërinjve të tyre, ata kishin dhënë jetën për fitoren e Partisë Komuniste, që kishte ardhur në fuqi. Jakup Cena e dinte se në luftë kishte patur shumë pak anëtarë të partisë dhe nuk ishte në gjendje t'i jepte ndonjë shpjegim këtij ndryshimi. Madje as nuk mendonte se kjo kishte ndonjë shpjegim. Ai vetëm vinte re. Dhe ndiente një keqardhje të çuditshme. Kishte një dyshim të verbër, që nuk e lejonte të gëzohej për rrënjët që po hidhte pushteti i tij. Çfarë kërkoj unë më tepër? pyeste ai veten gjithë inat.

Më shumë parapëlqeheshin sheshet. Arsyecja ishte e thjeshtë: atje mund të vendosej edhe një statujë e vogël e dëshmorit, gjë që Jakup Cenës i dukej fare e natyrshme. Ai përfytyronte nënën e vet në rrethana të ngjashme. Edhe ajo do të kishte dëshiruar që kujtimi i të birit të humbur të përtërihej në mënyrën më të mirë. Ai nuk kishte asnjë dyshim në qëllimin e të afërmeve të dëshmorëve dhe bënte të gjitha përpjekjet t'ua dëshmonte dhimbsurinë. Jakup Cena mendonte se fati e kishte mbrojtur nga plumbat e fashistëve dhe nuk kishte asnjë të drejtë të tregohej i paduruar me njerëz që lufta i kishte gjymtuar në shpirt. Por këmbëngulja e tyre i dukej gjithnjë e më shpesh e tepruar. Kryeqyteti ishte i vogël dhe nuk kishte rrugë e sheshe për të gjithë dëshmorët. Megjithatë, pamundësia për t'ua plotësuar dëshirën, siç e quante ai kërkesën e çdonjërit, e trishtonte thellë.

Si të mos i mjaftonin vizitat e pafund në zyrë, vërshuan letrat. Përditë merrte një thes. Kjo erdhi me shtimin e atyre që dilnin nga zyra e tij pa premtimin e tij. Individë dhe grupe, celula partie, organizata të Frontit Nacionalçlirimtar, të Gruas Antifashiste, të Rinisë Komuniste, të Sindikatave, të Shoqatës së Shkrimtarëve, të Shoqatës së Invalidëve të Luftës, i drejtoheshin me rekomandime të shoqëruara me jetëshkrime të gjata të dëshmorëve që meritonin të përjetësoheshin në rrugët apo sheshet e kryeqytetit. Më të shumtët e tyre, madje, kërkonin prerazi që kjo rrugë apo ky shesh të mos ishte diku në rrethina apo në ndonjë lagje të humbur, por në qendër. Doemos në qendër të kryeqytetit. Dëshmori i tyre meritonte më shumë nderime se të tjerët, sepse kishte bërë më shumë se të tjerët. Krahasime të tilla nuk i pëlqenin. Në fillim Jakup Cena i lexonte gjithë kureshtje. Dhe nuk u besonte syve. Ata flisnin në mënyrë urdhërore. Secili nga

## *Daullja prej letre*

të vdekurit në fushën e nderit ishte paraqitur si shpëtimtari i vetëm i Shqipërisë. Dukej sikur pa veprën e tij Tirana do të vazhdonte të ishte nën çizmen fashiste. Kureshtja iu shter dhe ia la vendin pak nga pak zemërimit kur ra në përshkrime të betejave ku kishte marrë pjesë vetë.

-Këta gënjejnë!- shpërtheu ai me një zë të shurdhër, ku përzihej ulërima e burrit me një ankim prej fëmije.- Përse gënjejnë?!- Ai hodhi sakaq sytë përreth, i trembur. Dhe mori frymë i lehtësuar. Nuk kishte asnjëri.

7.

Jakup Cenës iu bë e domosdoshme të çlirohej nga ajo punë. Ai nuk e dinte se ku do të shkonte. Donte vetëm të largohej. Dhe përditë e më shumë bindej se nuk kishte rrugë tjetër veç të çmendej. Shokët ia kishin thënë qartë se dorëheqja do të gjykohej si kapitullim. Ndoshta kjo ishte daullja prej letre, që i kishte përmendur Enver Hoxha. Ai e dinte se fati i dezertorëve në luftën politike nuk ishte i ndryshëm nga ai në luftën me armë. Sa më shumë dëgjonte dëshmi të atyre që i vinin për vizitë dhe lexonte nga këto letra rekomanduese, siç quheshin në gjuhën zyrtare, aq më fort i shtohej pasiguria për t'ia dalë mbanë. Ai e merrte me mend lehtë ç'pasoja kishte një dështim i tillë. Të zhgënjeje shokun Enver ishte si të hidhje valle në një fushë të minuar. Jakup Cena kishte frikë. Dhe për më keq, nuk kishte turp nga frika e vet. Kjo nuk i kishte ndodhur kurrë më parë. Ai mbushej përditë e më tepër me përçmim për veten.

- Shenjë e mirë, - i tha Nela B., e qetë. Dhe i buzëqeshi me një nënkuptim të huaj për Jakup Cenën.

- Çfarë?

- Frika.

Atij i ishte dukur gjithmonë pak e çuditshme kjo vajzë, me të cilën takohej edhe më shpesh dhe me njëfarë kënaqësie të re kohët e fundit. E mati me sy, mosbesues. Dhe për t'u siguruar se ajo tallej, do t'i pëlqente që ajo të tallej, iu drejtua:

- Shenjë e mirë?! Si?

- Është e thjeshtë: ti, mik i dashur, po merr zakonet e njeriut që drejton një zyrë të rëndësishme, - iu përgjigj ajo me qetësinë e vet të patrazuar. - Pra, një zyrë që nuk duhet humbur.

Jakup Cena nuk e kuptoi. Dhe nuk do ta kishte vazhduar bisedën sikur të mos e kafshonte përbrenda një kureshtje e papritur.

- Fol më qartë, të lutem! - Zëri i tij ishte i lodhur.

- Më qartë?! - Ajo e përfshiu me buzagazin plot



nënkuptime të pazbërthyeshme për Jakup Cenën.

- Më qartë,- përsëriti ai, kësaj here urdhërues.

- Shpjegime të hollësishme u jepen vetëm fëmijëve, apo jo?- tha Nela B. me një ton të lehtë shakatar. Ajo nuk ishte ironike dhe Jakup Cenës i mjaftoi. Të paktën nuk tallet me mua, mendoi ai.

Ai pati dëshirë të shtonte se nuk ishin vetëm fëmijët, por edhe një soj burrash, ata me zgjuarsi të kufizuar ( domethënë unë), që kishin nevojë për shpjegime të hollësishme. Ishte i mbushur me një inat të verbër. Por nuk kishte asnjë të drejtë ta shkarkonte mbi vajzën. E dinte. Ai buzëqeshi butësisht dhe heshti.

Nela u bë serioze.

-Ti matesh të më thuash diçka, e shoh.

Jakup Cena pohoi me kokë. Vështrimi i tij u zhjt thellë në sytë e vajzës. Ata ishin të ngrohtë. Ai u ndjç mirë, si të kishte gjetur papritur një mbrojtje. Por nuk i ra inati. Ishin duke shëtitur në bulevardin kryesor të kryeqytetit. Në fillimin e ndërtimit të saj, kjo shëtitore ishte quajtur NËNA MBRETËRESHË. Pastaj, me pushtimin e vendit nga Italia fashiste, ishte emërtuar MUSOLINI. Po unë, ç'emër do t'i vë? pyeti veten Jakup Cena. Në kokën e tij lëvriu një mashë e nxhtë , e panjohur. Ndërhyri Nela:

- Ç'deshc të më thuash?

- Nuk të kuptova pak më parë , sinqerisht.

Nela B. lëshoi një të qeshur të gjatë, gurgulluese, duke u fshikur lehtë pas supit të tij.

-Sa vjet jeton gamilja?

Jakup Cena u tendos.

-Nuk tallem,- tha.

-As unë,- u përgjigj vajza.- Më thuaj, sa vjet jeton gamilja?

-Nuk e di.

- Sipas shkencëtarëve jeton pesëmbëdhjetë vjet.

- Kush t'i ka mësuar gjithë këto, vëllai i vogël, ai që do të bëhet mësues?- ia ktheu Jakup Cena me dëshirën për shaka.

- Po struci?- vazhdoi Nela B., si të mos e kishte dëgjuar.

- Unë nuk kam bërë shkollë të madhe. Këto gjëra mësohen nëpër libra,- u përgjigj Jakup Cena, me një lehtësim, si të kishte nxjerrë jashtë vetes një ankth. Atij i erdhi keq që Nela nuk mund të kuptonte ku rrihte fjala e tij.

- Gjithnjë sipas shkencëtarëve, struci jeton dymbëdhjetë vjet,- vazhdoi ajo, e qetë. Dhe bëri një

## *Daujlja prej letre*

pushim të shkurtër.- Po miu?

- E shoh që sonte ke vendosur të më mësosh zoologjinë.

- Jo, dua të të shpjegoj atë punën e drejtimit të zyrës së rëndësishme.- Nela ishte serioze.

Jakup Cena u bë i vëmendshëm.

- Pra, nuk e di sa jeton miu?!

- Nuk kam menduar kurrë për miun dhe nuk e kuptoj ç'lidhje ka jetëgjatësia e tij me detyrën time,- ia ktheu Jakup Cena me një zë qortues.

- Vdekja e miut varet nga macja,- tha Nela, pa e prishur aspak seriozitetin.

- Po kjo është shumë e thjeshtë, këtë e di gjithkush,- u hodh ai, me një ngazëllim të papritur prej fëmije.

- Edhe unë ashtu them,- e mbylli bisedën Nela. Ajo nuk qeshi, gjë që i ngjalli një dyshim të vagullt Jakup Cenës.

Kishte diçka që nuk shkonte në sjelljen e morisë së njerëzve, që Jakup Cena priste përditë. Po çfarë? Ata paraqiteshin para tij me një përulje të pahijshme. Jakup Cena nuk ishte mësuar ta shihte hijen e vet të zmadhuar në sytë e të tjerëve dhe nuk e merrte vesh ç'po ndodhte. Ai ishte ende i pavetëdijshëm për rëndësinë e vet. Pyetja që i kishte bërë vetes gjatë shëtitjes me Nelën, për emrin e ri që duhej t'i vinte bulevardit kryesor të kryeqytetit, kishte dalë në mënyrë të pavullnetshme nga thellësitë e errëta të trurit të tij dhe po ashtu ishte rizhytur, pa lënë ndonjë gjurmë të dukshme.

Por ishin vështrimet e nënave të dëshmorëve, që e nervozonin veçanërisht dhe përditë e më shumë. Në sytë e tyre zvarrisej një përgjërëm, që Jakup Cenës i ngjante i rrejshëm. Gjithçka shkonte mirë derisa ato nuk kishin nisur të tregonin për qëllimin e vizitës. Fytyrat e tyre të mpakura ruanin nën lëkurën e rudhur një dhimbje të heshtur, që humbiste sapo ato përmendnin bijtë e rënë. Të gjitha, si t'i kishte mësuar i njëjti njeri thoshin të njëjtën gjë: le t'u shërbente të gjallëve sakrificat e të vdekurve! Ato nuk shpjegoheshin qartë se si do të ishte ky shërbim dhe u desh një kohë që kjo fjali të linte një vazhde të dhimbshme në trurin e Jakup Cenës. Kjo vonesë erdhi, ndoshta, ngaqë i mjaftonte përshtypja e pakëndshme që i shkaktonte vështrimi i atyre plakave pas shndërrimit të vuajtjes së vjetër në një përgjërëm të ri.

Shpresa se Hitleri do të dinte ta mbante së paku vendin e vet, fundja më në fund kryeqytetin e tij, po i pakësohej me shpejtësi. Edhe pa gjuhët e huaja, domethënë

vetëm me lajmet e përkthyerë për radion dhe gazetat e partisë, të përzgjedhura me kujdes, kuptohet, për të ushqyer entuziazmin e popullit, ai e ndiente se laku rreth qafës së Fyhrerit po shtrëngohej me një shpejtësi marramendëse. Hyrja e ushtrive aleate në Gjermani, vendosmëria e tyre për ta zhbërë bishën deri edhe në strofkën e vet, në Berlin, nisi t'i dukej Jakup Cenës një gjueti e tepërt. Madje edhe pak kriminale. Në fund të fundit Evropa ishte çliruar. Ky kishte qenë qëllimi më i lartë i gjithë atyre që kishin rrëmbyer armët kundër fashizmit. Për më tej u takonte vetë gjermanëve të vendosnin. Ata le të bënin me Hitlerin dhe me SS ç'të donin! Jakup Cena pyeti veten përse nuk i kishin vënë afat të përfundimit të detyrës rënien e Madridit. Edhe atje ishin në fuqi fashistët. Ai nuk dinte më ç'të mendonte. Ishte i vetëdijshëm për lajthitjet që i dyndeshin orë e çast në kokë. Dhe përpiquej gjithsesi të mos mendonte. Por ai ishte i bindur tashmë se zgjatja e kohës nuk do të ndryshonte asgjë në mënyrën e tij të punës, siç nuk do të ndihmonte në pakësimin e vizitave e të letrave që e prisnin çdo mëngjes në zyrë.

A duhej të niste seriozisht përgatitjet për t'u shtënë si i çmendur? Të fillonte pak nga pak të linte aty-këtu përshtypjen se nervat po e lëshonin. Çmenduria nuk është si goditjet në zemër, që vijnë papritur. Ndërkohë, planin e kishte përpunuar me aq hollësi, sa nuk do të kishte nevojë më pas të sajonte. Dhe i pëlqente plani i vet. I pëlqente dhe i jepte një siguri të çuditshme. Sido që të vinte puna, ai e kishte tashmë një dalje shpëtimtare. Ai e zuri veten duke vizatuar daulle prej letre.

Disa herë iu qas vendimit për të braktisur gjithçka dhe të shfaqej para të njohurve e të panjohurve si i ndërkrjer. Të qeshte e të qante me vetveten. Por e përmbante dyshimi në zgjuarsinë e vet të kufizuar. Në një çast a në një tjetër mund ta humbte kontrollin e vetes dhe do t'i zbulohet loja. Atëherë e priste plumbi. Nuk do të kishte asnjë mëshirë për të. Jakup Cenës nuk i pëlqente të pyeste veten nëse do të kishte kërkuar mëshirë në rrethana të tilla. Përshtypja e krijuar për të si njeri jo fort i zgjuar do t'ia lejonte përluljen. Në fund të fundit, vetë ideja për t'u hequr si i çmendur ishte dëshmi çmendurie. Jakup Cena mori frymë i lehtësuar, si ta kishte gjetur zgjidhjen. Më mirë ta merrnin për të çmendur sesa ta detyronin të lypte mëshirë. Nuk mësohej dot me këtë ndjenjë.

Në fillim ishte thjesht frika e vdekjes që ia shtonte durimin. Më pas kjo frikë i mori një formë tjetër.

8.

Ky shndërrim i ndodhi pa kuptuar, me kalimin e ditëve e të javëve, si fryrja e lumenjve nga shkrija e borës në male. Natyrisht, nën ndikimin e punës që po kryente, gjithnjë pa pasion, por me një kureshtje të vërtetë tashmë dhe me ankthin e një kërcënimi të panjohur. Zgjuarsia e kufizuar nuk e kishte mbrojtur dot Jakup Cenën nga dyndja e pafund e pyetjeve, ku më e rrezikshmja ishte: nga u vinte njerëzve gjithë kjo vëmendje ndaj të vdekurve në fushën e nderit gjatë luftës së fundit? Më shumë se pyetje ishte një dyshim që i futi dridhmën. Anekdotat që i kishte treguar Nela B. mbi jetëgjatësinë e miut, i kishte lënë një mbresë të pashlyeshme. Ai donte gjithnjë e më shumë të kuptonte se ç'po ndodhte. Të paktën të kuptonte.

Përgjigjen e kishte mbledhur copa-copa, kryesisht midis shpjegimeve të atyre që i vinin për vizitë, por edhe midis rreshtave të letrave të shumta që merrte dita-ditës dhe nëpër bisedat me shokët. Ishin gjysma fjalish, më së shpeshti të pavullnetshme, e që shfaqeshin aty-këtu befas, midis lutjeve të hartuara me fjalë prekëse apo propozimeve të fryra. Më e rënda ishte keqardhja që shihte aty-këtu tek ata që nuk kishin dëshmorë në rrethin e tyre familjar. Dukeshin pak si njerëz që u mungonte diçka thelbësore për të besuar plotësisht tek e ardhmja, si njerëz që kanë humbur rastin për të trashëguar një thesar. Ata gati e fajësonin njëri-tjetrin pse nuk e kishin kërkuar plumbin e armikut. Unë do të marr nga pak pjesën time të gjithë dëshmorët, tha Jakup Cenë, me një prapamendim gjithnjë e më të qartë.

Sekuestrimi i pasurive të vëna gjatë luftës përparonte me shpejtësi. Të gjithë e dinin se do të vazhdohej pa vonesë me shtetëzimin e përgjithshëm. Do të krijoheshin kooperativat socialiste dhe nuk do të kishte më të pasur. Mënyra e vetme për të shmangur barazinë në varfëri do të ishte kacavjerrja sa më lart në shkallët e pjerrëta të shtetit. Krejt jeta e të gjallëve, përmbushja e dëshirave më të çmuara të secilit do të varej tashmë nga mbështetja të të vdekurit e këtij lloji. Dëshmorët jepnin besueshmëri për të gjallët. Mjerë ai që nuk ka një të vdekur të lavdishëm në familjen e tij! Kjo ishte një e vërtetë e provuar prej shekujsh. Ndryshe nuk do të lindte miti i kurbanit në themele, që të mbanin muret e kështjellës.

Lodhja e gjatë, që i kishte shkaktuar plotësimi i kësaj përgjigjeje, e kishte ndihmuar Jakup Cenën të kuptonte arsytimin e fshehtë të Enver Hoxhës në zgjedhjen e tij për këtë detyrë vetëm në sajë të zgjuarsisë

## *Besnik Mustafaj*

së kufizuar, të besnikërisë dhe të vetmisë familjare. Jakup Cena nuk kishte vëllezër, as motra, as grua dhe as kushërinj të afërm. Vetëm dy prindër të plakur, të cilët nuk i paraqisnin kërkesë tjetër sa herë e shihnin veç asaj që të kthehej në fshat e t'i kushtohej punimit të tokës, si gjithë të parë t e tij. Enver Hoxha kishte dashur që kryetari i komisionit për caktimin e emrave të rinj të rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit të mos ishte i vetëdijshëm për pushtetin që po i jepej dhe as të mos kishte arsye gjaku të përkrahte dikë më shumë se një tjetër. Shkurt: të mos kishte asnjë përfitim vetjak veç falenderimeve zyrtare. Jakup Cena arriti në këtë përfundim kur nuk kishte më fuqi të besonte se kryetari i qeverisë kishte synuar kështu një drejtësi të përsosur. Përkundrazi, qëllimi i tij ishte që edhe këtë shpërndarje ta bënte si shpërndarja e posteve për të gjallët: ndër besnikët e tij. Ishte një llogari e stërholluar, që e përdezi si një ethe e panjohur trurin e Jakup Cenës. Ai nuk ishte shumë i zgjuar vërtet, por nuk ishte më budalla se të tjerët. Kishte zbuluar një lojë të madhe, ku i takonte të merrte pjesën e vet të fitimit. Nga thellësitë e errëta të kafkës iu ngjit ngadalë pyetja instinktive që i kishte bërë vetes gjatë shëtitjes me Nelën për emrin që do t'i jepte bulevardit kryesor. Mbreti e kishte mbajtur për vete, duke i vënë emrin e nënës së vet. Duçja e kishte patur nepsin edhe më të madh, i kishte lënë emrin e tij. Po unë? pyeti pa ndonjë brerje të ndërgjegjes Jakup Cena. Vetja iu duk si tregtari më i çuditshëm. U çlirua si me magji nga ankthi dhe nga urimi për t'u çmendur si shpëtim. Madje i erdhi të qeshte me daullet prej letre që kishte vizatuar. Dhe qeshi. Kam qënë vërtet pak budalla, tha pa asnjë fije inati. Tani donte vetëm që gjithçka të zgjaste sa më shumë, që të kishte kohë të caktonte çmimet e përshtatshme për rrugët dhe sheshet e qendrës e të periferisë së kryeqytetit dhe të përzgjidhte blerësit që paguanin më mirë.

## HISTORIA E DYTE

Ai nuk jeton më, por unë e kam njohur. E di se nuk do t'i pëlqente ta shihte emrin e vet të shtypur nëpër gazeta e libra dhe nuk do ta përmend. Sa për t'i vënë një emër letrar, do ta quaj Selim. Ishte një burrë i vogël dhe eshtëror dhe pak i kërrusur te supet, dhe me një fytyrë të imët e pa shumë rrudha edhe në pleqërinë e fundit. Nuk dëgjohej kurrë të qeshte, por as i zyrtë nuk ishte kurrsesi. Dhe, kur shihte të tjerët që shkuleshin gazit me bëmat e tij të pazakonshme, sytë e tij mbusheshin me një shprehje çudie të thellë e të sinqertë dhe sidomos pyetëse, gjë që zakonisht ngjallte një hutim të papritur përreth. Ata që e njihnin, dhe ishin të shumtë ata që e njihnin me kohë, thoshin se Selimi nuk kuptohej kur fliste seriozisht e kur tallej. Ishte gjithashtu e vështirë të dalloje se kur ai tallej me të tjerët e kur me veten. Unë vetëm seriozisht flas, ngulte këmbë ai sipas mënyrës së vet të pabesueshme. Jam shumë i vogël unë të tallem me të tjerët. E me veten nuk tallem se nuk ka vlerë. Të vjetrit tregonin se nuk kishte qenë gjithmonë i tillë. Kishte ndryshuar shumë karakteri i tij me vendosjen e pushtetit popullor. Nuk ishte më gjëkund ai Selimi i kohës së mbretërisë, kur, veç shumë peripecishë të tjera, ai kishte shkuar dy herë në burg si kundërshtar i regjimit. Selimi, që nuk dinte të rrinte në paqë me pushtetin, ishte urtësuar si me magji. Por të vjetrit nuk tregonin nëse ai kishte patur edhe më parë këtë sjellje, me një kufi të paqartë midis seriozitetit dhe talljes. Nuk tregonin nëse ai kishte patur edhe në rini një gjuhë aq të hidhur. Por, shaka sa për të qeshur dhe për të harruar sakaq, nuk bënte kurrë.

Selimi nuk i kundërshtonte kurrë ata që ia kujtonin këtë ndryshim. Nuk e merrte as për lëndatë të madhe e të kënaqej. Nuk ishte as i pandjeshëm. Por as nuk shpjegonte se si dhe pse kishte ndodhur urtësimi i tij mrekullueshëm. Vetëm përgjigjej dhe me seriozitetin më të madh, dhe fare njësoj, si kur i drejtohej gruas së vet ashtu edhe një oficeri të Sigurimit:

-Faleminderit asaj që më poqi, Partisë.

Ishte një përgjigje e shkurtër, me të cilën nuk lejohej të qeshej, edhe pse dihej botërisht se ai nuk ishte komunist. Selimi nuk ishte ndër ata që mund të radhiten ndër partira. Kishte raste kur e rrëmbente dëshira t'i vinte në pozitë të vështirë bashkëbiseduesit. Kjo ndodhte me ata që ia kujtonin ndryshimin me një nënkuptim të mbrapshtë. Selimi shtonte, gjithnjë me seriozitetin më të madh:

-Edhe juve ju ka pjekur Partia, por nuk e ndjeni ende. Do ta ndjeni, do ta ndjeni. Ndoshta nuk do të jetë vonë.

Miratimi ishte i detyrueshëm:

-Ashtu është, sigurisht, ashtu është.

Dhe Selimi i përgëzonte ngadalë, i qetë, duke mbetur i pakuptueshëm nëse fliste seriozisht, tallej apo provokonte. I pakuptueshëm, por, çuditërisht, jo i frikshëm.

Me këtë mënyrë të re sjelljeje ai ka ngjallur shpesh herë keqkuptime të rënda, ka vënë edhe burra autoritarë në mëdyshje poshtëruese. Rasti më i përmendur është ai që ndodhi në mars të vitit 1949, në prag të shtatëdhjetë vjetorit të lindjes së Stalinit.

Selimi thoshte për veten se ishte fshatar i qytetarizuar me dekret të kryeministrit dhe vendim të Byrosë Politike. Dhe, si gjithmonë, nuk shpjegonte më tepër. Unë duhet të kem qenë rreth gjashtëmbëdhjet vjeç kur e kam dëgjuar për së pari këtë përcaktim të tij për veten dhe buzëqesha, mosbesues. Ai ma përsëriti të vërtetën e vet me një zë prej plaku, që nuk linte vend për dyshim. Më kujtohet që u mahnita. Ai burrë i vogël dhe eshtëror, dhe pak i kërrusur te supet, dhe me një fytyrë të imët, dhe pa shumë rrudha si pleqtë e modhës së tij, fitoi sakaq në sytë e mi një rëndësi përrallore. Ishte mbledhur Byroja Politike për të zgjedhur vendin ku do të banonte Selimi, pastaj Enver Hoxha, që ishte edhe Kryetari i Qeverisë, kishte nxjerrë dekret të posaçëm... Nuk u përmbajta dot pa e pyetur se si kishte arritur te një nder i tillë i lartë.

-Fare thjeshtë, duke qenë i besueshëm,- m'u përgjigj ai.- Pra, Partisë i nevojitesha në qytet,- shtoi ai shkurt dhe qetë, duke më përfshirë me një vështrim qortues, që më bëri të skuqem.- Nuk shkova unë te qyteti. Erdhi qyteti tek unë.

Nuk kuptova asgjë në ç'më tha dhe nuk guxova ta pyes për çfarë më qortonte dhe as nuk u binda se qyteti kishte patur ndonjëherë nevojë për të. Ai nuk kishte dhe nuk kishte patur kurrë ndonjë përgjegjësi në komitetet që drejtonin jetën e qytetit. Të besueshëm ishin edhe dy dajot e mij, që përpiqeshin prej shumë kohësh të largoheshin nga fshati i tyre i thatë për t'u vendosur në qytet, por nuk i lejonin. Njëri prej tyre, i madhi, e kishte edhe djalin



komunist, njësoj si Selimi. Nuk kuptova asgjë nga përgjigja e tij, por nuk gërmova më tej. Ai arriti të mbështillet me një lloj misteri të papërshkueshëm. Asokohe unë ende nuk e dija se si kishte lindur qyteti ynë, (domethënë qyteti i Selimit, që ishte edhe imi, e ku djali i Selimit, që do ta quaj Din Qereçi, ishte një nga njerëzit më të rëndësishëm). Nuk e dija se ngritja e qytetit tonë kishte nisur fill pas prishjes me Jugosllavinë, më 1948. Kryeqendra e rrethit nuk mund të rrinte më aty ku kishte qenë gjithmonë për shkak të afërisë së kufirit me vendin ku sundonte renegati Tito, tradhtari më i madh i revolucionit proletar. Ishte e rrezikshme njësoj si të gjëndeje pranë një vendi të prekur nga kolera. Dhe ishte zgjedhur si më i përshtatshmi fshati ynë (domethënë fshati i Selimit, i babait tim dhe i nja dhjetë familjeve të tjera), në zemër të krahinës. Mua më ishte kujtuar instinktivisht qortimi i Selimit. Mos vallë Partia i do vërtet më të besueshëm banorët e qytetit se ata të fshatit? kisha pyetur veten pa u përgjigjur dot. Megjithë zhvendosjen në brendësi, ai mbetej përsëri qyteti më verior i Shqipërisë.

Pra, në kohën kur do të festohej shtatëdhjetë vjetori i Stalinit, Selimi mbushte disa muaj si qytetar. Nuk e kishte pyetur njeri, por me siguri që edhe ai do të thoshte se fqinjëria e padëshirueshme me kufirin jepte arsye edhe më shumë për festimin e ditëlindjes së Stalinit me madhështi të veçantë në qytetin tonë. Kjo ishte mënyra më e mirë për t'ia plasur zemrën Titos së shitur tek imperializmi amerikan, do të pohonte ai si gjithë të tjerët. Dhe nëpër sytë e tij të vegjël nuk do të lëvizte asgjë. Sipas shembullit të Tiranës, edhe në qytetin tonë ishte menduar që mikut të shtrenjtë e të largët t'i dërgohej si kujtim edhe një dhuratë, diçka që të bartte deri atje në Moskë ndjenjat e zjarra të dashurisë që ushqenin malsorët e porsapagëzuar qytetarë për Babain e të shtypurve, udhëheqësin e revolucionit botëror. Gjithnjë sipas shembullit të Tiranës, për këtë qëllim Komiteti i Partisë i rrethit tonë kishte ngritur edhe një komision të posaçëm, të kryesuar nga vetë sekretari i parë .

Rastësia, e mirë apo e keqe, por rastësia, e sollti që Selimi të kalonte një ditë prej ditësh ndanë ngrëhinës ku ishte mbledhur ky komision i rëndësishëm. Për Selimin nuk kishte nisur ende të thuhej se mbërrinte si i ftuari i qoftëlargut, gjithmonë aty ku nuk duhej. Ishin javët e fundit të dimrit dhe moti kishte nisur të ngrohej dhe qielli kaltëronte, dhe kumbullat e para, ato më të paduruarat e që nuk arrinin kurrë të lidhnin fruta, kishin nxjerrë kurorat e tyre të bardha. Sekretari i parë i komitetit të partisë të

rrethit e pa plakun nga dritarja e çelur e zyrës dhe e thirri. Ai i shpjegoi shkurt arsyen pse gjendeshin rreth asaj tryeze gjithë krerët e pushtetit lokal dhe Selimi e dëgjoji krejt i përqëndruar. Kurrë nuk është marrë vesh nëse sekretari i parë ndjeu vërtet nevojë për mendimin e Selimit apo deshi t'i shtendoste pak bashkëpunëtorët e vet me humorin e zi të plakut. Me siguri mund të thuhet vetëm se ai nuk e ka përfytyruar kurrsesi havalenë që po gatuate.

-Kemi kaç orë që rrahim mendimet dhe nuk vendosim dot çfarë t'i dhurojmë,- tha sekretari i parë me një pamje vërtet të brengosur.- Druhemi se dhurata jonë nuk do t'i pëlqejë. Na jep një këshillë!

-Oh! Oh! Nuk jam unë për këshilla kaç të rëndësishme,- u përpoq më kot Selimi të tërhiqej.- Nuk dua të më ndodhë si në historinë e daulles prej letre.

Anëtarët e komisionit, të gjallëruar nga shpresa e ëmbël se ndoshta po i afroheshin zgjidhjes, pra mbylljes së mbledhjes, ose thjesht nga dëshira për të qeshur pak, i thurën me radhë lavde pafund mençurisë dhe përvojës së tij si një shpëtimtari hyjnor të paparashikuar. Askush nuk e pyeti se si ishte historia e daulles prej letre. Selimi i dëgjoji në heshtje, deri në fund, pa shprehur as krenari e as bezdi. Tha vetëm:

-Falenderoj Partinë!

Dhe shtoi:

-Më tregoni më parë çfarë kishit menduar t'i dërgonit?

-Ndoshta një qilim tradicional të krahinës sonë. Me këtë rast tregojmë edhe se jemi popull me talent,- u përgjigj shpejt e shpejt sekretari i parë .

Selimi, fare serioz, e madje me njëfarë brengosjeje, zuri të tundte kokën majtas e djathtas në shenjë mohimi. Nuk pati nevojë të mendohet. Dhe tha:

-Do të kishte qenë gabim i madh.

-Pse?- u hodhën tre-katër zëra njëherësh.

-Do ta merrte për keq.

-Si? E pamundur.

Selimi i përfshiu me një vështrim sipëror prej njeriu që e di mirë përse flet, gjë që nuk u pëlqeu fort anëtarëve të përzgjedhur të komisionit. Veçanërisht i tepërt iu duk ky gjykim atij që e kishte thirrur.

-Na thuaj, si mund të merret për keq një dhuratë e tillë plot kuptim?!- u hodh sekretari i parë me një ton urdhërues.

Selimi, i paturbulluar fare, vazhdoi:

-Ç'e tregon bollëkun e shtëpisë?

Anëtarët e komisionit bashkë me kryetarin e tyre rrudhën supet në heshtje.

## *Daujlla prej letrë*

-Shtrojat e dyshemesë, apo jo?!- u përgjigj vetë Selimi pa vonesë.- Ju e dini se për zotërinjtë dikur thuhej se kanë qilima për të shtruar edhe oborrin.

Sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit miratoi instinktivisht me kokë. Të tjerët e ndoqën.

-Me ta marrë dhuratën tonë, Baba Stalini do të mendonte: këta shqiptarët më ditkan të varfër, me sa duket. Pa t'ua pres një herë ndihmat, që të mësojnë të më respektojnë.

Anëtarët e komisionit lëshuan me një frymë një pasthirmë habie.

-Stalini ka qilima për të mbuluar gjysmën e Europës, apo jo?- përfundoi Selimi, duke u përpjekur ta fshinte mirë nga zëri çdo tingëllimë triumfale.

-Ashtu është,- tha sekretari i parë, i pasuar nga kori i anëtarëve të komisionit.- Stalini ka qilima për të mbuluar krejt Europën, dhe Azinë, dhe Amerikën.

-Madje edhe Afrikën,- shtoi dikush dhe të tjerët e miratuan.

Selimi kishte pamjen e njeriut të qetë dhe të vetëdijshëm tashmë për ndihmën që i kërkohej. Asgjë më tepër. Dhe sidomos asnjë hije prej fitimtarit. Ai mori lejë të ndizte një cigare.

-Në fakt edhe ne kishim dyshime,- shtoi sekretari i parë si për t'u mbrojtur. Ai nuk ishte mësuar dhe nuk mund ta pranonte që dikush tjetër përreth tij të gjykonte më drejt, të shihte më larg. Sidomos për një çështje aq të rëndësishme, ku përzihej politika e madhe ndërkombëtare me ndjenjat e holla njerëzore, siç është miqësia dhe mirënjohja.- Dhe patëm heqë dorë nga qilimi.

-Shumë mirë kishit bërë. E çfarë do t'i dërgonit?- e mori fjalën Selimi. Ai nuk i kishte sytë për ta vënë re trazimin e të tjerëve.

-Një revolver shumë të bukur, të vjetër, me dorezë prej argjendi, nga ata që kanë përdorur gjyshërit tanë në luftërat për liri e pavarësi. Do të kishte edhe një kuptim simbolik.

-Çfarë kuptimi simbolik? Ç'është kuptimi simbolik?

Sekretari i parë qeshi me një nënçmim të lehtë, të nderur në majat e buzëve.

-Miqësia jonë me Stalinin dhe Bashkimin e madh Sovjetik mbështetet në idealin e përbashkët të luftës për komunizëm.

-Mua më duket se pikërisht për këtë arsye do të bënit një gabim edhe më të rëndë,- ndërhyri Selimi.

-Ç'na thua?! Po shkon shumë larg,- e ndërpreu sekretari i parë, me një nervozizëm të përmbajtur keq.

Të pranishmit lëshuan një mërmërimë pakënaqësie. Selimi përsëri nuk u turbullua.

-Unë po flas drejt, se më thirrret për një këshillë,- tha ai.- Këshillat e vërteta jepen hapur. Po e kam edhe detyrë patriotike të mos dredhohj, kur është fjala për të kënaqur Babain e Popujve. Ju, si të dëshironi! Më mirë po largohem. Kam punën time. Mirupafshim! Më thoni vetëm diçka, ju lutem: A mund t'i nis vetë me postë një dhuratë të vogël Stalinit? Si mendoni, bëhet? Duhet të kemi të drejtë edhe ne të vegjlit t'ia urojmë ditëlindjen...

-Dale! Ku do të shkosh?! Na shpjego ku do të ishte gabimi po t'ia kishim nisur revolverin! Pastaj, s'na ke dhënë ende këshillën,- u hodhën disa zëra me njëfarë paniku instinktiv. Dhe pasoi një heshtje e shkurtër. Ata që kishin folur shkëmbyen vështrime të shpejta. Kishin folur para sekretarit të parë.

Selimi nuk kishte lëvizur. Ai nuk kishte nevojë për lejë, që të vazhdonte.

-Stalini sot është në ballë të luftës me gjithë botën borgjeze, apo jo?!

Tundje miratuese kokash.

-Ne i shkojmë prapa.

Tundje tjetër miratuese kokash.

-Kur ta merrte koburen tonë, ai do të kishte të drejtë të na qesëndiste: me këto pisqolla të ndryshkura të Sulltanit duan ta mbrojnë komunizmin shqiptarët?! Eh, lum si unë për shokë që paskam! Dhe do të mbajnë llogoren më të vështirë ata, pale! Përballë Titos...

Kësaj here i iku goja edhe vetë Sekretarit të Parë. Ai u përpoq të bënte njëfarë buzagazi, sa për t'u dhënë pak zemër bashkëpunëtorëve të vet.

-Tani e ke radhën ti, shoku Selim, të na tregosh ç'duhet t'i dërgojmë.

Selimi, si gjithmonë i çetë dhe i përqëndruar, hetoi me sy një nga një anëtarët e komisionit. Të gjithë, të mbushur me adhurim e me ankth, ishin në pritje të zgjidhjes që do t'i jepte plaku një problemi të tillë me rëndësi politike dhe ideologjike. por me rëndësi edhe për ndjenjat thellësisht vëllazërore që ata, si njerëz të shtypur, që kishin qenë për shekuj e shekuj, pastaj antifashistë e më kryesorja tani, si komunistë, ushqenin ndaj Bashkimit të madh Sovjetik dhe vetë Stalinit. Do të përfitonin nga ky rast për të fituar edhe një përvojë që u mungonte. Ishte hera e parë që bënin dhurata për një udhëheqës ndërkombëtar. Deri atëherë u kishte qëlluar të mblidheshin për këtë qëllim vetëm në vigjilje të ditëlindjeve të Shokut Enver, i cili jo pse ishte udhëheqësi i tyre, por ishte vërtet i mirë, shumë i thjeshtë,

ishte zemër. Ai pranonte gjithçka dhe gjithmonë dhe me falenderime të përzemërta. Ata nuk dyshonin se këto cilësi të larta i kishte edhe Stalini. Megjithatë...

-Baba Stalini mbush shtatëdhjet vjet,- e prishi heshtjen Selimi. Ai kishte marrë një hije të rëndë, që nuk i shkonte fytyrës së tij të vogël dhe pa shumë rrudha.

Sekretari i parë dhe të tjerët miratuan me kokë. Ata e vështronin folësin drejt në gojë, pa menduar më për veten.

-Të mëdhenjtë nuk plaken kurrë si ne të tjerët, e di edhe unë siç e dini më mirë ju, por diçka si mizatje të pakëndshme ua lënë edhe atyre nëpër trup vitet që shkojnë.

Selimi bëri një hyrje fare të shkurtër, para se të jepte këshillën e tij befasuese: dhurata më e mirë për Stalinin në një ditëlindje të tillë shtatëdhjetë vjeçare do të ishte Shoqia Sekretare e Rinisë Komuniste. Atij nuk i bëri asnjë përshtypje pse të tjerët shqyen sytë, të hutuar, si të kishin marrë një goditje të fortë prapa kokës. Kësaj here fytyrë e tyre të thara nga frymëmarrja e përshpejtuar nuk nxorën asnjë tingull. Si burrë i duruar e i kthjellët që ishte. Selimi shpjegoi qetë e qetë edhe arsyet pse nuk mund të kishte zgjedhje më të përshtatshme. Gjithçka lidhej me atë mizatjen e pakëndshme që u lënë domosdoshmërisht nëpër trup edhe njerëzve të mëdhenj dimrat e verat që shkojnë pa u ndalur, si uji i lumit, që rrjedh nën urë.

-Sidomos në fund të qafës, në shpatulla, në ije, në gjunjë e më poshtë, në zogun e këmbës. Kudo ku trupi ka nyje,- saktësoi Selimi krejt serioz.- Ju ende nuk e dini se sa e keqe është. Nuk dhëmb, por cingris dhe njësoj natën e ditën, në gjumë të prish ëndrrat, zgjuar të prish gëzimin e dritës.

Dhe vazhdoi të përshkruante me të njëjtin seriozitet shoqen sekretare të rinisë, e cila ishte e re dhe e freskët si një lule marsi, e bukur dhe e dëshiruar si një dallëndyshe pranverë, e fortë dhe e shkathët si një sorkadhe mali, por edhe me duar të buta, të buta si të gdhendura mbi një shtëllungë resh. Madje ai edhe e detyroi pa asnjë urdhër, me një shkop të padukshëm magjik vajzën t'ua tregonte duart të tjerëve. Ata duhej të bindeshin se duart e saj ishin të buta, thua se vërtet nën lëkurën e saj të trëndafilte nuk kishte gjë tjetër veç shtëllunga resh. Shkurt: duart të lindura për të përkëdhelur, theksoi Selimi. Ai sqaroi se pak njerëz kanë duar për të përkëdhelur. Ka shumë që i kanë duart për punë dhe qofshin të lëvduar, të tjerë që i kanë për dhunë dhe gjetshin belanë! Ka nga ata që s'i kanë për asgjë dhe i mbajnë gjithë kohën të rrasura në xhepa, thua se kanë turp dhe kanë të drejtë të kenë turp nga duart e veta. Neve, më të largtëve, fati nuk na dha fushë për të

mbjellë grurë, nuk na dha det për të nxjerrë kripë, por nuk na la pa gjë. Na dha duart e shoqes sonë, që janë për të përkëdhelur. Ai la një heshtje të shkurtër, si t'i paralajmëronte dëgjuesit për një kumt të rëndë. Nën lëkurën e Baba Stalinit, për shkak të asaj mizatjes së keqe që lënë vitet e pamëshirshme edhe në trupin e njerëzve të mëdhenj, kishte tashmë vetëm një lëndë të ftohtë e të ngurtësuar si bukë bajate. Ai rrudhi pak buzët. E dini ju ç'është buka bajate? Sigurisht që e dini. Ju jeni bijtë më të mirë të një populli të ushqyer gjatë shekujve me bukë bajate. Selimi jepte pa u mërziur nga ato hollësira që e hutuan përfundimisht komisionin. Ata nuk vendosnin dot më nëse duhej ta ndërprisnin ligjërimin e tij të çuditshëm apo t'ia shkrepnin gazit. Sekretari i parë, si të kishte harruar pse ndodhej aty, nuk po u jepte asnjë shenjë.

-Na takon të gjithëve të mendojmë me zemër në dorë për të mirën e Baba Stalinit, siç mendon ai ditë e natë për të mirën tonë. Ai është fati ynë, e ardhmja jonë,- tha Selimi me një zjarrmi të pazakonshme. Dhe vazhdoi:- Duart e buta të shoqes sekretare, vetëm ato mund t'ia heqin atë mizatjen e padurueshme trupit të ftohtë si bukë bajate të Baba Stalinit. Kur ta përkëdhelin rreth qafës, në shpatulla, në ije, në gjunjë dhe poshtë te zogjtë e këmbës, ajo lënda si brumë i vjetër ngjitur pas kockave të brejtura, nën lëkurën e tij të murrme si të tymosur, do të nisë të zbutet e të gjallërohet siç po gjallërohet toka këto ditët e fundit. Është si lisi edhe trupi i njeriut, përtërihet nga shartimi me degën e re. Besomëni mua! Flas dhe veten e vë në vendin e tij. Do ta shohim Baba Stalinin të dalë para popullit njëzet vjet më i ri. Dhe rinia e tij është rini për ne, apo jo?! Është rini për të gjithë popujt e shtypur, për zezakët e shkretë të Afrikës, që luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha skllavëruese e kolonializmit europian, për indianët e pafajshëm të Amerikës, që imperializmi i Daj Samit po i zhduk me një barbari që nuk e meritojnë as mushkonjat, për kinezët, shkurt, për mbarë të dobët e botës, që nuk kanë mbrojtje tjetër veç hijes jetëdhënëse të Baba Stalinit. Le të mençur jme për këta të dobët, t'i ndihmojmë që edhe ata të bëhen një ditë si ne, zotër të botës!

Kishte arritur aty ku gazi nuk mbahej më. Dhe shpërtheu. Vetëm Selimit nuk i lëvizi asgjë në fytyrë. Madje, sytë e tij të vegjël u mbushën me njëfarë pikëllimi pyetës për shkakun e të qeshurës së anëtarëve të komisionit. Ai kishte pamjen e njeriut të përvuajtur, që sheh të tjerët t'ia shpërdorojnë përkushtimin më të sinqertë dhe nuk mbrohet dot. Sekretari i Parë e urdhëroi të largohej.

## *Daullja prej letre*

-Ne të respektoam duke të kërkuar një këshillë të tillë të rëndësishme. Ti nuk e çmova, aq më keq për ty! Kanë të drejtë ata që thonë se me ty nuk flitet seriozisht. - Sekretari i parë ishte thjesht i pakënaqur. Por edhe nëpër fytyrën e tij të shëndetshme valëzonte një e qeshur e përmbajtur.

-Gaboheni,- ia ktheu Selimi duke dalë. - Mua më ndodhi si në historinë e daulles prej letre. E ndjeja dhe u paralajmërova. Do të shihni që tek fjala ime do të vini.

Anëtarët e komisionit nuk e pyetën përsëri se ç'ishte historia e daulles prej letre. Ata vazhduan të qeshnin edhe një grimë, duke ngacmuar nga pak shoqen sekretare, e cila me duart e saj, vetëm me të prekur, (fatmirësisht, ata nuk përmendën përkëdhelitë) mund të bënte mrekullinë e rinimit njëzet vjet të Stalinit të madh. Pesë vjet u deshën për ta shfarosur nazizmin. Njëzet do të mjaftonin për të varrosur krejt reaksionin botëror. Dhe shoqja e tyre do të ishte shpëtimtarja e njerëzimit. Fotografitë e saj do të botoheshin në revista me ngjyra, për të do të këndoheshin këngë në të gjitha gjuhët, do t'i ngriheshin statuja të mermerta anembanë globit. Vetëm vajza nuk fliste. Ajo ishte skuqur lehtë në mollëzat e faqeve dhe kishte rrëzuar vështrimin mbi tryezë. Nuk dallohej çfarë ndjente.

-Bëri si bëri Šlimi e na e dha këshillën e vet, që nuk ishte dhe aq e keqe,- e ngriti zërin pak më shumë se të tjerët njëri nga të pranishmit.

Këtu filloi hataja.

Sekretari i parë u zymtua përnjëherësh dhe i hodhi shokut një vështrim të rreptë. Valëzima e fshehtë e gazit në fytyrën e tij u davarit si të mos kishte qenë kurrë.

-Nuk jemi mbledhur këtu për shaka,- thirri.

E qeshura u ndërpre gjithandej nëpër sallë si me thikë. Ra një heshtje e rëndë, thua se gjithçka u fundos papritur në ujë.

-Nuk jemi mbledhur për shaka, qartë,- përsëriti Sekretari i parë edhe më i zymtë. Nëpër sallën e madhe kaloi një frushullimë e ftohtë, që ua mpiu majat e veshëve të gjithë anëtarëve të komisionit. Ata e njihnin mirë paralajmërimin që sillte ky ndryshim i tonit të sekretarit të parë. - Kemi vende të tjera për argëtime. Jo këtë zyrë. U kuptuam?

U dëgjua një murmurimë miratimi, e cila me sa duket nuk e kënaqi sekretarin e parë. Ai iu drejtua njeriut që kishte folur:

-Edhe ti e kuptove?

-Po. Sigurisht që e kuptova. Më falni! Po nuk e kisha me të keq...

-Nuk e kishe me të keq?! Atëherë, për çfarë lyp të

falur? Thuaje me zë të lartë, që ta dëgjojnë mirë shokët!  
Nuk i shoh shumë të bindur.

Tjetri nuk u përgjigj. Vetëm uli kokën, i zënë ngushtë.

-Ke nevojë për kohë, që të mendohesh,- u shtrua disi sekretari i parë .

-Me siguri që ka nevojë të mendohet. Ka nevojë, ka nevojë! Le t'i lemë pak kohë!- ndërhyne me një dashamirësi të shtirur disa nga shokët.

Sekretari i Parë i përgëzoi me një vështrim të shpejtë për mirëkuptimin.

Legjenda thotë se mbledhja historike, bashkë me kohën që i nevojitej shakaxhiut mendjelehtë për t'u menduar mbi marrëzinë e vet, zgjati shtatë ditë e shtatë net. Tridhjet vjet më vonë, kur Stalini kishte vdekur tashmë, por në qytetin tonë të vogël verior si në mbarë Shqipërinë, vazhdonim t'ia festonim ditëlindjen me të njëjtën dashuri në të hyrë të pranverës, dhe drejtuesi i këtyre festimeve ishte vetë djali i Selimit, që unë e quajta Din Qereçi, pra, tridhjet vjet më vonë, kur edhe Selimi ishte mplakur shumë tashmë, por nuk kishte ndryshuar thuajse fare, (në qoftë se nuk përmendim atë mizatjen e padukshme që lënë vitet nëpër trup, për të cilën Selimi nuk guxonte kurrë të ankohej,) unë e kam pyetur personazhin tim nëse ishte e vërtetë ajo që tregohej mbi mbledhjen javore të komisionit. Ai më dha një përgjigje që ishte krejtësisht në stilin e tij. Punët e mia fillojnë të hënën e mbarojnë të djelën, më tha. Ju të rinjtë e shkolluar shpjegoni se kështu vërtitet edhe Dielli. Ai më rrahu shpatullat, siç i takonte një gjyshi të mirë dhe u largua pa më dhënë mohim as pohim.

Qysh nga ajo ditë më është ngulitur në mendje se kishte qenë e hënë kur Selimi ishte thirrur para komisionit për këshillën e tij të habitshme. Me siguri e hënë pasdite, po të mbajmë parasysh lodhjen e të pranishmëve nga diskutimet e pafrutshme. Dhe sekretari i parë , kur kërkoi t'i jepej kohë për t'u menduar shokut që ra në gabim, veç të tjerash dëshironte me siguri një ndërprerje të shkurtër, një pushim të paktën sa të pinin një kafe, që edhe ai vetë të fitonte pak kohë të përcaktonte vazhdimin.

Por kjo kafe nuk u pi kurrë. Madje, siç erdhën punët, edhe vetë sekretari i parë e harroi shpejt dëshirën e tij të përligjur për një pushim të vogël.

Shoqja bukuroshe e duarbutë, sekretare plot vullnet e organizatës së rinisë komuniste të rrethit, përfitoi nga heshtja e shkurtër që ra për të lëshuar klithmën që, me sa duket, e kishte mbytur me zor përbrenda prej një çasti tepër të gjatë.



## *Daullja prej letre*

-Ju nuk keni asnjë të drejtë të talleni me mua. Nuk jam bërë unë për t'u tallur. Morët vesh?

Askush nuk e priste klithmën e saj. Të gjithë u shtangën me një keqardhje të thellë, që nuk i kishin kushtuar sadopak vëmendje. Do ta kishin vënë re me kohë brengosjen e saj dhe do ta kishin shmangur sherrin. Por askush nuk dyshoi se ajo ndjehej thellësisht e fyer. Zëri i saj ishte i dëshpëruar e i thërmuar nga dënesat. Ç'na gjeti?! psherëtiu njëri nga anëtarët e komisionit. Vajza e dëgjoi dhe i hodhi një vështrim të zemëruar. Por nuk foli. Ajo priste tashmë.

Fundi i pasdites, mbrëmja dhe nata kaluan në përpjekjen sinqerisht të mundimshme për ta pajtuar shoqen. Më kot. Ajo nuk ngushëllohej. Nuk pranonte asnjë ndjesë. Lotët e saj kishin qenë të pashterrshëm dhe nën dritën e zbehtë shkëlqenin mbyturazi si unaza të pluhurosura. Secili nga të pranishmit zgjodhi fjalët më prekëse për ta siguruar shoqen për respektin e veçantë, që ndjente ndaj saj. Ajo nuk përgjigjej. Vetëm vazhdonte të qante. Ishte mënyra e saj për t'ua shprehur mosbesimin, apo kërkonte diçka tjetër?! Të gjithë mendonin, natyrisht pa ia pohuar njëri-tjetrit, se sherri mund të mbyllej vetëm nëse gjithçka paraqitej dhe pranohej si një shaka e thjeshtë. Një shaka e tepruar, e papërshtatshme, e pazgjuar pa dyshim, por prapë shaka. Dhe ata ishin të bindur se plaku i prapë kishte bërë një shaka, nga ato që Selimi bënte gjithnjë e më shpesh vitet e fundit. Ndoshta do të ishte më e dobishme që çështja të shtrohej ndryshe: nga i kishte ardhur Selimit ky damar i ri për shaka të tilla djegëse? Kësisoj do të çelnin një debat vërtet serioz dhe diskutimet i mbështesnin me citime nga fjalimet e shokut Enver. Por ata kishin tashmë një përvojë të mjaftueshme nëpër zyra, që ta parandjenin se cila ishte fjala e rrezikshme, që duhej shmangur deri në fund. Shakaja nuk lejohej kurrsesi të përmendej, për sa kohë ishte përqeshur Stalini dhe në të ishin përzier edhe ata vetë.

Në mëngjes sytë e tyre ishin të rrethuar me valle të zeza, ndërsa ata të vajzës të skuqur e të enjtur. Por askush nuk do të merrte guximin të ankohej.

-Ti po shkatërron veten,- iu drejtua dhemshurisht shoqes njëri nga anëtarët më të sprovuar e të respektuar të komisionit për festimin në qytetin tonë të shtatëdhjetë vjetorit të lindjes së Babait të popujve të shtypur, Stalinit. Ishte i njëjti që, të mbrëmshmen, kishte shprehur me mërmërimë bezdisjen duke psherëtirë: "ç'na gjeti?!".

Vajza-shoqe u gjallërua përnjëherësh. Nëpër sytë e saj të skuqur e të enjtur flakëroi një vetëtimë e njohur

zemërimi.

-Nuk jam bërë unë për t'u mëshiruar,- tha ajo.- E sidomos jo nga ti. Ke qysh mbrëmë që lëshon vetëm thumba.

-Më fal, shoqe, më fal!- u tërhoq tjetri dhe kërkoi me një vështrim të pjerrët mbështetjen e shokëve. Askush nuk iu përgjigj. Por ai nuk u ligështua.- E kisha për të mirën tënde, të betohem.

-Po ti, shok i dashur, për çfarë kërkon falje?- ndërhyri si zakonisht sekretari i parë .

Në sallë u përsërit heshtja e keqe.

Anëtar i komisionit kishte qëlluar edhe më dinak nga ç'njihej. Para se të përgjigjej ai u mendua një hop, si për t'i përgatitur disi ata që e dëgjonin.

-Unë kërkoi falje për diçka, që duhet të kërkojmë të gjithë,- tha ai me një zë të sigurtë.

U shkëmbyen vetëtimthi një mori vështrimesh të shastisura. Sekretari i parë u përpoq të mos e humbte toruan. Atij nuk i pëlqeu kundërvënia e tjetrit. Një parandjenjë e keqe ia përshkoi trurin.

-Po të dëgjojmë,- iu drejtua thatë.

-Ne të gjithë duhet të shtrijmë dorën e të kërkojmë falje para Partisë për nivelin e ulët politik e ideologjik që dëshmuam dje.- Ai ngurroi një hop, thua se nuk i kujtohej nëse ngjarja kishte ndodhur të djeshmen apo të pardjeshmen.- E them me zemër të hapur, më vjen turp nga vetja dhe pyes: ku e kisha mendjen? Erdhi tjetri nga rruga, (U vu re se ai i maste mirë fjalët. Nuk tha: u thirr tjetri nga rruga.) u tall me Stalinin tonë të madh, u tall edhe me shoqen tonë më të mirë e më të devotshme, para syve tanë dhe asnjëri nga ne nuk ishte i aftë t'i tregonte vendin. Për mendimin tim, kjo që na ndodhi, për ne si komunistë është shumë e rëndë. Ju ftoj të gjykojmë së bashku për veten tonë.

Qëndrimi i të pranishmëve me kokën ulur e bënte edhe më të rëndë heshtjen që vazhdonte. Ata e vidhnin me bisht të syrit folësin e rrezikshëm, me shpresë të zbulonin në fytyrën e tij ndonjë shenjë shakaje. Ose pavendosmërie për të shkuar më tutje. Ose ndonjë shenjë çmendurie. Kishin kaq orë me nerva të tendosura. Ishin të rrëgjuar. Gjithçka mund të ndodhte. Por jo. Ai nuk reshtte së mbushuri heshtjen me një seriozitet dhe qartësi të frikshme. Pati nga ata që e mallkuan Selimin dhe rastësinë që e shtyu plakun të kalonte atë ditë pikërisht ndanë ndërtesës së komitetit të partisë të rrethit, ku ishin mbledhur ata, dhe sekretarin e parë , që djalli, vetëm djalli ia shtiu në kokë për ta thirrur këshilltarin e mbrapshtë. Kishte qenë me të vërtetë një ditë

## *Daullja prej letre*

e zezë. Po askush nuk e mallkoi nënën e Stalinit, që kishte zgjedhur një stinë të tillë, kur gjaku ndërrohet e mendja harbohet, të lindte gjeniu e njerëzimit shtatëdhjetë vjet më parë.

Heshtja zgjati dhe do të kishte zgjatur derisa ndonjëri nga anëtarët e komisionit të zalisej, e të plasej me kokën pas tryezës, duke nxjerrë shkundë të bardhë nga goja, sikur sekretari i parë të mos kujtohej të bënte detyrën. Parandjenja e parë e keqe i kishte lënë gjithandej nëpër kokë një vragë të turbullt kërcënimi. Ai e mblodhi veten, pastroi zërin me një qetësi të detyruar, dhe i dha të drejtë shokut që kishte folur, dhe kërkoi një analizë të thelluar nga secili. Lindi një shpresë e vakët për afrimin e fundit të kësaj mbledhjeje, bashkë me një panik të vrullshëm. Ftesa që secili ta gjykonte veten ishte zakonisht thirrja e tërthortë për ta shkarkuar gjithë fajin mbi njërin. Nuk ishte faj ai që ndahej midis të gjithëve. Cili do të ishte fatkeqi? Sakaq, edhe në kokën e sekretarit të parë kërcënimi nuk ishte më dhe aq i vagullt. Po sikur të jem unë therori?

Por ata ishin gabuar edhe kësaj here.

Në të vërtetë analiza nuk zgjati. Qorrsokaku erdhi kur njëri nga shokët shtroi pyetjen që nuk shtrohej, se kush e kishte përgjegjësinë kryesore. Askush nuk dilte i larë, natyrisht. Por të gjithë nuk mund të dilnin të përlyer. Faji kishte qenë aq i rëndë, sa dikush duhej të përgjigjej më fort. Sekretarit të parë iu dridh buza. Ai shtrëngoi nofullat për ta fshehur tronditjen. Ai e mori si sulm kundër tij. Dhe nuk mund të merrej ndryshe. Ai ishte njeriu më i rëndësishëm i mbledhjes, i zgjedhuri për të drejtuar, dhe atij do t'i kishte takuar para të tjerëve të mos pajtohej. Sekretari i parë jo vetëm nuk ishte treguar i denjë për besimin, por edhe ishte bërë vetë shkak i të keqes, duke e thirrur Selimin nga rruga. Po sikur ndonjëri të pyeste nëse gjithë kjo ishte përgatitur më parë? Pse gjendej ai në dritare pikërisht në çastin kur andej do të kalonte Selimi? Ai nuk do të kishte asnjë shfajësim. Kur të vijë puna të shfajësimi, gjithçka ka marrë fund, tha ai me vete gati dëshpërueshëm. Do ta pësoj edhe unë si në historinë e daulles prej letre, përsëriti ai Selimin, pa e ditur përse ishte fjala. Dhe nuk i pëlqeu që po ia bënte kaq shpejt gjyqin vetes. Ai u përpoq ta fshihte sa më mirë inatin ndaj atij që e nxori diskutimin në një shteg të tillë të rrezikshëm. Sekretari i parë shpalli me një zë të tendosur se do ta vinin patjetër dhe në kohë gishtin mbi përgjegjësit, por më parë duhej të sqaronin synimin që kishte patur Selimi dhe nëse qëndronte dikush tjetër pas tij. Sidomos kjo e dyta kishte shumë rëndësi. Ai kishte folur qëllimisht

për "përgjegjësit" në shumës, gjë që pati ndikimin e dëshiruar të dëgjuesit: i shpërqëndroi ata. Ai mund të vazhdonte, më i sigurtë.

Sjellja dhe fjalët e Selimit u shqyrtuan nga secili dhe nga të gjitha anët për orë e orë, nën dritën qumështore të diellit të mëngjesit, nën dritën e kuqërremtë të diellit të pasdites dhe nën dritën e vërdheme të elektrikut. Por nuk u arrit dot në një përfundim. Nuk ishte fare e vështirë për ta veshur me një petk kundërrevolucionar të pafalshëm të ashtuquajturën këshillë të plakut. Sekretari i parë nuk e kuptoi menjëherë arsyen e ngurrimit të anëtarëve të komisionit dhe pati një fije dyshimi. Mos vallë bashkëpunëtorët e tij kryesorë ishin kurdisur më parë me plakun, kundër tij? Ndërsa ishte e kundërta. Anëtarët e komisionit nuk kishin kurrfarë mëshire për plakun dhe as nuk besonin se kishte ardhur çasti t'i lanin hesapet me drejtuesin e tyre. Të gjithë ata ishin të bindur se ndëshkimi i Selimit ishte i lehtë, ama nuk do të mjaftonte. Ai do të shënonte vetëm fillimin. Natyrisht, ideja e shakasë ishte plotësisht e përjashtuar tashmë. Përmendja e saj vetëm do ta rëndonte më shumë gjendjen, duke i bërë të tërë të pranishmit (përjashtuar sekretarin e parë ) njësoj bashkëfajtorë. U harrua lodhja dhe uria dhe mungesa e gjumit përpara kërcënimit të papritur. Asnjëri nuk ndjehej më i mbrojtur se tjetri.

Por, më i zbuluari ishte ai që e kishte pranuar si jo të keqe këshillën e Selimit për t'i dhuruar Stalinit shoqen e hirshme sekretare të rinisë. Gjatë natës dhe ditës ai e kishte marrë fare rrallë fjalën, duke u përpjekur me të gjitha mënyrat të jepte përshtypjen e njeriut që gërmon pamëshirshëm brenda vetes për të zbuluar të keqen dhe për ta shkukur atë. Këshillën që i kishin dhënë shokët të mendohej, ai e zbatonte si të ishte një urdhër. Në të vërtetë ai nuk e dinte për çfarë duhej të mendohej. Por e dinte gjithashtu se kjo nuk kishte asnjë rëndësi. E dinte mirë edhe se zgjatja e diskutimeve të tjera nuk ndryshonte asgjë në detyrimin e tij për të menduar dhe as nuk përbënte një shpresë që rasti i tij të harrohej apo të humbte rëndësinë. Shoqja sekretare e rinisë ndiqte me njëfarë hutimi atë që po ndodhte përreth. Herë pas here ajo vështronte vjedhurazi me një kureshtje të re, prekëse, duart e veta të djersitura lehtë. Dhe sidomos joshej t'i prekte, si për t'u bindur se vërtet nën lëkurën e bardhë kishte shtëllunga resh. Ajo u zu krejt në befasi kur dëgjoi sekretarin e parë të përmendte emrin e saj. Sikur u zgjua nga një ëndërr. Nuk kishte patur asnjë parandjenjë dhe vetëm mungesa e guximit e kishte penguar për të kërkuar lejë të largohej.

Vaji i gjatë e i thellë e kishte lodhur më shumë se qëndrimi në vend. Dhe ndjente një dëshirë të panjohur, që i rritej fshehurazi, të gjendej vetëm. Kudo, me kusht që të kishte një pasqyrë. Vajzën e përfshiu një valë e papritur turpi nga pantallonat e veta. Sikur jam ushtare, tha me përçmim për veten. Por nuk pati kohë të skuqej, si zakonisht.

-Po ti çfarë ke për të na thënë?- iu drejtua sekretari i parë. Ai e përfshiu me një vështrim të rreptë.

Të gjithë besuan se po vinte radha e ndëshkimeve. Dhe e para do ta pësonte ajo, që brofi e trembur si një fëmijë e zënë në befasi. Le të fillohej me atë, që kishte hapur një telash aq të madh me ankesën e saj të panevojshme. Askujt nuk i vinte keq. Më mirë të laheshin shpejt hesapet me të. Ishte një hakmarrje, por edhe një çelje shprese. Ndoshta koka e saj do të mjaftonte.

-Unë?! Asgjë,- u përgjigj ajo hutueshëm.- Bashkohem me shokët.

-Prit! Mos u nxito! Me shokët nuk bashkohesh dot,- u hodh njëri, si të kishte qenë i porositur. Ai mblodhi vështrimet përgëzuese përreth dhe vazhdoi:- Secili nga ne ka pjesën e vet të fajit, kjo është e qartë. Dhe do ta mbajmë këtë përgjegjësi, kokulur nga turpi e me zemër të prekur thellë para Partisë. Por e jotja është më e madhja. Unë kështu mendoj. Shokët le të gjykojnë.

Sallën e mbushi një mërmërimë e papërcaktuar. Njerëzit nuk e kishin pikasur nga do të anonte sekretari i parë, që të hidheshin në sulm.

-E imja?! Pse?- Vajza priti më kot një çast, që sekretari i parë t'i vinte në mbrojtje.

Ndodhi e kundërta.

-Nuk e kupton, thua? Apo nuk të pëlqen ta kuptosh?- ndërhyri sekretari i parë me një ton kërcënues.

-Nuk e kuptoj,- u përgjigj vajza duke e mbledhur veten. Edhe tek ajo ishte zgjuar instinkti i rrezikut.

-Aq më keq për ty. Po ta them unë dhe rrase mirë në kokë: me dashje ose pa dashje, ti bërë punën e atij gojëhelmit,- ia ktheu sekretari i parë.

-Unë nuk kam faj pse atij i mbetën sytë tek unë. Pastaj ju me përvojë më të madhe se unë, ku ishit ju? - u përpoq të mbrohej vajza. Ajo nuk ishte përgatitur për një sulm kaq të fortë. I kishin shterruar lotët dhe i digjte fyti. Ishte ngritur pavetëdijshtë në këmbë. Ajo nuk e përfytyronte dot vazhdimin. Rrëshqitazi vështrimi i zuri gjunjët e vet të mbuluar me pantallona dhe nëpër kokë i farfuriti një mendim marrok: a do të silleshin shokët ndryshe nëse ajo do të mbante fustan? Ishte e vetmja femër ndër ta. Nuk pati kohë as të dëshonte.

## Besnik Mustafaj

-Po duart që i zgjate, të na i tregoje ne, që t'i shihnim mirë e të bindeshim se ai kishte të drejtë?! Ishe ti, apo jo?! Fol hapur, thuaj se të pëlqeu!

-Nuk është e vërtetë. Tjetër kujt i pëlqeu. E dëgjuam të gjithë.- Ajo shenjoji me një vështrim të përshkënditur njeriun që kishte radhën.

Ai që e kishte quajtur dikur të mirë këshillën e Selimit u rrëqeth. Nuk e priste kaq shpejt.

-Ç'ke me mua ti?! Përgjigju për vete!

Sekretari i parë nuk lejoi që midis tyre të niste sherri. Ai e la mënjane shoqen sekretare të rinisë dhe pyeti fajtorin e fillimit nëse i kishte mjaftuar koha që të mendohej thellë. Ishte njësoj si t'i thoshte: ky është fundi yt. Fajtori, që mund të ishte kryetari i sindikatave ose përgjegjësi për arsimin në rreth, miratoi pafuqishëm me të tundur të kokës. Sekretari i parë ishte i vendosur të mos i linte asnjërit rast të thoshte gjithë ato që kishte në mend. Ndryshe, më i kërcënuari nga të gjithë do të ishte ai vetë, që e kishte thirrur nga rruga Selimin ndjellakeq dhe për më tepër, e kishte lejuar t'i tirte gjerë e gjatë lajthitjet e veta. Atij i rrëshqiti instinktivisht vështrimi në duart e sekretares së rinisë dhe u hutua pak nga drithërima që e përshkoi. Duart e vajzës qëndronin shkujdesur mbi tryezë si dy zogj të fjetur. Vërtet përkëdhelja e tyre mund ta rinonte njëzet vjet Stalinin? Vetëm Stalinin, apo çdo burrë? Ai mendoi për moshën e vet. Po t'i hiqeshin njëzet vjet, do të mbetej një djalosh ende i papërfillshëm nga të mëdhenjtë. Dhe sidomos nga vajzat. Jam i lodhur, tha dhe fërkoji ballin me një dyshim të papritur mos ishte përgjumur. Nga dritarja hynte një dritë e plotë dhe e nxehtë hënore. Për të shlyer çdo dyshim përgjumjeje tek të tjerët, ai vazhdoi edhe një çast të hiqej si i kredhur në mendime.

-Ende nuk na ke thënë asgjë,- iu drejtua atij që duhet të ketë qenë kryetari i sindikatave të rrethit. Dhe zërit i dha një ton të lodhur.- Ne presim, po jo aq sa të plakemi këtu.

Fytyrat e burrave të pranishëm i përshkoi një buzëqeshje e fshehtë. Por jo aq e fshehtë sa shoqja sekretare e rinisë të mos e vinte re.

-Filluat prapë ju?- u hodh ajo dhe kërkoi edhe një herë mbështetjen e sekretarit të parë me një vështrim ngulmues. Ai u shmang dhe ajo u ndje tmerrësisht e vetmuar. Ndjeu përsëri nevojë të qante.

Burrat e pranishëm mblodhën supet me një habitje të shtirur. Sekretari i parë e kapi me vonesë gabimin e vet, por nuk i erdhi shumë keq. Padashur kishte zbuluar se Selimi ua kishte molepsur përfytyrimin edhe të tjerëve

## *Daullja prej letre*

ashtu si atij vetë. Duhej vepruar shpejt dhe fort.

-Përgjigjuni shoqes!- tha prerë.

Vajza mori më në fund frymë paksa e lehtësuar. Rrotull askush nuk bëzani. Me supet e mbledhura ata burra ngjanin më të vegjël e të përcudshëm. Më mirë një femër me pantallona, tha vajza gjithë neveri. Nga këta duhet pritur gjithçka, tha me vete sekretari i parë, duke menduar me inat për marrëzinë e vet: thirrjen e Selimit për t'i këshilluar në një çështje aq delikate. Radhën për t'u vënë në qendër të sulmeve e kishte ai që kishte folur i pari për nivelin e ulët të edukimit të tyre ideologjik e politik. Ai nuk e kishte përjashtuar nga faji as sekretarin e parë dhe ky ishte një guxim i tepërt, për të cilin ai duhej të paguante shtrenjtë dhe pa vonesë. Për ndryshe ai do të shkonte shumë larg, deri në fund dhe me siguri do të shpallej shpëtimtari i vijës së Partisë nga ata që nuk e donin sekretarin e parë. Ai nuk e kuptoi nga i erdhi edhe një herë dëshira të përvetësonte shprehjen e pakuptueshme të Selimit: dhe unë do ta pësoj si në historinë e daulles prej letre.

-Ja, përgjigjiju ti i pari ankesës së shoqes!- iu drejtua.

Tjetri mori sakaq një pamje të vërtetë prej të humburi. Dukej që i kishte hyrë frika në palcë, gjë që i pëlqeu sekretarit të parë dhe i dha zemër.

-Unë gati jam t'i përgjigjem shoqes dhe ju të gjithëve, që përfaqësoni ndërgjegjen e Partisë, por nuk di çfarë më kërkohet. Ju betohem me zemër komuniste se nuk di gjë.

-Shpjegoja!- iu kthye vajzës butë, por në formë urdhëri sekretari i parë.

Ajo u skuq deri te veshët dhe rrasi duart thellë në xhepat e pantallonave, thua se donte t'i fshihte. Ajo ishte e para femër në krahinë që vishte pantallona. Mollëzat e gishtërinjve i digjnin.

-E di vetë ai,- tha ajo nëpër dhëmbë dhe mallkoi veten që nuk qante dot. I kam shterruar lotët kot, tha gjithë inat, si të kishte harxhuar panevojshëm diçka të çmuar.

-Unë s'di gjë, ju betohem,- u përgjigj i shenjuari. Nga fytyra e tij ishte davaritur shprehja marroke. Ai e kishte mbledhur disi veten.- Shoqja le të më thotë ç'pret nga unë! Jam gati t'i përgjigjem me zemër në dorë. Ose le ta ndihmojë shoku sekretar i parë! Ose ndonjë shok tjetër. Unë gati jam të dëgjoj dhe të kuptoj dhe të pranoj gabimet e mia, për të mos i pësëritur më kurrë.

Rrëshqite mirë, gjarpër, iu drejtua heshturazi sekretari i parë. Por nuk ke shpëtuar. Kot shpreson.

-Nuk kemi kohë për të humbur,- foli ai me zë më të lartë. Sytë kishin nisur t'i mjegulloheshin dhe ballin e

## Besnik Mustafaj

ndjente të ujcitur. U afrua instinktivisht te dritarja. Ajo ishte e hapur kanatash.- Nga vjen gjithë kjo vapë?- tha.- Pranvera sa ka hyrë dhe djeg si natë gushti. Vetëm gjinkallat mungojnë.

Sallën e kishte mbushur një qetësi e thellë. Ishte nga ato qetësi, që paralajmrojnë furtunën. Nga buzët gjysmë të hapura dhe qafa e zgjatur e shoqes sekretare të rinisë vinte një përmëritje e ëmbël. Selimi nuk ka vënë re pjesët më të bukura të vajzës. Duket që ka sy plaku, mendoi sekretari i parë me një kënaqësi të verbër.

-Nga vjen gjithë kjo vapë?- përsëriti ai, nervoz.

Qetësia e sallës nuk u trazua aspak. Sekretarin e parë e zuri paniku. Sytë e anëtarëve të komisionit ishin të gjithë të hapur e të përqëndruar mbi të. Në trotuarin ndanë ndërtesës së komitetit të partisë nuk dukej frymë njeriu. Andej ishte larguar Selimi. Ku ka shkuar? pyeti veten pa ndonjë kureshtje sekretari i parë. Dhe sakaq mallkoi siç nuk e kishte bërë kurrë: Shkoftë atje ku nuk ka kthim! Trotuari i zbrazur me pllakat e reja ngjante si i lyer me argjend qiellor. Ai nuk guxoi ta ngrinte vështrimin lart, nga frika se do të ndeshte në shtëllungat e bardha të reve dhe do t'i përhiheshin duart e buta të shoqes sekretare të rinisë.

-Kush e do fjalën?- thirri ai me një shpërthim të papritur, që nuk trembi asnjëri. Thirrma e tij mbeti pezull. Ata nuk e dëgjonin. Ata vetëm e shikonin. Ose ai vetë nuk i dëgjonte. Ai dyshoi se kishte humbur papritur zërin ose veshët, gjë që do ta mbyllte përgjithmonë të ardhmen e tij si sekretar i parë. Ai e dinte sa të çmuar ishin sytë. Por ata nuk mjaftonin për të drejtuar. Nevojiteshin edhe zëri, edhe dëgjimi- Askush nuk e do fjalën?- përsëriti ai me një ton të zbutur.

Në vend të përgjigjes, nga larg, si nga fundi i botës erdhi kënga e ngjirur e një gjeli të vetmuar. Nuk duhet të jetë këngë gjeli.

-Ne po presim,- tha salla.

Nga doli ky zë kolektiv? u çudit sekretari i parë. Buzët e të pranishmëve nuk kishin lëvizur. Ai ishte i sigurtë se buzët e të pranishmëve nuk kishin lëvizur. Sytë e tij nuk ishin shqitur për asnjë çast nga fytyrat e tyre të bardha, si të lyera me bojën e argjendit të trotuarit.

-Ai që pret jam unë,- nxitoi sekretari i parë t'u tregonte vendin hijeve mashtruese.

Në këtë kohë ra telefoni. Tringëllima e tij ishte metalike, e thatë, e prerë, si gjithmonë. E njohur njësoj për të gjithë anëtarët e komisionit. Sekretari i parë nuk u besoi veshëve. E kishte harruar fare ekzistencën e atij



## *Daullja prej letre*

aparati magjik. Ai u hodh me tërë trupin te doreza, i shtyrë nga një frikë e vetëdijshme se zilja nuk do të përsëritej. Ishte Komiteti Qendror i Partisë. Kërkonin të dinin përse dhurata e rrethit të tyre për Stalinin nuk kishte mbërritur në kohë. Delegacioni për në Moskë nisej pas disa orësh. Mos i kishte ndodhur gjë korrierit gjatë rrugës?

-Jo, jo,- u përgjigj sekretari i parë me një zë pafundësisht të lodhur.- Nuk kemi nisur asnjë korrier.

-Pse?

-Fajin e ka Selimi,- u përgjigj shpejt e shpejt sekretari i parë .

Duket se nga ana tjetër e fillit e pyetën se kush ishte Selimi.

-Një armik i popullit,- u përgjigj shkurt ai.

Nga ana tjetër e fillit e pyetën se çfarë kishte bërë ky armik.

-Eshtë përzier në një histori të ngatërruar me daulle prej letre.

1.

Nuk është përrallë, por nis si një përrallë.

Na ishte një fshat i vogël, por jo dhe aq i harruar, diku midis maleve të thepisura të Tropojës. Historia e njeriut aty është e moçme sa jeta e njeriut, por shkolla është çelur në fillimin e viteve pesëdhjetë të shekullit XX. Ndër mësuesit e parë ka qenë edhe një djalë i vendit, i quajtur M.B., i cili kthehej në shtëpi krenar dhe gazmor pas tri vjetësh të shërbimit ushtarak në Gardën e Republikës, ku kishte shkuar në sajë të ndërhyrjes të së motrës, Nelës, e cila thuhej se punonte në një zyrë të posaçme, në Postë-Telegrafën Qendrore në Tiranë. Në trupën e re pedagogjike ai ishte edhe më i riu në moshë e në zanat dhe i dhanë klasën e parë.

Tregohet se M.B. kishte gjetur shpejt një metodë origjinale politike dhe patriotike për t'i nxitur nxënësit e vet të dashur shtatëvjeçarë drejt përsosjes. Natyrisht që ua kishte shpjeguar qartë se vetëm duke përvetësuar mirë dituritë ata do të bëheshin bij të denjë të Partisë e të atdheut. Por ai nuk kishte mbetur te këto shprehje të përgjithshme e të harrueshme, të parashikuara në programin e ardhur nga ministria e arsimit. U vu re pa vonesë se suksesin më të madh ai e kishte patur në punët me shkrim, që zhvillonte me klasën. Fletoret e nxënësve të tij ishin të pastra e pa një njollë, pa një shkarravinë. Kolegëve apo prindërve kureshtarë e admirues, që dëshironin të dinin se si kishte arritur ai t'i shtronte aq mirë në punë të vegjlit e pamësuar me rregullin, M.B. nuk u përgjigjej menjëherë. Vetëm buzëqeshte, duke tundur kokën me nënkuptim. Dhe sytë e tij të kaltëremë, të mbushur me një vështrim të brendshëm, shndrisnin si luspa peshku në diell. Të gjithë në fshat e dinin se mësuesit tonë të ri i pëlqenin lëvdatat. Thoshin, pa të keq, se këtë zakon M.B. e kishte marrë në kryeqytet. Ai jetonte në një fshat ku nuk ishte zakon që lëvdatat të jepeshin falas. Por, në kryeqytet ai kishte mësuar edhe si t'ua shkëpuste njerëzve fjalën përkëdhelëse. Ata që donin të mësonin se si kishte arritur t'i shtronte aq mirë e aq shpejt

në punë të vegjlit, ai i shtynte ta përsëdytnin pyetjen, dhe me njëfarë këmbënguljeje madje, si t'i kërkonin çelësin e një enigme.

-Nxënësit e mi janë fëmijët tuaj. Janë brezi i parë që rritet me një kuptim të lartë për detyrën, me kuptimin komunist, - përgjigjej ai me një ton të papërcaktuar midis shakasë dhe pompozitetit.

Me të njëjtin ton, duke theksuar kryesisht pompozitetin, u ishte drejtuar M.B. të vegjëlve qysh ditën e parë të shkollës, tek u shpjegonte se fletoret e detyrave kishin një rëndësi të paçmueshme. Ato ishin pasqyra e shpirtit revolucionar të shkollarit. Fëmijët i përpinin fjalët e tij. Mësuesit M.B. nuk i kishte lënë asnjë përshtypje të keqe vështrimi adhuruës e pak i çmeritur i nxënësve. Përkundrazi. Kush bën një njollë boje në fletore, ai ka tradhtuar Partinë e atdheun, kishte përfunduar mësuesi.

-U kuptuam?

Fëmijët kishin lëshuar sakaq një POOO të gjatë e me plot zërin.

-Viti shkollor është i gjatë. Por unë nuk kam dëshirë t'ua përsëris më. Nuk do të jetë nevoja, apo jo?!

Fëmijët kishin miratuar me një JOOO po aq të gjatë dhe entuziaste.

Dhe vërtet, nuk kishte qenë më nevoja, që M.B. t'ua përsëriste nxënësve të tij rëndësinë që kishin fletoret e detyrave si pasqyra e shpirtit të tyre revolucionar. Herë pas here ai gjente gjurmët e ndonjë flete të shkukur, por hiqej sikur nuk e kishte vënë re. Ai e dinte shkakun dhe vetëm vidhte me kënaqësi me bisht të vështrimit fytyrën e përflakur të fajtorit të vogël. M.B. nuk e kishte menduar asnjëherë se çfarë ndjenjash të ndërlikuara ankthi e turpi e mbushnin kokën e pamësuar të nxënësit të tij në ato çaste.

Kjo lojë pati dobinë e vet disa muaj rresht. Nxënësit punonin të përqëndruar, shkruanin pak ngadalë, vërtet, por bukur, dhe fletoret e tyre ishin të pastra. Si uniformat e ushtarëve të Gardës së Republikës, mburrej M.B. para kolegëve të vet dhe prindërve të fëmijëve. Rregulli u prish gjatë një aktimi. Klasa ishte e kredhur, si zakonisht, në një qetësi të thellë. Dëgjohej vetëm zëri i mësuesit, që shqiptonte qartë fjalët dhe gërvishtja e lehtë e penave mbi letër. Gjithë kjo harmoni u ndërpre e u thërmua në një milion grimca e u ngri nga klithma tejet e dëshpëruar e një vajze:

-E shkreta unë ç'më gjeti!

Mësuesi M.B. u shtang ashtu si fëmijët. Fjala e fundit e tekstit, që diktonte, iu rrotullua nëpër fyt verbtazi dhe u shua si një rënkim. Kokat e nxënësve u ngritën

## *Daullja prej letre*

trembshëm. Vajza, që kishte klithur, vazhdoi e përmbytur nga lotët:

-Padashje, mësues. Unë nuk jam tradhtare, ju betohem për kokën e nënës e të babait e të vëllezërve e të motrave e për kokën tuaj, mësues. Unë nuk jam tradhtare e Partisë.

Mësuesi M.B. e kuptoi menjëherë se çfarë kishte ndodhur. Në fytyrën e tij u nder sakaq një buzëqeshje miqësore, e cila nuk e qetësoi aspak të voglën. Ajo nuk reshtte së përbetuari se nuk ishte tradhtare e Partisë. Dhe nuk u qetësua as nga fjalët siguruuese të mësuesit, i cili e dinte shumë mirë se ajo nuk ishte tradhtare e se Partinë e atdheun i kishte thellë në zemër. Sytë e mbushur me mosbesim dhe tmerr të vajzës së vogël derdhnin rrëke të vala lotësh. Mësuesi u ndje për herë të parë fajtor. Ai duhej ta ndreqte sa më shpejt gabimin dhe pa tërhequr vëmendjen te marrëzia e vet. Ndryshe vogëlushja, siç ishte e tronditur, nuk do të ngushëllohej.

Dhe e ndreqi gabimin, dhe pa vonesë, por në mënyrën më të papërshtatshme.

Ai iu afrua bankës së nxënësës së tronditur. Mori penën e saj dhe zuri ta shqyrtonte me kujdesin më të madh nga të gjitha anët. Në ballin e tij të ngushtë u thelluan tri rrudha. Vështrimi i tij u mpreh. M.B. e solli penën para e mbrapsht një grimë herë, tejet hulumtues. Pastaj, me një lëvizje të papritur e të vrullshme shkuli atë copë të vogël e të mprehtë metalike dhe e flaku gjithë inat në fund të klasës. Fëmijët i përshkoi një rrëqethje e përbashkët. Ata e ndiqnin me një palë sy të nemitur, si të kishin përpara një magjistar të dalë drejt nga bota e përrallave.

-Nuk është faji yt,- iu drejtua me një zë të dhemshur, por të sigurtë në vete, vajzës së vogël.- Fajin e ka pena, që kullon bojën. E kanë prodhuar keq atje, në Tiranë. Atje ka tradhtarë, jo në klasën tonë.

Klasën e mbushi një ofshamë e thellë lehtësuese. Të gjithë fëmijët dhe mësuesi me ta u çliruan nga një ankth.

-Vërtet?- kërkoi të sigurohej deri në fund e vogla.- Nuk ishte faji im?

-Sigurisht,- u përgjigj mësuesi, edhe ai i lehtësuar.

-Pata frikë për prindërit dhe për vëllezërit e motrat. Do t'i internonin për fajin tim,- belbëzoi ajo përmes një vale lotësh gëzimi.

Edhe mësuesi u mbush me frymë, i kënaqur. Dhe, për të mos i dhënë rëndësi asaj që kishte ndodhur, nxitoi të vazhdonte diktimin.

2.

Megjithatë, ngjarja mori një rëndësi të paparashikueshme. Qysh në pushimin pasues, të gjithë nxënësit e shkollës e kishin marrë vesh se në Tiranë kishte tradhtarë. Lajmi nuk kishte ardhur me gazetë. Nuk ishte thënë as në mbledhjen e organizatës së partisë të fshatit. Tradhtarët i kishte zbuluar mësuesi M.B. i klasës së parë, ai që kishte gjetur një metodë origjinale politiko-patriotike e që e ruante të fshehtë, për t'i vënë seriozisht në punë fëmijët shtatëvjeçarë të fshatit të tij.

Mësuesi i ri M.B., vëllai i vogël i Nela B., që punonte në një zyrë të posaçme në Postë-Telegrafën Qëndrore në Tiranë, ish-ushtari shembullor i Gardës së Republikës, që ishte kthyer në vendlindje të mësonte klasën e parë, u bë shumë shpejt heroi i të gjithë fëmijëve të shkollës. Ata e rrethonin plot adhurim dhe e mbytnin me pyetje nga më të çuditshmet. Si do të veprohej me tradhtarët, do t'i arrestonin apo do t'i linin edhe pak kohë, duke i ndjekur fshehurazi, që të zbuloheshin të gjitha lidhjet e tyre? Agjentë të kujt ishin, të amerikanëve apo të jugosllavëve? Mësuesi M.B. duket e pëlqeu lojën zbavitëse në të cilën u gjend papritur, dhe u vu me njëfarë dëshire ta vazhdonte. Ai u përgjigjej gjysma-gjysma, duke e përndezur më fort kureshtjen dhe përfytyrimin e të vegjëlve. Nuk u harrua as sendi i vogël, që u bë shkak për zbulimin e madh. Fëmijët u bënë tejet të vëmendshëm ndaj penave. I vështronin orë e çast nga të gjitha anët, të vendosur për të pikasur hilen e fshehtë të armikut. Ishin të bindur se veprimtaria sabotuese e tradhtarëve në Tiranë nuk kishte mbetur me një rast. Në tryezën e mësuesit M.B. mbledheshin për ditë një tufë sish, të shtrembëra, të nxira, të ndryshkura. Një thesar i pazakonshëm. Ai duhej t'i çonte atje ku do të nevojiteshin si prova. M.B. vazhdonte lojën pa u menduar më gjatë. Dhe argëtohej si kurrë më parë. Por edhe fëmijët i kishte pushtuar një ethe lumturuese, gjë që kishte rëndësinë e vet për mësuesin M.B.

Shqetësimin e parë M.B. e ndjeu kur njëri nga kolegët e pyeti krejt seriozisht nëse vërtet kishte zbuluar një grup komplotistësh në Tiranë. Mësuesi M.B. u lëkund për një çast në ishte më mirë ta fuste edhe tjetrin në lojën pafajshme të fëmijëve, apo t'i thoshte të vërtetën? Fytyra e kolegut kërkonte një shpjegim të bindshëm.

-Kjo është shakaja e shekullit,- iu përgjigj M.B. me të qeshur dhe i tregoi si kishte ndodhur. M.B. priti më kot që edhe tjetri të qeshte.- Si thua ti, a nuk është shakaja e shekullit?- nguli këmbë përsëri më kot M.B.

-Më duket se ke shkuar pak larg,- ia ktheu kolegu dhe

u largua me një pamje të papërcaktuar. I kishte besuar, që kjo ishte e vërteta mbi zbulimin e tradhtarëve në Tiranë?

M.B. e njihte kolegun e vet dhe e dinte se nuk ishte nga ata që bëjnë keq. Megjithatë u rrëqeth. Duhej ndërprerë menjëherë kjo lojë absurde. Në qoftë se nuk ishte tepër vonë tashmë, tha ai me vete me një panik të turbullt.

Dhe ishte tepër vonë, fatkeqësisht.

Qysh të nesërmen, para se të fillonte mësimin, M.B. u shpjegoi nxënësve të vet se historia e tradhtive, që ndodhnin në Tiranë kishte qenë vetëm një shaka. Ai nuk dinte si të ishte fare i qartë e bindës me ata fëmijë shtatëvjeçarë, të cilët e vështronin me ca sy lutës për të mos ua prishur magjepsjen. Ata nuk donin të besonin tashmë se mësuesi i tyre nuk ishte i jashtëzakonshëm. M.B. nuk i kishte dashur kurrë aq shumë nxënësit e vet sa në ato çaste. Ai ishte i mbushur me keqardhje dhe ndërkohë uronte fshehurazi që veprimi i tij të mos ishte tepër i vonuar. Paniku i turbullt që i kishte shkaktuar biseda me kolegun e vet, vetëm i ishte shtuar, pa iu sqaruar aspak. Çfarë mund të ndodhte? U kuptuam apo jo? Në Tiranë nuk ka tradhtarë. Dhe as nuk është tradhti ndaj Partisë e atdheut një njollë boje në fletore. Është vetëm një pakujdesi ose një punë e keqe, ose maja e penës është vërtet e dëmtuar, si në rastin e shoqes sonë.

Gjatë më shumë se një jave M.B. pati kohë të vinte re se përpjekja e tij për t'i dhënë fund keqkuptimit me nxënësit kishte shkuar dëm. Por ai nuk mori më asnjë shenjë të keqe nga të mëdhenjtë, dhe kjo ishte kryesorja. Gati po bindej se paniku i tij kishte qenë i kotë. Iu rralluan zgjimet trembshëm natën dhe gjumi iu qetësua disi. Natyrisht që mbarë fshati ishte në dijeni të zbulimit të tij dhe askush nuk i fliste për gjë tjetër. Ai nuk shqetësohej dhe as nuk hynte në shpjegime të hollësishme, derisa askush nuk ia kujtonte se mbase kishte shkuar tepër larg. Ai dëgjonte vetëm përgëzime. Nxënësit nuk i kishin përcjellë nëpër shtëpira shpjegimet e tij të fundit ose ato nuk kishin zënë vend. Në këtë pasiguri, M.B. e quajti të arsyeshme t'ua përsëriste të vegjëlve e të mëdhenjve të fshatit se kishte qenë vetëm një shaka. Dhe sa më shumë ngulte këmbë, çuditërisht aq më i pabesueshëm bëhej. E dimë ne, këto punë nuk thuhën rrugës, janë sekrete shtetërore, i përgjigjeshin ata duke i shkelur syrin me mirëkuptim dhe M.B. mbetej i paafte të mbrohej. Mungesa e shenjave kërcënuese ia zgjonte herë pas here dëshirën e vjetër për aventurë. Pse të mos u shkonte pas fillit? Ishte vërtet shakaja e shekullit. Vetëm instinkti i

fortë i vetëmbrojtjes e detyronte të përmbahej disi. Por jo mjaftueshëm.

3.

Ishte e thënë që mësuesi M.B. të bëhej realisht hero për disa muaj. Shakaja e tij e pazakonshme përkoi në kohë me një spastrim të rëndësishëm në udhëheqjen më të lartë të Partisë e të shtetit. U zbulua se dy nga anëtarët më të fuqishëm të Byrosë Politike dhe disa ministra punonin qysh në fillim të revolucionit për të huajt. Ishin agjentë të jugosllavëve. Ata dhe bashkëpunëtorët e tyre morën dënimin që meritonin: me vdekje.

Në fjalimin dritëdhënës, ku analizonte veprimtarinë e grupit të rrezikshëm komplotist, Enver Hoxha kishte thënë se Partia i zbuloi nepërkat që ishin futur në gjirin e saj, me ndihmën e popullit. Për organizatën e partisë të fshatit ku kishte lindur e ku jepte mësim M.B. në këtë fjali pohohej roli i rëndësishëm që kishte luajtur biri dhe mësuesi i fëmijëve të tyre në këtë ngjarje të madhe. M.B. nuk po u besonte syve as veshëve. Do të organizohej një mbledhje e gjerë me mbarë fshatin për të falenderuar heroin e tyre. Ata ishin krenarë. M.B. nuk guxoi të kundërshtonte fort. Po t'u thoshte prerazi se ishin keqkuptuar e se ai nuk meritonte gjëkundi lavde të tilla të larta, komunistët e fshatit mund ta vinin përpara përgjegjësisë: ke dashur të mashtrosh apo të tallësh me Partinë, me kryeqytetin tonë, me fëmijët tanë, që rriten për t'i shërbyer revolucionit? Për kë punon ti? Si t'i bindte se ai nuk kishte dhënë asnjë ndihmë në zbulimin e atyre që deshën t'i hidhnin helmin në vesh Partisë dhe as nuk kishte dashur kurrsesi të tallej me gjëra të tilla të shenjta? Ishte e pabesueshme që gjithë ata burra ta merrnin për të vërtetë një lodër të tillë të thjeshtë, që kishte sajuar ai për t'i nxitur nxënësit e vet të vegjël të punonin mirë. M.B. u dorëzua pak nga pak me mendimin se duhej të kishte medoemos ndonjë arsye tjetër, që ai nuk e përfytyronte dot, për shpalljen e një heroi në këtë fshat. Ai u ndje pak i fyer pse i jepnin një rol aq të madh si ky i heroit pa i shpjeguar asgjë. Por nuk guxoi të pyeste. Pastaj zuri edhe t'i pëlqente të ishte në qendër të vëmendjes. Të gjithë e nderonin dhe e vështronin me njëfarë adhurimi dhe frike të çuditshme. M.B. zuri të jetonte mekanikisht si në një ëndërr marramendëse. Ai nuk ishte mësuar që fjetet e lojës së sajuar nga ai vetë t'ia tërhiqte dikush tjetër, i padukshëm. Për më keq, ai nuk e dinte se cili ishte ky dikushi dhe as nuk e dallonte dot çfarë qëllimi kishte, gjë që e fundoste në një errësirë tmerruese.



Duke i sjellë e risjellë nëpër mend gjithë ç'po i ndodhte, atij i lindi një hamendje e ndryshme, më e pëlqyeshme. Shakaja e tij, të cilën nuk guxonte më ta quante shaka, por edhe nuk dinte ç'emër t'i vinte, me siguri ishte shkruar këtu, në fshatin e tij, dhe përcjellë lart, nga një zyrë në tjetrën, pse jo deri në Tiranë. Me siguri deri në Tiranë. Dhe nuk ishte përcjellë si një shaka e papjekur e një mësuesi fillestar me fëmijët e klasës së parë. Pra, ishin lënë mënjanë hollësitat "maja e penës së prishur", "njolla e bojës në fletoren e diktimit", "tronditja e vajzës së vogël" etj. Ajo që nevojitej për t'u vënë në dukje, ishte se mësuesi M.B., një bir i thjeshtë i popullit, ish-ushtar shembullor në Gardën e Republikës, dyshonte se dikush në Tiranë zhvillonte veprimtari armiqësore. Kaq kishte mjaftuar që të tërhiqej vëmendja e drejtuesve kryesorë të Partisë te problemi i madh. Në fund të fundit kaq kërkohej nga populli. Mandej hulumtimi për të gjetur fajtorët kishte qenë gjithsesi më i lehtë dhe ishte kryer nga njerëzit e zanatit. Nuk kishte pse të mos qëndronte një hamendje e tillë, derisa M.B. po i thureshin aq shumë lavde. Ai mësoi se shërbimi tri vjet në Gardën e Republikës kishte qenë shkolla e pazevendësueshme e edukimit të tij atdhetar e revolucionar. Një ceremoni e tillë nuk mund të ishte thjesht lajthitje naive e një grushti komunistësh të paditur fshati, të cilët kërkonin rastin për t'i dhënë pak nam vetes dhe vendlindjes së tyre të largët, disi të humbur në zemër të maleve.

U bë kështu mbledhja e gjerë me gjithë banorët e fshatit. Kishte të ftuar edhe nga fshatrat fqinje. U mbajtën fjalime të zjarrta dhe, kuptohet, u ngrit në qiell mësuesi M.B., biri i tyre më i mirë. Festë e vërtetë për t'u mbajtur mend, që u mbyll me raki, me mishra të pjekura në hell, me këngë e me valle. M.B. falenderoi thjesht, ashtu siç u pëlqente festuesve euforikë të lavdisë së tij. Tha se ky nder ishte tepër i madh e se nuk i takonte vetëm atij, por edhe nxënësve të tij e prindërve të tyre. Në fund u lexua publikisht edhe letra që do t'i dërgohej shokut Enver. Aty i tregohej udhëheqësit të shtrenjtë se si biri i tyre M.B. ishte përsosur gjatë tri viteve si ushtar në Gardën e Republikës sonë Popullore, dhe tani, me punën shembullore që bënte si mësues për edukimin e fëmijëve të tyre me dashurinë dhe besnikërinë e pakufishme për Partinë e për Atdheun, ngjallte frymëzimin e mbarë popullit. Natyrisht që nuk përmendej drejtpërdrejt roli i tij në zbulimin e bandës komplotiste. Nuk ishte nevoja, u kishte thënë M.B. hartuesve të letrës, duke ua fshehur me zor shqetësimin që i kishte ngjallur një mundësi e tillë. Sekretari i organizatës



së partisë e kishte marrë sjelljen e tij si dëshmi modestie dhe M.B. ishte detyruar të sajonte njëqind arsyetime absurde për ta bindur. Ai do të kishte dashur ta pengonte vetë letrën të nisej, por kjo gjë ishte e pashmangshme tashmë.

M.B. nuk iu davarit shqetësimi deri ditën kur shoku Enver u përgjigj. Këtu M.B. e humbi plotësisht fillin. Ai nuk dinte më as ç'të bënte e as ç'të mendonte. Nuk ishte më si në ëndërr. Ishte si në jerm. Si ka mundësi? Gjithë letra e Enver Hoxhës vërtitej rreth tij. Ai i porosiste komunistët e fshatit ta donin, ta respektonin, ta ndihmonin pa kursim e t'i besonin mësuesit të tyre të nderuar. Ai fliste për M.B. si ta njihite mirë dhe lëvdonte pa kursim cilësitë e tij të larta si mësues e si qytetar. Natyrisht që as Enveri nuk përmendte ndonjë meritë të M.B. në shpartallimin e grupit të fundit të armiqve të ngjitur deri në kreun e Partisë. Por fjalitë e tij ishin aq të shtrira, sa mund t'u përshtateshin lehtësisht edhe nënkuptimeve të pashembullta, që mbushnin kokat e komunistëve të fshatit, të cilëve u drejtohej letra. Ai thoshte, për shembull, se mësuesit si M.B. qëndrojnë në vijën e parë të luftës kundër të kaluarës reaksionare. Marrësit e letrës e kishin fare të qartë përse ishte fjala. M.B. nuk i mbetej veç t'i gëzohej lavdisë së paparashikuar.

Në sytë e fshatarëve mësuesi M.B. u bë një personazh më shumë se i rëndësishëm. Ai përfaqësonte një mister të madh, gjë që shumë shpejt solli edhe lindjen e legjendës. Fshati i tyre ishte buzë kufirit. Diku andej kalonte një nga rrugët e vjetra për të lidhur Shqipërinë Qëndrore me Kosovën e që vazhdonte deri në Beograd e në Sarajevë. Ishte një rrugë e vdekur prej kohësh për karvanet tregtare dhe për udhëtarët kureshtarë. Por jo për shërbimet sekrete shqiptare dhe të huaja, me sa duket. Të paktën kështu besohej nga të gjithë. Dhe M.B., ashtu i veshur thjesht dhe i dashur me nxënësit, me prindërit e tyre dhe me kolegët, drejtonte në të vërtetë një rrjet të fuqishëm informativ, që vepronte në Jugosllavi. U zbulua, madje, edhe emri i koduar i rrjetit të tij e që ishte DAULLJA PREJ LETRE. Njerëzit e tij ishin deri në kabinetin dhe në shtabin e përgjithshëm të ushtrive të Titos. (Dy anëtarët e Byrosë Politike dhe bashkëpunëtorët e tij ishin dënuar si agjentë të jugosllavëve.) Gjatë tri vjetëve të shërbimit në Gardën e Republikës ai nuk kishte qenë një ushtar i thjeshtë, i ngulur me pushkën në gjoks para derës së një ndërtese qeveritare. Ai ishte përgatitur me kujdes për detyrën shumë të rëndësishme, që do të kryente në të ardhmen. M.B. e dëgjoi këtë legjendë në të gjitha versionet. Dhe

## *Daullja prej letre*

qeshi sidomos me emrin e koduar të rrjetit të tij. DAULLJA PREJ LETRE. Kush e kishte një imagjinatë të tillë çmendurake? Asnjëherë ndokush, madje as miqtë e tij më të afërm, nuk e pyetën më nëse kishte diçka të vërtetë në këtë gojëdhënë. Këto nuk ishin pyetje që bëheshin. Por as ai nuk u përpoq ta përgënjeshtronte. Përkundrazi, duke qeshur si i marrë, e ushqente.

4.

Në mbarim të vitit shkollor, M.B. ishte i vetmi që shokët nuk e pyetën se ku do t'i kalonte pushimet. Dhe as ai nuk u foli, i shtyrë thjesht nga ndjenja e kotësisë për t'i fryrë edhe pak fantazisë së tyre të shturur. Në të vërtetë edhe nuk do të kishte ç'tu thoshte. Ai nuk kishte parashikuar asgjë. Ndoshta do të shkonte disa ditë në Tiranë, tek e motra.

Por, pas gjithë atyre që kishin ndodhur muajt e fundit, M.B. nuk u çudit dhe as nuk kërcëu nga gëzimi kur e njoftuan papritur se kryesia e sindikatës së mësuesve të rrethit e kishte caktuar për të pushuar falas gjatë gjithë muajit korrik në bregdet, në Shtëpinë e Pushimit të Punëtorëve. E pranoi si diçka që i takonte pa e kërkuar. Shumë mirë, tha me vete. Nga natyra M.B. nuk ishte shumë kureshtar. Tani ishte bërë skajshmërisht mospërfillës ndaj ngjarjeve që e përfshinin. Thjesht dorëzohej dhe ndiqte rrjedhën, duke synuar të argëtohej pa i lejuar vetes asnjë parandjenjë të mbrapshtë.

Në shtëpinë e pushimit dhomat ishin për dy veta. Kjo gjë nuk i bëri ndonjë përshtypje të keqe personazhit tonë. Si zakonisht, ai nuk kundërshtoi e as nuk u gëzua që do t'i kalonte netët dhe disa orë të ditëve në shoqërinë e një të panjohuri. Kushtet iu dukën fare të pranueshme. Ai nuk ishte mësuar të jetonte më mirë dhe as nuk kishte ndonjë mendim të lartë për rehatinë e veçantë të pushimeve. Ai e priti me të njëjtën qetësi edhe njohjen me bashkëbanorin e dhomës. Ishte një burrë pak më i moshuar se ai, por kurrsesi i vjetër, dhe, siç u paraqit, gjithashtu mësues fshati. Në jug. Quhej Mersin. Unë gërhas nganjëherë, e paralajmëroi me një ton disi asnjës M.B. Unë kam një gjumë të thellë, nuk ndjej asgjë sikur topat të bien, e siguroi tjetri. Por fle herët dhe zgjohem shumë herët. Shëtitjet e mëngjesit, kur ndjehet aroma e jodit, më japin jetë. Mua më shumë jetë më japin ëndrrat e mëngjesit. I kam gjithmonë të bukura, ia ktheu M.B. me shaka. Do të përpiqem të mos bëj zhurmë, tha Mersini. seriozisht. M.B. e quajti të nevojshme ta vinte në dijeni që nuk flinte dot para mesnatës. Zakon i mbetur nga jeta në konvikt. Por

jam i urtë, shtoi me të qeshur. Në dhomë kthehem në kohë, vetëm dhe asnjëherë i dehur. Tjetri iu përgjigj se drita nuk ia trazonte gjumin. M.B. do të kishte dashur që toni i shokut të ri të ishte më pak serioz. Megjithatë, mund të thuhet se u morën vesh për bukuri. Do ta kalonin mirë.

Por kjo marrëveshje e nevojshme u prish qysh mbrëmjen e tyre të dytë. Mersini flinte. Ndërsa M.B. lexonte, duke pritur pa asnjë shenjë padurimi të ndjente rëndimin e vonuar të qepallave. Herë pas here vidhte me bisht të syrit shtratin e tjetrit, i pushtuar befas nga një zili e çuditshme për gjumin e tij të qetë. M.B. kishte një përcëim të fshehtë ndaj vetes për gërhimat e pavullnetshme që i lëshonin fyti dhe hundët gjatë natës. Duhet të kem ndonjë mish të huaj në flegat e hundës, mendoi M.B. dhe vendosi të përfitonte nga rasti për t'u këshilluar me ndonjë kirurg. Në fshatin e tij nuk kishte ende as infermier.

Papritur Mersini foli:

-Pse më vështron?

Zëri i tij ishte i kthjellët e i qëruar dhe pa ndonjë gjurmë gjumi. M.B. mëmëriti diçka të pakuptueshme nëpër dhëmbë, i zënë në befasi, dhe buzëqeshi me një ndjenjë të pavullnetshme fajësie. Ndërkaq, nëpër trurin e tij rrëshqiti vetëtimthi një dyshim që nuk do t'i shqitej më kurrë. Mersini hiqej sikur flinte. Qetësia e tij ëngjëllore ishte e gënjeshtërt. Po përse shtirej? Çfarë përgjonte? Dhe pse përgjonte? Dhe kush e kishte vënë të përgjonte? Ishin një mori pyetjesh shkatërrimtare. M.B. shau veten që kishte pranuar dhuratën e kryesisë së sindikatës së arsimit. Unë jam gomar, tha. Kush të fal një muaj pushime në breg të detit, me të ngrënë e të fjetur pa një arsye tejet të fortë?! Sidomos në këtë kohë, kur shteti bën natë e ditë thirrje për të përcuar regjimin e kursimeve. Si nuk dyshova një fije, të paktën, pse do të më bëhej mua një nder i tillë? Sikur kisha pjellë vezën e kuqe! Ai nuk dinte si t'ia shfrynte vetes inatin për mendjehetësinë që kishte treguar. Por e kuptonte se nuk tërhiqej dot tashmë. Duhej të shkonte deri në fund. Ai i përsëriti vetes shumë herë se ishte në rregull me gjithçka: libri që po lexonte ishte shqip dhe i botuar në Tiranë dhe pas çlirimit dhe i shërbente për zanatin e mësuesit; ai rrinte i shtrirë në shtratin e vet dhe as i zhveshur me tepri dhe nuk bënte asnjë zhurmë. Në dhomë kishte ardhur herët, pas një mbrëmjeje të shkurtër, të kaluar qetësisht në restorantin e shtëpisë së pushimit, pa vënë në gojë asnjë pikë alkool, pa i hedhur asnjë vështrim të tepërt ndonjë gruaje dhe pa shkëmbyer me njeri ndonjë shaka me dy kuptime. Pra, përgjimi do të ishte i kotë, tha

## *Daullja prej letre*

ai pa u siguruar dot. Mbetej një pikë, ku M.B. nuk sigurohej dot: atij nuk i kujtohej çfarë kishte menduar gjatë orëve që tjetri e kishte përgjuar fshehurazi. Madje nuk i kujtohej asgjë, as edhe çfarë shkruhej në faqet e lexuara të librit, që mbante në dorë, dhe kjo e trondiste më tepër. Me siguri kishte menduar diçka të palejueshme dhe këtu ndërhynte në mënyrën e vet misterioze i quajhuri Mersin, i cili kishte, fshirë gjithçka nga truri i tij. Natyrisht, pasi kishte mësuar mirë çfarë fshihej brenda kafkës së M.B. Atij iu kujtua legjenda agjenturore DAULLJA PREJ LETRE dhe mendoi se nuk kishte qenë gjë tjetër veç një paralajmërim i stërholluar për kurthin që po i përgatitej. Ai nuk kërkoi arsyet e këtij kurthi. E ndjente veten fajtor.

Mersini nuk e përsëriti më pyetjen. Ai u krodh në një heshtje të re, të plotë, pa asnjë shenjë të njeriut, që një çast më parë ishte shqetësuar nga vështrimi i fqinjit të vet. Ishte e qartë. M.B. digjej nga dëshira të shihte nëse ai kishte marrë rishtas pamjen e njeriut të humbur në gjumë. Më merr për budalla, tha M.B. me vete, me një pikëllim të panevojshëm. Do të kishte dashur ta zinte tjetrin për këmbësh, ta tërhiqte zvarrë nëpër dysheme. Por nuk guxonte më të kthente as kokën drejt tij. Madje as bishtin e syrit. Tani ishte radha e tij të shtirej. Ai u përqëndrua, që të shtirej sa më mirë. Sikur lexonte. Shërbimi tri vjet në Gardën e Republikës i shërbeu për herë të parë .

Nisi kështu ushtrimi i tij i mundimshëm i mbrëmjeve, që do të vazhdonte deri në fund të muajit. M.B. kujdesej që asgjë të mos ndryshonte nga mbrëmja e parë . Ai zinte vend në shtrat në të njëjtën orë, nënkrejsën për ta ngritur kokën gjatë leximit e paloste në të njëjtën mënyrë, mëdys, dhe vështrimin e mbante të përqëndruar mbi fletët e librit, ku gërmat gumëzhinin si milingona të çmendura, pa u bashkuar dot për të krijuar fjalë. Më e lodhshmja ishte llogaritja e kohës për ndërrimin e faqeve. Tjetri, që përgjonte, i kredhur në heshtjen e vet jo dhe aq misterioze tashmë, duhej të ndjehej fare i sigurtë se M.B. po lexonte. Vetëm po lexonte. Krejt i qetë dhe pa asnjë dyshim apo trazim tjetër të mbrapshtë të trurit. Tejet i përqëndruar, siç i takonte një njeriu me ndërgjegjen në paqë. Kështu M.B. shtynte minutat, që nuk shtyheshin, për ta kapërcyer mesnatën dhe mallkonte veten për orarin e vonuar që i kishte caktuar gjumit natën e parë . Ai do të donte ta fikte dritën më herët. Errësira do t'i ngjallte me siguri përfytyrime të tjera, të ndryshme, që do ta ndihmonin të harronte disi praninë e makthshme të të ashtuquajturit koleg, e që ai e emërtoi nga ana e vet daullja prej letre. Por

nuk ndryshonte më dot asgjë, thua se edhe përditshmëria e tij bënte pjesë në ciklin e rrotullimeve tokë-die. Gjithçka kishte fituar papritur një rëndësi që i tejkalonte aftësitë e tij. M.B. mbetej i paqartë nëse tjetri kishte vërtet një mënyrë apo një mjet për të lexuar në trurin e tij. Kur bënte ushtrinë kishte dëgjuar se zbulimi sovjetik zotëronte aparatën, që nuk e kishin shpikur dot shkencëtarët e Hitlerit, për të lexuar mendimet brenda në kokën e armiqve. Qysh se lufta midis dy kampeve quhej e ftohtë, ai ishte gati të besonte gjithçka. Për t'i dalë përpara çdo të keqeje, ai zgjodhi rrugën e boshatisjes së kokës. Ajo duhej t'i ngjante rruzullit prej druri, me të cilin ai u shpjegonte nxënësve gjeografinë e botës. Ai që do të gërmonte, do të gjente atje vetëm një ajër të ndenjtur, që do t'i rrëshqiste midis gishtërinjve, paksa kutërbues, i përzier me një pluhur të vjetër shkumësi, i padukshëm dhe i paformë.

5.

Mersini gjithashtu nuk ndryshoi as edhe një fije deri në fund të pushimeve. Ai vazhdoi të shtrihej pak a shumë në të njëjtën orë të mbrëmjes dhe të mbështillej pa vonesë me heshtjen e vet gjumore, të papërshkueshme, torturuese për M.B. Mësuesi jugor nuk kërkoi më të mësonte arsyen e vështrimeve të vjedhura të mësuesit verior dhe as nuk ruajti ndonjë kureshtje nga që pyetja e tij e parë kishte mbetur pa përgjigje. Ndoshta nga që këto vështrime nuk u përsëritën kurrë më. Të paktën kështu e shpjegoi M.B. shpërfilljen e tjetrit. Mersini shfaqej vazhdimisht i kënaqur, gjë që ishte tejet e dyshimtë për M.B. Ai lavdëronte me fjalët më të bujshme diellin, që ngrohte ëmbëlsisht rërën dhe ujin e detit, parajsë e vërtetë për pushuesit që dëshironin plazhin. Por, me fjalë po aq të bujshme Mersini lavdëronte edhe retë e ngarkuara me shi, që dukeshin herë pas here mëngjeseve, e dallgëzonin detin, e ftohnin dhe njomnin ajrin dhe rërën, dhe i detyronin pushuesit të mbylleshin buzëvarur brenda. Vetëm fytyrën e gjerë e të shëndetshme të Mersinit nuk e trazonin aspak ato tufa të murrme si lesh i palarë delesh, që vinin nga perëndimi, shkarkoheshin në breg dhe humbisnin në lindje, pas maleve. Duhet edhe pak kohë për të luajtur shah, apo thjesht të njihemi më mirë me njëri-tjetrin. Edhe truri ka nevojë për gjimnastikën e tij, thoshte Mersini dhe shpirti ka nevojë për ndjenjën e ngrohtë të miqësisë, dhe M.B. e dëgjonte i lebetitur, duke miratuar mekanikisht. Ku e kishte ai fjalën me atë njohjen më të mirë të njëri-tjetrit? Mersini nuk fliste kurrë për veten dhe as nuk bënte asnjë pyetje rreth jetës së tjetrit dhe gjithë kohën avullonte nga

kënaqësia.

M.B. vendosi t'i shëmbëllente sa më mirë bashkëbanuesit të dhomës në këtë kënaqësi velëse, si mënyra më e përshtatshme për t'u mbrojtur nga dyshimet e tij të papërcaktuara. Mersini, alias daullja prej letre, nuk duhej të kishte asnjë rast për t'i kërkuar mendimin kolegut të tij verior. Ishte një vendim që M.B. e mori nga që nuk ndjehej dhe aq i sigurtë në kontrollin e vetes. Vërtet e kishte urdhëruar kokën të zbrazej, por druante se diku nëpër skutat enigmatike të trurit ishin fshehur copëza apo thërrime mendimesh të mbrapshta e të panjohura, të një kohe të huaj dhe mund t'i rrëshqisin pavullnetsëm nëpër gjuhë. Gjuha ishte çelësi, ishte e mira dhe e keqja më e madhe e njeriut. Kështu thoshte një proverb i moçëm dhe M.B. e besonte tashmë. Atij iu bë e zakonshme ta përsëriste tri herë me vete atë që do të thoshte, para se ta shqiptonte.

Edhe Mersini duhej të ishte i të njëjtit mendim, derisa nga gjuha e tij e lëvizshme si bishti i një peshku të mplakur dilnin vetëm lavdërime të ëmbla. M.B. e kishte edhe më shumë zili qetësinë dhe lehtësinë e sjelljes së tij. Mersin S. vazhdonte të mos i bënte asnjë pyetje dhe M.B. besonte se ai dinte gjithçka mbi të. Por M.B. nuk e përfytyronte dot se çfarë përfshihej në këtë "gjithçka". Mersini nuk pyeste, vërtet, por edhe vazhdonte të mos tregonte asgjë. Ai vetëm gëzohej dhe falenderonte rast e pa rast. M.B. u bind me kalimin e ditëve se kjo ishte një mënyrë e stërholluar e tjetrit për ta zberthyer. Ai u vu në një pritje të anktshme, e cila nuk mbaroi deri në fund të pushimeve. Ai nuk e dinte çfarë priste nga Mersini. Por priste dhe i dukej se kishte zbuluar domethënjën e emrit të përbërë DAULLJA PREJ LETRE. Kjo ishte e vetmja kënaqësi që merrte ai nga pushimet falas në breg të detit.

6.

M.B. nuk ishte përgatitur për torturën e re, atë të paspushimeve. Shkolla donte edhe dy javë të hapej, por mësuesit ishin mbledhur tashmë, që të përgatisnin klasat. M.B. nuk i kishte parë kurrë kolegët e tij aq kureshtarë dhe të drojtur para tij, gjë që ia përtëriu dyshimin se rreth tij po luhej një lojë e madhe, më e rrezikshme nga ç'mund të rrokte përfytyrimi i tij. Ai vetë ishte i hutuar dhe i trembur, si njeriu që ecën nëpër mjegull, pa parë ku e vë këmbën dhe nuk e kishte të lehtë ta fshihte gjendjen e vet. Shokët e tij e shoqëronin me vështrime zhbiruese dhe donin të mësonin patjetër gjithçka për të katër javët që ai

kishte kaluar në Shtëpinë e Pushimit të Punëtorëve të Dalluar. Por kureshtja e tyre kishte diçka lutëse dhe nuk ishte asnjëherë ngulmuese, gjë që për M.B. ishte shenjë e mungesës së sinqeritetit nga ana e tyre. Ndërsa ai vetë nuk kishte ç't'u tregonte. U tha se kishte njohur një mësues nga jugu, Mersinin. Por edhe atij vetëm emrin i dinte. Ai e shihte nga sytë e tyre se nuk e besonin. Si nuk i kishte mësuar as mbiemrin njeriut me të cilin kishte banuar një muaj në një dhomë? Më mirë të heshtte se sa të gënjente. Dhe M.B. vuante. Por tashmë nuk guxonte të sajonte historira të paqëna. Dhe sidomos nuk guxonte t'ua rrëfente hamendjet e tmerrshme, që s'mund të ishin hamendje, e që ia kishin shtrydhur trurin gjithë kohën. Ai e lidhi mirë gjuhën, për të mos përmendur daullen prej letre. U tha vetëm se Mersini ishte një tip i çuditshëm. I gëzohej gjithçkaje, pa e vrarë mendjen. Ishte nga ata që plaken pa u thinjur, tha M.B. i kënaqur me përcaktimin që gjeti. Ishte një përshkrim që e nxiti më keq kureshtjen e kolegëve. U shtuan pyetjet, të cilave M.B. u përgjigjej me një buzagaz të zorshëm, me të mbledhur të supeve, duke u përpjekur të dukej sa më i kënaqur nga njohja me Mersinin.

-Po ty, pse të kishin vënë në dhomë me të?

M.B. ndjeu majat e veshëve t'i fishkëllenin.

-Në mos atë, do të kisha një tjetër. E kishin zgjedhur, ndoshta, me që ishte mësues, si unë,- u përgjigj i hutuar.- Nuk kishte dhoma teke.

-Hë, hë, të kishin vënë ta zbërtheje...

-Si ta zbërtheja?

-Me siguri që ishte një spiun i rrezikshëm. Agjent i jugosllavëve, me siguri. Apo duhej ta rekrutoje?

M.B. iu errën sytë dhe nuk e vuri re se cili nga kolegët kishte folur. Kjo ishte hataja, krejt e paparashikueshmja për të. U dëgjuan disa zëra të kreshpëruar, që e qortuan shokun për ndërhyrjen e papërshtatshme. Ata e siguruan M.B. se nuk i kërkonin sekrete shtetërore. Nuk donin kurrsesi të mësonin gjëra që nuk u takonin dhe as nuk donin ta vinin në vështirësi shokun e tyre, me të cilin krenoheshin. Ai mund t'u tregonte diçka për gratë, për shembull. Asnjëri prej tyre nuk i kishte kaluar kurrë pushimet në breg të detit dhe të gjithë përfytyronin se katër javë i rrethuar nga gra pothuajse lakuriq, do të kenë qenë përrallore.

-Po ruse kishte?- u kujtua dikush.

-Thonë se gratë ruse, flokëverdha e lëkurëbardha, kur vijnë në vende të nxehta, harbohen fare,- shtoi një tjetër.- U vlon gjaku.

## *Daullja prej letre*

M.B. u përpoq më kot t'u shpjegonte se nuk mbante asnjë sekret shtetëror e se vërtet, lidhur me Mersinin nuk dinte asgjë më tepër nga ç'u kishte thënë. Duket se te ky pohim zëri e tradhtoi pak. Disa nga të pranishmit shtrembëruan lehtë buzët.

-Nuk është nevoja të na betohesh,- i thanë ata. Ishte njësoj si t'ia kujtonin se më e mirë është heshtja se sa gënjeshtër- Sekush bën detyrën që i ngarkojnë.

M.B., në lutjen e tij për t'i besuar, po shtyhej pak nga pak t'u tregonte se e vërteta ishte krejt ndryshe. Ishte e kundërta e asaj që mendonin ata. Ai nuk kishte qenë në bregdet as për të zberthyer një agjent të të huajve dhe as për të rekrutuar një agjent të ri për zbulimin tonë. Ai nuk mbante asnjë sekret shtetëror e nuk kishte asnjë lidhje me spiunazhin. Nuk kishte patur kurrë. M.B. ishte thellësisht i tronditur. Si t'i sqaronte se i mbikqyruri kishte qenë ai vetë, shoku i tyre M.B.? Dhe se kjo kishte nisur muaj më parë, me përhapjen e legendës për rrjetin informativ DAULLJA PREJ LETRE. Për këtë qëllim edhe i kishin dhënë falas katër javë pushime në bregdet dhe i kishin sjellë në dhomë një njeri, që kishte aftësinë e jashtëzakonshme edhe të lexonte brenda në trurin e tjetrit e të vidhte atje mendimet më të fshehta. Merreni me mend tmerrin që kam hequr! Nuk kam patur sy as për të kundruar bukurinë e zhveshur të grave. Bëra si bëra dhe kokën e zbrazta nga mendimet. Por keq e kisha me ëndrrat që më vërshonin netëve mizëri, nga më të pabesueshmet, dhe më linin gjithë ditën në ankth. Po sikur atë mizëri fytyrash e zërash e sjelljesh të shpifura në gjumë të mos i fshinte plotësisht mbushja e syve me dritën e diellit? Gërmuesi i kokës sime do të kishte lëndë të bollshme për raportet e veta. Ky ishte Mersini, i ashtuquajtur i mësues, që nuk e njihte ankesën, jo se kënaqej me ç'i jepej, po se kjo ishte mënyra e tij e stërholluar për ta provokuar tjetrin. Domethënë mua. M.B. nuk e kuptoi as vetë se ç'instinkt e ndihmoi të përmbahej.

Pak çaste më vonë ai merrte frymë i lehtësuar. I kishte kaluar përkitazi një rreziku të madh. Por nuk ndjehej i kënaqur. Përkundrazi, ndjehej bosh dhe i plogështuar, si njeriu i zhgënjyer me veten e që nuk i mbetet më asgjë. Përfundimisht midis tij dhe shokëve kishte hyrë një hije e keqe. I mbushur me një keqardhje të pafuqishme, ai tha se kjo hije kishte zënë vend tashmë midis tij dhe gjithë të tjerëve. M.B. e pranoi gjithë dëshpërim se nuk do të mund të ishte më kurrë ai i mëparshmi. Ai nuk e kuptonte se çfarë kishte ndryshuar dhe përse dhe as nuk e përcaktonte dot llojin e ndryshimit. Edhe Mersini kishte patur të drejtë



ta merrte për njërin nga ata që mbushin dosjet e të burgosurve të ardhshëm, tha ai papritur. Pse duhej medoemos të besonte se Mersin S. gjëndeje në dhomën e tij për ta mbikqyrur? Çfarë do të mbikqyrte? Puna duhet të jetë shumë më e ndërlikuar. Të gjitha ngjarjet e verës iu përmbysën. Mersini është i dyshimtë, por nuk ka prova për veprimtarinë e tij. Duke i dërguar në dhomë për katër javë një njeri të panjohur, synohet destabilizimi i tij. M.B. tha me vete plot fajësi se me sjelljen e vet prej njeriu të trembur, ai e kishte hutuar tjetrin më keq se sa po të kishte luajtur vetëdijshëm një rol. Gjithçka iu duk e ndërtuar djallëzisht, por kjo nuk e çliroi nga një ndjesi e thellë fajësie ndaj mësuesit jugor, dhe harroi fare torturën e vet absurde. Dhe më e rënda mbetej që ky keqkuptim nuk do të sqarohet kurrë. M.B. u përpoq më kot ta ndante përgjysmë fajësinë, duke thënë se të dy e kishin torturuar njësoj njëri-tjetrin. Të dy ishin viktima. Ai ishte i sigurtë tashmë se Mersini do të ndërronte rrugë, në qoftë se një ditë rasti do ta sillte të takoheshin. M.B. pati shijen e hidhur të humbjes së diçkaje të shtrenjtë, të pakthyeshme. Gjithë kjo për shkak të një shakaje të thjeshtë me nxënësit e vet, që i donte me zemër. Një shaka e tepruar, vërtet, dhe që kishte shkuar shumë larg, siç ishte shprehur kolegu i tij, por që prapë ishte një shaka. M.B. nuk mund të duronte më. Ai duhej të gjente sa më shpejt një zgjidhje, ndryshe do të çmendej.

7

Aty nga mesi i vjeshtës M.B. nuk duroi dot më dhe u paraqiti në zyrën e Sigurimit. Zgjodhi me kujdes ditën kur mungesa e tij të mos tërhiqte vëmendjen e askujt në shkollë e as në fshat. Dhe nuk vuri asnjëri në dijeni.

Njeriu, që e priti, i dha menjëherë të kuptonte se e njihte mirë.

-Paske ndryshuar shumë,- i tha.- Qënke dobësuar. Mos ke qenë gjë sëmurë?

M.B. e përfshiu me një vështrim të lemerisur. Ai e dinte se kishte ndryshuar shumë. E dinte edhe se ishte dobësuar shumë, tej mase madje, me atë prerje të oreksit e të gjumit që kishte prej muajsh. Por nuk i pëlqeu t'ia vinte në dukje njeriu i Sigurimit. E sidomos nuk i pëlqeu që tjetri, një i panjohur, ishte në gjendje të bënte një krahasim të tillë.

-Nuk kam qenë sëmurë,- u përgjigj shkurt M.B. Ai nuk donte që biseda të merrte ndonjë rrugë të paparashikuar. Nuk dëshironte, sidomos, që midis tyre të vendosej ndonjë afëri e rreme. I kishte menduar e

## *Daullja prej letre*

stërmenduar gjithë ç'do të thoshte dhe priste me padurim të shpëtonte nga pesha e fjalëve që i vrundullinin në tëmtha. Kishte ardhur në atë zyrë gjakftohtë dhe i vendosur të denonconte veten. Dhe ishte përgatitur të shkonte në burg, i sigurt se vetëm atje do të shpëtonte nga ankthi. Nuk mbante dot më. Nuk kishte frikë nga vuajtjet e trupit. Dhe nuk donte të çmendej.

-Të ka ndodhur ndonjë fatkeqësi?- vazhdoi shoku i Sigurimit. Ai dukej krejt i qetë, madje pyeste me një ton të preokupuar, dhe aspak i çuditur nga vizita, gjë që e tronditi edhe më fort të ardhurin. Ai nuk kishte vënë askënd në dijeni për vendimin e vet. Si ishte marrë vesh në këtë zyrë të frikshme? M.B. u ndje i pafuqishëm. Fjalët e renditura me aq ngulm në kokën e tij për orë të tëra u shpartalluan si t'i përfshinte një vorbull e papritur.

-Nuk më ka ndodhur asnjë fatkeqësi,- tha M.B. me majat e buzëve. Ai tani ishte i mbushur me një ndjenjë të thellë kotësie, që ia kishte mpirë trurin. E kishte humbur sakaq shpresën për t'u dhënë fund vuajtjeve. Nuk kërkonte më asgjë.

Ata ishin ende në këmbë, të dy, në mes të zyrës, si të ruheshin nga goditjet e fshehta të njëri-tjetrit. M.B. hodhi një vështrim lakmitar nga karrigia e lirë. I dridheshin gjunjët. Shoku i Sigurimit, i kuptueshëm, i bëri shenjë të ulej, por vetë nuk zuri vendin e tij të zakonshëm. M.B. ndjeu qafën t'i dhimbte nga rrotullimi i kokës për të ndjekur lëvizjet e shkujdesura të tjetrit.

Ra një heshtje, gjatë së cilës M.B. arriti të mendonte se paraqitja e tij në këtë zyrë kishte qenë e panevojshme. Madje, një marrëzi, e çoi ai më tej gjykimin e vetes. E zuri frika se mos i zoti i zyrës do ta pyeste për shkakun e vizitës. Pse kishte besuar në fajësinë e vet? M.B. nuk kishte përgjigje. Heshtja po zgjatej me tepri dhe shoku i Sigurimit nuk jepte asnjë shenjë se do ta prishte. Ai nuk dukej i nxituar dhe vështronte nga dritarja përhumbshëm, po aq i qetë sa edhe në fillim. Ngjante sikur e kishte harruar praninë e vizitorit. Ose nuk kishte kureshtje, nga që e dinte ç'do të dëgjonte. M.B. nuk duroi dot më që tjetri të sillej me të si me një të njohur të vjetër.

-Unë jam mësues,- tha. Nuk dinte si do të vazhdonte.

I zoti i zyrës u soll ngadalë drejt tij, e vështroi në sy dhe i buzëqeshi butësisht.

-Ty të njohin të gjithë, të kemi shembull frymëzimi,- tha.- Edhe vetë shoku Enver të ka shkruar.

M.B. e përshkoi një rrëqethje. Ishte i hutuar dhe sidomos i trembur.

-Ishte një keqkuptim,- foli me një zë lutës.- Një shaka

## *Besnik Mustafaj*

që mori për keq. Do t'jua sqaroj gjithçka. Unë nuk doja. Më saktë, nuk i kisha menduar pasojat. Papjekuri e madhe politike, e pranoj, por e pavetëdijshme...

Tjetri u zymtua.

-Shoku Enver nuk bën kurrë shaka kur përgëzon mësuesit shembullorë të fëmijëve të popullit,- u përgjigj ai.

M.B. u rrëqeth për së dyti. Një keqkuptim i ri, dhe për më tepër në zyrën e Sigurimit, do t'i kushtonte shumë më shtrenjtë.

-Nuk di si të shprehem,- tha.- Nuk di nga të filloj. Jam vërtet i tronditur.

-Ti fillove, shok i dashur, dhe fillove shumë keq, ta them unë,- e ndërpreu njeriu i Sigurimit.

-Unë nuk jam fajtor,- tha M.B. Në kokën e tij ishte ndezur papritur një dritë. Ai nuk duhej të denonconte veten, por të mbrohej. - Unë nuk jam fajtor,- përsëriti ai dhe më vendosmërisht.

-Atë e di ti më mirë se kushdo tjetër,- u përgjigj ftohtë oficeri dhe i tregoi derën me një vështrim urdhërues.

M.B. ndjeu një shtrëngim në kraharor.

-Si, do të kthehem në shtëpi?!

M.B. iu bë se dëgjoi: po, tani për tani do të kthehesh në shtëpi. Do të të marrim kur të na nevojitesh ne e jo kur të duash ti. Dhe do të vazhdosh të luash rolin e tellallit me daulle prej letre. Iu bë apo dëgjoi vërtet, nuk ka asnjë rëndësi. Rrugës për në fshat ai ishte i sigurt se kishte dëgjuar më shumë. Duke e përcjellë në oborr, njeriu i Sigurimit i kishte thënë se në takimin e tyre të dytë nuk do të flisnin më për shëndetin e për ligjen e tij. Dhe M.B. kishte miratuar instinktivisht, ndërsa vidhte me sy përreth. Nuk e dinte nëse do t'i pëlqente apo jo ta shihte ndonjë i njohur të dilte nga ajo ndërtesë.

**HISTORIA E KATERT**

Pjesa e parë

## DOLLIA

Të gjithë në ministrinë e Bujqësisë e dinin se Neki Palushi, inspektor në drejtorinë e drithërave të bukës, pinte vetëm në raste gëzimesh. Por, kur pinte, ia nxirrte fundin shishes, siç thotë një fjalë e vjetër, dhe ndryshonte krejt. Ai bëhej gazmor si një fëmijë. Neki Palushi njihej kështu nga të gjithë jo vetëm pse ishte më i gjati i ministrisë, por edhe për të qeshurat që shkaktonte në darkat e përbashkëta, të cilat zakonisht organizoheshin në prag festash kombëtare, dhe në pranverë, në përfundim të stinës së mbjelljeve, e që ishin darka- ceremoni për shpërndarje dekoratash punonjësve më të dalluar. Neki Palushi drejtonte sektorin kombëtar të kulturës së misrit dhe thirrej më së shpeshti Gjeneral-Misri, nofkë që ia kishte ngjitur një miku i tij evgjit, Hekuran Romalini, kur e caktuan në ministri e që ai vetë e kishte treguar vite të shkuara, gjatë njëres nga këto mbrëmje dhe që i pëlqente ta dëgjonte nga të tjerët edhe më shumë se emrin e vërtetë. Gjeneral-Misri linte gjithmonë përshtypjen e njeriut të lumtur dhe të sigurtë në lumturinë e vet. Nga fshatari i dikurshëm ai kishte ruajtur zakonin e përvjeljes së mëngëve të këmishës dimër e verë dhe nuk i drejtohej kurrë ndokujt me "ju". As eprorëve e as vartësve.

-Sonte do të pi,- shpalli Neki Palushi, duke zënë vendin e vet në tryezën qendrore. Askujt nuk i tërhoqi vëmendjen një hollësi e pazakonshme: Neki Palushi priti derisa njëri nga drejtuesit e mbrëmjes t'i tregonte karrigen.

Ata që ishin përreth qeshën.

-Sonte paskam një etje të madhe, rërë shkretëtire jam sonte,- vazhdoi ai, serioz. Serioziteti i tij ishte vërtet serioz. As kjo hollësi nuk i ra askujt në sy, që t'i ngjallte ndonjë parandjenjë të keqe.

Fjalët e tij u përcollën përsëri me gaz, si gjithmonë.

Ishte mbrëmja më madhështore e vitit, festimi i njëzet e pesë vjetorit të çlirimit të Atdheut dhe triumfit të

**Pushtetit Popullor.**

-Janë marrë të gjitha masat, Gjeneral-Misri, që të keni ç'tju pëlqejë,- iu përgjigj dikush me një zë të fryrë si t'i raportonte zbatimin e një urdhri ushtarak.

Gjeneral-Misri buzëqeshi i kënaqur dhe përgëzoi, si një aktor që e njuh dhe argëtohet me rolin e vet.

Askush nuk i kushtoi më tepër vëmendje paralajmërimit të Gjeneral-Misrit për etjen e pazakonshme. Të paktën kështu u duk. Madje as gruaja e tij, që e shoqëronte vetëm në raste të tilla. Askush nuk pyeti aty për aty se ç'do të thoshte "etje e madhe", "rërë shkretëtire" për Neki Palushin. Askush nuk pyeti se nga i vinte kjo "etje e madhe" në prag të festës madhështore. Sepse askush nuk mendoi për kokëçarjet e pazakonshme, që i kishte sjellë kjo vjeshtë gjithë ministrisë e veçanërisht Gjeneral-Misrit. E pra, të gjithë e dinin se të korrat kishin qenë të varfra. Asgjekundi nuk ishin përmbushur planet e caktuara. Ministri kishte bërë autokritikën e vet për thatësinë, që kishte zgjatur më shumë se 100 ditë dhe ia kishte shkarkuar gjithë përgjegjësinë atij që i takonte: kryeinspektorit të misrit në drejtorinë e drithërave të bukës. Domethënë Neki Palushit. Dhe nuk ishte një përgjegjësi e vogël, e shpërfillshme, që mund të kapërcehej si zakonisht, me një premtim të sinqertë se kjo nuk do të përsëritej më kurrë. Në mbledhjen e fundit të Byrosë Politike, ku ishte shqyrtuar kjo çështje, Enver Hoxha ishte shprehur shumë ashpër. Ai kishte thënë se hambarët e mbushur përgjysmë me misër lëshonin rryma të akullta, për ta ftohur gëzimin e popullit në jubileun e madh të njëzet e pesë vjetorit të çlirimit të Atdheut e të triumfit të Pushtetit Popullor. Me një fjalë, fajtorët duhej të përgjigjeshin një më një para Partisë. Neki Palushi e kishte të mprehur shqisën e rrezikut. Por nuk dinte si të mbrohej. Ai priste tashmë nga çasti në çast goditjen. Në shtëpi përgjonte trokitjen e derës. Në zyrë i druhej një mbledhjeje të paparalajmëruar. Po mbusheshin javë që nuk kishte marrë frymë i lehtësuar si në fillim të asaj mbrëmjeje, kur u sigurua se vendi i tij ishte si edhe më parë, në tryezën qëndrore, dy karrige larg ministrit. Domethënë, rrymat e ftohta nuk kishin mbërritur deri te protokollit. Nuk kishte ndryshuar asgjë. E përfshiu një valë e panjohur euforie dhe shpalli se do të pinte, i bindur se alkooli do ta çlironte edhe nga mbeturinat e fundit të ankthit. Ai kishte nevojë të çlironte plotësisht nga ankthi që e kishte torturuar gjysmën e dytë të vjeshtës.

Neki Palushi nisi të pinte me një gotë të madhe, nga ato që shërbenin për ujin, dhe në heshtje. Përreth prisnin

## *Daullja prej letre*

prej tij humorin dhe ai e kuptonte, shakatë e tij ishin tashmë diçka që u përkiste shokëve të tij, por nuk vepronte dot ndryshe. Instinktivisht ai kërkonte edhe një provë, që t'i davaritej edhe hija e fundit e dyshimit: duhej që ministrit vetë t'i tërhiqte vëmendjen heshtja e tij.

Dhe ashtu ndodhi.

Ishte shërbyer pjatat e dyta, kur u dëgjua zëri bubullues i ministrit:

-Ku je, Gjeneral-Misri? Këtu je a gjetkë?

Neki Palushit i hovi zemra përpjetë. Ai ndjeu gjuhën të trashur, por nuk u shqetësua. Kokën e kishte të kthjellët. Vetëtimthi zgjodhi të thoshte diçka, që të merrej edhe si autokritikë. Ai e dinte se autokritika nuk është kurrë e dëmshme.

-Aha, Gjeneral-Misrit i janë rrëzuar spaletat në baltën e arave,- u përgjigj ai.

Në sallë ra përnjëherësh heshtja.

-Spaletat na janë rrëzuar të gjithëve në baltën e arave sivjet, por Partia do të na vërë të reja,- ia ktheu ministri dhe zëri i tij u bë edhe më bubullues. Dhe kishte një tingëllimë gazmore.- Partia ka besim te ne.

Zemra e Neki Palushit hovi rishtas dhe çmëndurisht. Atij iu rrëmbushën sytë. Ministri e kishte kuptuar dhe e kishte siguruar faqe gjithë ministrisë se ai nuk ishte përgjegjës më fort se të tjerët për të korrat e këqia. Domethënë se nuk ishte ngritur asnjë sëpatë për të këputur kokën e tij. Neki Palushit i erdhi turp nga vetja. Si e kishte humbur aq lehtë besimin te Partia? Pak nga dyndja e emocioneve e pak nga trashja e gjuhës, falenderimi i doli fare e pakuptueshëm, një grumbull tingujsh të përtypur keq nëpër dhëmbë, gjë që u dha rastin e parë të pranishmëve të qeshnin. Qeshi edhe vetë Gjeneral-Misri, me kukurizma, tejet i kënaqur. Ai u përkul te veshi i së shoqes. Të gjithë i kishin sytë te fytyra e saj, që nuk tregonte asgjë. Ai vazhdoi të mërmëriste në veshin e saj, thua se e kishte harruar sallën, e cila, për një arsye të pashpjegueshme, e kishte përqëndruar vëmendjen te fytyra e gruas. Ishte ndërprerë edhe muzika, edhe tringëllima e gotave, edhe lëvizja monotone e nofullave. Ishte një qetësi e papëlqyeshme për ministrin, i cili ndërhyri me zërin e vet bubullues:

-Thonë se Gjeneral-Misri ka sonte një etje kreshniku. Ku janë vozat?

Neki Palushin e përshkoi një rrëqethje e ligë. Ministri përsëriste fjalët e tij apo hidhte ndonjë thumb? Ai largoi kokën nga e shoqja dhe përfshiu sallën me një vështrim hetues.

-Hajde Gjeneral, jo kaq i zyrtë!- u hodhën disa veta.

Neki Palushi u dha të drejtë. Ata nuk ishin mësuar ta shihnin aq të përmbajtur, gjë që mund të keqkuptohej. Zyrtia e tij do të ishte e përligjur në qoftë se ministri nuk do ta kishte ftuar të gëzonte. Tani vetë ministri mund ta pyeste për shkakun e brengosjes. Dhe ai nuk do të kishte përgjigje.

-Gjeneral-Misrit nuk i gëzon fytyra, por zemra,- tha Neki Palushi. Ai mblodhi gjithë forcat për t'i dhënë zërit një tingëllimë të përshtatshme.

-Ne ende s'e kemi parë ,- tha ministri. Dhe shtoi:- Desha të them sonte.

Neki Palushi i mbajti një hop në vesh fjalët e shefit. Ishin orvatjet e tij për t'u siguruar mirë se ministri donte sinqerisht ta shihte të gëzuar Gjeneral-Misrin. Domethënë se nuk fshihte asnjë prapamendim të keq. Në sallë kishte rënë një qetësi e re. Neki Palushit i bëri përsëri përshtypje pse njerëzit kishin ndërprerë edhe përtypjen. Çfarë përgjonin? Ministri ia kishte ngulur sytë Gjeneral- Misrit. Vështrimi i tij ishte i papërcaktuar.

Neki Palushi dëgjoi të shoqen t'i pëshpëriste:

-Ai kërkon të të dehej.

-Dhe unë do të dehem,- iu përgjigj ai me zë të lartë.-

Do të dehem se më pëlqen të dehem. Dhe do të këndoje.- Atij i kaloi vetëtimthi nëpër kokë kujtimi i Hekuran Romalinit, mikut të tij evgjit, që këndonte bukurinë e grave të panjohura, të paaritshme, kur dehej.

Ai e mbante mend edhe më vonë përgjigjen që i kishte dhënë gruas. Por nuk mbante mend nëse kishte patur vërtet dëshirë të dehej, apo ishte një mënyrë feminare për të përligjur disi nënshtrimin pa kushte ndaj ministrit. Edhe ai vetë e kishte pikasur po aq mirë sa e shoqja se ministri synonte ta dehte. Neki Palushi kishte kuptuar gjithashtu se atë mbrëmje, sidomos atë mbrëmje, nuk mund të paraqitej i ndryshuar. Nuk i lejohej të linte aspak përshtypjen e njeriut të frikësuar. Detyra e tij ishte të qeshte dhe t'i bënte të tjerët të qeshnin edhe më shumë se zakonisht. Por kishte diçka të padukshme, të pakapshme, që e pengonte. Nuk i kujtohej asgjë e përshtatshme për një atmosferë të tillë, asnjë histori, asnjë marrëzi e vetja e as e ndonjërit nga shokët. Me siguri që ngopja e trurit me alkool do t'ia zgjidhte gjuhën. Edhe më mirë që ministri e shtynte në këtë rrugë. Neki Palushi nuk i druhej pijes. Jo se mbante me tepri. Gjithmonë kishte menduar se pijes i druhen ata që fshehin në shpirt diçka të ligë. Ai nuk kishte asgjë për të fshehur.

-Do të dehem,- përsëriti dhe sakaq derdhi në gurmaz



një gotë të madhe me verë. Në bërryl ndjeu një pickim të fortë të së shoqes. Po këtë ç'e gjeti? tha me vete pa zemërim dhe pa i kushtuar më tepër vëmendje. Ajo nuk e kishte zakon t'i ndërhynte në rrethana të tilla.- Do të dehem se më pëlqen të dehem.

Pikërisht kjo shprehje do të kthehej qysh të nesërmen kundër tij. Askush nuk do ta besonte se kishte qenë i dehur. Nëse Neki Palushi do të kishte qenë i dehur, ai do të kishte ngulur këmbë në të kundërtën.

Aty për aty salla e përshëndeti veprimin e Gjeneral-Misrit me një brohorimë të gjatë e të zjarrtë. Dhe pastaj, me një brohorimë tjetër e fitoi ta përsëriste. Ai po pinte si gjeneralët romakë kur ktheheshin nga betejat. Kaq mjaftoi që Neki Palushin ta pushtonte euforia. Përreth ai nuk shquante më veç vezullima gotash e përndritje dhëmbësh të bardhë. Por dëgjonte qartë gjithçka. Dhe kaq i mjaftonte.

Ai e dëgjoi edhe njeriun që tha:

-Bravo, Neki Palushi! E meriton të jesh gjenerali i vetëm në Shqipëri. Spaletat e atyre që komandojnë divizionet e tankeve ranë si gjethet e zverdhura në vjeshtë, por ti i mbajte yjet e tua, që të komandosht kallingjtë e bardhë të misrit.

-Budalla! Unë jam ndryshe. Unë, me ushtrinë time të misrit, nuk rrezikoj të bëj ndonjë grusht shteti.

Neki Palushit i pëlqeu përgjigja e vet.

I pëlqeu edhe sallës, e cila shpërtheu në gaz.

Por nuk i pëlqeu ministrit, i cili ndërhyri menjëherë dhe rreptë:

-Ne kemi një ushtri revolucionare, që udhëhiqet drejt nga Partia dhe ka vetëm një ideal: mbrojtjen e Atdheut e të Pushtetin Popullor. Nuk kemi ne ushtri klikash, që mendon për grushte shteti.

Gazi ngriu gjithandej. Njerëzit ulën kokat mbi pjata, gjithë siklet. Ishte një përpjekje e kotë për t'ia fshehur ministrit fytyrat e përmdritura. Neki Palushi e kapi menjëherë marrëzinë e vet. Do të kishte dashur që pamja t'i kthjellohej aq sa ta shquante shprehjen që kishin marrë tiparet e shefit të madh. E ndjente deri në palcë hirnosjen e tij, por nuk e shihte. Duhet ndrequr pa vonesë keqkuptimi me një shaka më të bukur, tha ai me vete. Dhe foli nxitimthi, duke ngritur gotën, pa u menduar:

-Spaletat e mia janë speciale. Nuk këputen si gjethet e zverdhura në vjeshtë. M'i ka vënë Krushovi.

Sakaq, përreth ra një heshtje varri. Njerëzit sikur ndërprenë edhe frymëmarrjen. Vetëm trupi i gjatë e i hollë i Neki Palushit lëkundej në hapësirën e mbushur me

zbehtësi elektrike, tym të kaltër duhani e aromë të fortë mishrash të pjekura. Ai nuk mbante mend kur ishte ngritur në këmbë dhe tani nuk guxonte të ulej. Gjeneral-Misri shtrëngoi fort gishtërinjtë, që i dridheshin, rreth gotës, si të donte të mbahej aty për të mos rënë. Dhe nuk ishte më në gjendje ta vinte re heshtjen që digjej si shpirt i djallit nëpër vezullimat e qelqeve dhe të dhëmbëve të harruar jashtë buzëve. Mendoi një çast të këndonte ndonjëren nga këngët e përmallshme të mikut të vet evgjit. Pse jo? Nuk e kishte bërë kurrë dhe kjo mund të pëlqej. Ai kishte nevojë më shumë se kurrë të pëlqej. Por u kujtua sakaq për shakanë e nisur e që duhej ta sqaronte sa më shpejt.

-Këtë dolli e kam për Krushovin,- vazhdoi Neki Palushi dhe qeshi vetë i pari. Por askush nuk e ndoqi.

Ministri i bëri shenjë dikujt ta nxirrte jashtë. Neki Palushi e kapi me bisht të syrit përshkënditjen e syve të tij. I kishte dalë sakaq pija si ta kishin futur në një fuçi me ujë të ftohtë. Gomar! shau veten. U kthye nga e shoqja, të kërkonte mbështetje, por nuk ndeshi dot në vështrimin e saj. Ajo kishte ulur kokën. Neki Palushi e dinte se jo nga turpi tashmë. Ajo nuk dinte ku të futej nga frika. Trembet për mua, tha ai me vete plot dhemshuri. Dhe përsëri mendoi se e vetmja mënyrë për ta ndrequr sadopak gafën ishte vazhdimi i shakasë. Njerëzit, e në radhë të parë ministri, duhej ta merrnin vesh të tërën e të bindeshin se ai kishte dashur të tallej me Krushovin. Por nuk arriti ta rimernte fjalën. Të nesërmen dhe në ditët që pasuan atij i kujtohej mirë ndjesia e ndotjes që i shkaktuan duart e huaja, të mbërthyera në supe. Ishin dy veta, dy nga punonjësit e rinj të ministrisë, që e ftonin t'i ndiqte. E shoqja ishte ngritur në këmbë tashmë. Neki Palushi e kuptoi se çdo kundërshtim do të ishte i kotë.

Por ai mendoi se gjithsesi nuk duhej të dilte nga salla pa e shprehur ç'kishte në kokë. Të paktën le ta mësonin të vërtetën dy të ngarkuarit e ministrit për ta nxjerrë jashtë. Ata me siguri që do të tregonin ç'kishin dëgjuar. E kishte të qartë se nuk do të merrte më pjesë kurrë në darka të tilla. Pra, nuk do të kishte më rast ta përfundonte shakanë. Ai hodhi hapin e parë me një përkujdesje prej të verbëri. Donte të sigurohej se këmbët i bindeshin. Më vonë pati ndonjë nga shokët, që i tha se do të kishte qenë më mirë të hiqej si i dehur. Të lëkundej, të belbëzonte nëpër dhëmbë përçartje, e pse jo, edhe të binte. Por Neki Palushi nuk ishte mësuar të shtirej dhe as nuk e ndjente veten fajtor. Nga ana tjetër, atë çast dhe gjithmonë, ai e dinte fare mirë se dehja, e vërtetë apo e rrejshme qoftë, nuk do ta kishte ndihmuar. Ai ishte komunist dhe në statutin e Partisë nuk

## *Daujlla prej letre*

ishte parashikuar asgjekundi falja e gabimeve për shkak të pijes. Komunisti ishte përgjegjës për gabimet e veta në të gjitha rrethanat. Dhe Neki Palushi duhej të tregonte se ndjehej përgjegjës duke sqaruar keqkuptimin dhe jo duke iu shmangur gjykimit si frikacak. Neki Palushi nuk ndjehej fajtor dhe për të kjo ishte kryesorja.

Këmbët, ashtu si koka, nuk kishin asnjë gjurmë të verës së zbratur në fyt me gota të mëdha. Hapin e dytë ai e hodhi të ngadalshëm për një arsye krejt tjetër. E kishte matur me sy rrugën që do të përshkonte për të kapërcyer derën. Donte që t'i mjaftonte koha t'u tregonte dy shoqëruesve të vet historinë e dollisë për Krushovin. Do ta dëgjonte edhe e shoqja. Ai dëshironte që e shoqja të bindej se ai nuk ishte fajtor, nuk është as i dehur, e të qetësohej. Do të fliste me zë të lartë, që të dëgjohej edhe në sallë. Neki Palushi kishte besim te kumbimi i zërit të vet. E ndihmonte edhe heshtja, që kishte mbushur gropat e syve dhe gojët e të pranishmëve si masë e turbullt plastike. Duart e dy shoqëruesve kishin zbritur nga supet te bërrylat. Atij iu përhi për herë të parë vetja mes dy policëve dhe u rrëqeth. Vështrimi i tij kaloi vetëtimthi plot përçmim dhe frikë nga njëri te tjetri. Dy shoqëruesit ishin dy punonjës të ministrisë. Ai u buzëqeshi. E ndjeu se fytyra i kishte marrë një shprehje budallaqe. I erdhi inat me veten. Por nuk e ndryshonte dot. Ndërkohë kishte hedhur hapin e tretë e të katërt. Ai vuri re që dera ishte afruar shumë dhe e zuri tmerri. Ende nuk kishte filluar të shpjegonte se ç'e kishte shtyrë të ngrinte dollinë për Krushovin. Gjunjët ishin hapur e mbledhur më shpejt nga ç'e kishte parashikuar ai, duke shkurtuar përdhunshëm kohën e mbërritjes së trupit të tij te dalja.

-Daleni pak,- tha Neki Palushi, duke nxjerrë një buzagaz të mundimshëm.- Kam edhe diçka.

Dy shoqëruesit nuk iu përgjigjën. Ata vetëm e shtynë përpara dhe Neki Palushi zbuloi arsyen e përshpejtimt të pavullnetshëm të gjymtyrëve të veta. Ai u bë nervoz dhe vendosi të mos shpjegonte asgjë rreth dollisë. Nuk donin ta mësonin të vërtetën, madje as ministri nuk donte? Nami u bëftë! Kurrë nuk do ta mësonin. Ai e quajti të nevojshme, sidoqoftë, t'u uronte mbrëmjen e mirë atyre që kishin mbetur diku larg, si në një tunel të mjegullt.

Askush nuk iu përgjigj.

Dhe Neki Palushi shtoi:

-Bëni qejf pa Gjeneralin!

Pjesa e dytë

## JAVA E KËSHILLIMEVE

Neki Palushi u shtri menjëherë, gjë vështirë e shpjegueshme, dhe fjeti si i vdekur. Siç flinte gjithmonë kur kthehej nga mbrëmjet me kolektivin e ministrisë. Dhe u zgjua pa asnjë dhimbje koke. Qëndroi një hop në shtrat, duke sjellë nëpër mend gjithë ç'i kishte ndodhur të mbrëmshmen. Besonte se nuk kishte harruar asgjë dhe u ndje mirë, i siguruar. Nuk kishte qenë i dehur dhe do të dinte të përgjigjej. (Në qoftë se do ta pyesnin, gjë që nuk ishte aspak e sigurtë sipas mendjes së tij.) Ndjehej i qetë sikur sapo kishte dalë nga një banjë me ujë shumë të nxehtë. Nga dritarja vërshonte një dritë e pastër dhe e bollshme, e pazakonshme për fundin e nëntorit në Tiranë. Shtëpia ishte e përmbytur nga heshtja.

Ai mendoi për fëmijët që kishin shkuar në shkollë dhe aty pati një rrahje të përsheptuar të zemrës. Neki Palushi nuk e merrte dot me mend se sa ishte ora, por ishte i sigurtë se kishte fjetur më gjatë e më thellë se zakonisht pas mbrëmjeve të tilla. Nuk kishte ndjerë asgjë dhe nuk i pëlqeu që e shoqja nuk e kishte zgjuar për të shkuar në zyrë në orar. Madje, duhej të ishte ajo që i kishte detyruar edhe fëmijët të përgatiteshin për në shkollë duke ecur mbi majat e gishtërinjve, për të mos ia prishur gjumin. Me siguri u kishte thënë se babi ishte shumë i lodhur. Ajo bënte me tepri për t'ua fshehur fëmijëve të metat e të atit. Ai e njihte mirë të shoqen dhe nuk kishte nevojë as atë çast për hapat apo për zërin e saj, që ta pikaste praninë e saj. Ajo gjendej në kuzhinë, duke pritur pa u mërzitur, që ai ta thërriste. Neki Palushi uroi fort që ajo të mos kishte patur arsye tjetër për ta lënë aq vonë në gjumë veç dëshirës që ai të çlodhej mirë. Le të mendojë se mbrëmë jam dehur, por jo se nuk kisha vend në zyrë sot, tha ai me vete, tek ngrihej nga shtrati. Por nuk e përzuri dot plotësisht dyshimin.

Ky dyshim erdhi duke iu shtuar edhe pse e shoqja nuk i tha gjë tek pinin sëbashku, si zakonisht, kafënë e mëngjesit. Ajo, madje, nuk i foli as për dehjen. Vetëm po ta vëzhgoje me shumë kujdes mund të vije re se kishte një shqetësim të ri, me të cilin nuk ishte mësuar ende. Neki Palushi e quajti më me vend ta vazhdonte lojën e saj. Biseda do ta trazonte më keq trurin e saj të papërshtatshëm për ankthe të thella. Do të qetësohet ngadalë, duke parë se asgjë nuk do të ndodhë, tha ai më shumë për të siguruar veten. Te shkallët e shoqja e përcolli me një vështrim të dhemshur, por jo fort mirëkuptues, gjë

që nuk i pëlqeu Neki Palushit. Vështrimi i saj, më shumë se një përshëndetje të zakonshme ndarjeje, shprehte një urim të dëshpëruar.

Ai gjeti të njëjtin vështrim në ministri. Jo vetëm te shokët e zyrës, por edhe tek ata që ndeshi nëpër korridore. Askush nuk e pyeti për shkakun e vonesës. Madje as shefi i tij, dhe kjo Neki Palushit iu duk shenjë e keqe. Kjo shpërfillje nuk do të ishte për t'u çuditur nëse do të kishte ndodhur edhe më parë në raste të ngjashme. Nuk ishte hera e parë që ai paraqitej në punë me vonesë. Ai u përpoq ta merrte veten me të mirë. Nuk i kujtohej nëse i kishin kërkuar ndonjëherë eprorët shpjegime të kësaj natyre. Ishte i sigurtë se emri i tij nuk ishte përmendur kurrë për keq nëpër mbledhjet e organizatës së Partisë mbi disiplinën proletare. Përshëndetjet ishin me majat e buzëve dhe askush nuk i kujtoi shakatë e të mbrëmshmes. Ishte e qartë se diçka nuk shkonte. Neki Palushi tha se ai vetë duhej të ishte i fundit që të shfaqte shqetësimin. Si i pafajshëm që ishte, ai duhej të jepte përshtypjen e njeriut që nuk ka veshë për të dëgjuar mërmërimat e mbrapshta, absurde.

Përcaktimi i shpejtë i sjelljes që do të kishte në ministri nuk e lehtësoi dhe aq Neki Palushin. Koha nisi të rrjedhë me një ngadalësi të padurueshme. Nuk i punohej më. Ai priste dhe nuk dinte më ç'të bënte. Dhe për më keq, nuk e dinte çfarë priste. Ndoshta një shenjë, diçka të ngjashme me përgjigjen e ministrit për spaletat e rrëzuara në baltën e arave, që të sigurohej se nuk kishte asgjë për të pritur dhe se jeta rridhte në shtratin e vet. Dita e parë do të kishte kaluar krejt bosh, domethënë pa asgjë të jashtëzakonshme, sikur të mos ishte paralajmërimi i tërthortë, që i dha njëri nga shokët e tij më të vjetër, specialist në drejtorinë e vaksinimit të kafshëve. Ishte ora e mbylljes së zyrave dhe Neki Palushi e ftoi pa asnjë prapamendim për një birrë në Bar Sahati.

-Faleminderit,- ia ktheu ai.- Kam një takim e nxitoj. Një herë tjetër.

Neki Palushi u trishtua. Ata ishin ndaluar me qindra herë pas punës tek ai bar, të kthenin një gotë. Dukej që shoku gënjente. Nuk kishte asnjë takim dhe hera tjetër nuk do të vinte më kurrë. Neki Palushi nuk do të kishte më dëshirë të kthente një gotë me të.

-Ehë, s'paske më dëshirë të pish një gotë me Gjeneralin.

Tjetri, që i kishte folur duke fshehur sytë e më fort me majat e buzëve, e përfshiu përmjërësh me një vështrim plot frikë dhe qortim.

-Harroje Gjeneralin tani,- iu drejtua duke ulur zërin,- dhe mbaju fort pas Nekiut! Më kuptove?- Ai u largua me hapa të mëdhenj, pa pritur përgjigje.

Neki Palushi mbeti i ngrirë në mes të korridorit. Nuk kishte asnjë dëshirë.

Në shtëpi nuk guxoi t'ia shprehte gruas dyshimin e pakëndshëm për shokun e vet. Nga nxitimi i saj për t'ia çelur derën, ai dalloj padurimin me të cilin ajo e kishte pritur. Dhe nuk ishte padurimi i saj i zakonshëm, kur burri vonohej pa lajmëruar. Asaj dite Neki Palushi nuk ishte vonuar. Ai nuk ia lejoj vetes t'ia shtonte shqetësimin. Pyetjes së saj se si e kishte kaluar ditën, ai iu përgjigj me butësi, por shkurt:

-Mirë. Kishim shumë punë.

Dhe u përpoq të marrte një pamje fort të lodhur. Vetëm i lodhur ai sillej shpërfillshëm ndaj vogëlsirave dhe e shoqja e njihte. Nga prapa, midis dy shpatullave, ai ndjeu vështrimin shpues të gruas. Por ajo nuk e pyeti më tepër. Neki Palushi harroi veten duke menduar për bashkëshorten, që kishte patur gjithmonë një mënyrë aq prekëse për t'ia shprehur ndjenjën, që shkonte përtej dashurisë, dhemshurinë. Ajo nuk do ta braktiste në asnjë rrethanë. Gruaja shtroi drekën, zuri vend përballë tij, por nuk vuri pjatë para vetes.

-Po ti, nuk do hash?

-Kam ngrënë,- u përgjigj ajo.

Neki Palushi e përfshiu me një vështrim qortues. Ajo nuk hante kurrë pa e pritur.

-Jam përtypur gjithë ditën. Nuk kam uri,- saktësoi ajo.

Neki Palushi nuk drekonte dot vetëm dhe në heshtje. Ai zuri të ketë një frikë të panjohur nga vetmia dhe heshtja.

-As unë nuk kam oreks,- tha.- Por duhet ngrënë diçka.- Në fytyrën e tij ishte nderur një shprehje e vërtetë lodhjeje.

-Ha, ha,- e ftoi e shoqja.- Janë zarzavatet e fundit të stinës.

Neki Plushit iu kujtua miku i tij evgjit, që i gëzohej zgjatjes si ditëve me diell në vjeshtë vetëm për zarzavatet.

-Sot kam qenë e përgjumur gjithë ditën,- tha gruaja.

Ai iu tremb përmendjes së ngjarjes së mbrëmshme.

-Më duket se kam fjetur,- vazhdoi gruaja.

Neki Palushi u bë i vëmendshëm. Ai nuk e ndiqte dot se ku donte të dilte e shoqja.

-Madje kam parë edhe një ëndërr.

Neki Palushi ndjeu se ëndrra lidhej me ngjarjen e mbrëmshme dhe nuk e nxiti të tregonte. Por ajo, për herë

të parë në jetën e tyre të përbashkët, nuk ishte e aftë ta dallonte dëshirën e tij të fshhtë. Ajo kishte parë në ëndërr të shoqin, në mes të një are me misër. Ishte piku i verës dhe dielli digte dhe gjinkallat shurdhonin dhe në qiell nuk kishte asnjë re dhe toka ishte tharë e plasaritur gjithandej si buzët e një të sëmuri me ethe. Neki Palushi mbante varur në qafë një daulle të çuditshme prej letre. U çmënd, kishte menduar ajo për të shoqin dhe i kishte rendur prapa, e lemerisur. Por ishte qetësuar disi, kur ai i kishte shpjeguar se daullja e madhe prej letre shërbente për të thirrur shiun e se ai e kishte sjellë nga Bashkimi Sovjetik dhe e kishte ruajtur për një ditë të tillë të zezë.

-Unë nuk kam sjellë këso gjërash nga Bashkimi Sovjetik,- e ndërpreu Neki Palushi.- Ti e di mirë se ç'kam sjellë unë nga Bashkimi Sovjetik,- e përmblodhi ai veten.

-E di,- u përgjigj gruaja me një ndjenjë të thellë fajësie.- Por, ëndrra...

-Lëri ëndrrat!- Ai u zbut.

Neki Palushi do ta harronte vazhdimisht veten, duke menduar si ta mbronte të shoqen, gjatë gjithë asaj jave, që ai e quajti me të drejtë dhe krejt seriozisht JAVA E KESHILLIMEVE. Por asnjëherë nuk bisedoi me të për ç'po i ndodhte. Ai ngurronte t'i çelej dhe ajo, sidomos pas ëndrrës me daullen prej letre, druhej mos e lëndonte edhe më tepër. Shkurt, ajo mbeti e vetmja ndër njerëzit që e rrethonin, pa e këshilluar për qëndrimin që duhej të mbante ndaj gabimit të vet të rëndë. Sepse kështu u shtrua çështja qysh në fillim, në zyrën e drejtorit të tij, i cili e thirri në mëngjesin e ditës së dytë. Neki Palushi u paraqit para tij plot besim. Në gjithë ministrinë ai ishte njeriu që e njihte më mirë. Punonin bashkë prej afro dhjetë vjetësh, kishin shkelur me këmbë gjithë fushat e vendit, ishin grindur me dhjetëra herë për punën, por kurrë nuk kishte mbetur ndonjë hije mërie a keqkuptimi midis tyre. Para se të trokiste në derë Neki Palushi e siguroi edhe një herë veten se gjithçka do të shkonte për bukuri. Ai ishte i bindur se drejtori i tij do të ishte i fundit që do të dyshonte për Gjeneral-Misrin. Shumë-shumë do ta qortonte me të drejtë për budallallëqet që nxirrte nga goja. Neki Palushin e përfshiu një valë gëzimi fëmënor. Zgjedhja e një njeriu të tillë nga eprorët, me siguri nga vetë ministri, për ta qortuar, dëshmonte se asgjëkundi nuk kishte keqkuptime të thella për veprimet e tij. Kishte vetëm pakënaqësi dhe kaq Neki Palushi e pranonte. Ai u sigurua se andralla do të kapërcehej me një qortim. Ai ishte i vendosur t'u lypte sinqerisht ndjesë shokëve për pështjellimin dhe me këtë rast do t'u tregonte vazhdimin e shakasë. Ai donte,

sidoqoftë, që ata ta mësonin vazhdimin. Dhe të qeshnin si zakonisht.

Gjeneral Misritiu pre shpejt hovi i bukur. Ai nuk e kishte parë kurrë drejtorin e vet aq të zymtë, aq të ftohtë. Ishte një zymtësi që nuk i shkonte, siç nuk i shkonte as kostumi i ri bojëkafë që kishte veshur. Neki Palushit i erdhi instinktivisht të qeshte. E kuptoi se ishte e tëra një marrëzi, që do ta thellonte keqkuptimin, por s'u përmbajt dot pa qeshur. Nën lëkurën e regjur të fytyrës së drejtorit lëvriu gjaku. Ai ishte nervoz. Neki Palushit iu përtëri e qeshura.

-Qesh mirë kush qesh i fundit,- foli drejtori rreptë, pa e parë në sy.

Neki Palushi e mblodhi sakaq veten.

-Nuk të kuptoj,- ia ktheu.

-As unë ty,- vazhdoi drejtori me një ton fare të akullt dhe duke ia fshehur vështrimin.- Nuk të paskam njohur.

Neki Palushi u ndje i fyer thellë. Brenda tij u zgjua rrembi i vjetër i kokëfortësisë fshatarake, që vepronte vetëm kur zhgënjehej me tepri.

-Sa të rrojmë do të mësojmë,- iu përgjigj me ironi.

-Domethënë se e pranon...

-Çfarë pranoj? Bjeri drejt!- u hodh Neki Palushi gati me të bërtitur.

-Çfarë ka barku e nxjerr bardhaku, dihet,- vazhdoi drejtori me një proverb të vjetër, duke e shtruar zërin.

Neki Palushi nënqeshi me shpoti.

-Kjo nuk më shkon mua,- tha ftohtë.- Meqë nuk më paske njohur kaq vite, po ta them unë: kjo nuk më shkon mua.

-Po ajo që na bëre mbrëmë, ç'ishte?

-Ishte një shaka, që ju nuk më latë ta përfundoja.

-Mos do të thuash se fajin e kemi ne?! Ajo s'ishte shaka. Pohoje të vërtetën!- e ngriti zërin drejtori. Në tonin e tij fshihej keq një vuajtje.

Neki Palushin e përcëlloi një fyerje e dytë. Ai nuk pyeti më nëse drejtori shprehte mendimet e veta. E kishte pikasur vuajtjen e fshehtë të drejtorit, por kjo nuk kishte më asnjë rëndësi për të.

-Ti je ai që ma kërkon të vërtetën?!- iu drejtua, duke e përfshirë me një vështrim hetues e plot inat, e që pati një ndikim magjik mbi tjetrin.

Drejtori u qetësua pak.

-Mua më vjen keq dhe të këshilloj sinqerisht t'i hapësh zemrën Partisë,- tha. Ai kishte tashmë pamjen e njeriut të sikletosur, që tradhton veten.- Dëgjomë mua, vetëm kështu mund t'ia lehtësosh pak vetes përgjegjësinë.



## Daullja prej letre

Neki Palushi, i mbushur me fyerje dhe zemërim, ia ktheu:

-Unë s'i kam mbajtur kurrë ndonjë të fshehtë Partisë. Dhe nuk ndjej ndonjë përgjegjësi. Përkundrazi, ju të gjithë duhet të më kërkoni ndjesë që nuk më latë t'i shkoja në fund shakasë. Ju më keni vënë në vështirësi mua. Nuk bëhet kështu me shokët.

Ai ishte i bindur në ato që thoshte. Dhe nuk do të jepte asnjë shpjegim sa kohë nuk i kishin kërkuar ndjesë ata që i kujtonte shokët e vet. Si mund të hidhnin dyshime të tilla mbi të? Askush nuk do ta mësonte vazhdimin e shakasë së tij të ndërprerë në qoftë se nuk e pranonin më parë gabimin e rëndë që kishin bërë ndaj tij. Neki Palushi nuk ishte mësuar ta mendonte më të keqen dhe besonte sinqerisht se këto kokëçarje do të merrnin fund shpejt. Sidomos fyerjen nuk e duronte dot.

Dhimbja e shpirtit të tij i plagosur e kishte verbuar në atë masë sa ai nuk e zbuti gjuhën as me sekretarin e organizatës së partisë e as me zëvendësministrin, që e thirrën njëri pas tjetrit po atë mëngjes, gjithashtu për ta këshilluar shoqërisht t'i hapte pa vonesë zemrën Partisë. Madje, para zëvendësministrit Neki Palushi e humbi për një çast edhe kontrollin e vetes.

-Cilën zemër të hap?!- bërtiti.- Unë vetëm një zemër kam dhe atë ia kam dhënë me kohë Partisë. Më thuaj ti, ku ta gjej zemrën që më kërkoni? Pse nuk më thoni shkoqur, xhanëm, çfarë doni nga unë?

Zëvendësministri e priti me gjakftohtësi dhe i sigurtë në vete shpërthimin e panatyrshëm të Neki Palushit. Gjeneral-Misri u çudit edhe vetë me nxehjen e tij dhe sakaq i erdhi të qeshte. Po çmendem, tha me vete.

-Unë zemrën e kam të hapur kanatash.- shtoi me një ton pajtues.- Mos më çmendni!- Dhe buzëqeshi.

Ishte radha e zëvendësministrit ta humbte durimin. Ai e nxori nga zyra me të ulëritura. Nuk të kam thërritur këtu të më tregosh dhëmbët, tha. Neki Palushi ishte i paaftë të mbrohej. Ai nuk e kishte menduar kurrë se ndokush mund t'i fliste një ditë me një gjuhë të tillë. Për herë të parë ai i tha vetes se punët kishin marrë seriozisht mbrapsht dhe kushedi sa larg do të shkonin. Megjithatë, ai nuk ndjeu frikë. Dhe përsëri nuk e vuri në dijeni të shoqen. Madje bëri të gjitha përpjekjet që të fshinte nga pamja çdo gjurmë të ankthit që zuri ta brente. Gruaja e tij ishte e dhemshur me tepri dhe do të vuante tej mundësive të veta. Por asaj zuri t'i bënte përshtypje që në shtëpi u rralluan thuajse fare vizitat e shokëve të punës të të shoqit. Edhe ndonjëri që kalonte, nuk ishte nga ata të ministrisë. Ndoshta nga që

## *Besnik Mustafaj*

vërtet nuk e shpjegonte dot ç'kishte ndodhur, ndoshta nga që deshi të gërmonte pak te Neki, ndoshta e shtyrë nga ndonjë parandjenjë e mbjellë nga ëndrra me daullen prej letre, ajo e pyeti të shoqin për shkakun e këtij ndryshimi.

-Ku e di unë?! Po s'ka gjë për t'u shqetësuar,- i dredhoi ai shkurt.- Eshhtë fundi i vitit, të gjithë kanë shumë punë.

Ajo nuk nguli këmbë. Ndërsa Neki Palushi u luhat në një mendim të papritur: mos vallë ishte më mirë që ta vinte gruan në dijeni për ngatërresën ku ishte futur marrëzisht?! Për më tepër, ajo ishte dëshmitare e fillimit. Neki Palushit as që i shkoi nëpër kokë arsyeimi: ta përgatiste të shoqen për më të keqen. Ai ende nuk e kishte një droje të tillë. Neki Palushi ishte njeri me besim të fortë. Siç po rridhnin punët, vështirë të thuhej nëse kjo cilësi ishte vesi apo virtuti i tij. Dhe nuk i tha gjë gruas atë ditë e as në ditët që pasuan, kur vazhdoi t'u përgjigjej rreptë atyre që e këshillonin me gjysmë zëri korridoreve të ministrisë, duke iu vjedhur vështirimit të eprorëve, apo kërcënueshëm nëpër zyrat e rëndësishme, që t'i hapte zemrën Partisë. Gjeneral-Misri mbetej kështu padyshim i vetmi, që priste pak a shumë i qetë sqarimin e keqkuptimit.

Kjo javë u mbyll me bisedën e thatë në zyrën e sekretarit të organizatës së Partisë, i cili i tha:

-Neki Palushi, paske qenë një gjarpër, që të kemi mbajtur në gj. Gjarpërinjve helmues Partia jonë u këput kokën pa mëshirë.

Pjesa e tretë

## DEPONIMI

Neki Palushin e arrestuan pas disa orësh. Ia vunë hekurat në kafenenë e ministrisë, pak para mesditës. Dikush kishte lajmëruar për atë që do të ndodhte dhe më të shumtët nga punonjësit e ministrisë gjëndeshin në atë orë në kafene ose në korridore. Ish Gjeneral-Misri, i lidhur, rrethuar me dy policë, kaloi kokulur mes tyre. Ai i hidhte hapat hutueshëm, me vështrimin përdhe, por gjithandej nëpër trup ndjente sytë e mpirë të atyre që nuk do të ishin më shokët e tij. E kishte kuptuar se krenaria nuk kishte më asnjë vlerë. Ai nuk dinte si të bënte, që të paraqitej para tyre në ato çaste ashtu siç ndjehej: i pafajshëm. Ai mendoi me zemër të vrrarë për të shoqen dhe fëmijët. Ata nuk do të mund ta kishin duruar shfaqjen. Dhe kur të mësonin ç'i kishte ndodhur, do të zaliseshin, por ndoshta do ta kishin më të lehtë. Ai pyeti veten krejt i pasigurtë nëse do të besonin edhe ata se kishin mbajtur në gji një gjarpër helmues, koka e të cilit duhej prerë pa mëshirë.

Kjo pyetje nuk do të rreshtte së rrahuri në tëmthata e tij ditë e natë në vetminë e shurdhër të qelisë. Atij nuk i kishte mbetur më dëshirë tjetër veç mbrojtjes së dashurisë së tyre. Kjo nuk ishte e fshehta midis tij dhe gruas e fëmijëve. E dinin edhe hetuesit, të cilët ia kujtuan disa herë gjatë seancave të pyetjeve. Gruaja dhe fëmijët ishin të Partisë. Duke pohuar sa më shpejt të vërtetën, ai fitonte kështu një shpresë për të mos këputur çdo lidhje me ta. Ai u bind se hetuesit kishin të drejtë vetëm pasi mori një letër, ku njerëzit e tij më të shtrenjtë i kërkonin të gjithë me një zë, me një gjuhë gati urdhërore të njëjtën gjë. Pohoje të vërtetën! Partia ka zemër të gjerë, i thoshin ata. Neki Palushit i bëri përshtypje mungesa e fjalëve të dhemshura në letrën e familjes, por nuk deshi të mendonte më gjatë. Ai e kuptoi se duke menduar me tepri vetëm do t'ia mbushte më keq shpirtin me pezm. Ai u bind dhe veshi menjëherë lëkurën e gjarpërit, që i zgjatën. Ndoshta edhe me të do të ndodhte një ditë si me djalin e magjepsur, i cili jetoi vite e vite si bollë, në pritje të lumturisë së madhe. Pse jo? Lumturia për të do të ishte kthimi te gruaja dhe fëmijët.

E vërteta, ashtu siç e nënshkroi ai, ishte fort e ndërlikuar. Ai e shkroi me dorën e vet, që askush të mos kishte të drejtë të dyshonte. Në gjyq ai e lexoi pohimin e vet, gjithashtu për një arsye të thjeshtë: ishte tepër i tronditur, i merrej goja dhe mund të zgjatej e të humbiste

në shpjegime të panevojshme, kur popullit i nevojiteshin vetëm faktet.

Përveç datës së lindjes dhe asaj të martesës, gruaja e tij nuk dinte asgjë nga ato që dëgjoi. Aq më pak fëmijët. Ajo u shastis kur mësoi se burri i saj ishte vënë në shërbim të KGB-së qysh në rininë e hershme, kur kryente shërbimin ushtarak në marinë. Në repartin e tyre kishin patur një instruktor sovjetik, kolonelin Angelov, i cili e kishte rekrutuar. Pse koloneli sovjetik kishte zgjedhur pikërisht atë, Neki Palushin, si të përshtatshëm? Koloneli e kishte studjuar rastin tim me kujdes disa muaj, dhe kishte zbuluar tek unë një karakter të dobët, të thyeshëm, të ngjizur me ambicje të forta karrieriste. Trupi gjykuces zotëronte si prova disa fotografi të Neki Palushit dhe ia tregoi publikut, duke i kërkuar të akuzuarit të pohonte me zë të lartë nëse ato fotografi ishin të paprekura dhe i përkisnin atij dhe askujt tjetër. Në njërin prej tyre dukej Neki Palushi me kolonelin Angelov duke pirë vodka në shtëpinë e këtij të fundit. Të tjerat i paraqisnin të dy të përmendurit në shëtitje nëpër qytet ose në stërvitje ushtarake. Vetëm ata të dy.

-Domethënë se ai ka zhvilluar me ty stërvitje të posaçme?

-Po.

-Keni bërë edhe orgjira bashkë, keni dalë edhe shëtitje?- iu drejtua gjyqtari.

-Po.

-Për çfarë flisnit gjatë orëve që kalonit bashkë?

Neki Palushi u mendua një çast të zgjatur. Pati në sallë njerëz, që panë në heshtjen e tij një ngurrim për t'u shpjeguar. Të tjerë bënë hamendje të ndryshme. Vështrimi i tij kishte rrëshqitur jashtë tufës së letrave të shtypura, që mbante përpara fytyrës. Ai la të binte një heshtje, e cila mund edhe të përjetësohej, sikur të mos ndërhynte gjyqtari:

-Flisnit kundër Partisë dhe shokut Enver?

-Po.- miratoi Neki Palushi me një zë vullshëm, si të zgjohej nga gjumi.

-Dhe pastaj koloneli sovjetik të kërkoji të viheshe në shërbimin e tij?

-Po.

Ky kishte qenë fillimi. Këtu e kishte ngrënë ai lugën e çorbës së prishur, që do ta vllte gjithë jetën, siç u shpreh prokurori duke perfrazuar një film shqiptar të kohëve të fundit. Më pas, për afro dhjetë vjet e kishin lënë të qetë. Nuk i kishin kërkuar asnjë informatë. Nuk e kishin nxitur për asnjë veprim. Madje as lidhje nuk kishin marrë me të.

## *Daullja prej letre*

Pas përfundimit të shërbimit ushtarak Neki Palushi ishte kthyer në fshatin e vet, kishte filluar punën në kooperativën bujqësore, ishte martuar, kishte bërë fëmijë. Gjatë kësaj periudhe ai kishte kryer vetëm një operacion për llogari të padronëve të vet të Moskës. Gjatë një vere tmerrësisht të nxehtë, me një thatësi të shkaktuar nga plasjet bërthamore të dy superfuqive, ai kishte dalë nëpër fushat e kooperativës me një daulle prej letre, duke thënë se kjo shërbente për të thirrur shfën. Ky veprim kishte synuar të dëmtonte edukimin materialist që zhvillonte partia me fshatarsinë tonë revolucionare.

Për të zhdukur çdo keqkuptim mbi arsyet e një heshtjeje të tillë dhjetëvjeçare, gjyqtari kishte thirrur një ekspert të shërbimeve tona sekrete, i cili shpjegoi se në gjuhën e zanatit agjentë të tillë quhen latentë dhe ruhen e përgatiten qëllimisht për t'i futur në veprim në rrethana të posaçme. Detyra e tyre kryesore gjatë kësaj kohe është të fitojnë besimin dhe respektin e njerëzve që i rrethojnë dhe sidomos të pushtetit, të ngjiten, të marrin përgjegjësi të rëndësishme. Këtë gjë ka bërë edhe i akuzuari Neki Palushi. Ai u pranua anëtar i partisë pak kohë pas kthimit në fshat, dhe nga bujk i thjeshtë ai arriti në brigadier i kooperativës bujqësore. Gjyqtari ia ndërpreu shpjegimet ekspertit, për ta pyetur të akuzuarin nëse kishte besuar ndonjëherë se padronët e tij të KGB-së e kishin harruar. Neki Palushi u zu në befë. Ai hodhi përreth një vështim të hutuar. Gjyqtari e përsëriti pyetjen ndryshe:

-I pandehur, ti me siguri kishte besuar se padronët e tu të KGB-së të kanë harruar?

-Po, po, kisha menduar.- nxitoi ai të përgjigjej. Nuk e kishin paralajmëruar për një pyetje të tillë.

-Gënjen!- bërtiti gjyqtari.

-Po, gënjej.- u tërhoq Neki Palushi.

Pra, ai nuk kishte besuar kurrë se padronët e tij të KGB-së e kishin harruar. Ata nuk kishin vënë dorën mbi të, që pastaj ta harronin. Ata e ndiqnin nga larg gjithë vëmendje përparimin e tij dhe ishin të kënaqur dhe prisnin rastin kur ai do t'u ishte i nevojshëm për ta kthyer në fushën e lojës. Spiunazhet e huaja veprojnë me strategji afatgjata kundër vendit tonë.

Ambasada sovjetike jo rastësisht kërkoi që Hrushovi, gjatë vizitës së tij në vendin tonë, të shkonte edhe në kooperativën bujqësore ku punonte i pandehuri dhe të takonte pikërisht atë. Kishte ardhur më në fund radha e tij të futej në veprimin e madh. Gjithçka ishte përgatitur për mrekulli, pa rënë në sy gjatë disa muajve. Pak kohë më parë një gazetar, edhe ai agjent i rusëve, i dënuar tashmë,

kishte shkruar një reportazh të gjatë për mjeshterin e misrit Neki Palushi. KGB-ja kishte filluar zbatimin e planit të vet dinak. Në krye të herës e kishte shtyrë Neki Palushin të merrej me kultivimin e misrit. E kishte ndihmuar me mënyrat e veta agjenturore të arrinte rendimente më të larta se të tjerët, me një fjalë, të dallohej. Pastaj kishte ndërmarrë me njerëzit e vet fushatën e gjerë për propagandimin e shembullit të tij, duke shfrytëzuar mjetet e fuqishme informative të partisë sonë, siç janë gazetatat dhe radioja. Dhe ishte arritur heshturazi, si gjarpri që rrëshqet midis fijeve të barit, të takimi me vetë Hrushovin, dashuria e rreme e të cilit për misrin njihet botërisht. Ishte çelur kështu rruga e fluturimit të tij për në Bashkimin Sovjetik me pretekstin e shkëmbimit të të ashtuquajturës përvojë të tij origjinale me atë të kolkozeve më të përparuara sovjetike. Në të vërtetë atje Neki Palushi as që kishte vënë këmbën nëpër ara të mbjella me misër. Nuk kishte shkruar aq larg që të baltoste këpucët Neki Palushi. Gjatë një viti ai kishte kryer në fshehtësinë më të madhe një kurs kualifikimi si spiun. Të mos harrojmë, është koha kur kontradiktat parimore midis partisë sonë dhe asaj bolshevike po thellohen me shpejtësi. Hrushovianët e kanë përditë e më të qartë se komunistët shqiptarë me në krye shokun Enver nuk pajtohen me tradhtinë e tyre ndaj Stalinit të pavdekshëm, marksizëm-leninizmit të vërtetë. Ata përgatiten për të ardhmen, kur dyert e Shqipërisë do t'u mbyllen.

Për këtë qëllim ngrënë operacionin METASTAZAT, të cilin e drejton vetë Hrushovi, ku synohet ndërfitja e agjentëve të tyre më të aftë në të gjitha strukturat e partisë e të shtetit tonë proletar, me qëllim brerjen nga brenda ashtu si krimbat, që brejnë lisat në pyll. Njëri prej tyre, ndër më kryesorët, ishte edhe i akuzuari Neki Palushi. Detyra e tij ishte sabotimi, pengimi me çdo kusht i realizimit të objektivave madhore të Partisë e të shokut Enver për lulëzimin e ekonomisë sonë socialiste. Me veprimtarinë e tyre në errësirë i akuzuari dhe shokët e tij duhej të provonin profecinë e zezë të Hrushovit se pas shkëputjes nga Moska shqiptarët do të vdisnin për bukë. Në përfundim të kursit special agentit Neki Palushi iu caktua edhe pseudonimi GJENERAL-MISRI.

Salla e madhe, e mbushur kryesisht me ish-shokët e të akuzuarit, me farefisën e tij dhe me punonjësit e ministrisë së Bujqësisë, lëshoi një murmurinë të gjatë habije. Neki Palushi ndëpreu leximin dhe hodhi mbi të pranishmit një vështrim të përhumbur. Sytë e tij, të futur thellë në gropat e veta gjatë atyre javëve të hetuesisë, nuk u ndalën mbi

asnjë fytyrë. Ata nuk kërkonin asgjë, nuk prisnin asgjë dhe kjo i lehtësoi shumë të njohurit e tij. Neki Palushi u duk thjesht i befasuar nga ajo murmurimë. Nga vinte? U desh përsëri ndërhyrja urdhëruese e gjyqtarit, që ai të kujtohej për të vazhduar leximin monoton të dëshmisë së vet tronditëse.

Gjatë përgatitjes intensive si spiun në Moskë ai ishte udhëzuar nga vetë Hrushovi për mënyrat dinake që duhej të përdorte për të mos ngjallur dyshime. Hrushovi i kishte treguar atij përrallën e rojtarit frikacak të stallës, që thërriste "ujku, ujku!" sa herë dëgjonte një zhurmë dhe fshati ngrihej t'i vinte në ndihmë. Ujku erdhi kur fshati ishte lodhur e nuk i besonte më thirrjes plot panik të rojtarit. Neki Palushi do t'i vishte të vërtetat e tij me petkun e humorit. Dihet se nëpërmjet të qeshurës njerëzit e fitojnë më shpejt dashurinë e shokëve dhe të eprorëve. Pjesë e kësaj strategjie ishte edhe shndërrimi i pseudonimit të fshhtë të spiunit në një nofkë miqësore. Kujt do t'i shkonte mendja se prapa Gjeneral-Misrit të lezeçëm qëndronte KGB-ja?! Gjeneral-Misri do të përparonte pa u ndjerë në trupin e shëndoshë të partisë si një metastazë kanceroze dhe, sipas parashikimit të tyre të kobshëm, ne do të zgjoheshim vetëm kur kafshimi i saj do të na ishte vdekjeprurës. Kështu, ai priti afro një dekadë rastin kur goditja e tij do të na dhimbte më tepër: vitin e njëzet e pesë vjetorit të çlirimit të atdheut. Hambarët bosh pikërisht në vjeshtë, në stinën e festës më të madhe që ka njohur ndonjëherë populli ynë, do të gjëmonin si këmbana zie për harenë popullore. Ai shpresonte se duke u paraqitur duarthatë para popullit, partia do të detyrohej të qëndronte kokulur.

Salla lëshoi një mërmërimë të dytë. Kësaj here jo për të shprehur habi, por urrejtje. Neki Palushi ndërpreu sakaq instinktivisht leximin. Vështrimi i tij nuk u end më nëpër sallë i përhumur. Ndoshta nga që mërmërima kishte qenë e qartë. Ai nuk e duronte dot urrejtjen e tyre. Gjyqtari nuk e ndjeu më të nevojshme të urdhëronte vazhdimin e leximit monoton. Ai iu drejtua të pandehurit:

-Na shpjego kuptimin e shprehjeve ETJE E MADHE dhe RERE SHKRETETIRE, që shpalle në fillim të mbrëmjes me kolktivin e ministrisë!

Neki Palushi e vonoi përgjigjen, duke kërkuar diçka midis tufës së fletëve që mbante në dorën e djathtë. Salla lëshoi një murmurimë të dytë, jo dhe aq të përcaktuar, gjë që nuk i pëlqeu prokurorit. Ai ndërhyri, nervoz:

-I pandehuri përpiqet edhe këtu, siç e shihni, ta pengojë zbulimin e së vërtetës. Etja e tij e madhe shprehte

*Besnik Mustafaj*

rikthimin e sigurisë së lëkundur pas analizës sinoptike që kishte bërë shoku Enver në Byronë Politike. Ai besonte se ia hodhi rrezikut. Eshtë kështu?

Neki Palushi nuk u përgjigj. Ai vazhdonte të gërmonte me një lloj paniku midis fletëve të veta të shkruara, si të mos e kishte dëgjuar zërin e rreptë të prokurorit.

-Eshtë kështu?- përsëriti kërcënues prokurori.

-Po, po!- u përgjigj mekanikisht Neki Palushi. Ai kishte pamjen e njeriut që nuk e di përse është fjala.



## *Daullja prej letre*

Pjesa e katërt  
(pa epilog)

### SHAKAJA E PATREGUAR E NEKI PALUSHIT

-Këtë dollari e kam për Krushovin,- vazhdoi Neki Palushi, dhe qeshi vetë i pari. Por askush nuk e ndoqi.

Sikur të paktën një pjesë e të pranishmëve të qeshnin, një pjesë fare e vogël, vetëm disa prej tyre, ai do të kishte shtuar:

"Erdhi Krushovi me kostumin e tij të bardhë e me këpucët e bardha si prej kartoni e më gjeti atje në mes të arave. E shqova turbull kur m'u afrua. E prisja. Sytë më digjinin nga djersët. Trupi më hante. I kisha dhënë veçanërisht shatit atë ditë, që ai të shihte mirë si punoja edhe unë vetë, brigadieri. Po ku ta shkoja nëpër kokë se do ta zinte sevdaja me mua?! Dhe ai ka menduar: nga këta njerëz që punojnë e nuk mendojnë i duhen Shqipërisë, që unë ta kem të bindur, të nënshtuar, ta kem dele të urtë, që milet e nuk hedh shqelma. Ja, pra, shokë, si u ngjita unë deri këtu te ju, në drejtim. Po s'ishte thënë që t'i gëzohesha fatit. Nuk merr mbarësi jeta kur fatin ta ka dhënë Krushovi. Sa u bëra i rëndësishëm Gjeneral i Misrit, shqiptarët zunë të hanë bukë gruri. Misri mbeti për derrat. Tani s'e di, herë më duket vetja si Gjeneral-Misri, herë si Gjeneral-Derri e herë si gjysma-gjysma. Më thoni kush jam, o shokë të dashur!"

Askush nuk e kishte ndjekur të qeshurën e tij të zhurmshme. Ministri i bëri shenjë dikujt ta nxirrte jashtë dhe ai mori me vete vazhdimin e anekdotës së zgjedhur për të ndrequr keqkuptimin që shkaktoi duke thënë se me ushtrinë e tij të misrit nuk rrezikonte të bënte ndonjë grusht shteti siç ndodh me ushtritë e tjera. Ai nuk e tregoi kurrë anekdotën e vet. Në fillim nga sedra e lënduar, më pas... nuk kishte kujt t'ia tregonte.

Ishte hera e parë që unë shihja se si shakaja më dashamirëse mund të shndërrohet në një keqkuptim aq të madh. Në moshën time, kur ke nisur të besosh se nuk je më i ri, zbulime të tilla të dobësive njerëzore të shkaktojnë një dëshpërim të një lloji të veçantë, që është më i hidhuri.

Maksi u martua të dielën e fundit të korrikut dhe, për arsyt e veta, bëri një dasmë fare të vogël. Kjo ishte martesë e tij e dytë. Anita, gruaja e tij e parë, punonte gjithnjë me ne. Domethënë punonte në të njëjtin vend me Maksin dhe me ne të tre, mua, Lekën dhe Ilirin.

Gjysmën e parë të gushtit shoku ynë me nusen shkuan në plazh. Periudha e mjaltit! Gjysma e dytë na iku me sot e me nesër dhe, përfundimisht, ne të tre u bëmë për mbarë ta vizitonim familjen e re vetëm në fillim të shtatorit.

Për ne kjo vizitë ishte e domosdoshme. Ishim shokët më të vjetër e më të ngushtë të Maksit dhe ishim në dijeni të të gjitha mëdyshjeve të tij të ndërlikuara, para se të vendoste të martohej për së dyti. Sado që çdo gjë kishte marrë fund tashmë për mirë, ne përsëri druanim se megjulla në kokën e tij nuk ishte davaritur plotësisht. Nga ana tjetër, kjo vizitë do të ishte një rast të njiheshim më mirë edhe me nusen, Silvën, me të cilën ishim takuar fort rrallë. Neve sigurisht që na kishte rënë në sy, po nuk e kishim pyetur kurrë Maksin përse ngurronte ta sillte të fejuarën në shoqërinë tonë. Tani e tutje ky ngurrim nuk do të kishte më vend.

Gjatë asaj mbremjeje do të gjendeshim më në fund vetëm për vetëm me çiftin. Bisedat do të ishin intime, do të tregonim anekdotat e zakonshme, për të cilat Maksi me siguri i kishte folur më parë. Me një fjalë, siç u shpreh Leka, do të hiqim përfundimisht të gjitha maskat para njëri-tjetrit.

Leka tha se për njohje të tilla nuk mund të kishte hapje më të mirë se shakaja madje, duhej të ishte një shaka që ta çudiste, domethënë ta rrëmbente jo vetëm Silvën, por edhe Maksin, që ishte prej vitesh pjesëtar i humorit tonë.

Na u duk me vend ky mendim dhe ia lamë atij ta sajonte lojën. Ai kishte më shumë përfytyrim se unë dhe Iliri.

Që të mos ishim të nxituar zgjedhëm të shtunën. Maksin e njoftuam disa ditë përpara që të na priste në shtëpi dhe pa të ftuar të tjerë.

Leka na e njohe me kohë planin e vet. Do të gjenim një letër të bukur ambalazhi, të cilën do ta mbështillnim shumëfish e brenda do të vinim një kokërr gjysmë të kalbur qepe. Ai nuk na e shpjegoi se përse kishte zgjedhur pikërisht një zarzavat aq të shëmtuar si qepa dhe pse pikërisht gjysmë të kalbur. Por as neve nuk na shkoi ndër mend t'i bënim pyetje të tilla. Megjithatë, unë edhe sot jam i bindur se ai nuk ka patur asnjë prapaqëllim të keq.

Pakoja do të kishte një dukje të madhe e joshëse. Duke hyrë në shtëpi, Leka, që do ta mbante tërë përkujdesje, nuk do t'ia linte në dorë as Silvës, as Maksit. Do ta vendoste diku në dhomë, në sytë tanë, dhe do t'ua ndalonte të zotëve të shtëpisë ta çelnin para largimit tonë. Kështu, e qeshura do të përtërihej edhe në mungesë tonë e do të zgjateshin komentet. Maksi, sigurisht që nuk do të mungonte të na ngrinte në qiell. Ndërkohë, në të dalë, Iliri do të linte diku, pa rënë në sy, një zarf me një shumë të vogël parash, që kishim vënë të tre.

Deri në çastin e mbylljes së butë të derës pas shpinës sonë, gjithçka shkoi sipas parashikimit.

Të shtunën pasdite, në orën pesë, të tre, Leka me pakon e madhe në dorën e djathtë, Iliri me zarfin e parave në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe unë me duart dhe xhepat të lirë, u gjendëm para derës së apartamentit të familjes së re. Dukej që përgjoni mbërritjen tonë. Me t'i rënë ziles (unë e shtypa butonin) u dëgjua kërcitja e bravës.

Qëndruam gati tri orë.

Gotat e rakisë u mbushën e u zbrazën shumë herë. Dhe bashkë me gurgullimën e pijes nëpër gurmazet tona, erdhi duke u rritur edhe euforia jonë. Sidomos Leka ishte fare në formë. Iliri dhe unë e kurdisnim. Edhe Maksin, gjithmonë më i heshturi ndër ne të katër, ishte ndryshuar asaj mbrëmje. Ndërsa Silva, e veshur jashtëzakonisht bukur, hynte e dilte si një shtojzavalle në dhomë. Qëndronte pak, shkonte të sillte diçka nga kuzhina, thoshte ndonjë fjalë me një zë të ngadalshëm e të kumbueshëm, si të kishte një pengesë të fshhtë nën gjuhë, dhe ngrinte gotën e vet, duke u skuqur lehtas te mollëzat e faqeve, nuk e di pse, nga ndikimi i alkoolit apo nga ndonjë përzierje ndjenjash. Përkundrazi, mbi fytyrë i lodronte një farfurimë

## *Daullja prej letre*

kënaqësie e çiltër. Pra, Leka i kishte menduar mirë gjërat.

Gabimin që kishim bërë e vumë re me t'u gjendur jashtë. Nuk ishte vonë ta ndreqnim, por për drejç diçka na pengoi të ktheheshim.

\*  
\*       \*  
\*

Sapo dalin ata të tre, në shtëpinë e Maksit zhvillohet kjo skenë:

Dhoma, në tryezën ende të pangritur, ka një ndriçim pak të turbullt në të kaltër prej tymit të duhanit. Burri dhe gruaja vijnë nga korridori. Të dy ruajnë mbi fytyrë shprehjen e ëmbël, me të cilën sapo i kanë përcjellë miqtë.

Silva, që është e para, shkon gjithë nxitim drejt pakos.

Maksi, për të cilin nuk ka kurrfarë rëndësie përmbajtja e dhuratës së shokëve, kujtohet të ndezë televizorin.

Fytyrat e të dyve vazhdojnë ta ruajnë ngazëllimin.

Silva nis shpëstjelljen e pakos me njëfarë padurimi, por edhe solemniteti. Zëri i plotë i spikerit të televizorit, që jep lajmet, e mbyt fëshfërimën e gishtave të saj mbi letrën e bardhë e të lëmuar të pakos.

- Më duket se këtu brenda kanë vënë një perlë.-  
thotë Silva dikur.

Maksi nuk i përgjigjet. Nuk e ka dëgjuar. Ai po merret me televizorin.

Rritja e padurimit të Silvës duket te përshpejtimi i lëvizjes së gishtave dhe harrimi i shfaqjes së solemnë.

Në kohën kur Maksi përfundon me rregullimin e figurës dhe të zërit të televizorit dhe po kërkon me sy një vend për t'u ulur. Silva kthehet drejt tij me kokrrën e qepës në dorë. Nga të shtrënguarit nervoz, thonjtë i janë zhytur në pjesën e kalbur të zarzavatit. Fytyra i ka marrë sakaq një shprehje budallaqe, me një përzierje habie dhe zemërimi.

Maksi hedh vështrimin nga e shoqja dhe i plas e qeshura. Reagimi i tij e tallazit më keq fytyrën e gruas.

Në këtë pikë nis dialogu.

Silva:- Dhe të vjen për të qeshur?!

Silva skërmitet si njeriu që hahet me veten.

Maksit i nevojitet një grimë herë që të qetësohet.

Maksi:- Ç'u ka pjellë mendja?!

Silva:- Nuk e kupton që është për të qarë?!

Maksi:- Për të qarë! Ha-ha-ha! Jo po t'ia heqim

vetes...

Silva:- Si mund të qeshësh me talljet që të bëhen?!  
Maksi e mbledh veten si t'i kishin hedhur një kovë me ujë të ftohtë në kokë.

Maksi:- Ç'hyn tallja këtu?! Pse të shkon mendja vetëm për keq?

Silva:- Tallje, e bile cinike. Nuk bëhet më cinike...

Maksi:- Mos fol ashtu!... Është një nga ato shakatë e tyre të zakonshme... Unë i njoh mirë shakatë e tyre, besomë...

Maksi bën një përpjekje të kotë të qeshë sërish. Edhe brenda tij ka nisur të ftohet diçka.

Silva:- Vërtet thua?!... Pa lodhe pak kokën, nuk është fort e vështirë të gjesh domethënien...

Maksi:- Uf! Edhe ti! Asnjë domethënie nuk ka. Është thjesht për të qeshur, të siguroj unë...

Silva:- Ti flet kot dhe më habit me sa lehtësi i kalon gjërat. Ta kam thënë edhe herë tjetër...

Maksi e përfshin me një vështrim, të cilin Silva nuk di si ta marrë: si një kërcënim të burrit, si një dëshirë të tij për pajtim apo si një lutje për të mos i kushtuar rëndësi asgjëje që nuk e kishte kryer ai vetë. Sidoqoftë, Maksi nuk është në gjendje të pikasë sadopak se çfarë po ndodh përtej pasqyrës së kremtë të ballit të gruas.

Maksi:- Po edhe kështu, siç e tragjedizon ti gjithçka...

Silva:- Unë nuk tragjedizoj fare, se po të tragjedizoja, tani duhej të vija ulërimën...

Silva duket se e mori veten shpejt, pas luhatjes së parë që i shkaktoi vështrimi i papërcaktuar i Maksit.

Maksi:- Pa më thuaj se pse? Unë vërtet që nuk shoh asgjë të pakëndshme. Përkundrazi...

Silva bindet se me Maksin mund të fillojë të merret vesh vetëm pasi t'i shpjegojë diçka.

Silva:- Përkundrazi?!...Me një fjalë, të pëlqen? Bravo!... vërtet nuk e sheh se këtu ka një simbol?

Maksi bën një përpjekje tjetër të qeshë. Por buzët e tij përvijojnë vetëm një ngërdheshje. Në rrethana të tjera Silva do të ishte rrënoqethur. Ajo gjithmonë kishte menduar se asgjë nuk e zbulon në mënyrë më të shëmtuar pafuqinë e burrave se sa një ngërdheshje e pavullnetshme mbi fytyrën e tyre.

Maksi:- Çfarë simboli? Mos më çudit tani që jam edhe pak i pirë...

Silva nuk e zotëron më dot veten. Atë e mbërthen të qarët e del gati me vrap nga dhoma. Maksi, tashmë krejt i prerë, e ndjek, duke bëlbëzuar gjysma fjalësh të

## *Daullja prej letre*

palidhura. Nuk di si ta qetësojë. Nuk kupton asgjë.

Ndërkohë, të tre shokët kanë qëndruar në oborrin përpara pallatit, sepse Iliri është kujtuar për zarfin e mbetur në xhepin e brendshëm të xhaketës së tij.

Flet i pari Leka, pastaj Beni, në fund Iliri. Flet prapë Beni, i ndërhyr diçka Leka, shton diçka Iliri, edhe diçka Beni. Mandej Leka bën me kokë për nga rruga dhe të tre lëvizin, pa e ndërprerë diskutimin. Por as në fillim e as më vonë nuk duken fort të shqetësuar. Të tre janë në atë gjendje paksa të eksituar, kur përfytyrimi i të keqes, i rrezikut bëhet krejt i pamundur.

Tamam në këtë çast në dhomën e gjumit të çiftit të ri acarimi ka arritur kulmin.

Silva:- Ti më habit...më habit me këmbënguljen për t'i shfaqësuar dhe më bën të dyshoj nëse je i aftë t'i vlerësosh veprimet e njerëzve, t'i zbërthesh nënkuptimet e tyre.

Maksi ka në fytyrë një pikëllim të madh, të përzier me bezdi. Është një pikëllim që nuk i shkon, që e tregon si të plakur papritur.

Maksi:- Silva, mblidhe veten, të lutem, e mos na i prish nervat me kotësira! Çdo gjë e ka një kufi.

Maksi zgjat duart drejt gruas t'ia fshijë vazhdat e lotëve, që i zbresin deri poshtë në mjekër. Ajo e largon me brutalitet dhe me përçmim.

Silva:- Edhe i quan kotësira?!...Ti je burri im, more, dhe ti duhet të prekesh i pari kur më fyejnë mua... E ndien veten burri im ti, apo jo?

Zëri i Silvës mbetet pezull. Duket se ajo ka vendosur në çastin e fundit të mos e shprehë të plotë mendimin, që i gërryen trurin.

Maksi:- Po nuk ka asnjë fyerje, e dashur, të siguroj, një mijë herë të siguroj, unë i njoh mirë shokët e mi.

Maksi i përcjell fjalët me një psherëtimë të thellë.

Silva:- Ashtu?! Vërtet më siguron një mijë herë?!

Maksi:- Mos bëj ironi, unë po flas sinqerisht.

Silva:- Po seriozisht po flet?

Maksi:- Sigurisht. Me gjithë seriozitetin.

Silva:- Atëherë më fal, por detyrohem të të them se nuk paske seriozitet. Po më zhgënjën.

Maksi:- Silva, nuk ke të drejtë të më fyesh.

Zëri i Maksit është plot ankim, gjë që ngjan sikur e prek pak Silvën.

Silva:- Mirë, pra, më dëgjo: edhe unë po të përgjigjem krejt seriozisht. Ironi deri në cinizëm bëjnë shokët e tu, ata që ti thua se i njeh mirë. Unë vetëm vuaj

*Besnik Mustafaj*

thumbat e tyre, që nuk ua kam borxh.

Maksi:- Më thuaj, dreqin, ku qenka kjo ironi kaq e hidhur, që unë nuk e shoh dot?

Silva:- Ç'kuptim ka ajo qepë e kalbur, e ambalazhuar aq bukur?... Dhurata e zgjedhur për martesën time me ty...

Maksi:- Ajo... asnjë kuptim. Është një shaka pa kuptim, siç janë gjithmonë shakatë... për të qeshur... thjesht për të qeshur...

Silva e ndien fillimin e thyerjes së të shoqit, gjë që e shtyn ta bëjë më të shtruar sulmin.

Silva:- Përpiqu t'i shohësh gjërat përtej dukjes së tyre të thjeshtëzuar! Ti nuk je aq naiv sa ç'hiqesh tani...

Maksi lëkundet fort, por nuk do të dorëzohet.

Maksi:- Më konkretisht, të lutem, se po më çmend fare...

Silva:- Unë po çmendem, ti je fare i qetë, shihet... Po as unë nuk do të çmendem, nuk do t'i kënaq ata... E do më konkretisht?... E do më shkoqur?... Të pëlqen të ma shtosh vuajtjen, duke më detyruar ta komentoj poshtërsinë... Po pranoj. Ja: a nuk jam unë gruaja jote e dytë?

Vështrimi i Maksit është zbratur papritur. Ai e kupton me njëfarë vonese që Silva pret përgjigjen e tij.

Maksi:- E para apo e njëqindta. nuk ka asnjë rëndësi. Ti je gruaja ime.

Silva:- Jo. Ka shumë rëndësi. Unë jam gruaja jote e dytë.

Maksi:- Po.

Silva:- Si "po"?! Ky fakt nuk të ndihmon për ta zgjidhur ENIGMËN e lojës së shokëve të tu të dashur?

Maksi mbledh supet plot dëshpërim.

Silva:- E tmerrshme! Ti vërtet sikur i ke vënë vetes qëllim të më shkatërrosh nervat, duke më detyruar t'i them gjërat deri në fund. E pra gjithëcka është kaq e qartë... S'ka ku të shkojë më qartë.

Maksi vazhdon të shprehë me krejt qëndrimin e vet dëshpërim. Ai nuk bën më asnjë përpjekje për t'u mbrojtur.

Gruaja nuk duron që heshtja të zgjatet.

Silva:- Atëherë më dëgjo mirë dhe po deshe më kundërshtoj! A nuk po u afrohem unë të tridhjetave!

Maksi e ndjek me vështirësi arsyetimin e të shoqes.

Maksi:- E ç'rëndësi ka kjo?! Ç'hyn mosha këtu, xhanëm?!

Silva:- Hyn, si s'hyka? Më saktë, edhe nëse ti më

## *Daullja prej letre*

thua të vërtetën, të tjerët mendojnë se hyka. Kushedi ç'krahasim bëjnë me mendjen e tyre djallëzore midis meje dhe asaj, Anitës, për të cilën ti vetë më ke thënë se e donin shumë të gjithë shokët e tu. Pak sentimentalizëm ndaj asaj që nuk e meritonte të humbiste burrin... domethënë mëri ndaj meje, që i zura vendin dhe... figurë reale e këtij krahasimi na del ajo qepë... për të më simbolizuar mua.

Këtu Silva e humbet përnjëherë vetëpërmbytjen e mezifituar dhe shkrehet në vaj.

Maksi qëndron në këmbë, i ngrirë, me një shprehje të ngatërruar frike, mërzie, hutimi e dhemshurie në fytyrë. Ngurron t'i afrohet. Do të donte ta qetësonte, po nuk di se si. Është ndërdyzas: do të ishte më mirë t'i jepte të drejtë apo ta kundërshtonte dhe një herë?

\*  
\* \* \*

Në fund të shkallëve, kur po zbrisnim për të dalë në oborr, midis fjalëve tona prej gjysmë të dehurish, u fut zëri i Lekës, për të thënë se në atë çast Silva me siguri do të ishte duke hapur pakon.

Në fillim do të stepej. Ndoshta edhe do të trembej. Do të thërriste Maksin, që të siguroheshin të dy bashkë se nuk ishte një bombë me sahat.

Çue?! Pse t'u shkojë mendja te bomba? Ata e dinë mirë se shoqëria shqiptare nuk është e prekur nga sëmundje të tilla borgjezo-revizioniste si terrorizmi. Vetëm në qoftë se u ka marrë koka erë kohët e fundit, qysh kur kanë filluar të rrinë me njëri-tjetrin më shumë se në gjirin edukativ të kolektivit.

Në të vërtetë Silva nuk do të trembej. Ajo do të vazhdonte t'i shpëstjillte një nga një fletët e dendura të qepës. Do t'i digninin sytë nga pak, por nuk do të tërhiqej. Ishte e bindur se në zemrën e perimes së bardhë do të gjente margaritarin e ëndërruar qysh në fëmijëri.

Nuk arritëm ta çonim përfytyrimin deri në fund. Nuk e përfytyruam pasthirmën që do të lëshonte Silva kur, nga kjo shpëstjellje e gjatë nuk do të mbetej asgjë. Nuk e përfytyruam dot të qeshurën e saj, të qeshurën e Maksit. Sepse ndërhyri Iliri.

- Zarfi! - thirri ai gjithë panik.

Unë me Lekën ia plasëm të qeshurës tamam si në një lojë fëmijësh.

- Zarfi ka mbetur në xhepin tim, - vazhdoi ai serioz.



## Besnik Mustafaj

Dhe e nxori. E mblodhi instinktivist tub në dorë dhe po e tundte përhumbshëm para syve tanë, i përmbytur nga një shprehje e thellë faji.

Neve na ngriu gazi në buzë.

Edhe më keq na erdhi ngaqë brenda kishim vënë një letër plot humor, e cila do të ishte edhe shpjegimi e plotësimi i pjesës së parë të shakasë.

Nuk dinim si të bënim.

Unë mendova njëherë të ngjiteshim e ta fusnim pa u ndier nën derë. Leka mendoi të gjenim një fëmijë që ta çonte, duke thënë se ia dha postieri. Pastaj unë e kundërshtova mendimin tim e të Lekës. Nuk kisha asnjë arsye. Thjesht m'u duk e panevojshme ta zgjasim lojën, kur ajo ishte këputur vetvetiu. Leka nuk nguli këmbë. Iliri nuk propozoi asgjë. Unë thashë se ndërkohë Maksi me Silvën e kishin hapur pakon. Ajo e kishte mbaruar rolin e vet. Më e mira për ne do të ishte të ngjiteshim edhe një herë e t'ia linim në dorë atij që do të na e hapte derën. Leka tha se mund të fyheshin ngaqë aty kishte para. Unë i dhashë të drejtë. E gjetëm me vend të mos bënim as njërën, as tjetrën. Në fund të fundit, synimi i vizitës sonë nuk ishin ato para. Meqë i kishim mbledhur, le të blinim nesër diçka të nevojshme për një familje të re e t'ua çonim. Me kaq e quajtmë të mbyllur historinë e u vumë për rrugë. Nuk kishim asnjë parandjenjë të keqe.

Të nesërmen Maksi erdhi në punë si zakonisht, pesë -gjashtë minuta para orarit dhe unë e gjeta në korridor. Dukej disi i zymtë e me një pikëllim të përmbajtur, që i pikëzohej në skajet e syve e në mollëzat e faqeve. Fati i mirë e solli që të mos ishte Leka për ta takuar i pari. Sepse Leka me siguri do të merrte shkas nga pamja e tij për të bërë ndonjë shaka lidhur me torturën e ëmbël të jetës bashkëshortore.

Maksi ka një fytyrë të gjerë e të pastër, e cila ia zbulon edhe brengën më të vogël. Por nuk është vetëm fytyra. Ai është nga ata burra, të cilëve brenga u jep një hutim të përgjithshëm. Atë ditë, ndryshe nga përherë, bashkë me përshëndetjen, ai më dha edhe dorën, duke bërë një përpjekje të lodhshme të më buzëqeshte. Doemos që e ndiente peshën e pikëllimit të sytë dhe donte ta maskonte.

Mua m'u përcoll aty për aty një ndjenjë e pashpjegueshme alarmi, që më nguti të thosha patjetër diçka.

- Kaluam shumë mirë mbrëmë, - iu drejtova pa u menduar. - U kënaqëm...

- Mirë, - m'u përgjigj ai e përsëri sytë e tij nuk u morën vesh me buzët.

## *Daullja prej letre*

- Shumë mirë, - këmbëngula unë.  
Maksi miratoi me kokë dhe bëri një buzagaz të zbehtë.

- Po ti ç'ke kështu?- Nga më doli kjo pyetje? Po mendoja tjetër gjë.

- Pse? Ç'kam?

Por ai e priste pyetjen time. U përpoq më kot të merrte pamjen e të habiturit

Një parandjenjë më këshilloi ta ktheja bisedën në shaka.

- Të janë varur veshët sikur të ka ngrënë macja bukën...

Maksi bëri një buzagaz tjetër të zbehtë. Unë u binda se shakaja nuk ecte me të si zakonisht. Vazhdova:

- Se si më dukesh...

- Si?

-Nuk e përcaktoj dot. Sikur ke një brengë...

- Kam, - pranoi ai menjëherë, pa më vështruar. -

Do të ta them , por jo tani. Pastaj, kur të vemi në kafe. Veçse dua të jemi vetëm... Është e nevojshme të jemi vetëm ne të dy...

- Vemi tani!

- Jo, më mirë pastaj, s'ka ndonjë ngutje të madhe...

Pas nja një ore, kur dolëm për të pirë kafe, shokët na panë të çuditur. Pse po i shmangnim? Megjithatë nuk thanë gjë. E kishin ndier edhe ata se Maksi fshihte diçka të pakëndshme. Ndoshita nuk u erdhi mirë që ai më veçoi mua për të m'u hapur. Sidomos Ilirit, të cilit i ishte përvuajtur fytyra, si të ndihej mëkatari më i madh i botës.

\*

\* \*

Iliri me Lekën e pritën gjithë padurim çastin kur të gjendeshin vetëm e t'u tregoja për bisedën me Maksin.

Gjithë-gjithë shpjegimi im ishte vetëm një frazë: "Silva e ka marrë si tallje shakanë tonë dhe i ka mbetur hatri." Nuk shtova e as nuk hoqa nga ç'më tha Maksi. Madje ua përsërita fjalë për fjalë edhe pohimin e tij se ai për vete e quante thjesht një keqkuptim të së shoqes, e cila nuk ishte mësuar ende me shakatë tona.

- Atëherë, pse ma mbante atë fytyrë të vrenjtur, si t'i kishte rënë hataja mbi kokë? - u hodh Leka.

- Nervozizmi i gruas nuk kalon kurrë pa një prishje të humorit të burrit, - u përpoqa unë sinqerisht ta shfaqësoj Maksin. Ai më kishte thënë vetë se e quante thjesht një keqkuptim të së shoqes dhe nuk kisha arsye të

mos e besoja.

Iliri nuk foli. Veçse kapakët e syve iu varën më poshtë dhe shikimi iu fundos më thellë. Ai njihej për seriozitetin e tepruar, me të cilin i merrte gjërat e parë ndësishtme.

- Shih kur të na sëmuret edhe ky, - tha Leka, duke bërë me kokë nga Iliri. - Dreq o punë!

- Jo, po më vjen keq se u ngatërruat edhe ju për fajin tim, - belbëzoi Iliri.

-Ç'ngatërrësë, o derëbardhë, ç'faj?!- ndërhyra unë.

- Si të punon edhe ty mendja, vetëm për mbrapsht!

- Po tani, si t'ia bëjmë?- tha Leka.

- Hiç, - u përgjigja unë. - Ç'do të bëjmë? Do ta blejmë atë dhuratën, siç menduam, do të sillemi siç jemi sjellë gjithmonë. Për ne nuk ka ndryshuar asgjë.

- Ashtu është, - më mbështeti Leka.- Po ec e mbushi mendjen këtij shëlgut tonë lotues! - Ai tregoi me dorë Ilirin.

- Ky të mbushur e ka - kundërshtova unë me shpërfillje të shtirur. Duhet zhvlerësuar shqetësimi i Ilirit.

Folëm edhe pak, pimë nga një gotë verë e u ndamë gati-gati të qetë. Kjo përshtypje e mirë erdhi duke na u përforcuar kur u ndodhëm secili vetëm.

Të nesërmen në mëngjes u nisa për në punë thuajse i patrazuar nga ndonjë parandjenjë e keqç. Isha gabuar, siç ishin gabuar edhe dy shokët e tjerë. Përpjekja jonë e vetëdijshme për ta flakur nga vetja alarmin e ditës së parë vetëm sa ishte platitur në një skutë të fshehtë të trurit. Mjaftoi shfaqja e fytyrës së errësuar edhe më keq të Maksit, që alarmi ynë të kërcente si shpend i trembur.

Me Maksin u takova në të njëjtin vend ku isha takuar të djeshmen.

- Ty po të prisja, - m'u drejtua pa më përshëndetur dhe as që u përpoq të vinte buzën në gaz, siç bënte zakonisht kur kishte siklet. Më futi krahun jo aq në shenjë intimiteti, se sa për të më dhënë të kuptoj se do të më thoshte diçka të rëndësisë së veçantë. Gjithnjë heshturazi më tërhoqi jashtë.

Unë iu binda mekanikisht.

- Dua të bisedojmë pak- vazhdoi ai.

Unë prapë nuk foli, veç e ndoqa me hapa të vegjël, si të një fëmije që e tërheqin drejt vendit të ndëshkimit.

- Mund të bisedoja edhe me Ilirin, edhe me Lekën, por meqë e nisëm dje bashkë...

Heshtja ime e stepi një çast, për të më vështruar drejt në sy. Në shprehjen e tij përziheshin edhe habia, edhe

## *Daullja prej letre*

një lloj trembjeje. Nuk ishte fort i sigurt në vete. Në të vërtetë unë po bëhesha gati ta ndërprisja jo pa nervozizëm. Pse duhej biseduar patjetër vetëm me njërin nga ne? Tingëllon si një komplot qesharak. Ai e ndjeu tendosjen time.

- Si thua? - më pyeti me një ton ku zbulohet edhe më qartë pasiguria në vete.

E quajta të panevojshme t'ia zbrazja pakënaqësinë time.

E miratova me një lëvizje të vetullave. Dhe shtova:

- Por unë do t'ua tregoj atyre të gjitha... Nuk kam asgjë për t'u mbajtur fshehtë...

- Tregojua, - pranoi ai. - Do t'ua tregoj edhe vetë kur të vijë koha.

Sikur të mos më kishte pushtuar një ndjenjë kotësie, e cila për fat nuk më zgjati, do ta kisha shkundur, do t'i kisha ulëritur se cilën kohë priste ai të shpjegohet me shokët e vet më të afërt. Përsëri e përcolla me heshtje ligjëratën e tij. Ishim larguar ndonja njëqind metra nga qendra e punës. Kishte kaluar ora shtatë dhe njerëzit nëpër rrugë po rralloheshin.

- Gjithçka do t'i themi njëri-tjetrit dua të jetë krejt e sinqertë... Kam nevojë të jetë krejt e sinqertë... Maksi m'u drejtua me një patetizëm që nuk ia njihja e që dëshmonte më së miri për ankthin e fortë që e kishte pushtuar.

Megjithatë as unë nuk isha aq i qetë sa të mund ta shfajësoja.

- Më vjen keq- e ndërpreva pak i fyer. - Mos ke filluar të mendosh se deri tani ka munguar sinqeriteti midis nesh? Po të jetë kështu, atëherë...

Ai nuk më la të vazhdoja.

- Lere!- më ndërpreu me një pamje prej fajtori. - Ç'e ngjet?! As që e kam menduar kurrë, të betohem, po... - Për herë të parë më buzëqeshi. Damka e fajtorit u theksua në tiparet e tij. - Ja, për këtë gjë kam dy ditë që hahem me Silvën. Po ke parë ti, me atë këmbënguljen e vet sikur ma futi edhe mua krimbin. E sheh edhe vetë, mundësia e keqkuptimit është në çdo fjalë, në çdo gjest, mjafton një dyshim...

- Jo... desha ta kundërshtoj unë.

-Si jo?! Ç'thashë unë e si e more ti?!

- Unë e mora ashtu siç e dëgjova, - vazhdova unë me timen.

- Po ta zgjasim edhe pak, do të krijohet një grindje e re - u tërhoq ai. Kështu nisi edhe me Silvën e tani asaj i

është bërë koka daulle.

- Daulle prej letre, - thashë unë, pa menduar se ç'doja të thosha.

Dhe sakaq u tremba. Po sikur Maksi ta merrte si fyerje ndaj të shoqes?

Maksi ishte tepër i zënë me mendimet e veta dhe nuk më ndiqte mua.

Meqenëse të djeshmen më pati thënë vetëm se të shoqes i ishte krijuar një keqkuptim nga veprimi ynë, por nuk pati hyrë në hollësi. tani m'i tregoi të gjitha sa kishin ndodhur natën e parë, por edhe të dytën. Madje, sherri i natës së dytë kishte qenë edhe më i rëndë, pasi replikat mbeteshin edhe më të pashpjegueshme pikërisht pse në formulim nuk ndryshonin thujse fare nga ato të natës së parë. Ajo çka ishte shtuar gjatë përsëritjes, ishte toni i përvojshëm, ku përziheshin, po nuk treteshin dot në njëra-tjetrën lutja, ankimi, pak frikë, pak kërcënim. Si çdo këmbëngulje e pashpjegueshme, edhe ajo nuk kishte kaluar pa e turbulluar Maksin.

Pasi e dëgjova me vëmendje të plotë deri në fund, m'u duk edhe më e tepërt kërkesa e tij për sinqeritet. Maksi vetë nuk ishte plotësisht i sinqertë, përderisa përpiqej gjithsesi të ma fshihte turbullimin.

Unë isha qetësuar tashmë aq sa të mund të gjykoja mbi përgjigjet e mia.

Ishte e pavend t'i betohesha se nuk na kishte shkuar kurrë në mend të hetonim dobësitë e Silvës, e aq më pak ta përqeshnim. Sidoqoftë, ndjeja vërtet shumë keqardhje për shtrembërimin që pësoi shakaja jonë. E dija se duhej t'ia pohoja Maksit këtë keqardhje, por instinktivisht më bëhej se kaq do të ishte e pamjaftueshme dhe vetëm do të rrezikojta ta ndërlikojta më tepër historinë. Vura buzën në gaz krejt kot, sa për të mos e lënë fytyrën të zbrazët.

Maksi priti pak dhe, kur u bind se nuk do ta çelja gojën as për mirë, as për keq, m'u drejtua:

- Ç'do të më këshillosh?

Përmjeherësh u tremba se mos ai më kërkonte përsëri sinqeritet. Kur nuk doli aty, sikur u lehtësova. Por edhe u zura ngushtë. Ç'këshillë mund t'i jepja unë?

-Nuk të këshilloj asgjë. -iu përgjigja. - Shih e bëj!

-Po si? Ç'duhet të shoh? Nuk durohet...

M'u cingërisën përsëri nervat. Nuk di si u përmbajta pa e pyetur se kush nuk durohej, e quajtura fyerje nga ana jonë, apo marrëzia e së shoqes, që e kisha përcaktuar pa dashur në shprehjen "Daullja prej letre". M'u duk vërtet e tepërt që ai të binte kaq shumë nën

## *Dauillja prej letre*

ndikimin e absurditetit të saj.

-Ti nuk e fillove këtë bisedë që të marrësh një këshillë nga unë. - ia ktheva flohtë.

Ishte njësoj si t'i kisha ulëritur.

-Jo, po... - belbëzoi ai i tulatur.

Mua m'u dhimbs. Dhe ndieva nevojë ta qetësoja disi.

-Desha të them se të paktën ti vetë nuk duhet të dyshosh për asnjë çast se ky është thjesht keqkuptim nga ana e saj. Ndryshe, gjithçka do të majiset më keq. Kjo është këshilla ime. Edhe ne do të përpiqemi të bëjmë diçka.

Maksi më falenderoi më tepër me sy sesa me zë. Ai kishte nevojë vetëm për një premtim. Dëshpërimi i tij në atë masë më shtyu të mendoj se vërtet duhej të bënim diçka. T'ia shpjegonim Silvës veprimin tonë? Po ai nuk kishte asnjë pikë të errët. Të gjenim një mënyrë që ta siguronim Silvën për miqësinë tonë të pahilë? Domethënë, të përpiqeshim gjithsesi që ta përmirësonim imazhin tonë në sytë e gruas... Po kështu, do të pranonim heshturazi se ajo kishte të drejtë. As njëra as tjetra nuk shkonin.

Kjo bindje m'u përforcua më tepër duke menduar me vete, pasi u ndava nga Maksi.

Pasdite Leka me Ilirin më erdhën në shtëpi. Ua tregova një për një bisedën me Maksin, si dhe hamendjet e mia. Ata më dhanë të drejtë. Në qoftë se donim ta ruanim miqësinë me Maksin, nuk duhej të vepronim në asnjë rast kundër vetes sonë. Leka ishte i sigurt se çdo ndërhyrje e tij mund të tingëllonte edhe në një mënyrë tjetër që ai, përderisa nuk e kishte për qëllim, nuk e parashihnte dot. Por të tre ishim të vrarë në shpirt ngaqë ajo dëshirë e mirë na doli aq për mbrapsht.

Mua në vetvete, pak nga pak, po më krijohesh edhe një mendim tjetër, të cilin nuk ua thashë menjëherë shokëve. Pa dashur ne me siguri e kishim prekur atë grua në ndonjë të fshehtë të dhimbshme ose, së paku, të pakëndshme të jetës së saj, të pazbuluar para askujt. E sidomos para Maksit, jo. Dhe, aty për aty, i është dukur sikur ne ia njihnim sekretin. Dhe është trembur, është tronditur. Prandaj, kur ta kuptojë se është gabuar, se ne nuk përbëjmë ndonjë rrezik për të, ajo do të qetësohet. Atëherë, patjetër që do të përpiket të bëjë të kundërtën e të sotmes, duke e nxitur Maksin ta forcojë miqësinë me ne.

1

Deri ditën që i vdiq vajza, që ishte edhe fëmija i tij i madh, Nikoll Lokën nuk e njihje thujse askush përtej fshatit të tij. Dhe fshati i tij ishte i vogël e i varfër e i fshehur mes malesh, ku nuk shkelte thujse kurrë këmba e ndonjë të huaji. Dhe as vetë Nikoll Loka nuk kishte shfaqur kurrë ndonjë merak e as çudi pse nuk hynte ndër burrat e përmendur të krahinës. Madje, nga mënyra se si vishej dhe si jetonte, mund të thuhet se ai e kishte më fort qëllim të mos binte në sy për asgjë. Nikoll Loka ishte nga ata burra që kanë lindur vetëm për të rritur fëmijë. Ai kishte shtatë të tillë dhe i pari, vajza e madhe, Lulja, ishte shtatëmbëdhjetë vjeç kur vdiq. E mori një aksident në hekurudhë, ku kishte shkuar ose e kishin çuar të punonte vullnetarisht.

Nikoll Loka nuk kishte parë kurrë hekurudhë e as tren. Nuk ishte as nga ata që shpresonin se Shqipëria do të lulezonte me punën vullnetare të rinisë. Dhe as nuk besonte se vullnetarizmi është themeli për edukimin e shëndoshë të rinisë. Më saktë: ai nuk kishte menduar kurrë për çështje të tilla të mëdha. Nikoll Loka nuk kishte, pra, as kureshtje dhe as bindje për të kërkuar që fëmija i tij i madh, e për më tepër vajzë, të shkonte një muaj vullnetare dhe larg, në kantjerin e hekurudhës që po ndërtohej nga rinia për të lidhur një krahinë të jugut me portin e Durrësit. Por nuk kundërshtoi kur i thanë se emri i Lules ishte në listë. Askush nuk u çudit me heshtjen e tij. Dhe askush nuk e merrte dot me mend se kjo heshtje lidhej me një ngjarje të hidhur, që i kishte ndodhur një kushëriri të tij vite të shkuara, në rrethana të ngjashme. Vajza ime është vullnetare e caktuar nga kryetari i pushtetit dhe e marrë me polic, kishte thumbuar aso kohe pa u thelluar kushëriri i Nikoll Lokës. Po atë ditë e kishin thirrur në polici dhe e kishin rrahur si qen të prishur. Tallu përsëri me vullnetarizmin e rinisë sonë revolucionare, i kishin thënë duke e nxjerrë me shqelma nga posta e policisë. Nikoll Loka nuk donte të rrihej.

Humbja e vajzës iu ngul thikë në zemër, por ai nuk arriti ta qante siç do të kishte dashur. Fill pas lajmit të vdekjes së saj, në shtëpinë e Nikoll Lokës arriti edhe një letër nga vetë Enver Hoxha. Dhe sakaq shtëpia e tij u mbush me drejtues të partisë në rreth, drejtues të Komitetit Qendror të Rinisë, gazetarë dhe plot të tjerë që nuk e tregonin funksionin. Sidomos gazetarë kishte shumë dhe ata i drejtonin pyetje nga më të çuditshmet për jetën e Lules. U vu re shpejt se ai nuk dinte t'u përgjigjej dhe jo thjesht për shkak të hutimit të rastit. Sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit e tërhoqi tinëz mënjanë. U mbyllën të dy në një kthinë që edhe mund të quhet dhomë, për lehtësi përfytyrimi. Ai kishte me vete një kopje të letrës së Enver Hoxhës, të cilën ia lexoi marrësit me zë të lartë dhe ngadalë, duke i theksuar veçanërisht disa nga shprehjet e tij. Megjithatë Nikoll Loka, që e kishte dëgjuar një herë kumtin e Enver Hoxhës, lexuar nga prurësi, nuk u kthjellua ndopak. As pyetjen më të thjeshtë për arsyen e një veprimi të tillë të sekretarit të parë të komitetit të partisë të rrethit nuk ia bëri vetes Nikoll Loka. Ai vazhdonte të ishte i përhumbur dhe t'u përgjigjej fare shkurt gazetarëve: Lulja kishte qenë gjithmonë vajzë e urtë dhe e dashur me të gjithë. Ai nuk e kuptonte përse nuk u mjaftonte ky shpjegim, që shprehte gjithë ç'uronte ai si baba për fëmijët e vet. Të nesërmen të vdekurën nuk e kishin sjellë ende, por shtëpia ishte qysh në mëngjes plot me të afërm, bashkëfshatarë e me të panjohur të rëndësishëm, ardhur nga Tirana dhe nga qytetet e tjera. Natyrisht që midis tyre ishte përsëri edhe sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit, i cili sillej si zoti i vërtetë i shtëpisë. Nikoll Loka ia dinte për nder. Ai nuk do të ishte në gjendje të organizonte pritjen e aq shumë njerëzve. Por sekretari i parë dukej i pakënaqur veçanërisht me mpirjen që tregonte Nikoll Loka para gazetarëve dhe të adhurve nga larg. Ai e tërhoqi sërish tinëz mënjanë, i vendosur t'i fliste më drejt kësaj here.

-Duhet të tregosh më gjatë për vajzën.- i tha.

Nikoll Loka mblodhi supet.

-Nuk di ç'të them. Nuk kam ç'them më gjatë.

-Thuaj si ishte. Të vërtetën.- vazhdoi sekretari i parë.

-Këtë e kam thënë e përsëritur gjithë kohën. Ishte e urtë dhe e dashur. Kurrë s'më ka mërëzitur.

-S'është gjë kjo. Duhet më tepër. Njerëzit presin më tepër. Rinia, gjithë populli kërkojnë të mësojnë më tepër për vajzën tënde. Ajo i përket socializmit tashmë.

-Nuk ka më tepër.- u përgjigj Nikoll Loka me një shprehje prej fajtori.



## *Daullja prej letre*

-Si nuk ka më tepër?! Lulja është tashmë heroinë. Ajo nuk u bë heroinë në një ditë. Si thotë shoku Enver në letrën që të shkruan, të kujtohet?- Zëri i sekretarit të parë nuk arrinte ta fshihte plotësisht nervozizmin.

-Nuk më kujtohet,- u përgjigj nëpër dhëmbë Nikoll Loka.

-Ç'po më dëgjojnë veshët?!- Sekretari i parë u bë haptas i rreptë, kërcënues.- Të bëhet një nder që ta ka zili çdo prind anembanë Shqipërisë dhe ty as të ngroh e as të ftoh. Je në zi, pa do të të kisha dhënë një mësim që ta mbaje mend gjithë jetën. Lulja iku, mendo për vëllezërit e motrat e saj, kokëtull!

Nikoll Loka e ndjeu kërcënimin. Dhe u rrëqeth thellë nga kujtimi i kushëririt të vet të rrahur si qen i prishur vite të shkuara. Ai nuk donte të rrihej. E përfshiu sekretarin e parë me një vështrim lutës.

-Duhet të jesh krenar për Lulen,- ndërroi ton tjetri.

-Jam,- u përgjigj Nikoll Loka disi i trimëruar.

-Duhet të dish ta shfaqësh krenarinë

Sytë e Nikoll Lokës u mbushën sërish me lutje.

-Shoku Enver të tregon në letrën e vet aq të ngrohtë, aq vëllazërore, se si të flasësh e të sillesh me njerëzit e tu dhe me të ardhurit nga larg. Gjithë populli, e veçanërisht rinia, i kanë sytë e veshët te ti. Kupton?

Nikoll Loka kuptoi edhe më shumë nga ç'mund të shpresonte sekretari i parë. Vështirë të thuhet nëse ky kthjellim i solli fatmirësi apo fatkeqësi. Por, e vërteta është se ai kuptoi.

2.

Edhe gazetarët e ndërruan mënyrën e të pyeturit, gjë që ia lehtësoi Nikoll Lokës gjetjen e përgjigjeve të përshtatshme. Ai mendoi se edhe ata kishin marrë ndonjë këshillë të dobishme nga drejtuesi kryesor i partisë në rreth. Tashmë në ndihmë Nikoll Loka kishte jo vetëm kujtimin e kushëririt të rrahur, por edhe letrën e shokut Enver. Ai zuri të mahnitej me veten dhe të mahniste të tjerët. Po i përshtatej me një shpejtësi të habitshme një bote që nuk e kishte parë as në ëndërr. I dërguari i Komitetit Qendror të Rinisë e njoftoi se trupi i vajzës do të vononte edhe dy ditë. Ai shok i ri kishte një pamje thellësisht të pikëlluar dhe priste me ankth, që Nikoll Loka t'i shprehte pakënaqësi, dhe do të kishte të drejtë. Shtëpia e të vdekurit pa të vdekurin ka hije fort të rëndë. Ose mund ta pyeste për shkakun e asaj vonese të paarsyeshme. Shoku i ri, me mollëzat e faqeve të kuqe si vajzë e turpshme dhe një palë sy të butë, do ta kishte tepër të

vështirë, ndoshta të pamundur të sajonte diçka të besueshme, për të shmangur shpjegimin se trupi i të vdekurës gjendej në Tiranë, në duart e mjekëve, që përpiqeshin ta sillnin sadopak në formën e një kufome njerëzore. Masa e dheut, që i ishte shembur përsipër, e kishte shpërfytyruar tërësisht. Ai mori frymë i lehtësuar kur Nikoll Loka nuk i drejtoi asnjë pyetje dhe as nuk i shprehu pakënaqësi. Ai vetëm dha një miratim të ftohtë e të largët me kokë, si njeriu i vetëdijshëm për ndërlikimet që ka historia e madhe, dhe i kërkoi një radio me bateri si diçka që i takonte, pa iu lutur e pa e falenderuar. Fshati i tyre nuk ishte elektrifikuar ende dhe ai dëshironte të dëgjonte. Tjetri e mori me mend çfarë dëshironte të dëgjonte babai i heroinës së re dhe i dha të drejtë. Nikoll Loka duhej të dëgjonte.

Radioja arriti brenda ditës.

Vinin edhe gazetat, por Nikoll Loka kishte vështirësi për t'i lexuar. Më saktë, nuk i lexonte dot. Ai kishte kryer vetëm dy klasë shkollë në fëmijërinë e largët dhe më pas nuk kishte zënë kurrë me dorë ndonjë fletë të shtypur e as të shkruar. Deri në ngjarjet e fundit ai nuk kishte menduar se do t'i nevojitej ndonjëherë njohja e gërmave. Prania e paparashikuar e aq shumë njerëzve të ditur në oborrin e ngushtë të shtëpisë së tij dhe sjellja e tyre plot respekt ndaj tij, ia zbuluan këtë mungesë të vjetër si një dobësi të dëmshme, pra, që duhej fshehur. Ai vendosi që fëmijët t'i çonte në shkollë të mëdha, dhe ky ishte mësimi më i çmuar që mori ai nga ngjarja. Nikoll Loka i shfletonte gazetat, por vështirësi i tij, zakonisht disi i fjetur, ndalej vetëm te fotografitë. Gjithë Shqipëria njihte tashmë fytyrën e tij dhe të gruas dhe të fëmijëve të tij. Nikoll Loka ndjente zemrën t'i rrihte me forcë. I pëlqente, pa e ditur dhe pa pyetur përse. Ndërsa radion e dëgjonte gjithë vëmendje. Vdekja kishte humbur diçka të rëndësishme, ishte bërë më e durueshme si të mos ishte vdekje dhe ai nuk e dallonte dot nëse i përkiste ta falenderonte Enver Hoxhën, letra e të cilit kishte ndryshuar gjithçka, apo ta mallkonte e ta sikteriste si një magjistari, që po ia ftohte dhimbjen më të shtrenjtë, atë për vajzën e nisur në pakthim. Ishte kryesisht radioja, që e shtyu Nikoll Lokën drejt mirënjohjes për UDHËHEQËSIN, duke mbytur pak e nga pak çdo ndjenjë tjetër. Ti nuk qave për vajzën dhe unë të përgëzoj, i thoshte në letërën e tij Enver Hoxha. Përkundrazi, ashtu siç të takonte si patriot socialist, ti iu gëzove veprës së saj. Nikoll Loka nuk u kujtua kurrë të pyeste veten as të tjerët se nga e dinte shoku Enver, që ai nuk kishte qarë. Letra ishte shkruar para se ai të merrte lajmin e kobshëm. Nikoll

Loka nuk pyeti kurrë as se cila ishte vepra e të bijës.

E vërteta është se fjalët e Enverit nuk i kishin bërë dhe aq përshtypje sa kohë nuk i kishte dëgjuar në radio. Shqiptimi i theksuar i spikerit u jepte një tingëllimë tjetër, i nguliste një nga një në tru si gozhdë të mëdha. Nikoll Loka mendoi se ai nuk duhej të ishte i vetmi që drithërohej tek sa veshët ia përshkonte ky kumt. Madje, ai nuk ishte i pari që e përvetësoi. Në radio ai dëgjoji disa djem e vajza të fshatit të tij të shpreheshin me një krenari të thellë për Lulen. Ata pohonin se ajo kishte qenë gjithmonë shembull frymëzimi për ta. Në fillim Nikoll Loka çuditej dhe nuk e kuptonte ç'po ndodhte. Ai nuk kishte vënë re kurrë tek e bija ndonjë frymë shembullore. Ai nuk gënjente kur thoshte se e bija kishte qenë gjithmonë e urtë dhe e dashur në shtëpi dhe jashtë. Por ajo nuk kishte qenë më tepër. Nikoll Loka e dinte tashmë se kaq nuk mjaftonte. Por nuk e dinte përse. Dhe nuk e dinte as se kujt nuk i mjaftonte. Gjithsesi, as kjo nuk e shqetësonte. Bashkëfshatarët e tij u treguan më të shpejtë se ai. Jo vetëm rinia, që e njihte jetën e re nga shkolla dhe nga mbledhjet e dendura. Edhe burra e gra të moshuar, që nuk ishin mësuar kurrë të bisedonin më tepër se për motin e për të mbjellat, për shëndetin e fëmijëve dhe për ëndrrat e gjumit të keq, po tregoheshin me gojën brisk para mikrofonëve të zinj si kuti magjike të gazetarëve. Nikoll Loka mësoi i mrekulluar se në fshat të gjithë e kishin dashur Lulen si vajzën e tyre, por edhe si një mësuese të pjekur. Në fillim Nikoll Loka nervozoheshin me të tilla gënjeshtër, dhe pyeste veten se ku ishte interesi, por edhe i kishte zili folësit për zhdërvjelltësinë dhe sigurinë. Fillimi ishte dy ditët e para, kur trupi i të vdekurës nuk kishte ardhur ende të varrosej në fshatin ku kishte lindur. Dhe askush nuk çuditej dhe as nuk shqetësohej dhe as nuk pyeste përse kjo vonesë, thua se futja në dhe e të vdekurës nuk kishte më asnjë rëndësi. Në përpjekjen për të kuptuar se ç'po ndodhte, Nikoll Loka arriti në përfundimin se gjithëcka lidhej me mënyrën e mbinatyrshme si kishte ndërruar jetë e bija. Ajo ishte mbuluar me dhe e gjallë, kishte dhënë shpirt atje poshtë dhe pastaj e kishin zhvarrosur për ta shëtitur mes të gjallëve. Nikoll Lokën e pushtoi një frikë e fshehtë, e panjohur. Si do të ishte vazhdimi?

Kur për Lulen nisën të flasin me krenari edhe shumë të panjohur, të rinj e të moshuar, burra e gra anembanë Shqipërisë, Nikoll Loka pati ndjesinë se po i rrëmbenin diçka të çmueshme, që i përkiste vetëm atij. Nuk e përcaktonte dot se çfarë dhe as nuk iu përtëri dhimbja e harruar për vajzën e varrosur një herë për së gjalli e që do

të varrosej për së dyti e vdekur. Gjatë kësaj kohe brenda lëkurës së tij të ashpër nga puna dhe ushqimi i keq, ishte mbryjtur djallëzisht një dikush tjetër, që zuri të shfaqet me një shpejtësi të mahnitshme. Nikoll Loka thirri gazetarët. Instruktorët e komitetit të partisë, që vigjëlonin aty natë e ditë, shkuan gjithë ankth në dhomën e tymosur, ku priste i zoti i shtëpisë. Pati nga ata që dyshuan se ai do të kishte pësuar ndonjë krisje mendore. Kjo do të ishte më e rënda, e që do t'ua prishte të gjitha planet. Ata morën frymë të lehtësuar vetëm pasi e dëgjuan t'u drejtohej gazetarëve me një kthjelltësi prej njeriu të sprovuar në punëra të tilla. Askush nuk mund ta merrte me mend çfarë kishte ndodhur brenda kokës së tij. Por askush nuk ishte aty për të kërkuar këso shpjegimesh të ndërlikuara e madje fare të panevojshme. Gazetarët dhe instruktorët e komitetit të partisë ishin aty për të siguruar rezultatin që po niste të dukej. Asgjë tjetër nuk kishte rëndësi. Instruktorët e komitetit të partisë të rrethit dhe ata të Komitetit Qendror të Rinisë e përgëzuan singërisht Nikoll Lokën dhe e falenderuan. Na ke dhënë një mësim të mrekullueshëm, i thanë ata. Ndërsa gazetarët e palodhshëm, sidomos ata radiofonikë, ishin të lumturuar. Për herë të parë do të kishin në valë zërin e babait të heroinës, që tregonte.

3.

Pas disa orësh Nikoll Loka dëgjoi veten në radio. Dhe u trondit. Nuk e njohu zërin e vet. Dhe as nuk mbeti shumë i kënaqur me ç'kishte thënë. Por harroi gjithëcka pak më vonë, kur dëgjoi njerëz të moshave të ndryshme, të gjithë të panjohur, punëtorë dhe intelektualë, nga fshatra dhe qytete ku ai nuk kishte shkelur kurrë, të shpreheshin plot admirim për ç'kishte treguar ai mbi të kaluarën e vajzës së tij. E quanin baba me fat. Në mënyrë të pavetëdijshme Nikoll Loka kishte arritur në përfundimin se vajza e tij do të kishte tashmë vetëm të kaluar. Lulja e tij mund të lulëzonte disi vetëm duke e zgjatur kohën e mbetur prapa. Dhe ai e kishte gjithë lirinë e nevojshme. Madje pikë isht kjo gjë kërkohej prej tij.

Ai tha me vete se bisedën e dytë me gazetarët duhej ta mendonte më mirë. E dinte se në kujtimet e veta nuk kishte shumë për të gërmuar. Madje nuk kishte fare ç'gërmonte. Por tashmë kishte në ndihmë gjithë Shqipërinë. Nuk ishte vetëm radioja dhe instruktorët dhe gazetarët që kishte në shtëpi natë e ditë. Ai merrte çdo ditë qindra letra e telegrame, të mbushura me fjalë të bukura e që vinin nga gjithandej, e që i tregonin se si ishte përgatitur vajza e tij gjatë gjithë rinisë së saj të shkurtër për lavdinë e

përrjetshme. Vetëm shprehje ngushëlluese nuk i sillte kurrë posta. Ai e kuptoi se e shoqja po e tepronte me të qarë. Sytë e saj të skuqur me siguri që u linin përshtypje të keqe të deleguarve të partisë dhe adhuruesve që dyndeshin gjatë gjithë ditës e deri vonë në mbrëmje. Nikoll Loka urdhëroi të shoqen të lante fytyrën dhe të gazmohej. Nuk donte më lotë. Ajo e përfshiu me një vështrim të tmerruar. Në shtëpinë time nuk ka zi, iu përgjigj ai me një zë të fryrë kundërshtimit të saj të heshtur. Këtë bisedë të pazakontë me gruan ai e zhvilloi në mëngjes, dhe qëllimisht në prani të gazetarëve. Pa kaluar mesdita kjo do të përcillej anekënd atdheut si pika kulmore e ngjarjes. Në të vërtetë, ai vetëm kishte përsëritur një nga fjalitë e letrës së Enver Hoxhës. Kjo ishte një hollësi që nuk u ra në sy instruktorëve që ndiqnin me vëmendje çështjen në vend. Ata ishin tejet të kënaqur. Por i tërhoqi vëmendjen dikujt tjetër, më lart e që duket se e ndiqte ngjarjen edhe më me vëmendje se vëzhguesit në vend. Natyrisht që vërejtja u bë dhe jo thjesht sa për t'u vënë në dukje, por që të zbriste deri te Nikoll Loka. Dhe ai e pranoi me zemër të hapur. Ai ishte i bindur tashmë për forcën e panjohur që i kishte dhënë letra e Enver Hoxhës. Pse të mos e pohonte për mbarë popullin? Ai e ndreqi gabimin brenda ditës. Dhe sakaq mori përgëzimet.

-Nuk janë nga ana ime, ti e kupton.- iu drejtua lajmëtari i rëndësishëm.

-Faleminderit shumë.- iu përgjigj Nikoll Loka duke e përfshirë me krahët e gjatë dhe eshtrorë.- Faleminderit me gjithë zemër Partisë dhe shokut Enver.

Nga shtëpia e tij u përzu përfundimisht fjala "vdekje". Ajo nuk u përmend, madje, as gjatë ceremonisë së varrimit, ku morën pjesë mijëra vetë, sidomos të rinj, të ardhur nga gjithë Shqipëria. Sipas radios dhe gazetave dhe raporteve të komitetit të partisë të rrethit dhe atyre të Komitetit Qendror të Rinisë, gjithëka shkoi për mrekulli. Ndërsa një anekdotë e treguar asokohe nga gojët e këqija dhe, çuditërisht, e paharruar ndër vite, thotë se Nikoll Loka i uroi të rinjtë e pranishëm të ktheshin nga kantieret e hekurudhave si Lulja e tij. Ata kishin përshkuar qindra kilometra, kryesisht në këmbë, për t'u gjendur pranë tij në atë çast të madh.

Vështrirë të besohet se Nikoll Loka ka bërë një urim të tillë. Edhe në fotografitë bardh e zi, që ruhen ende në shtëpinë e tij dhe nëpër arshiva dallohet mjegullimi i vështrimit të tij ditën e ndarjes së përrjetshme me trupin e së bijës. Lotët janë diku thellë si retë e ngarkuara me rrebes prapa horizontit. Ai mbështjell me vështrimin e vet

të zbutur turmat e të rinjve që e rrethojnë, edhe ata thellësisht të prekur. Këto fotografi nuk e paraqesin episodin aq heroik sa ç'mburren raportet zyrtare dhe shtypi, ku thuhet se babai i heroinës e ftoi gjithë popullin shqiptar të shtrengonte radhët rreth Partisë dhe Shokut Enver. Në këto raporte përshkruhet gjithashtu edhe një pjesë e së vërtetës. Në letrën e tij Enver Hoxha i thoshte Nikoll Lokës se shqiptarët ishin mësuar gjatë shekujve që të sakrifikonin bijtë e bijat e tyre me të mira në themelet e kështjellave që ndërtonin. Në këtë rrugë të lavdishme do të cete edhe ndërtimi i kështjellës së tyre komuniste. Sakrificat e Lules do t'i bënte muret e saj të pathyeshme. Megjithëse jo menjëherë, ky paragraf e kishte trazuar jashtë mase përfytyrimin e Nikoll Lokës. Ishin zgjuar kujtime të fëmijërisë, legjenda dhe ëndrra, të cilat ai as që e dinte se ruheshin në trurin e tij, dhe me lëndën e tyre të pazakonshme ishte mbryjtur dikush tjetër brenda lëkurës së babait të heroinës. Ishte një qenie e mpirë dhe jo nga dhimbja, por nga një përzierje e skajshme e frikës me joshjen. Ai kishte humbur ndjeshmërinë dhe kishte fituar një kthjelltësi që i hutonte ata që e kishin njohur më parë. Përmendjen e sakrifikimit të Lules në themelet e kështjellës komuniste shqiptare ai e la qëllimisht për në ceremoninë e varrimit. Me atë rast i njoftoi të pranishmit edhe se do të fillonte pa vonesë ndërtimin e një shtëpie të re, me dhoma të mëdha e mure të bardha e plot dritë, që të kishte gjithmonë vend dhe rehati për shokët e Lules, që do të bënin rrugë të gjatë për t'u ngjitur në vendlindjen e saj, atje ku ajo kishte lënë gjurmët e para. Ajo do të ishte kurdoherë shtëpia e Lules, pra streha e rinisë revolucionare.

4.

Vështirë të gjykohet se sa i sigurtë, i sigurtë dhe i vendosur ishte Nikoll Loka t'i shkonte në fund ndërmarrjes së tij. Mund të thuhet pa u gabuar vetëm se ai nuk i kishte mjetet për të ndërtuar një shtëpi të madhe e të bukur, siç e kishte përshkruar para mijëra shoqëruesve të Lules për në banesën e fundit. Madje nuk i kishte mjetet për të ndërtuar as edhe një shtëpi të vogël. Nuk kishte para. Nuk i kishin lënë të parët, nuk kishte fituar as vetë me tepër nga ç'hanin fëmijët për ditë. Dhe fëmijët i kishte ende shumë të vegjël për të shpresuar në ndihmën e tyre. Pati edhe nga ata që pyetën se ç'do t'i nevojitej një shtëpi e tillë. Fshati ishte i vogël e i mënjanuar nga pjesa tjetër e botës, siç dihet tashmë, dhe rrallë do t'i qëllonte ndokujt rruga andej. Ndërsa rinia, vëllezërit dhe motrat e panjohur të Lules,



natyrisht që nuk do të ktheheshin më në atë rrëpirë. Me se do ta mbushë një shtëpi kaq të madhe Nikoll Loka, pra? Ishte një pyetje sa për të mos thënë drejt se ai shihte ëndrra me sy hapur. Por askush nuk ia mori për keq dhe as nuk e shqiptoi një pyetje të tillë të mbrapshtë. Askush nuk do të mund ta merrte me mend se si do të vazhdonte kjo histori. Më pak nga të gjithë parashikonte Nikoll Loka.

Ai nuk pati kohë të qetësohej, të harronte pak vorbullën marramendëse që e kishte përfshirë ditëve të fundit, të ndjente boshin që kishte lënë edhe në ajrin e shtëpisë Lulja e ikur përgjithmonë. Qysh të nesërmen në mëngjes në oborrin e tij u paraqitën dy veta, që thanë se vinin nga Tirana. Asnjë hollësi më tepër. Madje as emrat. Ishin më të rinj se ai, por jo fare të rinj. Ata ishin të veshur mirë, shumë të sjellshëm, të qeshur, ama nuk i dhanë rast t'u drejtonte ndonjë pyetje të nevojshme, kur e njoftuan se do ta merrnin me vete. Në Tiranë e priste dikush. Nikoll Loka pati një kërcim të papritur të zemrës. Trupi i vajzës së vdekur ishte mbajtur në Tiranë disa ditë, dhe ai nuk ishte kujtuar të shkante ta shihte, ta shoqëronte në kthimin e fundit në follenë e vet. Ishte një rrahje e vetme e zemrës, si një shkrepëtime rrufeje në qiell të kthjellët, që e tronditi, për një çast përmbysi gjithçka në kokën e tij. Ndoshta në arkivolin e bukur prej bronxi, që më sollën pa më lejuar ta çelja, nuk ka qenë fare trupi i saj, dyshoi ai gëzueshëm. Ndoshta ajo nuk ka vdekur fare, e çoi ai më tej dyshimin e vet lumturues. I ra në sy veshja e vet e vjetëruar. Nuk kishte më të mira. Nuk kishte patur kurrë. Gati u çudit si nuk ishte kujtuar dikush për paraqitjen e tij gjatë atyre ditëve. Instruktorët e partisë i kishin tërhequr vëmendjen vetëm që të rruhej çdo mëngjes. Të ishte i pastër. Thua se anët e tjera të paraqitjes nuk kishin rëndësi. Ai i mori inat. Dhe pyeti dy të ardhurit me një zë të tendosur nëse ishin indstrukturë.

-Jo,- iu përgjigjën ata me një gojë, pa ia kërkuar domethënjen e një pyetjeje të tillë, dhe i bënë shenjë të nxitonte.

Nikoll Loka u ndje i lehtësuar si të kishte shmangur një sherr të rrezikshëm. Por vështrimi iu mpi gjithsesi të mëngët e rjepura të këmishës së vet.

-Nuk vij dot,- vazhdoi ai.- Shihni si jam i veshur!  
Dy të ardhurit i buzëqeshën me mirëkuptim dhe i thanë të mos shqetësohej. Ishte menduar për gjithçka, që të paraqitej siç duhet atje ku e prisnin. Nikoll Lokës iu përtëri dyshimi për vdekjen e paqenë të së bijës. Nuk kishte asnjë parandjenjë tjetër. Vetura ishte e rehatshme, dy bashkudhëtarët e tij të heshtur, por gjithnjë të

vëmendshëm e të sjellshëm, dhe ai pati kohë të mjaftueshme gjatë gjithë rrugës të përkundej në përfytyrimin e takimit të jashtëzakonshëm me të bijën. Ishte i lumtur si të dilte nga një ëndërr e tmerrshme dhe ndjehej papritur fajtor para Lules. Si ta përligjte para saj harrimin e dhimbjes? I vinte edhe turp. Ajo me siguri i kishte dëgjuar gjithë ç'kishte dërdëllitur ai nëpër radio e gazeta. Ai ishte gati të qante me të gjitha lotët, që i kishin munguar qysh nga lajmi i... Nuk e kishte ditur sa shumë vrer i ishte mbledhur në shpirt. Dhe do të kishte qarë sikur njëri nga bashkudhëtarët e tij të panjohur të mos ia ndërpriste papritur përhumbjen.

-Je treguar burrë, shoku Nikoll,- iu drejtua ai.- Gjithë Shqipëria të merr si shembull.

Nikoll Loka erdhi në vete. Por nuk iu davarit shpresa se po e çonin të takonte të bijën. Ai kishte nevojë tashmë për këtë shpresë më shumë se për ajrin dhe e falenderoi tjetrin me një buzagaz të drojtur, të largët. Ai nuk e dinte nëse duhej thënë diçka më tepër. Buzagazi i drojtur mbeti varur mbi fytyrën e tij edhe një copë herë. Ai vëzhgonte dy bashkudhëtarët. Dukeshin të dashur, por ishin tepër të heshtur. Edhe me njëri-tjetrin rrinin si të huaj. Nuk shkëmbejin asnjë fjalë. Nikoll Loka do të kishte pëlqyer të bisedonte me ta. Ndoshta mund ta kishin këshilluar si të sillej me të bijën, të paktën në fillim, sa të kapërcente keqkuptimin. Ai ishte i bindur se kishte një keqkuptim dhe nuk mendonte dot gjë tjetër. Ndjenja e fajësisë ia kishte topitur trurin. Nuk i shkoi asnjë çast nëpër kokë pyetja e thjeshtë se përse do të sajohej gjithë kjo histori e ndërlikuar? Dhe përse kishin zgjedhur pikërisht atë. Nikoll Lokën dhe vajzën e tij, të pamësuar të dy me çështjet e mëdha të shtetit? Dhe kush i kishte zgjedhur? Ankthi i shtoej me afrimin drejt Tiranës. Dhe vetura nxitonte si e përndjekur nga hijet e liga. Nuk ndaluan diku as për të ngrënë diçka dhe në krveqytet arritën rreth orës katër pasdite. Zemra e Nikoll Lokës u çmend fare. Vetura dredhonte duke fërshëllyer gomat nëpër rrugët e rrethuara me ndërtesa të larta. Bota jashtë ose xhami i përparmë i veturës ishin veshur befaz me mjegull. Nikoll Loka fërko i fort sytë dhe pyeti për herë të parë, pa iu drejtuar veçmas njërit e as tjetrit nga shoqëruesit:

-Ku është takimi?

-Do ta mësosh më vonë,- iu përgjigj i pari.-Tani për tani është sekret.

Dhe i dyti shtoi:

-Nuk është çështje mosbesimi, por disiplina jonë. Dhe do të kesh kohë të çlodhesh mirë e të ndërrosh. Mos kij



merak! Eshtë menduar.

Nikoll Loka përfshiu me një vështrim tjetër të tmerruar veshjen e vet. Ai nuk e kishte dëgjuar atë punën e sekretit e të besimit ose nuk i kishte bërë përshtypje.

-Nuk kam tësja për t'u ndërruar,- tha përmes një ofshame. I ishte tharë fyti. Dhe kishte harruar krejt bisedën e mëngjesit.

-Gjithçka do ta gjesh gati. Mos u shqetëso fare!

-Ku? Kush e ka përgatitur?

-Gjithçka të pret atje ku do të strehohesh sonte.

-Kush e ka përgatitur?- përsëriti Nikoll Loka, me shpresë se do të ishte e bija. Vetëm ajo mund të kujdesej kaq mirë për të atin. Sigurisht që ajo ishte.

Në vend të përgjigjes ai mori një buzëqeshje tjetër të vagullt. Nuk kuptonte asgjë. Ata kishin një sjellje fort të çuditshme. Në fund të fundit ai po shkonte të takonte të bijën. Edhe heroinë, ajo ishte e bija dhe nuk kishte të drejtë t'i dërgonte shoqërues të tillë, që argëtoheshin me hutimin e tij prej njeriu të pamësuar me ngjarje të bujshme. Nikoll Loka ndjeu t'i ngjitej një valë e pafuqishme zemërimi ndaj Lules. Nëse ajo kishte harruar, ai do t'ia kujtonte se edhe heroinë, edhe perëndi, ajo mbetej prapë vajza e tij, qingjëza e tij lozanjare. Ai mendoi i lhtësuar se me këtë qortim në çelje të bisedës, do t'ia hiqte Lules të drejtën e ankesës për gjithë marrosjen që kishte ndodhur gjatë ditëve të zisë për vdekjen e saj të rrejshme.

5.

Veshur me kostumin tradicional të malsorit, si të dilte drejt nga këngët e kreshnikëve. Nikoll Loka ngjiti me një hap të rëndë dhe krenar shkallët e mermerta të Komitetit Qendror të Partisë. Ai shkonte te biri dhe udhëheqësi i shtrenjtë i popullit tonë, shoku Enver Hoxha. Sytë prej shqiponje të burrit të maleve, babait të heroinës më të re komuniste, ishin të përlotur tek përqafohej me atë që e nxori Shqipërinë nga nata shumëshekulllore në dritën e lumturisë.

-Mbahu!- i tha shoku Enver.- Lulja të bëri ty babain e gjithë brezit tonë të ri.

-Qaj nga gëzimi,- u hodh Nikoll Loka.- Më lerë të derdh një lot gëzimi, shoku Enver! Lotët e hidhërimit na i fshive ti me Partinë njëherë e përgjithmonë.

Të dy burrat, nxënës dhe mësues të njëri-tjetrit, që kanë vënë përherë interesat e atdheut e të socializmit mbi gjithçka, ulen gju më gju për të biseduar. Kanë aq shumë për të thënë.

-Të ftova, që të shkëmbejmë disa mendime. Pa ju,

njerëzit e thjeshtë, ne që punojmë nëpër zyra do të mykeshim. Këtu e ka burimin parimi i Partisë sonë se në Shqipëri është populli që drejton. Kështu, pushteti ynë është bërë i pathyeshëm.

Malsori trim, i zgjuar e patriot Nikoll Loka e kupton menjëherë ftesën e shokut Enver. Me një gjuhë të thjeshtë, por të çiltër si ujvarat e vendlindjes së tij, pa zbukurime të kota, siç dinë të shprehen vetëm zotërit e vërtetë të punës, ai i ngrë Udhëheqësit problemin e burokratizimit të disa kuadrove, të cilët, të fryrë nga vetëkënaqësia dhe besimi në vete, i shkëpusin dita-ditës lidhjet me bazën punonjëse. Në qoftë se lejohen gjatë të veprojnë në këtë mënyrë, ata do të harrojnë nga kanë ardhur e do të bëhen mish i huaj në trupin e shëndetshëm të shtetit tonë leninist, thotë Nikoll Loka, i bindur se në atë zyrë është vendi ku u shkohet të vërtetave deri në fund. Shoku Enver e dëgjon i zhytur në mendime dhe herë pas here miraton me kokë.

-Po sikur Partia të vendosë që kuadrot dhe intelektualët të kalojnë një muaj në vit drejtpërdrejt në prodhim?

-Do të ishte shumë mirë.- përgjigjet i sigurtë Nikoll Loka.- Kokat e tyre do të freskoheshin, do të mbusheshin me frymën jetëdhënëse revolucionare të klasës punëtore. Kuadrot dhe intelektualët janë bijtë e shtrenjtë të popullit. Ata duhen ndihmuar vazhdimisht, që të mos gabojnë, njësoj si vaksinat që bëjmë çdo vit për të mos u sëmurur.

Shoku Enver i jep të drejtë malsorit të mprehtë dhe shton se këtë mendim do t'ia shtrojë për diskutim plenumit të Komitetit Qendror të Partisë në mbledhjen më të afërme.

Pastaj, me një frymë të ngrohtë shoqërore, ata diskutuan për zhvillimin më të shpejtë të zonave malore. Nikoll Loka i ngriti shokut Enver çështjen e zgjerimit të kolektivizimit.

-Nuk është e drejtë që fusha ka tashmë kooperativat, ndërsa ne kemi mbetur ende te prona private. Na vret edhe ndërgjegjja, na duket vetja si muze i të kaluarës.

Shoku Enver e siguroi të ftuarin e nderuar se edhe kjo prapambetje do të kapërcehej shpejt. Vullneti i popullit ishte dhe do të mbetet urdhri suprem për Partinë dhe shtetin. Në vazhdim, Udhëheqësi i shtrenjtë i Partisë dhe i popullit u interesua më hollësisht edhe për aspekte të jetës shpirtërore të njerëzve. Ai pyeti malsorin nëse zhvillonin veprimtari të bukura vatrat e kulturës.

-Ato duhet të bëhen çerdhet e vërteta të mbledhjes së rinisë e të pleqve, të burrave e të grave. Vetëm kështu do të zbrazen kishat e xhamitë, të cilat e mbushin parreshtur

kokën e banorëve me megjull reaksionare. Do të vijë dita që vetë populli do t'u verë kazmën e t'i rrafshojë.- tha shoku Enver.- Fetë nuk janë në traditën shqiptare, na i ka sjellë armiku i huaj. Kishën katolike e kanë sjellë pushtuesit romakë, atë ortodokse ata grekë e serbë, xhamitë na i bëri peshqesh me tuhn e shpatës në qafë turku. Shqiptarët nuk kanë patur kurrë fenë e tyre, apo jo?

-Kurrë,- u përgjigj Nikoll Loka plot entuziazëm.- Dhe dijeni, shoku Enver, se dita e fundit të kishave e xhamive ka ardhur. Ne populli vetëm shenjën e Partisë presim, që t'i rrafshojmë çil e mbyll sytë, dhe t'ua rruajmë mjekrat klerikëve e t'i mësojmë si fitohet buka duke punuar tokën e jo duke mashtruar popullin me përrallat e Jezu Krishtit e të Muhametit.

-Ah, jo!- u hodh shoku Enver.- Partia nuk jep kurrë shenja të tilla. Ato duhet të jenë inisiativa të vetë popullit. Partia vetëm mëson se për të ndërtuar një të ardhme të sigurtë, populli nuk duhet të besojë në fantazmat e Jezu Krishtit e të Muhametit, por në virtytet e gjalla të heronjve të vet, që i ka lindur e i ka rritur, siç është shembulli i ndritshëm i Lules.

Biseda zgjati disa orë, me zemër të hapur. Tek e përcillte në derë, shoku Enver e njoftoi të ftuarin e vet se Komiteti Qendror i Rinisë kishte shprehur dëshirën që shtëpinë e tij të re ta ndërtonin një grup të rinjsh, shokë të Lules, me punë vullnetare. Unë them që ti të pranosh. Kështu bëhet realitet edhe vullneti yt që ajo të jetë shtëpia e rinisë. Nikoll Loka nuk dinte ç'fjalë të zgjidhte për të falenderuar.

-Më takon mua të të falenderoj. Më ke dhënë mendime shumë të çmuara për punën e Partisë.- iu përgjigj shoku Enver dhe e shtrëngoi gjatë në kraharorin e vet të gjerë si mali.

Nikoll Loka u largua nga ky takim me zemrën të mbushur lumturi dhe frymëzim. Ai kishte padurim të kthehej në fshat. Në sy i shndrisnin dy diej, të cilët duhej ta jepnin dritën e tyre për të gjithë.

6. Po ta zinin historinë nga fundi, do të duhej të tregonim se bashkë me botimin e reportazhit të mësipërm në të gjitha gazetat e ditës, doli edhe udhëzimi i Komitetit Qendror për studimin e tij në organizatat-bazë të partisë të vendit. Të gjithë komunistët do të thelloheshin në përmbajtjen e asaj bisede programatike të shokut Enver me njeriun e popullit Nikoll Loka dhe të gjenin aty detyrat e tyre. Pastaj ky udhëzim u shtri edhe në Lidhjen e

Shkrimtarëve e të Artistëve, edhe te organizatat e rinisë, ato të grave, ato të veteranëve, në Universitet dhe në sindikatat.

7.

Grupi i të rinjve që do të ndërtonin shtëpinë e re kishte mbërritur në fshat para Nikoll Lokës. Ata kishin sjellë me vete projektin, çimenton, hekurin dhe gjithë materialet e tjera të nevojshme. Kishin caktuar edhe vendin dhe kishin nisur nga hapja e themeleve. Në këtë pikë kishin ndeshur në një kundërshtim të dobët të gruas së Nikoll Lokës dhe nënë e Lules. Ajo u ishte lutur të prisnin të shoqin. Vetëm ai e dinte ku duhej ngritur shtëpia, nga do ta kishte derën e nga dritaret. Ndërsa ata i ishin përgjigjur gjithë mirësjellje, por në mënyrë të pakuptueshme për gruan, se edhe kjo ishte detyrë e tyre, pasi kishin fjalën e arkitektit. Ajo nuk e dinte ç'ishte arkitekti dhe kishte heshtur.

Ndërsa Nikoll Loka e dinte tashmë qartazi se edhe kjo ishte detyrë e tyre dhe vetëm i falenderoi me një zë gurgullues, i vendosur që vetë të mos prekte punë me dorë. Detyra e tij do të fillonte kur shtëpia të përfundonte. Ai do të merrte çelësat, do të përshkonte me një hap të ngadalshëm korridoret plot dritë, do të lëvdonte gjithçka do të shihte dhe do të zgjidhte dhomën më të mirë për veten dhe gruan.

8.

Të rinjtë e ardhur për ndërtimin e shtëpisë së Nikoll Lokës ishin të gjithë nga qytetet e mëdha. Një pjesë studionin në fakultetin e inxhinierisë në Universitetin e Tiranës. Mbrëmjet ata i kalonin me rininë e fshatit. Këndonin, vallzonin dhe zhvillonin tema mbi emancipimin e shoqërisë. Shokët dhe shoqet e Lules nuk kishin qenë kurrë aq të lumtur. Ata po zbulonin, të mrekulluar, argëtimin modern me përmbajtje revolucionare.

Në mbrëmjen e fundit të javës së parë e ftuan edhe Nikoll Lokën.

-Nuk janë për mua këngët e vallet,- deshi ai të shmangej. Por sakaq u pendua. Pati frikë se të rinjtë do të dyshonin se ai mbante fshehurazi zi për Lulen. Do të ishte shkëlqje e rëndë e fjalës që i kishte dhënë shokut Enver. Dhe i ndoqi, duke u përpjekur të dukej sa më i gëzuar.

Ai nuk e dinte se në një nga pushimet midis vallzimeve do të vendosej që të nesërmen, që ishte e djelë, të shembej kisha e fshatit. Të gjithë të rinjtë që e merrnin fjalën, i drejtonin falenderime të nxehta atij, dhe ai, i hutuar, nuk e kuptonte shkakun. Por kjo ishte një hollësi, që gazetarët e

shumtë të pranishëm, ardhur posaçërisht, nuk e shënuan në reportazhet e tyre.

Shumë shpejt kjo stuhi përfshiu gjithë Shqipërinë.

Me gurët e vjetër të kishës, në fshatin e Nikoll Lokës, filloi sakaq ndërtimi i një memoriali për Lulen dhe zgjerimi i vatrës së kulturës.

9

Edhe dëshira e Nikoll Lokës për kolektivizimin u përmbush pa vonesë. Në fshatin e tij u ngrit e para kooperativë bujqësore për krahinat malore. Ishte një ditë pranvere dhe fshati ishte zbukuruar si për festë. Gjithë murin ballor të vatrës së kulturës e kishin mbuluar me një karton, ku kishin pikturuar një burrë duke i rënë daulles. Dhe poshtë ishte shkruar: LAJMETARI I GEZIMIT. Gjithandej nëpër fshat ishin edhe portretet e anëtarëve të Byrosë Politike dhe shumë flamuj, por Nikoll Lokës iu ngulit në mend vetëm ai burrë i shëndetshëm, që shpallte kooperativën e re me një daulle prej letre. Ajo do të ishte dallandyshja lajmëtare e pranverës socialiste, që po vinte edhe për krahinat malore, thanë gazetat dhe radioja. Tek dorëzonin dhitë e dhentë, lopët e kuajt, derrat e pulat, bashkëfshatarët e përfshinin Nikoll Lokën me një vështrim laraman, dha pastaj e falenderonin duke zbardhur dhëmbët. Dhjetëra mijë bujq e barinj të tjerë, nga malet e jugut e të veriut, që nuk kishin fatin të shiheshin sy për sy e të përqafoheshin me Nikoll Lokën, ia dërgonin falenderimet nëpërmjet shtypit. Ai ishte bërë zëdhënësi i vullnetit të tyre të zjarrtë pranë shokut Enver.

Nikoll Loka përfytyronte vështrimet laramane të falenderuesve, por gjithnjë e më pak ndjente rrezet e tyre të mprehta ta shponin midis ballit. Ai dëgjonte. Vetëm dëgjonte. Gjithë ç'thuhej për të. Gjithë ç'i thuhej atij. frymëzuesit. Fjalët arrinin në veshin e tij të zhveshura nga të gjitha nënkuptimet e pakëndshme. Arrinin të pastra. Reportazhin mbi bisedën me shokun Enver e ruante veçan, të prerë e të futur në një kornizë. Dhe, me mundimin e tij të njohur për t'i bashkuar gërmat, e lexonte dhe rilexonte mbrëmjeve, larg syve të botës. Sepse ai jo vetëm dëgjonte. Por i kërkonin edhe të fliste. E pyesnin. Dhe ai përgjigjej me dëshirë. Tregonte. Shpjegonte. Jepte mendime para kuadrove të partisë në bazë. Ftohej edhe nëpër ministrira e në seksionet e Lidhjes së Shkrimtarëve e të Artistëve t'i ndihmonte funksionarët e lartë dhe intelektualët të njihnin vetveten si bij të popullit, të mos molepseshin nga burokratizmi dhe intelektualizmi mikroborgjez, t'i shërbenin mirë atdheut e socializmit. Ishte bashkëbisedues

i përhershëm i rinisë, asaj punëtore dhe asaj studentore. Kishte për ta gjithmonë një kujtim të ri nga jeta e Lules, shembullit të tyre të madh. Para tij intelektualët ishin më të urtët. E dëgjonin të mrekulluar dhe shumë rrallë, thujse kurrë, i bënë ndonjë pyetje. Me gazetarët, që e ndiqnin kudo, merrej vesh më së miri. U linte liri. Ata nuk gabonin kurrë. Ata e dinin më mirë edhe se ai vetë ç'duhej të thoshte për popullin mbarë dhe kur. Nikoll Loka ishte njeri i lumtur dhe plot besim në të ardhmen e Shqipërisë.

10.

Ishte krejt e natyrshme që Nikoll Loka të mos çuditej kur e lajmëruan për t'u paraqitur në polici. Sigurisht që do t'i dërgonin një veturë për ta marrë. Nuk kishte vend për asnjë parandjenjë të keqe. Madje ai vuri re se nuk kishte folur asnjëherë para ruajtësve të rendit. U mbush me një kënaqësi të fshehtë. Pushteti që do të kishte qoftë edhe për disa orë mbi tufën e policëve do të ishte si një hakmarrje për kushëririn e rrahur dikur. Më saktë, ai do ta përjetonte këtë takim si një vënie në vend të nderit të humbur të kushëririt. Ndjente njëfarë borxhi të pazakonshëm ndaj atij kushëriri. Shembulli i tij, përvoja e tij e hidhur e kishin mësuar ta pranonte me buzëqeshje të ëmbël caktimin e Lules vullnetare për ndërtimin e hekurudhës.

Nikoll Loka ngjiti me një hap krenar shkallët e postës së policisë. falenderoi shefin që kishte dalë në derë ta priste dhe pyeti se ku do të zhvillohej takimi. Krejt si një njeri i mësuar. Por i humbi menjëherë siguria në vete, kur shefi e vuri në dijeni për qëllimin e ftesës. Do ta ballafaqonin me një armik shumë të rrezikshëm. Shefi nuk lypsi as edhe falje për shqetësimin dhe i vonoi shpjegimet e mëtejshme. Dhe Nikoll Loka nuk pati guxim ta gërmonte. Kaluan disa minuta të gjata. Një anekdotë e gojëkëqinjve të asaj kohe thotë se Nikoll Loka e pyeti shefin e policisë nëse kishin marrë leje të shoku Enver për ta thirrur në atë vend. Nuk ka asgjë të vërtetë.

Por vizita e tij në polici lidhej me një anekdotë. Disa ditë më parë ishte arrestuar poeti Frederik Shtepani. Nikoll Loka nuk ia kishte dëgjuar kurrë emrin. Nga njerëzit që përmendeshin nëpër gazeta ai njihnte vetëm shokun Enver dhe veten e tij. Sipas shpjegimeve të shefit të policisë, Frederik Shtepani ishte paksa i çakërdisur, por nuk ishte i çmendur. Dhe sidomos nuk ishte budalla. Gjuha e tij e helmatisur dëshmonte se ai ishte tepër i rrezikshëm. Nikoll Loka i dëgjoji gjithë këto shpjegime në heshtje të plotë. Ishte një kohë e dobishme, që ai të mblidhte veten. Mendoj se e kishin thirrur për ndonjë

## *Dauillja prej letre*

këshillë lidhur me dënimin e këtij armiku. As në letërën e as në bisedën me shokun Enver nuk ishte prekur tema e luftës së klasave. Nikoll Loka, plot ankth të papritur, por të fshehur mirë, nuk vendoste dot nëse duhej ta jepte një këshillë të tillë apo jo. Po sikur të bënte ndonjë gabim? Iu kujtua përsëri kushëriri i largët, por tashmë me mësimin e parë që i kishte dhënë shembulli i tij dhe jo me shpresën e panevojshme për ta vënë në vend nderin e tij të humbur.

Mëdyshjet e Nikoll Lokës nuk zgjatën. Shefi i policisë i tregoi se faji i Frederik Shtepanit lidhej me figurën e tij.

-Me figurën time?- u hodh Nikoll Loka, i tronditur. Ai ishte ngritur instinktivisht në këmbë dhe kishte mbledhur dy duart në gjoks, si ta mbante zemrën të mos i binte mbi dýsheme.- Unë nuk e njoh fare, nuk ia kam dëgjuar kurrë emrin. Ai ka shpifur.

Shefi i policisë i dha plotësisht të drejtë. Frederik Shtepani kishte shpifur. Dhe me qëllim. Sipas tij, Nikoll Loka paska thënë si ai vetë dhe shoku Enver nuk kishin vendosur të kolektivizoheshin pulat, por e kishte bërë Mehmeti në kry të vet.

-Ka shpifur, i poshtri, ka shpifur.- përsëriti Nikoll Loka, i pushtuar nga një ankth i ri. Ai nuk e përfytyronte dot se ç'kërkohej prej tij tashmë dhe nuk dinte si të mbrohej.

-Ka shpifur, e dimë që ka shpifur.- e mbështeti qetësisht shefi i policisë.- Ndaj ju kemi shqetësuar deri këtu, që t'ia përplasni të vërtetën në sy. Partisë i nevojitet përgënjeshtrimi juaj, që ta ndëshkojë pamëshirshëm këtë armik tepër të rrezikshëm, i cili ka dashur që me një gur të vrasë disa zogj: të ndotë figurën tuaj të pastër, të përqeshë kolektivizimin socialist të fshatit, dhe më e rënda, tepër e rënda, apo jo, të hedhë një hije të zezë mbi marrëdhëniet vëllazërore të dy udhëheqësve kryesorë të Partisë e të shtetit tonë, sikur midis tyre ka kontradikta lidhur me politikën ekonomike. Siç e shihni, shoku Nikoll, armiku vepron natë e ditë dhe me dinakëri të madhe. Ai përpiqet të na godasë atje ku na dhëmb më tepër.

-Ashtu është.- tha Nikoll Loka.- Veprimi i tij duhet ndëshkuar pamëshirshëm dhe shpejt, që t'u shërbejë si shembull edhe të tjerëve. Si patriot, unë jam gati të kryej detyrën time.

Ai mori frymë thellë dhe i dërgoi shefit të policisë një vështrim plot mirënjohje. Pastaj uli sakaq sytë, nga frika se diku thellë tyre do të shfaqej përhitja e kushëririt të rrahur dikur si qen.

11.

Nikoll Loka nuk kërkoi kurrë të mësonte nëse u dënua poeti Frederik Shtëpani dhe sa. Madje ai bëri të gjitha përpjekjet ta fshinte plotësisht nga kujtesa atë njeri të çuditshëm. Por ai nuk e harroi kurrë vizitën e tij të parë në polici. Përkundrazi. Ajo la një gjurmë të fortë, që nuk lidhej më me përvojën e hidhur të kushëririt të tij të largët e që ai përpiqej t'ia fshihte edhe vetes. Nikoll Loka zbuloi se nga të gjithë anëtarët e Byrosë Politike, vetëm kryeministri nuk i kishte shkruar asnjë letër përgëzimi pas dekorimit të së bijës si heroinë dhe as më vonë, pas botimit të bisedës së tij me shokun Enver. Si nuk më kishte rënë më parë në sy? pyeti veten disa herë i befusuar dhe çuditërisht i trembur Nikoll Loka. Nuk e shpjegonte dot gjithë këtë shpërfillje ndaj tij nga bashkëlufëtari më i afërt i Enver Hoxhës.

Por edhe më e pashpjegueshme ishte anekdota, siç e quajti poeti Frederik Shtëpani historinë e tij të treguar në kafene për t'u gajatur pijanecët. Nga ishte marrë vesh që pikërisht kryeministri ishte i vetmi ndër udhëheqësit e lartë të vendit, që nuk i kishte dërguar as edhe një telegram të shkurtër? Madje as edhe një përshëndetje gojore. Frederik Shtëpani, me kokën e tij të vogël e të qethur zero, i kishte lënë përshtypjen e një burri të çakërdisur, të tillë siç ia kishte përshkruar shefi i policisë. Sigurisht që ai nuk kishte nga të mësonte gjëra të tilla. Nikoll Loka u pushtua pak nga pak nga një ankth i tmerrshëm: mos vallë gjithë kjo ishte vetëm një lojë e stërholluar e Sigurimit? E rrotullonte ngjarjen nga të gjitha anët, por nuk zbulonte asgjë që ta ndihmonte për të kuptuar arsyen dhe as qëllimin e kësaj loje. Iu prish gjumi dhe u bë grindavec me gruan dhe fëmijët, të cilët e vështronin si të shastisur dhe nuk i përgjigjeshin. Ata nuk e përfytyronin dot çfarë ndodhte brenda tij.

Nikoll Loka u vu në një pritje torturuese të letrës së kryeministrit. Udhëtimet nëpër Shqipëri dhe pritjet e delegacioneve në shtëpinë e tij vazhdonin si edhe më parë. Gazetat e përmendnin pak më rallë, por e përmendnin rregullisht. Disa nga anëtarët e Byrosë Politike i shkruan për së dyti. Nga Tirana i vinin ftesa sa herë kishte ndonjë festë të madhe zyrtare. Por të gjitha këto nuk i mjaftonin Nikoll Lokës, nuk e qetësonin, për sa kohë kryeministri nuk ndjehej. Asnjë copë letër, asnjë fjalë përshëndetëse. Shurdhëri. Duhej që kryeministri ta merrte vesh sa shumë e donte Nikoll Loka. Ai nisi ta lëvdonte nëpër takimet me punëtorët, me intelektualët e sidomos kur gjendej nëpër ministrira. Ishte i bindur se fjalët e tij do të mbërrinin te



Shoku Mehmet dhe ai do të kënaqej dhe një ditë a një tjetër do ta thyente heshtjen me një përgëzim të ngrohtë. Ndoshta edhe do ta ftonte në shtëpi. Ai nuk e kuptonte nga i vinte gjithë kjo nevojë që kryeministri ta donte. Ishte diçka më shumë se sa rrëzimi i dyshimit për lojën e çuditshme të Sigurimit.

Duhet besuar se lavdet e tij të zjarra mbërritën te Shoku Mehmet. Por fakti është se ato tërhoqën më parë vëmendjen e dikujt tjetër. Nikoll Loka nuk e mësoi kurrë deri ku ishte ngjitur shqetësimi. Atë e thirri Sekretari i Parë i komitetit të partisë të rrethit, të cilin Nikoll Loka e njihnte mirë tashmë. Por kësaj here ai nuk ishte dhe aq i qeshur si zakonisht. E thirri në zyrën e tij. Dhe nuk i drejtoi asnjë pyetje për shëndetin e për familjen, siç bënte më parë. Megjithatë, u tregua i kujdesshëm të mos e fyente dhe Nikoll Loka ia diti për nder.

-Kohët e fundit ke bërë një gabim,- i tha ai.

Nikoll Loka u zverdh dhe Sekretari i Parë e vuri re.

-Eshhtë gabim,- vazhdoi ai.- Nuk është faj.

Nikoll Loka kishte në veshë një gumëzhimë të zgjatur, që nuk e lejonte ta kapte dallimin midis gabimit dhe fajit, që Sekretari i Parë deshi me dashamirësi të vinte në dukje. Iu kujtua pandehma për lojën e Sigurimit. Me siguri ishte kërkuar prej tij një rol, që ai nuk kishte ditur ta luante. E zverdhura zuri vend mirë në fytyrën e tij.

-Eshhtë një gabim që nuk të ngarkon me përgjegjësi. Ne e dimë, e ke bërë nga dashuria për Partinë. Por nuk duhet përsëritur.

Nikoll Loka e ndiqte fare turbull. Ai dëgjoi qartë vetëm fjalët "përgjegjësi" dhe "Parti". C'do të bëhet me mua? pyeti veten. Sekretari i Parë e pikasi tronditjen e tij.

-Më kuptove?- iu drejtua butë.

-Jo.- iu përgjigj nëpër dhëmbë Nikoll Loka, duke bërë gjithë përpjekjet ta mblidhte veten.

-Gabimin ti e ke bërë nga dashuria për Partinë, ne e dimë, por nuk duhet përsëritur.

Nikoll Loka gati sa nuk thirri nga gëzimi.

-Sigurisht që nuk do ta përsëris,- tha.- Kurrë më nuk do të dëgjoni se e kam përsëritur.- Ai as që do të kujtohej të pyeste për gabimin. C'ishte ai hap i mbrapshtë, që rrezikoi ta fuste në sherr me Partinë?

Sekretari i Parë e përcollti ndryshimin e tij me një buzëqeshje ku përzihej dhëshuria me përçmimin.

12.

Nikoll Loka dëgjoi pa u mërzitur shpjegimin e Sekretarit të Parë. Shqipëria kishte vetëm një udhëheqës.

Shokun Enver. Të tjerët ishin bashkëpunëtorët e tij. Si trupi që ka vetëm një zemër për të ushqyer me gjak edhe kokën, edhe duart, edhe këmbët. Nuk mund të falenderohen këmbët që ecin, për shembull, kur jetën ua jep zemra. Apo jo? Ishte e panevojshme që gabimi të përmendej më hollësisht. Nikoll Loka miratonte me kokë, i shastisur nga budallallëku i vet. Unë e kam hak një dru edhe më të fortë se kushëriri im dikur, tha ai me vete. Nuk dinte si ta shprehte pendimin e thellë që ndjente. E përçmonte veten si kokëtrashë, por edhe si mosmirënjohës ndaj Shokut Enver, që e kishte mbuluar me nderë. C'kërkoja unë më tepër?

Gjithë kjo pendesë e sinqertë nuk ia mbyti dot plotësisht të paktën kureshtjen se përse nuk u kujtua kurrë kryeministri për të. Cfarë inati mund të kishte? Pas bisedës në zyrën e Sekretarit të Parë të komitetit të partisë të rrethit, ftesat për të zhvilluar takime me kolektiva punëtoare dhe intelektuale erdhën duke u rralluar me shpejtësi. Por ai nuk kishte më guxim të pyeste se ç'po ndodhte, përse po e harronin, përse po e shpërfillnin. Nuk ishte vetëm brerja e ndërgjegjes si mosmirënjohës ndaj Enverit, që e pengonte. Instinktivisht e ndjente se do të prekte në diçka të rrezikshme. Dhe nuk i kishte mbajtur gjatë mendimi se e kishte hak një dru edhe më të fortë se kushëriri i tij dikur.

Pak nga pak u ndërpreu edhe ardhjet gazmore të rinjve në grupe. Ai banonte tashmë në shtëpinë e re, e cila, e përmbatur nga heshtja, ngjante përditë e më e madhe. Më shumë se gjysma e saj ishte e panevojshme. Jo vetëm ai, por as gruaja dhe as fëmijët nuk shkelnin kurrë. Muajt kalonin ngadalë dhe ai nuk po mësohej dot me këtë heshtje. Nikoll Lokës nuk i kujtohej si kishte qenë fshati më parë. Dhe "më parë" ishte para vdekjes së Lules. Ai iu rikthye punimit të tokës, tashmë në kooperativë. E vetmja gjë që nuk iu ndërpre ishte pensioni që i jepnin për Lulen. Ai kishte marrë një pamje të hutuar, si njeriu që del nga një ëndërr tronditëse, nga e cila kishte ruajtur zakonin e dëgjimit të dios në oraret e lajmeve dhe të shfletimit të gazetës pa e lexuar. Sidomos shfletimin e gazetës e bënte gjithmonë me një rrahje të fshehtë të zemrës, edhe pse ishte i bindur se nëpër faqet e saj nuk do të shfaqej më kurrë fotografia e tij dhe as ajo e Lules. Gjithë vëmendja e botës ishte përqëndruar tashmë tek një i verbër në jug, i cili arrinte të shkruante emrin e Partisë e të Shokut Enver, edhe pse nuk e kishte parë kurrë dritën e diellit. Nikoll Loka e përcillte gjithçka me një trishtim të njëtrajtshëm si ajri i maleve që rrethonin fshatin e tij qysh nga krijimi i

## *Daulja prej letre*

botës.

Ai kishte ende dy të panjohura nga ajo kohë, siç i quante ai muajt e lavdisë së tij të bujshme. Dy të panjohura që nuk e tallazisinin, por gjithsesi e brenin ngapak parreshtur përbrenda. Njëra ishte diçka si parandjenjë e bukur se një ditë prej ditësh do të paraqitej dikush në oborrin e tij me një letër të kryeministrit. Do të ishte një letër e shkurtër, ndoshta një urim i thjeshtë për vitin e ri, por e shkruar nga dora e kryeministrit. Ai nuk e kuptonte përse bartësi i letrës i përhihej gjithmonë me tiparet e burrit të pikturuar, që i binte daulles prej letre ditën e krijimit të kooperativës. Përfytyrimi i urimit iu ngulit pak nga pak në kokë, nga që ai nuk priste asgjë nga ajo letër. Asnjë lajm nuk do të kishte më kurrë fuqi t'ia ndryshonte jetën. E panjohura e dytë kishte të bënte me enigmën e pazgjidhur lidhur me të ashtuquajturën anekdotë të poetit Frederik Shtëpani. Ai ishte i bindur tashmë se kishte qenë një lojë e Sigurimit. Po pse? Me ç'qëllim? Ajo nuk kishte vazhduar, gjë që Nikoll Lokës i linte shijen e hidhur të kërcënimit të një magjistari të padukshëm. Për çudi, pikërisht heshtja e thellë që sundonte natë e ditë në fshatin e tij ia ushqente këtë shije kërcënimi.

Kur djali i madh, Leka, mbushi nëntëmbëdhjet vjet, ai vendosi, pa u këshilluar me të shoqen natyrisht dhe as me djalin, t'i bënte një provokim shtetit. Ai i shkroi ministrit të brendshëm, për t'i kërkuar një vend në shkollën e Sigurimit për të birin. Përgjigja do të ishte prova përfundimtare e besimit që kishin tek ai. Nikoll Loka e dinte çfarë përzgjedhjeje bëhej për në atë shkollë. Ai ishte përgatitur për më të keqen dhe letrën e nisi në fshehtësinë më të madhe. Kështu do të mund ta mbante fshehtë edhe përgjigjen e padëshiruar dhe të paktën në fshat askush nuk do ta mësonte se Nikoll Loka ishte i dyshimtë për Partinë. Ai do të vazhdonte të bënte jetën e vet të heshtur si ndërrimi i gjetheve të pemëve. Por e kishte një ankth. Druhej se përgjigja negative do t'ia mbyllte djalit rrugën për një shkollë tjetër. Dhe kjo do të ishte më e rënda. Ai nuk do t'ia falte vetes.

Kjo ngjarje i dha shpejt gëzimin më të madh të jetës. E pakrahasueshme me gjithë ç'i kishte ndodhur më parë. Ministri i Brendshëm iu përgjigj pa vonesë dhe me një letër shumë të ngrohtë. Sigurisht që Leka ishte i pari që do të pranohej në shkollën e Sigurimit. Duke qenë i vëllai i Lules, heroinës, që me shembullin e saj kishte frymëzuar dhe frymëzonte gjithë brezin e ri... etj., dhe i biri i Nikoll Lokës, i cili me patriotizmin e tij të zjarrtë dhe dashurinë

për Partinë kishte... etj., etj., pra duke qenë vëllai i Lules dhe biri i Nikoll Lokës, Leka i plotësonte të gjitha kushtet për t'u bërë... etj., etj. Nikoll Loka i bashkoi të gjitha arsyet për t'u gëzuar si kurrë ndonjëherë. Djalit i siguroi një të ardhme. U çlirua nga një barrë aq e rëndë siç ishte frika për kurthin që mund ta groposte për së gjalli e me të gjithë njerëzit e vet më të dashur. Dhe kishte krijuar një rast që të flitej për Lulen. Edhe kjo ishte shumë e rëndësishme. Edhe në shtëpi pothuajse e kishin harruar tashmë vajzën. E kujtonin aq rrallë, thua se emri i saj ishte i papranueshëm për heshtjen në të cilën duhej të rridhte jeta e tij dhe e familjes së tij tashmë.

13.

Dhe kjo heshtje zgjati edhe disa vjet, duke marrë një pluhur ndryshku, si të gjitha gjërat që mplaken pa u shkundur nga pak. Ajo zgjati deri një mbrëmje të ftohtë dhjetori, kur në emisionin e fundit të lajmeve radioja njoftoi se kryeministri Mehmet Shehu kishte vrarë veten. Krizë nervore. Nikoll Loka nuk u besoi veshëve. Zëri i folëses në radio ishte fare i qetë dhe u pasua nga një muzikë feste. Nikoll Loka mendoi për herë të parë për moshën. Po e tradhëtonin veshët. Thirri gruan dhe e pyeti nëse kishte dëgjuar në radio diçka të jashtëzakonshme. Ajo e përfshiu me një vështrim të çuditur. C'gjë të jashtëzakonshme priste ai në mesnatë?

Nikoll Lokën nuk e mbante vendi.

-Po dal një shëtitje,- i tha gruas.

-U çmënde?- ia ktheu ajo.

-Më duket se po,- iu përgjigj ai me një zë asnjanes.

Nuk guxonte ta përsëriste atë që nuk besonte ta kishte dëgjuar në radio. Duhet të më ketë ndodhur diçka në kokë, tha ai me vete. Kaq kohë që pres një letër pa kuptim.

Tronditja e tij u shtua pasi e përshkoi fshatin kryq e tërthor. Të gjitha shtëpitë kishin drita. Ai nuk kishte dalë prej shumë kohësh në një orë të tillë dhe në një mbrëmje të tillë. Nuk e dinte nëse fshati flinte gjithmonë kështu vonë. Por dritat e ndezura i ngjanin me sy që përgjionin njëri-tjetrin. Ishte një përhitje që i futi dridhmën dhe e shtyu të kthehej shpejt në shtëpi. Me siguri që edhe mua dikush më përgjon, tha. Sidomos sonte, shtoi, pa e kuptuar përse duhej ta përgjionin veçanërisht atë mbrëmje. Ai nuk u bind dot se kërkonte thjesht të sigurohej se ajo që kishte dëgjuar ishte e vërtetë. Po çfarë mund të kërkonte më tepër? Nuk ndjente as trishtim e as gëzim. Ishte bosh si qielli dimëror që i rrinte fshatit përmbi.

Më vonë, kur ishte sqaruar se kryeministri kishte

## *Daullja prej letre*

vdekur, ky bosh i mbush pikë-pikë me një lloj gëzimi të panjohur prej fëmije që sheh të ndëshkohet rëndë njeriu që e ka fyer me shpërfillje. Nuk dihej ende ç'qëndrim do të mbahej ndaj të vdekurit. Por Nikoll Loka, nga padurimi për të shfryrë dufin e vjetër, i tha një ditë prej ditësh fqinjit të vet se Mehmet Shehu ka qenë armik.

-Mos fol kështu,- e këshilloi tjetri.

-E di mirë unë,- iu përgjigj Nikoll Loka me një siguri të shtirur.

Nga fundi i janarit, një pasdite, para shtëpisë së Nikoll Lokës ndaloi një veturë e zezë me targën e Tiranës. Ishte për të mos u besuar syve. Po kujtoheshin përsëri për babain e heroinës. Nikoll Loka u nis me atë veturë dhe nuk u kthye më. Gruaja e tij, ashtu si i gjithë fshati, mësuan se ai kishte qenë i molepsur keq në historinë kompllotiste të Mehmet Shehut. Dhe kishte vepruar sipas një plani shumë dinak. Për të mashtruar Sigurimin që e ndiqte, ai i kishte thënë poetit Frederik Shtepani se Mehmeti vepronte në krye të vet, pa e pyetur udhëheqjen e Partisë. Më vonë kishte ndërruar taktikë. Ishte përpjekur të mohonte rolin vendimtar të Shokut Enver në ndertimin e Shqipërisë, duke i thurur himne kryeministrit tradhtar në të ashtuquajturat takime të tij me popullin. Dhe tani së fundi, për të fshehur gjurmët, i kishte pohuar një fqinjit të vet se e kishte ditur që Mehmet Shehu ishte armik. Këtu ai kishte thënë padashur të vërtetën. I pushtuar nga paniku, kishte harruar se do ta pyesnin: atëherë pse nuk e ke vënë në dijeni Partinë? Heshtja mbi fshat u dendësua nga mungesa e Nikoll Lokës.

## Viti i Parë

Hekuran Romalini ishte një evgjiti i vërtetë. I gjatë e i hollë, me një fytyrë të hequr e me mollëzat pak të kërcyera, me një lëkurë të mugët e të ndritshme si të pahitur me kafë, me sy të gjelbër e me mustaqe tufë të mëdha, që i vareshin mbi buzët e plota. Nga ata që quhen burra të bukur. I binte fizarmonikës, këndonte për vete, por edhe për të tjerët nëse ia kërkonin, fitonte para si mundej dhe nuk kishte kurrë në xhep aq sa i nevojitej, bënte vit për vit nga një fëmi dhe për asgjë nuk shqetësohej me tepri. Shpresa tek ai ishte gjithmonë më e fuqishme se dëshpërimi. Ai shpresonte për të shpresuar, pa pritur diçka, por kjo nuk e ndryshonte asnjë fije mënyrën e tij të jetesës. Hekuran Romalini ka lindur për të jetuar, thoshte ai dhe me këtë fjali ia jepte vetes të gjitha të drejtat t'i binte fizarmonikës, të këndonte bukurinë e grave ikanake dhe të pinte një gotë. Ai banonte bashkë me evgjitetë e tjerë në lagjen e tyre jashtë qytetit, në breg të lumit, një vend ku rrugët dhe sheshet nuk kishin emra, në një barakë të bërë me copra teneqesh e të mbuluar me katrama e që s'ishte as më e mirë e as më e keqe se të tjerat përreth. Ai njihej si burri që nuk e rrihte gruan as kur pinte, gjë që te gratë e fqinjëve ngjallte një ndjenjë të përzier zilie, çudie dhe admirimi bashkë. Por, i pirë ai ngatërronte emrat e fëmijëve. Kishte nëntë. Ku mbaheni mend ju të gjithë, që ngjani si kaprojt? thërriste ai dhe qeshte vetë i pari. Sepse Hekuran Romalini ka lindur për të jetuar. Dhe s'ka jetë pa dashuri. Dhe s'ka më keq se të duash gruan tënde. Dhe s'ka dashuri me gruan tënde pa ngjizur fëmijë. C'të bësh?! Hekuran Romalini ka lindur për të jetuar.

Një ditë prej ditësh, pa çuditur njeri, do të vinte fëmija i dhjetë, të cilit ai nuk do t'ia ngatërronte kurrë emrin. Madje do ta shqiptonte gjithë respekt edhe kur ishte i pirë. Ishte djalë dhe lindi në vjeshtë, në fillim të tetorit. Në kohën më të përshtatshme për të festuar pa shpenzime të

mëdha. Në kohën më të përshtatshme për t'i dërguar lëvdata falas Ministrisë së Bujqësisë, thoshte Hekuran Romalini duke ngritur dollinë e duke kujtuar mikun e tij të humbur burgjeve. Neki Palushin. Në treg zarzavatet ishin ende me çmim të ulët dhe sapo kishte filluar të piqej rakia e re. Asgjë nuk kushtonte shtrenjt nga ato që i nevojiteshin Hekuran Romalinit për ta mbushur barakën me hare. Pjesë e kësaj hareje të papërmbajtur ishte edhe zgjedhja e emrit për të porsalindurin, që qante në një qoshe, krejt i shpërfilluar nga qejflinjët e vegjël e të mëdhenj. Njëri nga fqinjët e kënaqur nga rakia e re dhe zarzavatet e skuqura, tha duke ngritur gotën se nuk mund të lagej më mirë edhe sikur të kishte lindur Mao Ce Duni. Ishte një mënyrë e stërholluar cigane për të shprehur një përgëzim e që i drejtohej të zotit të shtëpisë, në sajë të cilit ishte ngjizur foshnja nëntë muaj më parë, dhe asaj dite ishin blerë zarzavatet e fundstinës dhe rakia e re. Hekuran Romalini e shijoi thellë lëvdatën e tjetrit dhe në kokën e tij u ndez një shkëndijë e çuditshme.

-Djali im do të quhet Maocedun,- tha ai duke rrekëllver në fyt një hurbë të gjatë me raki.

-Rroftë Maoceduni i ri!- thirrën të gjithë të pranishmit, pa u menduar.

-Maocedun Romalini,- saktësoi dikush.

-Maocedun Hekuran Romalini,- saktësoi përfundimisht vetë Hekuran Romalini me të drejtën e pakundershtueshme të babait. Atij i pëlqeu tingëllimi i emrit të plotë të të porsalindurit të vet. Pse thonë se gjuha kineze nuk përngjason fare me tonën? pyeti ai veten seriozisht. Dhe ky ishte i vetmi mendim që e përshkoi trurin e tij gjatë asaj mbërmeje gazmore, që zgjati si zakonisht deri në mëngjes.

Pastaj erdhi një gjumë i gjatë e me të gërhitura, i cili fshiu nga koka e Hekuran Romalinit shumë nga gjurmët e darkës së nxehtë, por jo emrin e djalit. Ai nuk e kuptonte as vetë pse ishte aq i vendosur ta quante Maocedun.

-Do të na e përqeshin,- e kundërshtoi dobët e shoqja.

-Ti s'kupton asgjë nga politika. Nuk guxon njeri të përqeshë Mao Ce Dunin,- iu përgjigj ai, i sigurtë në vetë.

-S'bejmë dot Mao Ce Dun unë e ti,- vazhdoi ajo.

-Ne bëjmë Maocedunin tonë evgjit.

Gruaja nuk nguli këmbë më tej. Dhe Hekuran Romalini, i përshkuar nga një frikë absurde se do të ndërhynte diçka që do t'ia ndërronte mendjen, nxitoi të paraqitej në zyrën e gjendjes civile për ta regjistruar. Ai nuk e kishte parashikuar mospranimin pikërisht atje ku do të duhej ta përgëzonin.

## *Daullja prej letre*

Nëpunësja e gjendjes civile, një grua sykaltër e buzëhollë, ia preu shkurt:

-E pamundur. Shko ankohu ku të duash!

Hekuran Romalini nuk kishte ndër mend të tërhiqej edhe pas pritjes së ngrohtë, por të padobishme, që gjeti në Komitetin e Partisë të rrethit, ku e këshilluan ta thërriste të birin me emrin e ndonjërit nga të parë t e vet. Ishin dy instruktorë. që e pritën. Nëpër sytë e tyre lëvrinte një gaz i përmbajtur me kujdes, që Hekuran Romalini nuk donte ta vinte re. Mao Ce Dunin e njoh më mirë se të parë t e mij, vazhdoi Hekuran Romalini i sinqertë, serioz dhe ngulmues. Dy instruktorët shkëmbyen një vështrim dhe u dorzuan. Ata e përshëndesnin veprimin e tij politik, që dëshmonte sa thellë ishin ngulitur në popullin e thjeshtë ndjenjat vëllazërore ndaj aleatit tonë të madh, Kinës Popullore. Por nuk e ndihmonin dot për regjistrimin. Gjithçka varej vetëm nga zyra e gjendjes civile. Do ta njihni kokëfortësinë time, u betua ai heshturazi dhe pa inat, tek kapërcente pragun e daljes nga ndërtesa më hijerëndë e qytetit e ku shkelte për herë të parë. Paralajmërimi i të shoqes se me atë kokëfortësi do t'i hapte telashe vetes nuk e preku fare. Ai vazhdonte të mos e kuptonte ç'e shtynte të ishte aq i vendosur dhe i qetë. Emrat e fëmijëve i kishte zgjedhur gjithmonë rastësisht dhe nuk u kishte kushtuar asnjë rëndësi. Ai nuk dinte se si do t'ia dilte mbanë të ruante emrin e Maoce dunit të vogël, siç nuk e dinte pse i nevojitej patjetër ky emër dhe kujt i nevojitej, atij vetë apo të voglit. Kaloi kështu një muaj dhe nga gjendja civile e njoftuan se do ta gjobisnin në qoftë se nuk vinte të regjistronte fëmijën. Rreziku i gjobës e trazoi pak. Atij nuk i pëlqente t'ia merrnin paratë. Ai donte t'i harxhonte ato vetëm sipas mënyrës së tij dhe për kënaqësinë e tij.

Shkurt. Hekuran Romalini mendoi dhe guxoi të kërkonte një zgjidhje të papërfytyrueshme. Ai i shkroi një letër ambasadorit kinez në Tiranë, për ta njoftuar se djali i tij quhej tashmë Maoce duni. Letra e tij ishte e gjatë, por në thelb përsëriste mendimin, që ai kishte dëgjuar nga dy instruktorët e sjellshëm të Komitetit të Partisë sipas të cilit me një veprim të tillë ai kishte dashur të shprehte ndjenjat e veta më vëllazërore ndaj Kinës motër. Ai nuk kishte ndonjë shpresë të vërtetë të kjo hile. Por ishte i vendosur të bënte edhe përçapjen e fundit para se të jepej. Gjobën nuk do ta paguante. Në fund të fundit djalin do ta regjistronte me një emër çfarëdo dhe do të vazhdonte ta thërriste Maoce duni. Ai e dinte se kështu të gjithë do ta njihnin si Maoce duni i Hekuran Romalinit. Pak rëndësi ç'shkruhej



në letra!

Nuk kishte patur të drejtë kur nuk kishte shpresuar se guximi shpërblehet për arritjen e qëllimit. Ambasadori kinez iu përgjigj shpejt dhe me një letër tejet të ngrohtë. Hekuran Romalini nuk u besonte syve. Letra fillonte "Shumë i dashur vëlla i idealit..." Ai puthi në gushë foshnjën, që u gudulis nga tufa e mustaqeve të tij, puthi të shoqen, e cila gjithashtu u gudulis dhe rendi të blinte zarzavate dhe raki. Ishte një ngjarje që duhej festuar me gjithë lagjen. Ambasadori e falenderonte nxhtësisht atë bir të thjeshtë të popullit të madh shqiptar për pagëzimin simbolik të të birit dhe e njoftonte, madje, se do t'i vinte pa vonesë për urim. Ky lajm i fundit nuk tërhoqi aspak vëmendjen e Hekuran Romalinit. Ai ishte i bindur se kishte në dorë dokumentin magjik, që do ta thyente nëpunësen fodulle të gjendjes civile. Ai nuk priste gjë tjetër. Ishte i mbushur me adhurim për veten, që kishte menduar kaq thellë.

Pra, Hekuran Romalini nuk ishte gabuar në përbetimin e fshehtë se dy instruktorët e Komitetit të Partisë të rrethit do ta njihnin kokëfortësinë e tij. Ishin pikërisht ata të dy që erdhën ta kërkonin të nesërmen. Ata u mbushën me panik kur e gjetën të kredhur në gjumin e vet të zakonshëm të pasdehjes. E shoqja dhe fëmijët i ndihmuan gjithë zell e kënaqësi dy të ardhurit ta largonin Hekuran Romalinin nga shtrati, për t'i hedhur kova me ujë të ftohtë në kokë. Ai nisi të përmendet, duke ngjallur në sytë e dy instruktorëve gazin e ditës së njohjes. Hekuran Romalini vështronte ende turbull, por dëgjonte pothuajse qartë, tek i shpjegonin se nuk kishte kohë për të humbur. Vizita e ambasadorit kinez ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për të gjithë, dhe kërkonte përgatitje të posaçme. Hekuran Romalini dëgjonte, vërtet, por nuk kuptonte asgjë. Pse do të vinte ambasadori kinez?

-Për të nderuar Maoedunin tënd, pra.

-Le të nderojë Mao Ce Dunin e vet ai, sa të dojë. S'ka punë me timin.- Nëntori kishte hyrë me një erë të ftohtë e të lagësht dhe atij i shkuan të dridhura. Nuk mbante mend ku ishte lagur dhe i kërkoi të shoqes një këmishë.

Dy instruktorët nuk e mbanin më të qeshurën. Qeshnin edhe gruaja dhe fëmijët e Hekuran Romalinit, i cili zuri të tregonte duke përtypur fjalët se Maoedunin e kishte zënë një mëngjes, dimrin e shkuar. E mbante mend mirë. Nuk kishin dru për zjarrin dhe ia kishte hypur të shoqes vetëm për t'u ngrohur pak. Ja që edhe fukarallëku ka anët e veta të mira, tha ai fare serioz.

Rrugës për në qytet të dy instruktorët e porositën që

## *Daujlla prej letre*

historinë e zënies së djalit të mos ia tregonte ambasadorit.

-Cilit djalë?- pyeti ai.- Kam gjashtë.

-Të fundit.

-Aha, Maocedunit.

Ata pohuan me kokë.

-E ç't'i them ambasadorit?- pyeti ai seriozisht.

-Trego ndonjë gjë tjetër, më të bukur.

-Nuk di asgjë më të bukur,- tha ai trishtueshëm.- Nuk më ka ndodhur kurrë ndonjë gjë më e bukur.

-Ke edhe një javë të mendohesh,- e ngushëlluan ata.

Rrjedha e ditëve nuk kishte patur ndonjëherë rëndësi për Hekuran Romalinin. Për herë të parë ai zbuloi se një javë ishte fare e shkurtër. Gjithë koha ishte e zënë me ato përgatitjet e posaçme, që kishin përmendur dy instruktorët. I dhanë një apartament të ri me katër dhoma, për të cilin Hekuran Romalini nuk kishte asnjë vërejtje. Mobiljet dhe pajisjet e tjera ai i zgjodhi vetë, edhe pse nuk kishte bërë kurrë blerje të tilla. Ai ishte tashmë i kënaqur dhe plot besim në vete. Instruktorët ishin pranë tij thjesht të paguanin faturët. Me shijen e vet të pavarur ai zgjodhi edhe kostumin e këmbësorë të tij. Gruaja dhe fëmijët zgjodhën teshat e veta. Ai vetëm i shoqëroi bashkë me dy instruktorët, që kishin paratë. Ata nuk i vunë asnjë kufi për shpenzimet dhe nuk dukeshin aspak të bezdisur nga detyra që u ishte ngarkuar. Ambasadori duhej të largohej me përshtypjet më të mira nga qyteti i tyre. Hekuran Romalini ishte i vendosur ta nderonte mikun e largët si një mbret. Ai ndjehej sinqerisht mirënjohës ndaj atij kinezi të fuqishëm, por me një emër që nuk mbahej mend.

-Mos bëj gabim ta krahasosh me mbretin,- e këshilluan dy instruktorët.

-Pse?

-Ai është komunist. Do të fyhet.

-Me çfarë ta krahasoj?

-Thirrë shërbëtor i madh e i devotshëm i revolucionit.

Kjo ishte e vetmja këshillë që ata i dhanë Hekuran Romalinit dhe ai nuk e harroi, edhe pse përcaktimi "shërbëtor" nuk i pëlqeu dhe aq. Në fjalimin e mirëseardhjes, që i mbajti ambasadorit, ai tha se shtëpinë e tij të thjeshtë nuk e kishte nderuar kurrë një shërbëtor kaq i lartë i revolucionit. Miku kinez falenderoi sinqerisht, por aty pranë gjendej dikush tjetër, jo më pak i rëndësishëm, që u ndje disi i nënvlefësuar, gjë që nuk i ra fare në sy për keq Hekuran Romalinit. Ishte M.B., sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit.

Viti i dytë

Jehona e historisë se pazakonshme të Hekuran Romalinit zgjati disa javë, dhe pushtoi gjithë qytetin. Pati nga ata që qeshën me zgjuarsinë e tij. Pati edhe nga ata që e patën zili. Vetë Hekuran Romalini ishte i lumtur. Ai kishte arritur shumë më tepër nga ç'kishte synuar: kishte zyrtarizuar emrin e djalit, duke korrur një fitore fort të çmueshme mbi nëpunësen mendjemadhe të gjendjes civile, të cilën sytë e kaltër nuk e bënë dot të bukur, dhe mbi dy instruktorët e sjellshëm, por që e kishin përcjellë duarthatë nga komiteti i partisë. Tashmë foshnja quhej Maocedun Hekuran Romalini. Dhe për më tepër, ai kishte përfutur edhe një apartament të madh e të bukur, me katër dhoma e në një lagje të zgjedhur dhe të mobiluar më së miri. Ishte veshur vetë, gruaja e të dhjetë fëmijët si zotërinj të vërtetë. Kishte pritur në shtëpinë e tij një mik të lartë, i cili veç nderit, i kishte sjellë edhe një kamion me dhurata për krejt familjen. Të gjitha këto kishin ndodhur si në përrallat me plakun e vitit të ri, pa e vënë dorën në qese.

Pati në qytet edhe nga ata sqimatarë, që shfrynë nën zë kundër komitetit të partisë të rrethit, që kishte rënë në mënyrë aq të trashë në kurthin e një evgjiti dinak. Pati të tjerë, që thanë se kjo ishte një lojë shumë më e madhe se sa teka e një evgjiti të paditur dhe bënë hamendje të përçartura për koniunkturën politike midis dy vendeve. Vetë M. B., sekretari i parë, e harroi shpejt prishaqejfin e fjalimit të Hekuran Romalinit. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij ishin tejet të kënaqur. Evgjiti Hekuran Romalini u kishte dhënë rastin të prisnin në qytetin e tyre përfaqësuesin fuqiplotë të Kryetarit Mao. Qyteti i tyre nuk kishte jetuar kurrë një ngjarje kaq të rëndësishme. Në të vërtetë ata do të kishin dashur që mishërimi i Maos të ishte një fëmijë i racës së pastër shqiptare dhe biri i një komunisti. Por u mbetej të kënaqeshin me atë që kishte ndodhur, e që nuk ishte e keqja më e madhe. Të paktën nuk ishte kulak dhe as gjak i ndonjë të burgosuri politik. Për më tepër që ambasadori kinez nuk kishte shprehur asnjë vërejtje për pahitjen e kaftë të lëkurës së Romalinëve. Madje as nuk ishte çuditur. Dhe kishte lëvduar bukurinë e foshnjës, duke e përkëdhelur gjithë drojtje në mjekër me gishtërinjt e shkurtër e të tultë e duke belbëzuar përhumbshëm në gjuhën e tij diçka si lutje.

Më krenarët ishin evgjitët e lagjes se Hekuran Romalinit. Ata ngritën një këngë heroike për njeriun e tyre, që ua kishte çuar namin deri në Pekin dhe bënë një festë, që zgjati shtatë ditë e shtatë net. Hekuran Romalini

## *Daullja prej letrë*

vetë ishte si në ëndërr. Ai theu zakonin, nuk piu, gjë që nuk u çmua fort dhe vetëm falenderonte këdo që i fliste e për çfarëdo që i thoshte, pa e dëgjuar. Falenderonte dhe buzëqeshte duke rrotulluar sytë nga të gjitha anët, aq sa dikush i tha se kishte nisur shumë shpejt të merrte sifatet e vëllezërve kinezëve.

Jehona erdhi duke rënë nga java në javë deri sa u shua fare, si të mos kishte qenë kurrë. Dimri solli shumë të ftohtë dhe lagështirë dhe Hekuran Romalini zbuloi se apartamenti i ri ishte tepër i madh, i papërshtatshëm për familjen e tij. Fëmijët dhe gruaja zunë të ankoheshin, duke kërcëllitur dhëmbët edhe nën batanije. Ai nuk blente dot drutë që nevojiteshin dhe sobat që kishin, nuk digjinin çkado. Këto janë soba për zotërinj, shfrynte Hekuran Romalini me përçmim, por pa inat, si gjithmonë. Dhe e shoqja miratonte. Dhomat gjithashtu ishin për zotërinj. Një letër të digjie, mbusheshin me tym. Dhe fqinjët ishin si tela të tendosur. Nuk duronin një zhurmë, dhe për ta gjithfarëlloj tingulli ishte zhurmë. Ai nuk e dallonte dot nëse ata vërtet kishin nerva të lodhura, apo kërkonin arsye për të bërë mbledhje të lagjes, ku i nxirrin sytë njeri-tjetrit, duke cituar secili sipas nevojës së vet fjalimet e Enverit. Hekuran Romalini nuk guxonte më të pinte e t'i binte fizarmonikës e të këndonte me zërin e vet bukurinë e grave të panjohura. Shkurt, ishte një shtëpi e pabanueshme e madje e rrezikshme. Maoceduni i vogël mund të merrte një plevit, që ta vuante gjithë jetën. Hekuran Romalini nxitoi të shiste mobiljet e qilimet e sobat e perdet e u kthye i lumtur në barakën e tij në breg të lumit. Fqinjët e vjetër, ata që kishin lindur për të jetuar e jo për të bërë mbledhje, e që nuk i kishin shkuar dot në apartamentin e huaj, e pritën krahëhapur. Aq më mirë që ai kishte sjellë edhe një dorë parash, me të cilat mund të kalonin disa mbremje të gëzuara, duke ngrohur gurmazet me raki të fortë. Hekuran Romalini as që mendoi se duhej të njoftonte në komitetin e partisë për shpërnguljen. Zaten, ishte i bindur se atje e kishin harruar dhe nuk gabohej.

Kaloi kështu dimri, pranvera dhe vera. Paratë e pajisjeve të shitura u mbaruan. Rrobot e bukura u vjetëruan në trupin e tij e të gruas. Ndërsa ato të fëmijëve kishin arna tashmë. Maoceduni, i përkëdheluri i gjithë lagjes së evgjitëve, ishte rritur. I kishin dalë dy dhëmbët e përparmë dhe i ati e thërriste "lepur". Qeshte e madje shqiptonte edhe grumbuj tingujsh, që me pak vëmendje mund edhe të dëgjoreshin "mami", "babi". Hekuran Romalini ishte i kënaqur me gjithçka i sillte rrjedha e jetës së vet.

Afrimi i tetorit i zgjoi papritur Hekuran Romalinit një përfytyrim tejet pjellor. Me përvojën e vitit të shkuar ai kishte të drejtë të ndjehej i sigurtë në vete. Ai e ndjente për detyrë ta festonte ditëlindjen e Maoqedunit. Do t'ia festonte gjithmonë, sa të ishte gjallë. Ishte fëmija që i kishte sjellë më shumë fat. Hekuran Romalini nuk ishte kthyer prej muajsh në apartamentin e ri as edhe për të hedhur një sy. Hajdutët nuk kishin ç'të merrnin. Ai vetë nuk kishte mall as kureshtje. E dinte tashmë se nuk do të banonte më kurrë atje. Nuk jetonte dot brenda atyre mureve të ftohta në dimër e të nxeha në verë, rrethuar nga fqinjë që përgjionin natë e ditë njëri-tjetrin për të zbuluar çfarë kishin të huaj në sjelljen e tyre. Hekuran Romalini nuk do ta kuptonte dot ndonjëherë këtë punën e shfaqjeve të ideologjisë së huaj në mënyrën e jetesës. Por apartamenti do të mbetej i tij. Ai nuk do ta lironte, që ta merrte ndonjë oficer apo treneri i skuadrës së futbollit të qytetit. Edhe pse me vonesa, ai e paguante qeranë, dhe për çudi, në këtë rast nuk kishte ndjesinë cingërisëse të shpenzimeve të panevojshme. Afrimi i ditëlindjes së Maoqedunit ia përtëriu kujtimet e mrekullueshme të vjeshtës së shkuar. Ai tha me vete, i bindur dhe si gjithmonë i qetë, se arsyja e donte që gjithçka të përsëritej. Ai zbuloi me krenari se ishte i aftë të mendonte edhe gjëra të pazakonshme. Për shembull, ai mori parasysh që kësaj here ambasadori mund të mos i përgjigjej dot ftesës së tij. Por ai do të dërgonte medoemos një përfaqësues, gjë që për Hekuran Romalinin ishte fare njësoj.

Gjykimi i tij i drejtë shkoi edhe më larg. Sivjet ai do t'i bënte përgatitjet nën drejtimin e komitetit të partisë. Kështu edhe ai vetë do të paraqitej si një shërbëtor i devotshëm i revolucionit. Instruktori që e priti, e që ishte njëri nga dy të njohurit e tij, deshi ta përcillte me të butë, por duke ia prerë hovin. Hekuran Romalini e njohu menjëherë stilin e tij.

-Djali të të rrojë!- i tha.- Tani kemi punë të tjera më të rëndësishme. Boll më!

Toni i tjetrit ishte miqësor. Megjithatë Hekuran Romalini mori qëndrimin e të fyerit.

-Unë s'kam punë tjetër më të rëndësishme se ditëlindjen e djalit,- u përgjigj.- Unë jetoj vetëm për Maoqedunin tashmë.

-Ja pra, këtë them edhe unë. Ditëlindjen e djalit bëje me njerëzit e tu. Ke gruan, fëmijët, fqinjët, miq të tjerë. Mos u zgjero kësaj here!

Hekuran Romalini u ndje pak në kurth, por jo i

dorëzuar.

-Në ditëlindjen e djalit tim unë do të ftoj kë të dua, kë të më pëlqejë,- tha.- Dhe le të vijë kush të dojë! Unë nuk detyroj njeri.

-Ti mirë e ke, por...

-Unë kështu e kam vendosur,- e ndërpreu Hekuran Romalini, nga frika se tjetri do ta zinte përsëri në kurth me fjalët e veta.

-Dëgjomë mua, ashtu të madhe bëje më vonë! Është edhe për të mirën tënde.

-...

-Bëje më vonë, ç't'u prish!

-Mos u tall me mua! Ditëlindja ka kohën e vet.

-Ke të drejtë, por kjo kohë është edhe mot, apo jo?!

Madje, më e përshtatshmja do të më dukej mua kur djali të mbushte pesë vjet, i rritur, kupton, merr pjesë në gëzim, mban edhe mend për më vonë.

-Ku e di unë si sillen vjet deri atëherë.

-Mos bëj gabime të tilla ideologjike! Ne s'kemi punë me vjet e qiellit. Ne kemi vetëm një yll dhe ai është në tokë dhe nuk e ngatërron kurrë rrugën e vet të mbarësisë për ne. E kupton për kë e kam fjalën, besoj.

U ndanë pa u marrë vesh. Por jo të zemëruar. As njëri e as tjetri nuk e parashikonin se do të takoheshin përsëri të nesërmen dhe për të folur krejt ndryshe. Hekuran Romalini u largua i trishtuar dhe duke mallkuar veten. Kishte dashur të vinte vetulla dhe i nxorën edhe sytë. Tani ishte e kotë t'i shkruante ambasadorit kinez. Letra nuk do të mbërrinte kurrë. Por lajmi që gjeti në shtëpi e kapërcente përfytyrimin e tij. Gruaja dhe fëmijët fluturonin nga gëzimi. Pas disa ditësh ishte festa kombëtare e Republikës Popullore të Kinës dhe ambasadori i kishte dërguar një ftesë për në pritjen madhështore që do të jepte me këtë rast. Ai puthi Maoedunin gjithë afsh, duke e gërvishur me mustaqet e mëdha.

-Rrofsh!- i tha.

Instruktori i komitetit të partisë u dorëzua para kartonit të zbukuruar me emblemën e njohur të vendit vëlla. E soditi një grimë herë i mrekulluar. Nuk kishte parë kurrë ftesë të tillë. Në qytetin e tyre ishte hera e parë që dikush merrte ftesë nga një ambasador. Ai mendoi me një kënaqësi të fshehtë për zilinë e pafuqishme që do ta pushtonte sekretarin e parë.

-Duhet të shkosh,- tha dhe nëpër fytyrën e tij u end një buzëqeshje e turbullt.

-Do të shkoj,- u përgjigj Hekuran Romalini.- Rregulloj kështu edhe çështjen e ditëlindjes. S'ka nevojë t'i shkruaj.

Ia them gojarisht.

-Mos i përziej gjërat! Pastaj, për ditëlindjen u morëm vesh. Më vonë.

-Nuk u morëm vesh. Aq më tepër tani, ti e kupton apo jo, jam dyfish i detyruar. Ambasadori më nderon, si të mos e nderoj unë!

-Unë për të mirën tënde e kisha.- ia ktheu instruktori pa asnjë keqardhje e as ndonjë kërcënim të mbuluar.

Hekuran Romalini nuk e priste që tjetri të tërhiqej aq qetësisht dhe mendoi mirë për të.

-Na lajmëro për datën, që të vijmë edhe ne. Në qoftë se ke dëshirë. natyrisht.

-Unë kam dëshirë. por kam edhe nevojë.- Hekuran Romalini ishte i sigurtë në vete tashmë.

-Çfarë nevojë?

-Nuk kam ku i pres miqtë kinezë. Do të ishte turp...

-Po shtëpia që të dhamë vjet?

-Aty është.

-Atëherë?

-Është fare bosh. Edhe lakuriqi i natës thyen kokën. Veç t'i ul për tokë njerëzit.- Hekuran Romalini e përshkoi një rrëqethje e parë. Tjetri do të nxehej, do të shpërthente.

Instruktori përpëliti qepallat, i shastisur.

-Nuk kuptoj asgjë. Ne vjet t'i dhamë të reja pajisjet. apo jo?

-Ashtu është.

-Kolltuqet. qilimat, perdet nuk dalin jashtë përdorimi në disa muaj.

-Ashtu është.

-Fol më qartë! Nuk të kuptoj fare.

-Nuk i kam më as kolltuqet. as qilimat e as perdet.- tha Hekuran Romalini pasi u kapërdi, që të njomte fytin. Ndjente një frikë të largët.

-Ku i ke çuar? Mos u tall!

-Nuk tallem. I kam shitur.

-Përsërite. të lutem, nuk e dëgjova mirë.

-Si të them... I kam shitur. E di, jam fajtor, më vjen turp. por isha ngushtë për para.

-Ti nuk je në vete.- Nëpër fytyrën e instruktorit kaloi një gaz i përmbajtur. Dhe nuk kishte zemërim.

-Ashtu është.- ia ktheu Hekuran Romalini, i hutuar.- Nuk jam në vete. Më vjen turp.

-Mos gënje. Nuk të vjen fare turp.

-Të betohem. Digjem nga turpi, po nuk dukem. Kjo është fatkeqësia e ne zeshkanëve. Nuk na ndihmon surrati të tregojmë çfarë ndjejmë.

-Tani duhet t'i blejmë rishtas?

*Daullja prej letre*

Hekuran Romalini tundi kokën në shenjë miratimi.

-Pse, ç'është arka e Partisë, lopë që të pjellë nga një viç për vjet?- Zëri i instruktorit vazhdonte të mos shprehte zemërim, gjë që e hutoi më keq Hekuran Romalinin. Ai do të kishte dashur që tjetri t'i ulërinte, ta kërcënonte me burgun, dhe e kishte të gatshme përgjigjen.



Me të përfunduar festimet e ditëlindjes së Maoedunit, në komitetin e partisë të rrethit u zhvillua një mbledhje e rreptë, e cila nuk mbeti sekret, edhe pse urdhri ishte i prerë. Dikush duhej të mbante përgjegjësi për lojën që u kishte kurditur evgjiti. (Kësaj here të gjithë ishin të bindur se evgjiti Hekuran Romalini po u luante një rreng.) Sekretari i parë, shoku M. B., e tha shkoqur mendimin e vet: ai po na bën qesharak në sytë e popullit. Duhej gjetur mënyra për t'i dhënë fund. (Ai nuk e shtroi pyetjen se kush e shtynte evgjitin të përqeshte komitetin e partisë. Askush nga të pranishmit nuk e dinte se shoku M. B. kishte një kujtim të largët, historinë e rrjetit informativ me emrin e koduar DAULLJA PREJ LETRE, që ruhej rrëqethëse në trurin e tij, e që e detyronte të matej shumë para se t'i kërkonte të ndërhyrja e armikut të jashtëm arsyet e veprimeve të çuditshme të njerëzve. Ai përcaktoi vetëm se kjo histori e pakëndshme duhej të merrte fund pa u zgjatur më.) Policia nuk ndihmonte dot. Hekuran Romalini kishte Maoedunin e tij, që e mbronte edhe nga ligji. Shoku M. B. nuk e zuri në gojë emrin e fëmijës, por të gjithë të pranishmit e kuptuan se ku ishte fjafa, kur ai përmendi mbrojtjen e pathyeshme të evgjinit.

Ndërsa për Hekuran Romalinin ajo mbledhje do të mbetet si dita më e zezë e jetës së tij. Ai mori vesh se instruktori i ngarkuar për të ndjekur çështjen e tij, ai që i përfundonte gjithmonë takimet me të duke i lëshuar udhë të qeshurës, ishte pushuar nga puna dhe përjashtuar nga partia. Hekuran Romalini u ndje thellësisht fajtor, por nuk u pendua për ato që kishte bërë. Tiparet e tij prej burri të bukur u shtrembëruan, thua se nën lëkurë i kaloj papritur një ngarkesë elektrike. Pas lindjes së Maoedunit ai kujdesej që të rruhej çdo mëngjes. Të ka dalë fytyra në dritë, i thoshte e shoqja, e kënaqur. Kësaj here ajo do ta kishte dashur si dikur, të parruar, dhe qimja e zezë t'ia fshihte disi, farë ndjente. Nuk i pëlqeu fytyra e të shoqit me shprehjen aq të qartë të dhimbjes. Ai u betua se do të hakmerrej, por as gruas dhe askujt tjetër nuk i tha gjë. Hekuran Romalini, i lindur për të jetuar, kishte besuar se nuk ishte i aftë të mbante inat. Ai pyeti një shok se si veprohej, që të mos zbutej zemra, të mos harronte. Dhe mori këshillën, që i nevojitej.

Ai kishte tashmë një arsye më tepër dhe më të fortën të fillonte nga shitja e pajisjeve të reja pa pritur ardhjen e dimrit. Hartoi edhe një plan të hollësishtëm. Nuk do t'i

shiste të gjitha njëherësh. Dhe nuk do të kërkonte blerës të heshtur, me të cilët të merrej vesh që pazari i leverdisshëm të mbetej midis tyre. Mobiljet, perdet dhe qilimat do t'i jepte një e nga një çdo muaj, dhe ditën, nën vështrimet çkërmitëse të fqinjëve. Të fundit do ta nxirrte nga shtëpia nga mesi i shtatorit të ardhshëm, pak ditë para ditëlindjes së re të Maocedunit, kur gjithçka duhej të përtërihej si zakonisht. Në këtë mënyrë do të zgjatej jehona e bëmave të tij. Ai nuk e mohonte më kur i thoshin se po tregohej më i mënçur se Ali Baba i përrallave. Pse ta mohonte? Por nuk ishte as budalla, që ta pranonte. Vetëm qeshte dhe ndërronte bisedë duke rrotulluar kokën në një mënyrë të papërcaktuar.

Ama, Hekuran Romalini nuk kishte marrë parasysh se edhe ata që e mbikqyrnin e që kishin vendosur t'i jepnin fund lojës së tij, e që nuk ishte më lojë për askënd, kishin planin e tyre të përpunuar mirë. Shkurt, Hekuran Romalini nuk arriti të shiste asgjë. Fill pas mbledhjes së posaçme, ku Shoku M. B. dha porosinë e prerë që kjo mesele të përfundonte një herë e mirë, tek ai u paraqitën dy të dërguar të komitetit të partisë të rrethit, me listën e plotë të blerjeve të bëra së fundi për apartamentin e tij në qytet.

-Duhet të nënshkruash.- i thanë.

Hekuran Romalini tundi kokën dhe buzëqeshi ngadalë, duke i përfshirë me një vështrim mosbesues. Ishte hera e parë në jetën e tij, që dikush zyrtar i kërkonte nënshkrimin. Dy të ardhurit nuk dukeshin fort të gatshëm për shaka. Ata i vunë përpara fletën e shtypur me makinë, pa i drejtuar asnjë pyetje. Ishin në shtëpinë e vjetër të Hekuran Romalinit, siç e quante ai barakën në breg të lumit. Atje ku njerëzit banonin për të jetuar. Fëmijët dhe gruaja qëndronin rrotull, të heshtur, me sytë plot frikë të panjohur. Vetëm Maoceduni flinte, shpërfillës dhe i sigurtë në vete. Dhe Hekuran Romalini e kuptoi se duhej të mbështetej pikërisht tek ai.

-Mos e ngrini zërin!- tha.- Do të zgjoni Maocedunin. Ai tani po sheh një ëndërr të bukur. Është fëmijë që ka nevojë të ëndërrojë Maoceduni im. Ka kujt t'i ngajjë, zaten!

Ai priti më kot që dy vizitorët e pazakonshëm ta pyesnin se kujt i ngjante fëmija fatlum. Ose të bënin një shaka të vogël. Natyrisht, t'i thoshin, dardha nën dardhë bie. Le të ishte edhe një shaka thumbuese! Nga dritarja e vetme e barakës zbardhëllonte një qiell i vakët tetori. Me siguri që fqinjët kishin vënë veshin pas teneqeve rrethuese. Ata kishin qenë gjithmonë fort kureshtarë për bisedat e tij

me njerëzit e rëndësishëm, që ishin shokët e zyrave. Ishte hera e parë që mund ta dëgjonin drejtpërdrejt. Hekuran Romalini u rrëmbye nga një dëshirë e pakufishme për t'u pëlqyer spektatorëve të vet të fshehur, atyre që e donin, krenoheshin me të aq sa t'i kushtonin edhe një këngë heroike. Dy vizitorët e pazakonshëm nuk po i jepnin rastin. Si nuk e kuptonin ata se me Hekuran Romalinin mund të merreshe vesh vetëm me të mirë? Fleta e shtypur me listën e mobiljeve, qilimave e perdeve, që mbushnin shtëpinë e re, rrinte para tij si një pasqyrë e turbullt, ku mblidhej drita e zbardhëlleme qiellore, që përshkonte dritaren e ngushtë të barakës. Ai bënte një përpjekje të madhe për të mos i kushtuar vëmendje.

-Nuk doni të dini se kujt i ngjan Maoceduni im i vogël?- pyeti ai.

-Kemi punë të tjera,- iu përgjigj njëri nga të dy.

Hekuran Romalini e kuptoi se nuk do ta kishte të lehtë t'u pëlqente fqinjëve të vet, t'ua shtonte krenarinë. Të paktën nuk duhej t'i zhgënjente.

-Çfarë punësh kemi?- Ai u përmbloodh, për t'u dukur shumë serioz. Nën lëkurën e butë e të ndritshme të mollzave i vërshoi një shkulum i nxehtë gjaku.

-Ja, nënshkruaj këtu!

-E ç'është kjo?

-Inventari i shtëpisë tënde. Domethënë, inventari i atyre që të kemi blerë ne për të pritur vëllezërit kinezë.

-Pse duhet nënshkrimi im?! Ju e dini ç'më keni blerë.

-Po duhet ta dish edhe ti e të mos i shpërdorosh.

-Ç'më thoni?! Si do t'i shpërdoroj? Me ato sende ju ma keni zbukuruar jetën e fëmijëve. Ju faleminderit nga zemra.

-Falendero tjetër kend, jo ne.

-Kë të falenderoj?

Dy fytyrëvrosurit e komitetit të partisë shkëmbyen një vështrim të ndryshuar. Hekuran Romalini e vuri re mirë. Për një çast në sytë e tyre u davarit ashpërsia, pa u zëvendësuar nga ndonjë e qeshur e brendshme. Ishte e kotë të shpresohet se ata do të zbuteshin. Hekuran Romalini u nështrua. Ai e nëshkroi fletën e inventarit pa e lexuar, pasi i siguroi dy të deleguarit e plotpushtetshëm se gjithëka ishte blerë për të pritur vëllezërit kinezë, gjëndeje e mirëmbajtur në shtëpinë e re, ku, saktësoi ai, shkonte vetëm për të fjetur. Fëmijët dhe gruaja dhe ai vetë ishin mësuar me mërmërimin e lumit dhe ajrin e pastër, gjë që u mungonte në apartamentin e bukur në mes të qytetit. Ai e kafshoi fort gjuhën për të mos u ankuar për fqinjët. Hekuran Romalini i dëgjoji me një vëmendje të shtirur

urdhurat e tyre për të mos shitur asgjë nga mobiljet qilimat e perdet. E bëre një herë, i thanë ata kërcënueshëm. Hera e dytë nuk falet. Hekuran Romalini nuk e përshkoi asnjë frikë, edhe pse kërcënimi i tyre ishte fare serioz. Ai nuk pati madje as kureshtje të pyeste se cili do të ishte ndëshkimi në qoftë se e shkelte urdhërin. Ai ndjehej bosh si njeriu që ka humbur një bast. Në kokën e tij nuk po përvijoheshin asnjë plan i ri. Por nuk ishte i dëshpëruar. Dhe përsëriti me vete se kishte një hesap për të larë. Ai pyeti krejt instinktivisht, nuk kishte ende asnjë prapamendim, nëse ishte e pafalshme edhe që pajisjet të vjetëroheshin deri vitin e ardhshëm.

-Nuk t'i kemi dhënë për ekspozitë. Po i përdore, edhe do të vjetërohen. Vetëm mos i shit!

Kjo përgjigje e arsyeshme ndezi dritën e nevojshme në përfytyrimin e Hekuran Romalinit. Brenda ditës ai e dinte ç'do të bënte gjatë vitit që kishte përpara deri në ditëlindjen tjetër të Maocedunit të tij të shtrenjtë. Gjërat ishin ndërlikuar, por ai do të tregonte se ishte i aftë t'u shkonte në fund synimeve të veta. Ai nuk druhej më se ndjenja e inatit do të vinte duke iu shuar. Një njeri kishte humbur punën e mirë, dhe për jetë respektin e shoqërisë (i përjashtuar nga partia) për shkakun e tij.

Hekuran Romalini u paraqit në komitetin e partisë si zakonisht, në mesin e shtatorit. I qeshur dhe mirënjohës. Me vete kishte edhe një zarf me fotografi të Maocedunit. Fëmija ishte rritur. Faqet i ishin rrumbullakosur dhe flokët i ishin zgjatur e nxirë mirë. Sipas përshkrimit plot dashuri të babait, biri ecte pa u mbajtur tashmë dhe shqiptonte fjali të tëra. Por nuk dinte ende të tregonte. Për çudi, krejt vetë, ai kishte mësuar vetëm të lypte. Dhe shpesh lypte gjëra të paparashikueshme. Herën e fundit i kishte shkrepur në kokë për një veturë.

-Kam frikë se mos i kërkon gjë shokut ambasador,- tha Hekuran Romalini me një pamje thellësisht të brengosur.- Do të më turpërojë.

Ata që e dëgjonin në zyrën e pritjes të komitetit të partisë e dinin për cilin ambasador bëhej fjalë.

-Pse, kur do të vijë?

-Si gjithmonë, për ditëlindjen e Maocedunit.

Ata që e dëgjonin ishin fare të qetë, gjë që i pëlqeu Hekuran Romalinit.

-Do të na ftosh apo jo?

-Patjetër, si gjithmonë, s'bëj dot gjë pa Partinë.- u përgjigj babai i lavdishëm i Maocedunit të ri.- Ju e keni vendin në krye të sofrës. Në fund të fundit, pa ju unë edhe nuk e pres dot, ju e dini.

-Si jo?! Mos e tepro! Dy ëmbëlsira e një shishe raki i blen edhe ti.

-Jo shokë, nuk është fjala për dy ëmbëlsira e një shishe raki. Duhet ndërruar gjithë kolltuqet, perdet qilimat. Janë vjetëruar, janë bërë leckë. Më vjen turp ta vë në to shokun ambasador.

Ata nuk i besuan, gjë që Hekuran Romalini e kishte parashikuar. Por, kur mësuan se bashkëqytetari i tyre e kishte njoftuar tashmë kinezin, kishte caktuar edhe datën e festës, i kishte dërguar edhe fotografitë e djalit. (gojët e këqia do të thoshin se edhe kjo ishte një dhëlpëri, për t'i treguar ambasadorit masën e dhuratave që do t'i sillte Maoçdunit të ri), pra, kur mësuan sa larg kishte shkuar Hekuran Romalini në përgatitjet e tij, ata u ndjenë të përgjegjshëm ta shqyrtonin vendin ku do të pritej miku i lartë. Për më tepër, morën edhe një telegram nga zyra e protokollit të shtetit, ku porositeshin të përkujdeseshin edhe për hollësinë më të vogël të pritjes. Ambasadori duhej të kënaqej plotësisht. Në vitet e mëparshme kishin ardhur njoftime pak a shumë të thjeshta. Jo porosi dhe sidomos jo kaq të rrepta. Dhe gjithëcka kishte shkuar fare mirë. Ata i zuri sakaq paniku. Nuk patën kohë të pyesnin çfarë kishte ndodhur, çfarë rengu të panjohur u kishte punuar Hekuran Romalini. Më vonë do të mësonin se fotografitë e djalit kishin arritur. Zoti e di se si, në Pekin të Kryetari Mao dhe ai kishte shprehur ngazëllim të thellë. Aty për aty grupi i punës ishte me mendje të ngritur, si njerëzit që gjenden para një të papriture të madhe. Apartamenti i Hekuran Romalinit ishte në një gjendje të vajtueshme. Duhej lyer. Duheshin vënë xhamat e thyera. Dhe më e pabesueshmja: kolltuqet, perdet e qilimat ishin katandisur vërtet në leckë. Në inventarin që ruhej me kujdes në arshivën e komitetit të partisë të rrethit nuk kishte asnjë të dhënë për pajisjet veç vitit të blerjes dhe çmimet. Të gjitha hamendjet për arsyet e një vjetërimi të tillë të përshpejtuar ishin të panevojshme. Hekuran Romalini nuk dha asnjë shpjegim. Vetëm rrudhi supet me keqardhje dhe nën lëkurën e ndritshme të fytyrës i lëvriu gjaku.

Më pas instruktorët e komitetit të partisë do ta ffillonin të vërtetën. Pa dobi, si zakonisht. Hekuran Romalini i kishte ndërruar mobiljet. Domethënë, i kishte shitur të rejat dhe kishte gjetur të vjetrat, sa për të qenë në rregull me inventarin. Sasia nuk kishte ndryshuar. Sekretari i parë i komitetit të partisë të rrethit kishte edhe më shumë të drejtë të shkulte flokët duke u ulëritur bashkëpunëtorëve të vet se po u shkonte nami si budallenj

*Daujja prej letre*

deri në Pekin.

-E kuptoni apo jo, gjithë Kina qesh me ne!- tha shoku M.B. dhe me dorën që i dridhej kërkoi trinitrinat në xhepin e vogël të setrës.

Ata miratuan me një përpëlitje të qepallave.

Viti i katërt dhe i pestë

Erdhën dy vite plot me ngjarje të jashtëzakonshme për Hekuran Romalini. Ai ishte bërë një lloj heroi i çuditshëm në krejt qytetin e vet. Admirohej fshehurazi. Përqeshej e përçmohej haptazi. Ndërsa evgjitet e bregut të lumit njejtësoheshin krenarisht të gjithë me të. Cilësia më e rëndësishme që kishte Hekuran Romalini te vetja gjatë kësaj periudhe ishte për të bluar në shpirt një inat të mbuluar, që nuk shpërthente para askujt. Por kjo nuk ia kishte ndryshuar aspak mendimin se kishte lindur për të jetuar. Ai vazhdonte t'i binte fizarmonikës plot mallëngjim, ta njomte gurmazin me hurba të mëdha rakie të fortë dhe të këndonte me një zë paksa të ngjirur si t'i drithëroheshin të gjitha brinjët njëherësh bukurinë e grave të panjohura, që vetëm largoheshin e largoheshin. (ku shkonin, djallushat?) pa i dhënë kurrë një buzëqeshje. Sidoqoftë, i pëlqente kur të tjerët e tregonin me vështrim në rrugë apo në kafene.

Në komitetin e partisë të rrethit kishin vënë re dhe mirë vetëm krenarinë e tij dhe ishte marrë vendimi që t'i ulej me çdo kusht hunda. Dhe sa më shpejt. Shumë shpejt. Në ato zyra hijerënda frynte natë e ditë një erë e tërbuar zemërimi kundër Hekuran Romalinit, i cili kishte gjetur një mënyrë aq të përsosur për të sjellë rrotull zotërit e qytetit, duke u bërë vetë i paprekshëm. Cili djall e kishte udhëzuar aq saktësisht të futej si nyje në lidhjet midis dy shteteve? Shoku M. B. e mundi kujtimin e hidhur të rrjetit të tij të paqenë informativ DAULLJA PREJ LETRE dhe kërkoi ndihmën e Sigurimit. Nga studimi i hollësishëm i dosjes së tij dilte se ai nuk kishte takuar kurrë ndonjë të huaj para vizitës së ambasadorit kinez në shtëpinë e tij. Përjashtojë kështu mundësia e ndonjë manovre të shërbimeve të huaja sekrete. Ky përfundim nuk i qetësoi aspak kokat e trazuara të drejtuesve të komitetit të partisë të rrethit, të cilët nuk mund të përfytyronin se gjithë kjo bela ndërkombëtare kishte nisur krejt rastësisht, gjatë dollisë së një evgjiti gjysmë të dehur, dhe se asgjë nuk do të kishte ndodhur në qoftë se nëpunësja e Gjendjes Civile, gruaja me buzë të holla, të cilën nuk e zbkuronin dot as sytë e kaltër, do ta kishte regjistruar pa kundërshtuar foshnjën me emrin Maocedun.

Edhe Hekuran Romalini mendonte më shpesh se më parë për komitetin e partisë të rrethit. Instruktorit të ndëshkuar rëndë për fajin e tij ia kishte harruar emrin dhe fytyrën. Por mbante mend mirë se ai burrë, që nuk duronte

dot gjatë pa qeshur me atë që ishte për të qeshur, ishte ndëshkuar për fajin e tij, e që ai vetë, domethënë Hekuran Romalini, nuk e dinte edhe pas kaq kohësh se cili ishte faji i tij. Ai kishte nisur të besonte sinqerisht se këtë lojë të maces me miun e vazhdonte kryesisht për të zbuluar fajin e vet. Ai shihte se gjërat po ndërlikoheshin tepër dhe kishte një frikë instinktive se do të gjendej papritur në një rrugë qorre, nga ku nuk do të dilte dot më. Ishte një frikë që nuk arrinte t'ia topiste joshjen. Ai nuk ishte më i qetë si dikur. Por të tjerët nuk e shihnin trazimin e tij. Ai kishte kuptuar se duhej të hiqej sikur bënte jetën e vet të parëndësishme, krejt si më parë.

Paralajmërimin e parë, të fortë, ai e mori pak javë pas festimit të tretë të ditëlindjes së Maocedunit, e që kishte qenë edhe më madhështor se vitet e mëparshme. Veç dhuratave të shumta e të bukura për gjithë familjen, ambasadori buzagaz i Republikës Popullore të Kinës i solli edhe një dekoratë të lartë atij vetë. Ishte si e bërë qëllimisht për t'i turpëruar autoritetet lokale, që nuk kishin menduar kurrfarë shpërblimi të ngjashëm për bashkëqytetarin e tyre mendjehollë, por edhe për t'i trembur me frikën e një incidenti diplomatik, si nënvleftësim të rastit. Hekuran Romalini do ta mbajë mend deri në vdekje ngërdheshjen e sekretarit të parë, shokut M. B., tek falenderonte për nderin që i bëhej krejt qytetit të tyre me këtë dekorim. Brerja e shtirur e ndërgjegjes si dhe frika e një incidenti diplomatik zgjatën vetëm disa javë, për t'ia lënë vendin llavës së shtuar të zemërimit. Në këtë pikë Sigurimi dha ndihmën e vet të çmuar për herë të dytë. Ai gjeti pa vonesë blerësit e paligjshëm të mobiljeve të shtëpisë së Hekuran Romalinit dhe ushtroi mbi ta presionin e duhur. Ata u paraqitën njëri pas tjetrit, kokulur, të shitësi i tyre bujar bashkë me kolltuqet, sobat, perdet apo qilimat dhe i kërkuan paratë.

-Nuk kam.- iu përgjigj secilit Hekuran Romalini, pa kundërshtuar të drejtën e tyre për kthimin e mallit.- Më merrni shpirtin, po deshët.- shtoi ai, duke parë se ata nuk do të pajtoheshin.- Më merrni shpirtin, po deshët. Para nuk kam.- Dhe thoshte të vërtetën. Paratë ishin shndërruar me kohë në raki të fortë e zarzavate, ishin tretur nëpër stomaket e evgjitëve të bregut të lumit dhe ishin kthyer në natyrë.

Të gjithë, ashtu kokulur e pa e vështruar në sy, u sollën me të si me një borxhli të keq. E shanë, e pështynë, e poshtëruan faqe gruas dhe femijëve, faqe fqinjëve, që çkërmiteshin me veten, nga dëshira për sherr. Ata donin t'i dilnin në mbrojtje heroit të këngës së tyre të vetme heroike.



Hekuran Romalini i përmbajti. Dy prej blerësve, ata më të rinjtë, shkuan edhe më larg: e goditën. Hekuran Romalini nuk ua ktheu, madje nuk bëri asnjë lëvizje për t'iu shmangur grushtit. Ai vetëm u përpoq t'i kuptonte. Ata kryenin një detyrë, por edhe shfrynin dufin e humbjes së parave. Mobiljet nuk do të mund t'i merrnin mbrapsht. Ngjarja pati në qytet një jehonë krejt të kundërt nga ajo që synohej. Në vend që të përbufej nga të gjithë, Hekuran Romalini u rrethua nga një kureshtje e re, në të cilën përzjerja e çudisë me admirimin ishte më e madhe. Dhe ja sepse: kolltuqet, perdet e qilimat e mbledhur para barakës së tij, ai ua shpërndau pa vonesë fqinjëve të vet gazmorë. Njerëzit thanë me të qeshur se komiteti i partisë po kthehej në një shoqatë humanitare me qëllim pajisjen e shtëpive të të gjithë evgjitëve të lagjes së bregut të lumit. Kjo nuk i shërbeu aspak qetësimit të marrëdhënieve të Hekuran Romalinit me shtetin.

Vetëm një herë u trondit seriozisht Hekuran Romalini. Ishte në kafene, dhe në tryezën ngjitur dëgjoi një mjek të tregonte se në spital kishte arritur një urgjencë e jashtëzakonshme. Një fëmijë kishte ngrënë Mao cedunin. Ai nuk qëndroi të mësonte vazhdimin. U ngrit si i prishur mendsh dhe vetëm para sallës së operacionit pyeti veten se si mund ta hante një fëmijë djalin e tij, që mbushte së shpejti katër vjet dhe peshonte më shumë se dhjetë kile. Po budallepsem nga pak, tha dhe pati dëshirë të qeshte. Qeshi në shtëpi, tek i tregonte të shoqes historinë e fëmijës që kishte gëlltitur një distinktiv të Mao Ce Dunit dhe i ati kishte rendur në spital duke qarë me ulërime:

-Do të më vdesë djali. Ka ngrënë Mao Ce Dunin.

Hekuran Romalini e dinte tashmë se për herë të katërt nuk do të mund ta detyronte komitetin e partisë të paguante. Por nuk e kishte parashikuar se do t'ia ndryshonin edhe mënyrën e festimit të ditëlindjes së djalit. Sipas planit të vet, Hekuran Romalini do ta priste ambasadorin kinez ose përfaqësuesin e tij vetëm me evgjitetë e lagjes. Nuk do të thërriste asnjëri nga të pushtetit. Punë e madhe se miku i nderuar do të shihnte një varfëri që ia kishin fshehur më parë. Ndoshta kjo do ta shtynte t'u jepte diçka edhe atyre. Fqinjët e tij e pritën ftesën me klithma gëzimi dhe me ndjenjë të vërtetë përgjegjësie. Ata nisën pa vonesë të mësojnë disa këngë serioze për punën socialiste dhe për jetën e lumtur kolektive, nga ato që këndoheshin në radio, për rastin. Ata nuk donin të gjëndeshin ngushtë përpara mikut të lartë. Domethënë, nuk donin të kishin biseda të gjata me të. Ishin të lumtur ta shihnin, ta takonin, t'i shtrëngonin dorën,

ndoshta do të bënin edhe një fotografi sëbashku, në qoftë se ai pranonte. Por pa folur shumë. Asnjëri prej tyre nuk ishte anëtar i partisë. Madje nuk ishin as anëtarë të klasës punëtore. Do të ishte turp i madh për ta të tregonin përpara kinezit se jetonin në Shqipëri dhe nuk jepnin kurrfarë ndihmese për ndërtimin e socializmit. Dhe më turp akoma do të ishte në qoftë se ai do të pikaste në fytyrat e tyre se ata nuk i brente aspak ndërgjegjja. Për më keq, rrezikonin t'i dëmtonin edhe marrëdhëniet e sivëllait të tyre, Hekuran Romalinit, me Kinën Popullore. Rruga më e mirë për ta fshehur këtë gjendje prapambetjeje ishte kënga, hareja, natyrisht, me përmbajtje revolucionare.

Përgatitjet e tyre shkuan dëm.

Me vendim të posaçëm të komitetit të partisë, festimi i ditëlindjes së Mao cedun Hekuran Romalinit u bë në sallën e madhe të teatrit të qytetit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha lagjet e fshatrat përreth. Për ambasadorin ishte hartuar edhe një program i gjerë veprimtarish, me vizita në ndërmarrjet kryesore industriale e në shkolla. Hekuran Romalini nuk pati kohë të shkëmbente me të më shumë se një përshëndetje të thjeshtë. Dhe pa ngrohtësinë e mëparshme, siç iu duk Hekuran Romalinit, Kushedi ç'i kanë thënë për mua! mendoi ai paksa i pikëlluar. Pas ceremonisë u kthye në barakën e vet i trishtuar, si t'i kishte ndodhur diçka shumë e keqe. E ndjente veten të mundur. Mblodhi fqinjët e vet dhe, duke falenderuar gruan, vetëm gruan e vet pjellore, që ia kishte lindur djalin në tetor, kur zarzavatet dhe rakia ishin ende të lira, pinë dhe kënduan si dikur deri në pikë të mëngjesit. Për herë të parë pas katër vjetësh ai u deh duke thirrur në kupë të qiellit se Hekuran Romalini kishte lindur për të jetuar e jo për të mbajtur fjalime. Ai u shfajësua përpara shokëve të vet të qejfit, që i kishte detyruar të mësonin këngë të përshtatshme vetëm për në radio, në atë kuti të zeze ku nuk kishte vend për bukurinë e magjishme të grave të panjohura, që plakeshin pa i dhënë një buzëqeshje. Në gjumin e gjatë që pasoi, ai pa një ëndërr të paharrueshme. Kishte shkuar për vizitë në Kinë i ftuar nga vetë Mao Ce Duni.

Ndjesia e të mundurit i vazhdoi deri nga fundi i dimrit. Ajo ishte e fortë, por jo aq sa t'ia lëkundte bindjen se kishte lindur për të jetuar. Ai piu, i ra fizarmonikës duke kënduar gjithë brengë bukurinë e paarritshme të grave të panjohura, u rropat të gjente ç'mund të digjej për ta ngrohur sadopak barakën dhe harroi ditë pas dite shumë nga taksiratet që i kishin ndodhur. Vetëm ëndrrën e vizitës në Kinë nuk e shkulte dot nga koka. Por nuk guxonte të

ndërmerre asnjë përçapje. Një bindje e paarsyeshme ia ushqente shpresën se një ditë do të merrte një ftesë... Hekuran Romalini jetonte në një pritje të fshehtë dhe absurde, që ia mbaroi fije-fije durimin. Me afrimin e pranverës, kur edhe gjaku ndërrohet, siç thotë një proverb evgjit, ai mori vendimin ta thyente heshtjen. I bëri djalit disa fotografi të formatit të madh, ku të dilte mirë në pah shëndeti dhe bukuria e tij, shkroi edhe një letër të zjarrtë, qëndroi tri ditë pa vënë në gojë raki, që të ishte esëll sido që të vinte puna, dhe mori trenin për në Tiranë pa i treguar drejtimin askujt, madje as gruas. Në kryeqytet shkante për të vënë në postë zarfin e madh. Nuk kishte besim te posta e qytetit të tij. Dyshimi i tij ishte i turbullt dhe ai nuk donte t'i vinte emër.

Hekuran Romalini kishte lindur që t'i përmbushen ëndrrat. Në rastet kur komiteti i partisë të rrethit nuk përzihej në punët e tij, saktësoi ai me vete, duke dëftuar se ishte shndërruar në një inatçi të pandreqshëm. Përgjigjen e dëshiruar ai e mori nga vetë sekretari i parë, shoku M. B., në zyrën e tij të madhe e të shtruar me qilima të kuq, ku me siguri që nuk kishte vënë këmbën kurrë ndonjë evgjit. Por nuk ishte vetëm ky rekord që e kënaqi Hekuran Romalinin. Ai vuri re se drejtuesi i partisë për rrethin nuk e njihte fillimin e historisë, gjë që i dha një shtysë të papritur përfytyrimit të tij.

-Të kemi zgjedhur për të të çuar në Kinë.

-Ç'do të bëj unë në Kinë?

-Të shohësh vendin e Mao Ce Dunit.- Zëri i sekretarit të parë ishte thumbues.

-Vendi i Mao cedunit është në breg të lumit, në mes të shelgjishtes.

-Aha! Mos bëj lojra fjalësh me mua!- sekretari i parë e tradhtoi veten. Ai ziente nga zemërimi.

Hekuran Romalini kishte arsye ta ruante qetësinë.

-Nuk bëj lojra fjalësh, shoku sekretar. Dua vetëm të di pse do të më çoni në Kinë.

-Je në një delegacion punëtorësh të zgjedhur nga gjithë Shqipëria, që do të marrë pjesë në festimet e 1 Majit në Pekin. Me këtë rast do të udhëtoni gjithandej nëpër atdheun e madh të socializmit e do të shkëmbeni përvojën e pasur me shokët kinezë.

-Unë nuk jam punëtor. Nuk kam asnjë përvojë për të dhënë. Në moshën time gënjeshtër është turp i madh.

Sekretari i parë bëri një buzagaz me nënkuptim, që i futi dridhmën Hekuran Romalinit.

-Ke të drejtë.- tha.- Ti je burrë i ndershëm. Bën mirë që nuk e pranon diçka që nuk të takon.

## *Daullja prej letre*

-E pranoj, si jo?!- u hodh babai i Maocedunit të ri, i pushtuar nga paniku. Dinakëria e tjetrit rrezikonte t'ia prishte ëndrrën më të mrekullueshme të jetës.

-Unë kështu e kuptova kundërshtimin tënd. Dhe e çmova. Të këshilloj të më drejtosh një letër falenderimi. duke më shpjeguar thjesht e me zëmër të hapur se nuk e ndjen veten të denjë për një nder të tillë të lartë. Mund të ngarkoj një instruktor ta përgatisë letrën. Ti vetëm e nënshkruan. U morëm vesh, apo jo?

Hekuran Romalini ishte i vendosur të mos tërhiqej. Por kishte një hutim dhe një pasiguri, si njeriu i vetëdijshëm se kishte dëmtuar veten. Unë jam budalla, tha. Dhe vuri re se sekretari i parë priste miratimin e tij të fundit.

-Jo, jo,- iu përgjigj.- Unë s'kam përvojë për të dhënë, është e vërtetë. ama dua të marr përvojën e shokëve kinezë. Do të më vlejë shumë për edukimin e fëmijëve. Sidomos të Maocedunit, që po rritet.

Kështu, ai shkoi në Kinë. Komiteti i partisë i rrethit e veshi edhe një herë në të reja nga këmbët te koka. Fatkeqësisht, të ra ty fati të jesh pasqyra jonë, i tha instruktori që e shoqëronte nëpër dyqane, si zakonisht për të paguar. Udhëtimi zgjati gati gjashtë muaj. Kina ishte e madhe, e pafund. Dhe punëtorët shqiptarë duhej të shihnin gjithandej mrekullinë e vëllezërve kinezë. Hekuran Romalini u kënaq, por në kthim ndjeu edhe një keqardhje të lehtë: kishte munguar në ditëlindjen e Maocedunit, i cili kishte mbushur pesë vjet. Ai mësoi se festimet i kishte organizuar përsëri komiteti i partisë dhe se çasti më i bukur kishte qenë kënga e Maocedunit.

-Cila këngë?

-Ajo për Kryetarin Mao.- E shoqja ishte e vetmja që shprehej kështu, për ta dalluar të birin nga homonimi i vet i madh.

-Ka mësuar Maoceduni këngë për Maon?

-Po. E madje kinezçe.

-Kush ia mësoi?

-Erdhi një burrë posaçërisht nga Tirana.

Hekuran Romalini lëshoi një fishkëllimë të gjatë. i mahnitur.

Viti i gjashtë

Hekuran Romalini e priti qetësisht lajmin e vdekjes së Mao Ce Dunit. Kishte pirë pak, si zakonisht, por jo aq sa t'i mpihej truri. Ai e kuptoi se duhej të shprehte një dhimbje, të dërgonte një telegram. Po kujt? Ai priti të nesërmen, që të mësonte se kujt i drejtoheshin ngushëllimet zyrtare. Edhe ai e quante veten zyrtar tashmë. Qysh nga udhëtimi i tij në Kinë, gruaja dhe fëmijët ashtu si ai vetë ishin të veshur nga këmbët te koka me tesha kineze. Atij nuk i dukeshin vërtet të bukura. Por ishte i kënaqur. Gjithmonë i kishte pëlqyer të dallohej nga të tjerët. Pak rëndësi ka se si. Mendimi i parë që i erdhi në kokë ishte ndalimi i përmendjes së vdekjes së Mao Ce Dunit në shtëpinë e tij. Nuk e kuptonte as vetë përse i krijohesh një përjasje ndjellakeqe për të birin. Hekuran Romalini do të kishte vazhduar ta jetonte qetësisht javën e zisë kombëtare që u shpall edhe në Shqipëri për vdekjen e Kryetarit Mao, sikur njëri nga fëmijët të mos e pyeste me lot në sy se ç'do të bëhej me ta në të ardhmen. Hekuran Romalini e pickoi diçka e fortë brenda kafkës. Sytë e përлотur të fëmijës ia turbulluan vështrimin.

-Shko luaj në oborr, këlysh!- iu hakërrye.

-Nuk dua të luaj. Nuk dua të ha. Nuk dua të pi. Më thuaj, ç'do të bëhet me ne?

Hekuran Romalini nxori një buzagaz të zorshëm.

-Me ne? Asgjë. Veçse nuk do të kemi më tesha të reja nga Kina,- tha ai përgjigjen e parë, që i erdhi, ndërsa në kokë iu përsërit pavullnetshëm pyetja e të voglit.

Pastaj babai i Maocedunit të ri u pushtua nga një ndjesi e ndërlikuar fajësie. E kishte katandisur vdekjen e një njeriu të madh, që kinezët e kishin të gjithë si baba, në humbjen e një tufe leckash. U përpoq më kot ta përligjte sadopak veten, duke thënë se për atë vetë kjo humbje ishte e rëndësishme, nuk ishte një humbje e thjeshtë materiale, që do të zevëndësohej në një mënyrë a në një tjetër. Ajo veshje kineze mishëronte dëshirën e tij të fshehtë për t'u dalluar nga të tjerët. Më pas ndjesia e fajësisë iu lidh me shumë bestytni, që e mbushën trurin e tij me një frikë misterioze. Fëmija duhej të kishte parandjerë diçka të tmerrshme, gjersa ishte tronditur në atë masë për t'iu prerë dëshira e lojës, e të ngrënit, e të pirit. Ai e dinte se në shpirtin e fëmijës pajtoheshin e flinin në një shtrat ëngjëlli me djallin. Ç'do të bëhet me ne? pyeti veten instinktivisht Hekuran Romalini. Ai u betua të mos shkelte më kurrë në apartamentin e ri dhe u vu gjithë zell të kërkonte një

shkurtim të këndshëm për veshin të emrit të djalit. Nuk donte më ta thërriste Maocedun. Ishte ende aq i kthjellët sa ta kuptonte se ndryshimi i menjëhershëm i emrit mund t'i hapte telashe. Duhej të vinte më vonë dhe pak nga pak, që të mësoheshin njerëzit pa u çuditur.

Hekuran Romalini u detyrua ta shkelte shumë shpejt vendimin për të mos vënë kurrë më këmbë në apartamentin e ri. Nga komiteti i partisë i rrethit e njoftuan të përgatitej shpejt e shpejt për të pritur një grup specialistësh kinezë, që punonin në qytetin fqinj për ndërtimin e një uzine plehrash kimike. Ai nuk guxoi as të pyeste për qëllimin e kësaj vizite. Zia kombëtare vazhdonte gjithandej dhe ai duhej të vendoste në ballkon flamurin tonë në gjysmështizë, që i sollën.

Ishin dhjetë kinezë, të gjithë burra, në të njëjtën moshë, veshur njësoj në kostume të zeza të kopsitura deri në fyt, në të njëjtën moshë dhe që ngjanin në sy e në hundë si të kishin dalë nga një bark nëne. Kjo ishte një vërejtje që e bëri e shoqja, me të pëshpëritur në veshin e Hekuran Romalinit. Ajo kishte parë në ngjashmërinë e tyre një shenjë të keqe. Hekuran Romalini e urdhëroi, po me të pëshpëritur, të mos fliste marrëzira. Edhe për atë vetë gjithë ç'po ndodhte ishte shenjë e keqe dhe ishte i pushtuar nga frika e tij misterioze, që e torturonte ditët e fundit. Nuk kishte nevojë t'i shtoheshin edhe përhitjet e gruas. Të dhjetë kinezët, të shkrehur në vaj, ishin gjunjësuar rreth Maocedunit të ri, i cili i vështronte i shastisur. Në dhomë sundonte një heshtje që e shtonte tronditjen e Hekuran Romalinit. E dija unë, thoshte ai me vete, edhe më i bindur se lotët e fëmijës së tij kishin paralajmëruar një fatkeqësi të panjohur. Ai ndjehej i pambrojtur si kurrë ndonjëherë. Ç'do të bëhet me ne? përsëriti edhe një herë pavullnetshëm. Pyetja e tij humbi në një zbrazëtitë, që nuk kishte fillim as mbarim brenda kokës së tij.

Hekuran Romalini priti me zemër të ngrirë disa muaj hatanë e paracaktuar. Pak nga pak u lodh nga shurdhëria e barakës dhe nga malli i grave të panjohura, që zgjoheshin e zbukuroheshin vetëm nën tingujt e fizarmonikës së tij. Ato po plakeshin nga braktisja e tij tashmë. Por edhe ai ishte plakur me tepri nga mungesa e tyre. Fyti i digjte sa herë pinte ujë. Dhe ai e dinte shkakun. Në vjeshtë, kur nisi të piqet rakia e re, dhe nuk ishin mbaruar ende zarzavatet e stinës. Hekuran Romalini e humbi durimin.

-Le të bëhet ç'të bëhet!- tha si të kishte shkundur nga supet një barrë të huaj.

Dhe nuk u bë asgjë. Madje edhe njerëzit vazhduan ta shoqëronin me vështrime të mbushura me kureshtje dhe

*Besnik Mustafaj*

admirim tek hynte në kafenetë e qytetit. Kaq i mjaftonte Hekuran Romalinit që të mos pendohej për lojën e pabesueshme që kishte sajuar padashur me emrin e djalit të vet të vogël e që do të ishte edhe fëmija i tij i fundit.

**HISTORIA E TETE**



1.

Ku tregohet se gjashtëdhjet e pesë vjetët e para të jetës, më saktë dyzet vjetët e fundit të jetës së tij gjashtëdhjetë e pesë vjeçare, SH. K. i kishte kaluar pa asnjë tronditje të madhe, veç vdekjes së parakohshme të së shoqes. Madje as grindur nuk ishte kurrë me njeri. Ishte burrë i urtë. Por, thuhej për të edhe se nuk ishte aspak nga ata burra që vijnë nga asgjëkundi e shkojnë asgjëkundi, shkurt, e përshkojnë udhën e jetës pa u ndërë dhe krahasohen me përçmim me hijet. SH. K. kishte patur gjithmonë aftësinë e madhe ta gjente pa zhurmë e pa ngjallur zilira vendin që i takonte midis të tjerëve, të merrte më pak nga ç'i zgjatej dhe të mos fliste me zë të lartë për t'u dukur i sigurtë në vete. Për të thuhej edhe se ishte trim, gjë që ai e pranonte përgjysmë. Dhe saktësonte:

-Kur kam qenë i ri, në moshën kur gjithkush është trim,- duke e hedhur fjalën kështu te periudha e luftës, kur edhe niste nami i tij i mirë.

Por ai nuk i përmendte kurrë bëmat e veta luftarake, aq sa më të rinjtë, përfshirë edhe fëmijët e tij, ata që e kishin njohur vetëm të qetë dhe qetësues, e kishin të vështirë, të pamundur madje, ta përfytyronin si hero syshkëndijë. Për të thuhej tashmë gjithandëj se nuk kishte zemër të vriste as edhe një mizë. Ishte një shprehje figurative për të treguar se kishte zemër tejet të dhemshur. Nuk kishte bërë kurrë keq. SH. K. dëgjonte lavdërimet me një buzagaz falenderues dhe e gjente gjithmonë të nevojshme të saktësonte, gati shfajësues:

-Nuk kam patur rast t'u bëj keq të tjerëve.

E vërteta është se ai nuk kishte punuar kurrë mirëfilli nëpër zyrat ku përcaktoheshin fatet e njerëzve, domethënë atje ku gatuhej e keqja. Kishte qenë gjithë jetën nëpunës i sjellshëm banke. Por të gjithë e dinin se ishte një punë që Sh. K. e kishte zgjedhur vetë, duke shkaktuar shpesh edhe çudinë dhe pakënaqësinë e eprorëve, (shokët e tij të luftës) të cilët kishin dashur t'i jepnin përgjegjësi të rëndësishme politike. Mbahej mend se SH. K. kishte arritur të mos pranonte edhe një post ministror, gjë që kishte ngjallur një habi të përgjithshme dhe e kishte bërë më të njohur e në mënyrë të pabesueshme më të respektuar në Tiranë se sa po ta kishte pranuar. Ai kishte gjetur mënyrën e vet të mos e zemëronte udhëheqjen e shtetit me tërheqjet e tij, pra, të mos bëhej i dyshimtë, dhe kjo ishte një mister më vete. Por një gjë është e sigurtë: SH. K. nuk kishte asnjë arsye politike që t'u shmangej përgjegjësive të tilla. Ai mbetej një komunist i bindur në vijën e Partisë, i besonte sinqerisht fjalimet e shokut Enver dhe nuk kishte asnjë

pendesë për jetën që kishte zgjedhur. Ai ishte përpjekur gjithmonë t'i edukonte fëmijët të vazhdonin në të njëjtën rrugë. Edhe qëndrimin e vet paksa mënjanë rrjedhës së vrullshme ai e përligjite sinqerisht me dëshirën për të mos u turpëruar si komunist. Askush nuk u çudit kur ai e paraqiti kërkesën për të dalë në pension sapo mbushi moshën, megjithëse mund ta kishte shtyrë edhe disa vite. Me shëndet mbahej shumë mirë dhe banka kishte nevojë për përvojën e tij. Ai ishte i vendosur. Tashmë fëmijët ishin rritur, kishin jetën e tyre dhe SH. K., mbetur herët i ve, kishte zbuluar një lumturi të panjohur tek i nipi.

Pikërisht ky fëmijë, që gjithashtu kishte fort kënaqësi të shëtiste me gjyshin, do ta shtynte Sh. K. t'i shtronte vetes disa pyetje të reja, të panjohura, gjithnjë e më tronditëse. Nipit nuk i kishte pëlqyer të dëgjonte për gjyshin e tij të thuhej si një lëvdatë se nuk kishte zemër as për të vrarë një mizë. Natyrisht që ai nuk e kishte kuptuar domethënien figurative të shprehjes. Ai ishte vetëm gjashtë vjeç. Për një arsye të pashpjegueshme ai nuk i duronte dot mizat. Pa e mësuar askush ai kishte arritur në përfundimin se ato insekte të zeza, të pista, të vogla, të shëmtuara, mishëronin një rrezik të madh për njeriun. Sh. K. e dëgjonte dhe miratonte të voglin me buzë në gaz dhe nuk kishte asnjë parandjenjë për kthesën që do të merrte biseda.

-Po ti, gjysh, pse i do mizat? Ato janë të këqija, apo jo?

-Shumë të këqija.

-Me thumbin e tyre ato çojnë sëmundje në gjakun tonë.

-Ashtu është.

-Duhet zhdukur mizat, të gjitha.

-Duhet zhdukur.

-Po ti pse i do, pra?

-Nuk i dua. Kush të ka thënë se i dua?

-Ooo... Të gjithë thonë se ti nuk ke zemër për të vrarë një mizë. Domethënë se i do ato.

Sh. K. u mendua një hop. Fëmija ishte serioz.

-Nuk është fjala për mizat e vërteta,- tha.

-Pse, ka edhe miza të rrejshme?

-Jo, nuk ka miza të rrejshme.

-Unë nuk kuptoj asgjë,- tha i vogli dhe fytyrën ia mbështolli një hije trishtimi.

Ai shfaqte një vuajtje, që plakut i dhembti. Si t'ia shpjegonte?

-Mizat janë kudo të këqija,- tha Sh. K.- E sheh, edhe në bisedën tonë e futin thumbin e tyre plot mikrobe

helmuese.

-Nuk kuptoj asgjë,- përsëriti i vogli buzëvarur.

Sh. K. mblodhi supet, i zënë ngushtë.

-Pse duhet ta kuptosh?

-Dua të di pse ti nuk ke zemër për të vrarë një mizë.

-Nuk është fjala fare për mizat, që ta dish ti. Njerëzit duan të thonë se nuk kam zemër për t'u bërë keq të tjerëve.

-Ata që kanë zemër për të vrarë mizat, u bëjnë keq edhe njerëzve?- u hodh fëmija.-Unë kam vrarë miza, po nuk u bëj keq njerëzve.

Sh. K. ndjehej i detyruar të shpjegohej. Por nuk dinte se si. Edhe më të vështirë do ta kishte sikur nipi ta kishte pyetur se cilët ishin ata që u bënin keq të tjerëve. Sh. K. mendoi me keqardhje se nuk do të kishte mundur të përgjigjej. Ai u zu për herë të parë duke pyetur veten se kush ishin të këqinjët, ata që u bënin keq njerëzve. Nuk mbante mend të kishte njohur të tillë, gjë që nuk e qetësoi. Ishte e pafalshme për një burrë në moshën e tij dhe me përvojën e tij të mos bënte dot dallime në botën që e rrethonte. Thua se e kishte kaluar gjithë jetën në gjumë, i kredhur ëmbëlsisht vetëm në ëndrrat e veta të bukura. Për një periudhë të pafund koka e Sh. K. u mbush me çuditjen troditëse të këtij zbulimi. Ai nuk e dinte nëse përreth tij kishte patur nga ata që bëjnë keq. Ai kishte njohur plot njerëz që ankoreshin. Por i kishte quajtur gjithmonë si qaramanë ose ishte përpjekur t'i ndihmonte, pa arritur dot kurrë as deri te dyshimi nëse vuanin nga ndonjë padrejtësi. Unë nuk kam bërë kurrë keq, përsëriti ai me një nevojë të papritur që të sigurohej. Në ditët që pasuan nipi nuk e çeli më bisedën e mizave. Ai vazhdonte t'i pëlqente veçanërisht shëtitjet me gjyshin dhe ishte i pari që e ndjeu hutimin e plakut.

-A jam çun i mirë?- e pyeti.

-Shumë i mirë,- iu përgjigj Sh. K. pa ngurrim.

Fëmija e përfshiu me një vështrim mosbesues.

-Më ke xhan?

-Sigurisht,- iu përgjigj gjyshi me një hovje të papritur për ta përqaftuar.

Nipi u dha në krahët e plakut me një kënaqësi jo të natyrshme. Ai dridhej lehtë.

-Kisha frikë mos nuk më kishë më xhan,- tha me sytë të përlotur.

Plakut i mungoi në mënyrë të pabesueshme guximi ta pveste të voglin se nga i ishte shpifur një frikë e tillë absurde. Vetëm i përsëriti se e kishte dritën e syve dhe ndjeu t'i përcilleshin atij vetë ethet e padukshme të fëmijës.

Sh. K. zuri të bëhet nervoz, aq sa ditë pas dite e njihte

gjithnjë e më vështirë më veten. Në çdo lloj bisede me të tjerët ai përgjonte të dëgjonte lëvdata për zemrën e tij të butë, i gatshëm të kundërshtonte dhe të mbrohej, si ta kishin sharë. Dhe kur kjo nuk ndodhte, për çudi thua se po harrohej kjo cilësi e tij, e pushtonte një ndjenjë e bezdisshme kotësie, një bosh, që ia zhvlerësonte gjithçka. Ai nuk e dinte më se ç'kërkonte. Dyshimi se e kishte përshkuar jetën symbyllur, si një somnambul që këndellet në ëndrrën e vet, nuk i shkulej nga koka. Por në asnjë çast nuk pyeti veten i shqetësuar se çfarë nuk kishte parë, çfarë i kishte shpëtuar vështrimit të tij të shkurtër, a kishte qenë vërtet i shkurtër vështrimi i tij dhe pse, çfarë kishte humbur në fund të fundit, nëse kishte humbur vërtet diçka? Ai vazhdonte i jepte të drejtë vetes të ankohej për asgjë. Duke marrë gjithmonë më pak nga ç'kishin dashur t'i jepnin, ai i kishte kapërcyer vitet pa qenë kurrë në pritje të diçkaje. Ai parapëlqeu të besonte se gjithë këtë rrëmujë në kokë ia nxiste vetmia e shtëpisë. Ai kishte dashur disa herë t'i lutej nipit të vogël të vinte të jetonte me të, madje kishte nisur të mblidhte në kujtesë edhe përrallat që do t'i tregonte mbrëmjeve, por ia kishte lidhur gjuhën një pengesë e çuditshme që lidhej me frikën e fëmijës nga mizat. Sh. K. kishte zemër për të vrarë ushtrinë e mizave të botës mbarë. Por nuk dinte si ta bindte të voglin.

Pikërisht në këtë kohë te fqinjët e tij ndodhi një hata: arrestuan djalin e tyre 25 vjeçar. Me sa u mor vesh, mbi të rëndonin akuza të rënda politike. Kishte folur kundër regjimit, gjë që në kodin penal parashikohej në nenin e propagandës kundër shtetit, me qëllim rrëzimin e Pushtetit Popullor dhe dënimi synonte jo vetëm asgjësimin e kundërshtarit, por edhe mësimdhënien për të tjerët. Sh. K. nuk u kujtua të pyeste as nga kureshtja se çfarë kishte thënë djali i fqinjit të tij dhe ku. Ai e dinte se çdo propagandë e ka një qëllim, por nuk e përfytyronte dot se çfarë qëllimi kishte patur fqinji i tij i ri, të cilin gjithkush e njihte si të marrë. Ky mendim iu përforcua nga biseda me nënën e të arrestuarit. Ishte një bisedë e rastësishme, tek ngjisnin një ditë të dy shkallët. Me fjali të këputura nga rrallimi i frymëmarrjes, ajo i thoshte se i biri nuk e kishte vendin në burg. Nëse duhej mbyllur diku si i rrezikshëm, ai duhej çuar në spitalin psikiatrik. Je vetë prind, iu drejtua ajo, e merr me mend se nuk është krenari të pohosh për djalin tënd se është krejt i papërgjegjshëm. Sh. K. mund të pyeste fëmijët e vet, që e njihnin fare mirë, ishin rritur me të.

2.

Ku tregohet se arrestimi i beftë i fqinjët të ri, të pamend, por jo të rrezikshëm, ishte një ngjarje, që e trazoi jetën e Sh. K. në mënyrë të pashpjegueshme e në thellësi, atje ku ai nuk kishte gërmuar kurrë. Atij i lëvrinin orë e çast nëpër tru sytë e mbushur me ankth të plakës tek i pohonte se djali i saj ishte i papërgjegjshëm, dhe i përcillnin një fajësi të huaj, të pakuptimtë, nënshtruese. Aq e padurueshme iu bë kjo ndjenjë, sa një të shtunë pasdite, pa asnjë paramendim, e ndaloi në oborr nënën e të burgosurit dhe e pyeti se kush e kishte arrestuar djalin e saj. Plaka e përfshiu me një vështrim të çuditur dhe mosbesues. Sh. K. vetë, krejt i pavetëdijshëm për absurditetin e pyetjes së vet, nuk e dinte ç'kërkonte nga plaka. Njëra nga përrallat që kishte zgjedhur për të nipin, tregonte për një njeri që ende rrugëve me një daulle prej letre. Një ditë hoxha e pyeti se ç'i shërbente ai send. T'i bie kur të takoj një hoxhë që bën mirësira, u përgjigj daullexhiu. Po ajo është prej letre, çahet, u hodh hoxha. S'e di, s'kam patur rast t'i bie kurrë, u përgjigj daullexhiu. I hutuar nga vështrimi i hutuar e mosbesues i fqinjës, Sh. K. shtoi:

-Desha të di nëse pret gjë nga unë...

-Jo,- iu përgjigj ajo me gjysmë zëri.- Faleminderit.

Sh. K. i solli instinktivisht shpinën, pa e përshëndetur. Ai u largua nxitimthi, me një gëzim të shkurtër, që plaka nuk lëvdoi pafuqinë e tij për të bërë keq. Në atë çast Sh. K. pyeti për herë të parë veten nëse kaq mjaftonte për t'u krenuar. Të tjerët mendonin për të se ishte njeri i mirë vetëm pse nuk kishte bërë kurrë keq. Sh. K. u mbush me trishtim dhe vazhdoi të vuante nga ndjenja e një fajësie të huaj, të pakuptimtë, por sunduese e që nuk e shtynte ta kërkonte shkakun. Për të qenë në paqë me veten, ai pyeti fëmijët se ç'mendonin për djalin e burgosur të fqinjët. Dhe mori të njëjtën përgjigje: është i çmendur. Gjithmonë ka qenë i çmendur. Sh. K., i bindur se i çmenduri gjendej në burg nga një keqkuptim, besoi se kishte ardhur rasti të shtonte diçka të rëndësishme në jetën e vet: do të ndërhynte për lirimin e të arrestuarit. Kështu, për të nuk do të thuhej më vetëm se nuk bënte keq. Nuk e quante një ndërmarrje tepër të vështirë. Njohjet e tij ngjiteshin deri në udhëheqjen më të lartë të partisë e të shtetit. Kishte ndër ta, që i kishin thënë më shumë se një herë qortueshëm: si s'pate kurrë nevojë për ne! Qortime të tilla Sh. K. i kishte pritur gjithherë me shumë kënaqësi. Ai solli nëpër mend të gjithë ata që kishin pushtet të mjaftueshëm dhe zgjodhi Jakup Cenën, nënkryetar i Këshillit të Ministrave dhe anëtar i

Byrosë Politike. Mbulonte drejtpërdrejt Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Gjithçka e mendonte fare të thjeshtë dhe të dobishme për të gjithë dhe u nis për të takuar njeriun e rëndësishëm i mbushur me njëfarë gëzimi të çuditshëm. Lirimi pa vonesë i djalit të fqinjit do t'i jepte fund vuajtjes së një të riu të papërgjegjshëm dhe vuajtjes së dy pleqve të pafajshëm; do t'i jepte fund një keqkuptimi të dëmshëm për politikën e Partisë; do t'i jepte fund edhe namit të atij vetë si njeri që vetëm nuk bën keq. Sh. K. nuk e kuptonte përse i nevojitej ky ndryshim, por e dëshironte tashmë. Ndoshta që nipi të mos e njësojë butësinë time me paaftësinë për të vrarë mizat, tha ai me vete gjysmë me shaka.

Dhe vërtet, pritja e parë në shtëpinë e shokut të tij të vjetër qysh nga koha e luftës shkoi ashtu siç e kishte përfytyruar Sh. K. Ishin vetëm ata të dy, në sallonin e madh, me nga një gotë të vogël me raki, të cilën ua shërbeu vetë e shoqja e Jakup Cenës, Nela dhe jo ndonjë grua e shërbimit, dhe të ulur shkujdesur në kolltuqet e buta. Nënkrystari i Këshillit të Ministrave e dinte se Sh. K. vinte më në fund për një hall, por nuk dukej fort kureshtar ta mësonte, gjë që vizitorit të matur nuk po i pëlqente, e madje zuri t'i krijonte nga pak drojtje dhe ankth të pazakonshëm. Sh. K. këmbëngulte heshturazi me një farë kryeneçësie prej sederliu për të mos e çelur bisedën pa dëgjuar nga shoku i vjetër pyetjen nxitëse: Pa hë, i dashur Sh., si është puna?

Sh. K. priste, duke dëgjuar gjithnjë e më turbull të zotin e shtëpisë, që kishte nisur një ligjëratë të pafund mbi perspektivat e zymta të ekonomisë kineze për shkak të reformave liberale, kapitaliste, që kishte ndërmarrë Ten Hsiao Pini pas vdekjes së Maos. Vetë Mao nuk ka qenë kurrë komunist i vërtetë, ndryshe do t'ia kishte prerë me kohë kokën gjarpërit që mbante në gji. Sh. K. e mbante veshin te telefoni me një droje instinktive. Ai do të tingëllonte papritur dhe gjithçka do të prishej. Bashkëbiseduesi i tij ishte nënkryeministër dhe anëtar i Byrosë Politike dhe minutat e tij kishin një vlerë tjetër nga ajo e pensionistit Sh. K., i cili pikërisht tani, kur nuk përgjigjej më para askujt, (nëse lëmë mënjanë nipin e vogël) kishte vendosur të bindte botën se ishte burrë i mirë jo thjesht pse nuk kishte bërë kurrë keq, por se përpiqej dhe arrinte t'u bënte mirë të dobtëve e të fortëve njëherësh. E kam për detyrë si komunist, shtoi ai me vete, me një frikë të papritur. Nënkrystar ministri vazhdonte ta siguronte se në vendin tonë nuk do të përsëritej kurrsesi shembulli

kinez. SH. K. u përmend disi kur tjetri e siguroi që edhe kuadrot e rinj, që po zëvendësonin pak e nga pak shokët e luftës, jeta ka ligjet e veta të pamëshirshme apo jo, ishin të brumosur mirë me mësimet e Partisë.

-Të gjithë do të nisemi në pension njëri pas tjetrit, si ti,- tha ai me një zë të thellë.- Kryesorja është se nisemi të qetë. Shqipërinë e çliruam, e bëmë çerdhe të lumturisë për mbarë popullin dhe veprën tonë e lëmë në duart e sigurta të bijve tanë.

Telefoni përsëri nuk tingëlloi dhe as Nela nuk u duk në derë me ndonjë shenjë për të shoqin dhe heshtja që pasoi fjalët e nënkryeministrit u ndje e plotë. Sh. K. pyeti veten i trembur se mos tjetri priste ndonjë përgjigje a miratim. Nuk i kujtohej qartë se si e kishte mbyllur ai bisedën për krizën e ekonomisë kineze. Ai u përpoq ta fshihte shqetësimin e beftë që e pushtoi. Nuk ishte mirë që heshtja të zgjatej. Pastaj, aty në qoshe ishte edhe telefoni, që mund të tingëllinte brutalisht për t'i dhënë fund pasdites së tyre. Ai nuk do të mund të kërkonte një takim të dytë. Ose edhe mund të kërkonte, por do ta merrte me vonesë, kur djali i fqinjit të ishte dënuar. Ndërhyrja e tij nuk do të kishte më dobi. Sh. K. mendoi se nuk ishte rasti të tregonte krenari të tepruar, duke pritur që Jakup Cena ta ftonte vetë të çelej. Një krenari e tillë do t'i shkonte dikur, kur paraqitej para shokëve të rëndësishëm për të refuzuar përgjegjësitë që i ofroheshin. Kësaj here ishte ai në rolin e lypësit dhe i takonte të ndryshonte sjellje.

-Të thashë në telefon se kam një hall,- foli Sh. K. më në fund.

Nënkryetari i Këshillit të Ministrave u gjallërua pak, sa për të treguar se dëgjoi, por nuk çeli gojë, nuk e ftoi madje as me sy që të vazhdonte, gjë që Sh. K. ia shtoi drojtjen. Megjithatë, ai ishte i vendosur të mos ndalej. Ndërkaq iu duk e pavend ta përvetësonte problemin e fqinjit, me të cilin nuk kishte asnjë lidhje veç afërisë së banimit.

-Në të vërtetë nuk është hall që më prek drejtpërdrejt mua,- deshi ai të saktësonte dhe sakaq pati ndjesinë e gabimit. Ishte nisur me tjetër bindje.- Të themi se edhe mua më prek, si komunist. Na prek të gjithëve.

Nënkryeministri dha një shenjë të papëlqyeshme të humbjes së durimit. Sh. K. e vuri re mirë dhe e përligji. Ai po zgjatej më kot.

-Një fqinjit tim i kanë arrestuar djalin,- tha.

-E di,- iu përgjigj Jakup Cena me një seriozitet të ri, që shkonte afër zymtësisë.

Sh. K. e hetoi me vështrim, me një shpresë të vakët të

merрте diçka më shumë se një pohim të thatë. Ai nuk u shty deri te pyetja se nga e dinte nënkryeministri lidhjen e tij fqinjësore me një nga mijëra të burgosurit politikë. Ai nuk i kishte folur askujt për ndërhyrjen që do të bënte. Sh. K. shpresoi vagëllimthi se Jakup Cena do ta përgëzonte. Ai me siguri e dinte edhe se i arrestuari ishte bir i një familjeje të ndershme punëtoře, por fatkeqësisht i çmendur. Jo, Jakup Cena, që e ndiqte me një vështrim të përhumbur, nuk mund ishte kurrsesi në dijeni të çmendurisë së të burgosurit. Vetë nëna e tij kishte thënë se djali i saj duhej mbyllur në çmëndinë. Si një komunist i vërtetë, Sh. K. mendonte se pushteti i tyre nuk nderohej duke renditur ndër kundërshtarët e vet njerëz të papërgjegjshëm. Ai kishte dashur vetëm të tërhiqte vëmendjen te ky veprim i gabuar i Sigurimit. Keqkuptime që ndodhin, por që dëmtojnë kur zvarrisen. Sh. K. besonte sinqerisht se meritonte përgëzime nga shoku i tij i vjetër, anëtar i Byrosë Politike dhe nënkryetar i Këshillit të Ministrave.

3.

Ku tregohet se SH. K. u largua nga shtëpia e shokut të vjetër i mbushur me një ndjenjë të re fajësie. Nënkyeministri e kishte ruajtur deri në fund seriozitetin e përzier me pak zymtësi. Por nuk e kishte humbur qetësinë dhe kishte qenë fare i qartë në shpjegimet e veta. Madje, Jakup Cena kishte bërë shumë kujdes, që të mos shqiptonte ndonjë qortim plagosës për shokun e vet të vjetër. E kishte pranuar se Sh. K. ishte nisur, si gjithmonë, nga qëllimi i mirë për t'i shërbyer punës së Partisë. Por ishte mashtruar, gjë që mund t'i ndodhte edhe një komunisti besnik e me përvojë. Kishte rënë pafajësisht në kurth. Mund të kisha rënë edhe unë dikur, tha ai dhe nëpër tru i lëvriu një kujtim shumë i largët. Jakup Cena nuk i tha shokut të vjetër se edhe ai vetë kishte qenë dikur një komunist besnik, por jo shumë i zgjuar. I arrestuari nuk ishte aspak i marrë, vazhdoi. Përkundrazi, ishte një armik tejet dinak. Çmenduria ishte një mburojë që e përdornin dendur armiqtë, për t'i shpëtuar ligjit. Sh. K. e dëgjonte gjithnjë e më i shushatur, nuk kishte dyshime në përgjithësi, por nuk bindej për rastin e fqinjit të tij. Ai ishte siguruar edhe nga fëmijët e vet se i arrestuari ishte vërtet i çmendur. Nënkyeministri vazhdoi t'i shpjegonte ngeshëm se çmëndurinë e përdornin të gjithë llojet e armiqve të pushtetit popullor. Diktaturat e djathta, për shembull, kanë mbushur vendet e tyre me spitale psikiatrike, ku kanë mbyllur kundërshtarët e shumtë. Eshtë



## *Daullja prej letre*

mënyra e tyre për t'i zhvlerësuar kundërshtarët, që burgu do t'i kthente në heronj. Për të ngritur krye e për të bërë revolucione populli frymëzohet nga heronjtë, apo jo? Të çmëndurve s'u besohet, pra nuk i ndjek njeri, apo jo?

Sh. K. nuk po kuptonte asgjë dhe kishte miratuar për herë të parë dhe mekanikisht dhe kishte nxituar të përfitonte nga ndërprerja e ligjërimin të tjetrit për të përsëritur se në rastin e fqinjit të tij ishte fjala për një të çmendur të vërtetë. Ai e njihte vetë, e njihnin fëmijët e tij, e njihte gjithë lagjja. Ishte një i ri, që i kishin munguar gjithmonë mendtë e kokës.

Nënkryetari i Këshillit të Ministrave dhe anëtar i Byrosë Politike i ngarkuar për të ndjekur veprimtarinë e ministrisë së Brendshme, gjithnjë i sigurtë në vete, kishte nënqeshur me një ironi të lehtë, miqësore.

-Më thuaj mua, pse nuk e shtyn çmënduria fqinjin tënd të flasë mirë për ne, por vetëm të na shajë?- i ishte drejtuar Jakup Cena shokut të vet të dashur Sh. K.

Heshtje e plotë. Sh. K. nuk kishte përgjigje. Ishte i zënë ngushtë.

Nënkryetari i qeverisë kishte buzëqeshur edhe një herë me mirëkuptim dhe i kishte shpjeguar me durim dinakërinë e armiqve të pushtetit popullor, që hiqeshin si të çmendur për t'i shpëtuar ligjit.

-Ka dalë nëpër rrugë me një daulle prej letre fqinji yt?- pyeti papritur Jakup Cena.

-E di edhe ti atë historinë?- ia ktheu Sh. K. duke menduar për përrallën që do t'i kishte treguar nipit.

-Ata synojnë kështu të përfitojnë nga humanizmi ynë, është e qartë, apo jo?- e mblodhi veten Jakup Cena. Ai pothuajse nuk e kishte dëgjuar përgjigjen e Sh. K. Ishte i përpirë nga kujtimi i vet i largët, kur drejtonte punën e komisionit për caktimin e emrave të rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit. E pushtoi një dyshim i befte, që i futi dridhmën: Mos vallë kishte ardhur radha e kokës së tij dhe nevojitej shkundja e pluhurit të kaq viteve? Unë do të tregoj se jam më i mënçur nga sa më kujton ai, tha me vete si dikur Jakup Cena, pa u siguruar dhe vodhi me bisht të syrit, plot urrejtje portretin e Enver Hoxhës në murin e sallonit.

-Por ne nuk biem në kurthin e të çmendurve të rremë, apo jo?- iu drejtua ai vizitorit.

Sh. K. kishte miratuar përsëri dhe e kishte kuptuar se kjo ishte mbyllja e bisedës.

Sh. K. doli nga shtëpia e nënkryeministrit thellësisht i tronditur. Në kokën e tij gjithçka kishte lëvizur, nuk kishte më asnjë rend. Ishte e vërtetë se të gjithë të çmendurit

shkonin rrugës duke sharë regjimin. Ai vetë kishte patur rastin të vinte re të tillë, por nuk i kishte bërë kurrë ndonjë pyetje vetes. Vetëm kishte sjellë kokën mënjanë, i mbushur me dhemshuri për ta. Sh. K. deshi më kot të çuditej përse shoku i tij i vjetër, anëtar i Byrosë Politike dhe nënkryeministër, nuk i kishte përmendur vigjilencën revolucionare. Ishte a s'ishte biseda e tij një kritikë? Ka menduar me të drejtë se nuk është më nevoja, tha Sh. K. me një lloj brengje. Unë jam plak tashmë, nuk vlej për asgjë. Ai kishte të njëjtën moshë me nënkryetarin e qeverisë, por jo të njëjtën pleqëri. Jakup Cena punonte, kishte përgjegjësira të rëndësishme dhe kjo e rinonte. Puna, përgjegjësia i jepnin një freski tjetër trurit. Ishte një përfundim i trishtueshëm për Sh. K. Ai besoi se nuk ishte më në gjendje të zhvillonte biseda të tilla të mprehta si ajo e dinakërisë së armiqve. Ai nuk shkoi më tej, nuk bëri asnjë përpjekje të kujtonte nëse kishte qenë i aftë të zhvillonte nga këto biseda dikur, kur edhe ai punonte dhe kishte përgjegjësitë e tij të vogla, por të mjaftueshme. Rrugën për në shtëpi dhe gjithë mbërmbjen e kaloi i kredhur në një topitje të çuditshme. Adhurimi për shokun e vjetër dhe trishtimi për pleqërinë e vet të padobishme pllauritëshin plogësht, pa i ngjallur asnjë dëshirë. Fatin e hidhur të fqinjit të tij të ri e kishte harruar fare. Telefoni ra vetëm një herë. Ai e mori me mend se do të ishte ndonjëri nga fëmijët dhe mungesa e përgjigjes do ta shqetësonte. Ndryshe nuk do ta kishte ngritur. Fjeti herët dhe pa ngrënë dhe bëri një gjumë të thellë e pa ëndrra, thua se topitja ia kishte mpirë përfundimisht trurin.

Në mëngjes u zgjua vonë dhe ndjehej krejt ndryshe. Vetëm atëherë e kuptoi sa shumë e kishte lodhur takimi i djeshëm me Jakup Cenën. Të gjitha shpjegimet e shokut të vjetër mbi përdorimin dinak të çmendurisë nga armiqtë e pushtetit popullor ruheshin në kokën e tij të gdhendura si një zbulim i madh, që e kishte befasuar pa e bindur. Ai nuk donte të merrte në mbrojtje dhe as të vinte në dyshim të gjithë të çmendurit që kishte parë gjatë jetës të rëndin rrugëve duke ulëritur sharje politike për qeverinë. Nuk e dinte nëse ata kishin përfunduar në burgje apo në spitalet psikiatrike. Sh. K. nuk e kishte patur kurrë zakon të gjykonte të panjohurit. Prirej të besonte se shoku i vjetër i kishte thënë të vërtetën. Dhe do të kishte besuar pa ngurrim, sikur të mos ishte rasti i fqinjit të tij, për çmendurinë e të cilit Sh. K. ishte tejet i sigurtë. E njihte vetë qysh fëmijë. Të bijtë ishin rritur në një oborr me të dhe i kishin thënë të njëjtën gjë. Vetë nëna e të arrestuarit kishte pohuar se djali i saj duhej mbyllur në çmendinë e jo

## *Daullja prej letre*

në burg. Asnjë arsye e rreme nuk mund ta shtyjë një nënë të bëjë një zgjedhje të tillë kaq të dhimbshme. Mbetej diçka që e turbllonte pak: pse edhe fqinji i tij, i çmenduri i vërtetë, shante regjimin si të tjerët? Nuk ishte e lehtë të rrëzohej pyetja e nënkryeministrit, se përse nuk i shtynte kurrë çmenduria këta njërez të flisnin mirë për pushtetin.

Po atë ditë ai u kryqëzua në shkallë me nënën e të arrestuarit dhe një drojtje e pashpjegueshme e pengoi t'i përgjigjej përshëndetjes së saj. Plaka u largua duke mermëritur nëpër dhëmbë dhe Sh. K. u bë kureshtar. Ai nuk hodhi dot më shumë se dy- tre hapa dhe i thirri:

-Çfarë deshët të më thoni?

-Asgjë. Ju urova ditën e mirë.

-Thatë edhe diçka pas shpinës sime.

Plaka u nxeh.

-Unë nuk flas kurrë pas shpine.

-Më keqkuptuat. Thatë diçka, që nuk e dëgjova mirë,

kur po zbrisja shkallët.

-Ju kanë bërë veshët, nuk thashë asgjë, nuk fola hiç me ju.- ia ktheu plaka thatë, duke shtyrë me rrëmbim derën e apartamentit të vet.

Sh. K. ishte i sigurtë se nuk i kishin bërë veshët. Por edhe plaka kishte folur krejt e sigurtë në vete dhe me një ftohtësi poshtëruese. Këta duhet të kenë një dërrasë mangut si familje, tha Sh. K. me vete në përpjekje për t'u qetësuar disi, dhe vazhdoi të zbriste ngadalë shkallët. Nuk mbante më mend se për ku ishte nisur. Vendosi të bënte një shëtitje. Dita ishte e bukur. Ai mendoi një çast të kalonte nga shtëpia e të birit për të marrë nipin. Por hoqi shpejt dorë. Madje me nipin nuk do të shëtiste më deri në fund të vjeshtës, kur të ftohej moti e të mos dukej gjëkund farë mize. Gjatë kësaj kohe do të arrinte të harronte edhe përrallat si ajo e daulles prej letre. Nuk duronte më që i vogli ta pyeste nëse zemra e tij ishte forcuar aq sa të mos i dhimseshin ato insekte të neveritshme. Kush e kishte gjetur një shprehje aq të shëmtuar për të përcaktuar një njeri të mirë? Doemos që ndonjë i çmendur, tha me vete Sh. K. Edhe daullexhiu, që endej rrugëve me daullen prej letre do të ketë qenë i çmendur. Njerëzit i përvetësonin në mënyrë të pabesueshme lajthitjet e të çmendurve. Ai kishte vënë re vetë sa e sa herë si mblidheshin kalimtarët grumbull rreth ndonjë të krisuri, i dëgjonin përcartjet e tij e ia përsërisnin njëri-tjetrit gjithë kënaqësi. Megjithatë, edhe më enigmatike mbetej shtyrsa e të çmendurve për të folur vetëm për politikë dhe gjithmonë mbrapsht. Pse nuk i shtyn çmenduria kurrë të na lëvdojnë? përsëriti ai pyetjen e shokut të vet të vjetër. Kishte vërtet diçka të dyshimtë

këtu. Sh. K. zuri t'i dhimbte koka dhe iu ftoh dëshira për ta vazhduar shëtitjen. Por nuk kishte dëshirë të kthehej në shtëpi. Në oborr ose nëpër shkallë do të ndeshte nënën e të arrestuarit dhe ajo patjetër që do të mërmëriste diçka nëpër dhëmbë, pas shpinës së tij. Sh. K. nuk dinte ku të shkonte. Dhimbja e kokës iu shtua.

4.

Ku tregohet se fundi i vjeshtës, kur në Tiranë nuk mbetej më gjurmë mize, e gjeti Sh. K. me një dhimbje të pandërprerë të kokës. Herëpashërë kishte edhe të vjella. E kishin parë mjekët më të mirë, kishte bërë të gjitha llojet e analizave e të radiografive, kishte përdorur barna pa mbarim. Dhe gjithçka kishte shkuar kot. Madje nuk përcaktohej dot as çfarë sëmundje kishte.

Në fillim ishte shqetësuar seriozisht gjithë rrethi i tij: fëmijët, shokët, të afërmit. Me kalimin e javëve e të muajve Sh. K. kishte vënë re se si shqetësimi i njerëzve që e donin, kishte ardhur duke u davaritur, dhe vësh. rimet e tyre kishin marrë pak nga pak prehjen e zakonshme. Sh. K. kishte një ndjenjë të përzier pakënaqësie ndaj vetes dhe ndaj tyre. Me kohë, kur kontrollet mjeksore nuk kishin dhënë asgjë, ata kishin nisur të mos u besonin dhe aq rënkimeve të tij dhe Sh. K. e kishte pikasur. E shpëtonte disi vetëm vjellja. Ata nuk kishin provë tjetër të dukshme të vuajtjes së tij. Ishin dhimbje të mprehta në tëmtha, në ballë dhe në rrëzë të qafës. Gjithë koka i gjëmonte si një shpellë e vjetër. Ai nuk mbante më mend as si e kishte zënë, më saktë, i vinte turp të tregonte se goditjen e parë e kishte ndjerë fill pasi kishte përsëritur me vete pyetjen rreth arsyeve miserioze që duhet të kenë të çmendurit për t'u pasionuar aq fort pas politikës dhe jo çfarëdo politike, por pas asaj antikomuniste. Ai druhej se do t'i shihte fytyrat e mjekëve apo të afërmeve të mbusheshin me një nënqeshje të përmbajtur. Ata do të kishin të drejtë të besonin se ai vetë kishte nisur të rrëshqite pak. Gjëra që ndodhin nga pleqëria, do të mendonin ata dhimshurisht dhe Sh. K. nuk do të duronte dot. Si të erdhi? A pate marrje mendsh? A pate humbje të vetëdijës? Dhimbja ishte menjëherë e fortë apo erdhi duke u rritur? Po të vjellat kur filluan? Çfarë kishte ngrënë në mëngjes? Sa orë kishte shetititur në diell? Ai i kishte dhënë njëqind herë këto shpjegime, pa u mërzitur, me një shpresë gati feminare t'i ndihmonte ata që donin ta ndihmonin. Dhe sidomos t'i bindte ata se ishte vërtet i sëmurë. Kjo tashmë kishte rëndësi për të edhe më shumë se shërimi. Vetëm pyetjes se çfarë po mendonte në çastin kur i kishin gjëmuar tëmthat,

ai i përgjigjej shkurt:

-Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet asgjë. Me siguri që nuk po mendoja asgjë.

Ai nuk e dinte nëse kjo ishte përgjigjja më e përshtatshme për të shmangur çdo mundësi që ankesat e tij të merrreshin si shenja çmendurie. Sh. K. nuk e kuptonte se nga i vinte një frikë e tillë absurde, por nuk e përzinte dot. Në orët e pakta që arrinte të kotej, i shfaqej vazhdimisht në ëndërr shoku i tij i vjetër, tashmë nënkryeministër dhe anëtar i Byrosë Politike, duke i folur për përdorimin e çmendurisë nga armiqtë. Në një shoqëri si e jona nuk ka arsye që njerëzit t'i lënë trutë, i kishte thënë nënkryetari i qeverisë për ta bindur sa e rreme ishte çmenduria që dukej aty këtu nëpër rrugë dhe Sh. K. kishte miratuar mekanikisht. Sh. K. nuk e dallonte dot më nëse frikën më të madhe e kishte nga vetë çmenduria apo nga damka që do t'i vinin të tjerët. Edhe për të do të thoshin se shtirëj si i çmendur. Sh. K. nuk e çonte dot mendimin më tutje. Ai nuk kishte besim se do të ishte ndryshe nga të çmendurit e tjerë dhe nuk donte ta përfytyronte veten duke sharë pushtetin.

Sh. K. u mësua pak nga pak edhe me dhimbjen, edhe me ndërprerjen e oreksit, edhe me të vjellat, edhe me vështrimet gjithnjë e më pranë shpërfilljes së njerëzve të vet më të dashur. Vetëm me këtë frikë nuk po mësohej dot. Po sikur të çmendej vërtet? Jakup Cena do të pyeste dikë nëse Sh. K. kishte dalë rrugëve me një daulle prej letre. Afrimi i dimrit i rralloi edhe vizitat, duke e ngadalësuar për ditë e më fort lëvizjen e akrepave të sahatit. Sh. K. nisi të mësohet kështu edhe me vetminë. Mjekët ia kishin ndaluar rreptësisht të dilte në erë dhe ai nuk e kuptonte përse. Dhe nuk i pëlqente. Si mund ta dinin ata se era e ftohtë apo ajri i lagësht i Tiranës dimërore i bënin keq, derisa nuk e kishin përcaktuar sëmundjen e tij? Megjithatë bindej. Domethënë nënshtrohej. Atij nuk e kishin pëlqyer kurrë njerëzit e vështirë. Por kësaj here bindja e tij ishte edhe më e vetëdijshme. Vetëm një njeri me arsye të shëndoshë, pra, i paprekur nga çmenduria, dorëzohet urtësisht në duart e mjekëve. Ai e kalonte kohën kryesisht duke dëgjuar radion, në përpjekjen për të mos menduar se edhe njerëzit më të afërm po e braktisin nga pak. Ai përpiqej ta kuptonte rrallimin e vizitave. Moti i keq, punët e zakonshme, shkurtimi i ditës. Dhe lëngata e tij po zgjaste me tepri. Askush nuk mund të sakrifikoje pafundësisht, përsëriste me vete Sh. K. dhe nuk ankohej për asgjë. Do të kishte dashur ta fshihte tashmë edhe sëmundjen, por nuk arrinte dot. Me kokën që i gjëmonte parreshtur si shpellë e

vjetër, nuk ishte në gjendje t'i shkonte në fund një bisede. Sytë i rrinin të skuqur nga pagjumësia dhe fyti i digjte nga të vjellat e shpeshta. Ai nuk kërkonte nga të bijtë e as nga shokët më tepër veç t'i besonin se ishte shumë i sëmurë. Dhe se vuante vetëm nga dhimbja e kokës.

Erdhi dita që ata i besuan.

Në sjelljen e tyre nuk kishte ndryshuar asgjë. Ai nuk dëgjoi as ndonjë fjalë të pakëndshme. Vetëm se nuk e lajmëruan, si zakonisht, për mbledhjen e organizatës- bazë të partisë të muajit dhjetor. Ai nuk do të ishte shqetësuar aq shumë sikur t'i thoshin se e kishin harruar. Gjëra që ndodhin.

-Ftohtë, dhe menduam se nuk do të bënte mirë të dilje.- iu përgjigj sekretari i organizatës- bazë.

Sh. K. hetoi një grimë herë më kot të gjente në fytyrën apo në zërin e tjetrit ndonjë shenjë keqardhjeje, shfaqjesimi. Ata nuk e kishin lajmëruar qëllimisht. Sh. K. e dinte se duhej ta përbante zemërimin e befte që e pushtoi.

-Herë tjetër më lini mua të zgjedh çfarë më bën mirë e çfarë më bën keq.- tha duke peshuar fort mbi fjalët.

-Sigurisht.- u përgjigj sekretari i organizatës-bazë, një ish-officer artilerie. Do të të lajmërojmë kur të kemi çështje të rëndësishme për të diskutuar. Për mbledhjet e zakonshme nuk është nevoja të lodhesh.

-Do të më lajmëroni për të gjitha.- ia ktheu edhe më prerë Sh. K.- Kur të mos më lejojë shëndeti të vij, do t'ju shkruaj sipas normave të statutit të Partisë.

Biseda nuk shkoi më tej dhe Sh. K. e ndjeu se nuk do ta thërrisnin më kurrë nëpër mbledhje të rëndësishme e as të parëndësishme. Ai nuk do të kishte më vend midis tyre. Ai nuk kishte patur ndonjëherë kënaqësi nga mbledhjet dhe në rrethana të tjera vetëm do të ishte gëzuar nga ky çlirim, ashtu siç u gëzua kur i erdhi mosha e pensionit. Por kësaj here nuk mund ta pranonte arsyen e lënies mënjane. Ai e kuptoi shpejt se nuk kishte ku të ankohej. Shokët e vjetër, që vazhdonin të mbanin përgjegjësi të larta, sigurisht që nuk do t'ia thoshin të vërtetën. Cila ishte e vërteta? Ata vetëm do t'i buzëqeshnin dhemshurisht dhe do të përpiqeshin ta qetësonin me fjalë të ëmbla. Të shtirura, saktësoi ai me një valë inati. Ai i njihte mirë. Për herë të parë në jetën e vet Sh. K. u ndje shumë i dobët, pa asnjë mbrojtje. Nuk mund të mbante shpresë të shpjegohej as me fëmijët. Edhe ata do t'i kërkonin të mos e vriste mendjen për gjëra të tilla dhe të kujdesej për veten, të shërohej sa më shpejt. Asgjë tjetër nuk kishte më rëndësi. Si t'i bindte se pikërisht "vramendja për gjëra të tilla" ishte mënyra e tij më e mirë e përkujdesjes për veten? Ai do ta

## *Daullja prej letre*

kishte pranuar me kënaqësi këshillën për të mos e vrarë mendjen sikur fëmijët, të paktën ata, t'ia shqiptonin në sy ato që thuheshin për të pas shpine. Ai i merrte me mend, por donte t'i dëgjonte. Iu kujtua fqinja e tij me djalin e arrestuar e të dënuar tashmë dhjetë vjet, dhe keqkuptimi për fjalët pas shpine. Ai vetë e kishte marrë pa ngurrim plakën për të çmendur. Kjo ngjarje e vogël e ndihmoi Sh. K. për të mos i fajësuar rëndë njerëzit e vet më të dashur. Ai mendoi se ishte shumë lehtë t'ia ngjisje tjetrit nofkën e të çmendurit. Sh. K. do t'i lypte ndjesë plakës në rastin më të parë. Ai tha me vete se i takonte vetëm atij ta shkulte atë nofkë poshtëruese, që ia kishin ngjitur. Ai duhej t'u tregonte edhe fëmijëve, edhe shokëve se kishte vetëm një dhimbje të fortë koke, të cilën nuk e zbulonin as mjekët nga vinte, dhe ky s'ishte faji i tij, por truri i punonte për mrekulli. Truri i tij nuk kishte asnjë shkarje. Ishte vetëm pak i lodhur nga dhimbjet e parreshtura. Por fare i kthjellët. Si nuk e shihnin?!

Sh. K. pati kohë ta përfytyronte bisedën që do të kishte në fillim me djalin e madh, që do të vinte në mbrëmje për t'i sjellë darkën dhe të shihte si zakonisht nëse ai kishte ndonjë nevojë tjetër.

-Pse më marrin për të çmendur?- pyeti Sh. K., i qetë, por drejt e drejt të birin, duke ia ngulur vështrimin.

Tjetri u zu në befasi.

-Kush të merr për të çmendur? Mos thuaj marrëzira!

-Nuk them marrëzira. Dhe nuk jam i çmendur. Vetëm se më dhemb koka. Kaq.

Djali e mblodhi veten.

-Ke vënë re nëpër darka: ata që kanë pirë më shumë ngulin këmbë se nuk janë të dehur.- ia ktheu i riu përmes një buzagazi të butë, dashamirës.

-Unë nuk kam punë me të dehurit, nuk kam patur kurrë punë me ta.- e ngriti zërin Sh. K. siç nuk kishte bërë kurrë.- Thuaju të gjithëve se nuk jam i çmendur, more vesh! E ke për detyrë, si djali im i madh që je. Nderi im është edhe nderi yt. Duhet ta mbrosh.

-Ti dukesh se nuk je i çmendur, baba, nuk ka nevojë të them unë.

-Ku e sheh ti se nuk jam i çmendur? Thuaje! Dua ta dëgjoj.- u hodh Sh. K. dhe nuk i bëri asnjë përshtypje frika e papritur, që pushtoi sytë e të birit.- Ju më merrni për të çmendur vetëm pse nuk shaj pushtetin dhe partinë. Gaboheni. Ka edhe njerëz që nuk i kanë lënë trutë dhe prapë nuk shajnë politikën e shtetit. Më kuptove? Pse duhet të jenë në rregull nga trutë vetëm ata që dalin rrugëve me një daulle letre në qafë dhe shajnë pushtetin?

1.

Mund të duket e pabesueshme. Por është krejt e vërtetë. Ndryshimi i Din Qereçit nisi një të shtunë të fundit të dimrit, në rrethanat më të paparishikueshme. Në berberhanë. Ishte ulur përpara pasqyrës së madhe, i heshtur, dhe po ndiqte me vëmendjen më të thellë lëvizjen e shkathët të duarve të berberit mbi kokën e tij. Ai donte që flokët e rralluara pak nga pak gjatë viteve t'i qetheshin në mënyrë të tillë, që të ngjanin shumë. Jo për t'u dukur më i ri, siç kishte të drejtë të besonte berberi dhe ndonjë tjetër. Din Qereçi kishte një arsye tjetër, të cilën nuk e merrte dot me mend askush. Ndërsa ai, kuptohet, si për gjithçka lidhej me jetën e tij të fshehtë, nuk i ishte hapur askujt. Madje as të shoqes. Berberi, sidoqoftë, dinte aq sa ishte e nevojshme Shokut Din duhej t'ia qethte flokët në mënyrë të tillë, që të ngjanin shumë.

Berberi ndjehej gjithnjë dyfish i sikletosur tek punonte në kokën e tij. Din Qereçi ishte i vetmi ndër klientët e tij, që tregonte një përkujdesje të veçantë për të qethurën. Pra, ishte rasti i vetëm kur aftësitë e berberit viheshin në provën e vërtetë. Nga ana tjetër, edhe pse nuk shfaqej shumë nëpër mitingje. Din Qereçi hynte ndër njerëzit më të rëndësishëm të qytetit N. Një gabim në kokën e tij nuk kalohej me një të lypur ndjese.

Zakonisht, midis tij dhe berberit shkëmbeheshin vetëm dy fjalë, dhe kjo para se të ndaheshin.

-Shpresoj se mbetët i kënaqur edhe kësaj here, shoku Din.- thoshte njëri.

-Patjetër. Si gjithmonë.- e siguronte tjetri përmes një buzagazi të lehtë e të largët, duke i shtrënguar dorën. Din Qereçi buzëqeshte gjithmonë njësoj, me një asnjanesi që berberit i fuste dridhmën.

Të shtunën, kur fillon historia, berberi iu drejtua Din Qereçit ndryshe nga zakonisht.

-Paskemi një shkrimtar në qytetin tonë, shoku Din. Nuk e dija.

Din Qereçi e përfshiu me një vështrim të çuditur dhe



lehtësisht qortues, duke i shfaqur kështu për herë të parë hijen e një ndjenje.

-Nuk e njihje Lisian Zhupën?! E njeh gjithë Shqipëria...

Berberi u çlirua nga ankthi. Dhe shtoi:

-E njihja, sigurisht që e njihja. Por vetëm si klient dhe si mësuesin e vajzës. Kam dëgjuar edhe se bën vargje. Poet, siç thuhet nëpër gazeta. Nuk ma merrte mendja se ishte shkrimtar. - Berberi mblodhi supet si i zënë në faj.

Din Qereçi bëri një nënqeshje të vogël. Nëpër sytë e tij të shngjyrosur kaloi një dritë e shkurtër dashamirëse. Por nuk pyeti se si i përfytyronte ai shkrimtarët. Dhe as si e mendonte dallimin mes poetëve dhe shkrimtarëve. Ajo drita e shkurtër erdhi duke u ngjeshur sa u ngri në sytë e tij të shngjyrosur dhe u shndërrua në çuditje.

-Tani po shkruaja një roman,- vazhdoi berberi, gjithnjë pa e ditur se për çfarë i nevojitej një bisedë e tillë.- Më tha vetë. Një roman për historinë bashkohore, më tha, dhe të gjitha personazhet, të mirët e të këqinjët, do t'i qëmtojnë në qytetin tonë.

-Ehë...- ia bëri nëpër dhëmbë Din Qereçi.

Berberi ndjeu një thyerje të beftë në zërin e klientit të nderuar dhe u pushtua nga një panik i turbullt. Ai nxitoi me shpresë ta ndreqte keqkuptimin:

-Ju ishit në dijeni, patjetër. S'mbeti t'ju jap unë lajme të tilla, e di.

Din Qereçi nuk u ndje, si të mos e kishte dëgjuar. Ai qëndroi një çast të shkurtër i përhumbur, gjë që e shtoi panikun e berberit. Pastaj u afrua rrëmbimthi nga pasqyra. Në sytë e tij të shngjyrosur, vendin e çudisë e zuri një frikë e panjohur. Berberi e ndoqi me një vështrim të lemerisur. Kishte një përfytyrim të përcartur. Shoku Din dhe shëmbëlltyra e tij qëndronin ballë për ballë dhe afroreshin ngadalë, por të vendosur, drejt njëri-tjetrit. Ç'do të ndodhte kur syri i djathtë i shokut Din do të përplasej (do të përputhej) me syrin e majtë të figurës mbi qelqin e pasqyrës dhe e kundërta? Syrin e majtë të shokut Din do ta përpinte syri i djathtë i shëmbëlltyrës dhe syri i djathtë i shokut Din do ta përpinte syrin e majtë të shëmbëlltyrës. Pasi e vëzhgoi veten një copë herë, që berberit iu duk e pafund, Din Qereçi foli:

-Kjo kokë nuk durohet, apo jo?

Ai u ul sërish në karrige. Pa dhënë asnjë shpjegim dhe as shenjë më të vogël të dëshpërimit. Përkundrazi. Ishte plot gjallëri. Por jo i gëzuar.

-Nuk durohet, apo jo?- përsëriti.

Berberi e kuptoi se pyetja nuk i drejtohej atij.

2.

Din Qereçi u qeth fare shkurt. Ndokush mund të thotë se Din Qereçit i kishte hypur papritur dëshira të dukej më i moshuar. Trill i tij, dëshirë e gruas apo dikush nga lart i kishte tërhequr vëmendjen? Asnjëra nga këto arsye nuk ishte. Ndryshimi i paraqitjes nuk kishte asnjë lidhje me moshën. Tani ai e dinte se do t'i shpjegohej vetëm shkrimtarit Lisian Zhupa. Por ishte një rrëfim që kërkonte disa kushte të caktuara. Mënyra si e vështronte berberi tek e përcillte i mjaftoi për t'u siguruar se ia kishte arritur qëllimit.

Po atë mbrëmje ai ftoi për darkë shkrimtarin Lisian Zhupa. Nuk e ftoi me korier. Kaloi vetë nga shtëpia e tij, dhe në këmbë, gjë që ishte një përjashtim tepër i rrallë në sjelljen e Din Qereçit ndaj bashkëqytetarëve të vet. Por vetë Din Qereçi e quajti krejt të natyrshme. Ai ishte në një gjendje të re psikologjike. Dhe nuk e përligji habitjen e përmbajtur të Lisian Zhupës. Nuk është i vetëdijshëm për pushtetin e vet, mendoi Din Qereçi. Aq më mirë.

Takimi me shkrimtarin ishte rasti i parë për Din Qereçin që të zhgënjehej disi. Ose të dyshonte, të paktën. Lisian Zhupa nuk shfaqti asnjë kureshtje për ndryshimin e pamjes së tij. Madje, la përshtypjen sikur nuk e vuri hijë re. Ose nuk e vuri re, vërtet. Me siguri që shkrimtari nuk i kishte kushtuar vëmendje më parë qethjes e as sjelljes së Din Qereçit dhe nuk bënte dot krahasim. Din Qereçi nuk do t'ia kishte falur gjithë këtë shpërfillje një bashkëqytetari tjetër. Por rasti i Lisian Zhupës ishte ndryshe. Ka kohë. Kemi gjithë mbrëmjen përpara, tha me vete durueshëm Din Qereçi. Kemi ditët e javët e muajt, që vijnë. Ai e dinte se puna e shkrimtarit do të ishte e gjatë. Lisian Zhupa e pranoi ftesën, pa pyetur për arsyen e një darke të tillë të paparashikuar. Dhe falenderoi. Me majat e buzëve, me një vështrim përshkues. Ftohtë, si t'i nënshtrohej një detyrimi. Por falenderoi. Din Qereçi u kënaq sinqerisht edhe me aq. Dhe nuk u çudit me veten pse u kënaq.

Sikur të mos ishte e pranishme gruaja e hirshme e Din Qereçit, darka do të kishte kaluar pothuajse në heshtje të plotë.

Lisian Zhupa ishte gjithë mbrëmjen ai i zakonshmi e që Din Qereçi po fillonte ta njihje: i largët e i huaj. Por ai nuk ngjante nga ata që nënvleftësojnë të tjerët përreth. Me qëndrimin e tij, ai sikur mbrohej nga diçka e padukshme. Biseda më e gjatë që u zhvillua midis tij dhe të zotit të shtëpisë ishte kjo:

-A nuk do të ishte më mirë që romanet të shoqëroheshin me fotografi?- pyeti Din Qereçi, duke bërë

kujdes ta fshihte prapamendimin.

-Çfarë fotografish?

-Ato të personazheve.

-Personazhet letrare nuk mund të kenë fotografi, shoku Din,- u përgjigj Lisian Zhupa seriozisht, pa ironi dhe pa u çuditur.- Kanë shpirt, por jo fytyrë.

Ishte një shpjegim fort i ngatërruar dhe i largët për Din Qereçin. Ai vazhdoi, duke u kujdesur gjithnjë ta fshihte mirë prapamendimin:

-Si nuk paskan?! Edhe ju shkrimtarët për veprat tuaja niseni nga njerëz realë, kështu na kanë thënë dikur mësuesit në shkollë, të paktën.

-Ndodh, si jo?! Por në këto raste ne i vrasim modelet, që t'u marrim shpirtin. Kokallat nuk na hyjnë në punë.- Lisian Zhupa vazhonte të përgjigjej me gjithë seriozitetin, dhe kjo ishte shenjë e mirë.

Din Qereçi i shkoi një e rrëqethur nga koka te këmbët.

-Ndarja e trupit nga shpirti është thjesht një bestytني e njerëzve primitivë,- deshi ai të mbrohej.

Lisian Zhupa nënqeshi lehtë, për herë të parë , dhe përsëri pa ironi, pa nënvleftësim.

-Edhe letërsia është bestytني,- ia ktheu.

Din Qereçi u ndje ende i papërgatitur për ta zhvilluar bisedën dhe zgjodhi heshtjen. Do ta kishte më të lehtë dhe do t'i pëlqente më shumë të përgjigjej. Por Lisian Zhupa nuk i drejtonte asnjë pyetje. Ai ndjehej i kënaqur mbështjellë me heshtjen e vet të papërshkueshme. Din Qereçi mendoi të bënte edhe një përpjekje për ta tërhequr Lisian Zhupën të hapej sadopak. E pyeti nëse ndodhte që realiteti t'i jepte një personazh të gatshëm.

-Po, sigurisht,- u përgjigj shkrimtari.

-Për shembull, qyteti ynë ka banorë të tillë?- Zemra e Din Qereçit lëshoi një goditje të rrëmbyer.

-Ka, si jo! Ka edhe qyteti ynë. Nuk jemi më të njëjlojtë se të tjerët as ne.

Din Qereçi mblodhi instinktivisht supet. Nuk kishte kuptuar dhe shkrimtari e pikasi.

-Ka edhe ndër ne ndonjë dele galë, për fat.

Din Qereçi nuk u sqarua, por e zotëroi veten të mos e shfaqte moskuptimin.

-A është e tepërt të pyes kush është?- e shtroi ai ndryshe pyetjen.

-Selimi, babai juaj.

Din Qereçi nuk u besoi veshëve.

-Babai im ka vdekur,- tha.

-Po ja që nuk ka vdekur,- ia ktheu shkrimtari, gjithnjë serioz.

## *Daullja prej letre*

Din Qereçi ndjeu një turp të papritur dhe pastaj një rrezik. E shoqja qeshi dhe mirë bëri që qeshi. Din Qereçi nuk donte të flitej për të atin.

Të dy burrat uleshin për së pari bashkë dhe nuk ishin miq. Por njiheshin. Aq sa të shkëmbenin një përsëritje kur ndesheshin në rrugë. Nuk kishin asnjë mendim të përcaktuar për njëri-tjetrin. Si të thuash, jetonin në dy botë të shkëputura. Din Qereçi mund të krenohet që e kishte kuptuar i pari nevojën e lidhjes midis këtyre dy botëve. Duke qenë nismëtar, ai besonte se do ta ruante deri në fund epërsinë, do ta vinte shkrimtarin në shërbimin e vet të pazakonshëm. Me kusht, që në lidhjen e tyre të ndërlikuar të mos përzihej shumë babai i vdekur. Ajo puna e vrasjes së modelit, për t'i marrë shpirtin, me siguri që ishte vetëm një shprehje e përçartur letrare. Të themi, një shprehje figurative, për të treguar nga e morre frymëzimin letërsia. Ai kishte dëgjuar për shkrimtarë që çmendeshin, por jo që vrisnin. Aq më pak dukej i aftë për një veprim të tillë Lisian Zhupa, të cilit i dridheshin duart edhe tek çonte cigaren te buzët.

Darka nuk zgjati shumë. Pa ia kërkuar njeri, gruaja e hirshme e Din Qereçit ishte zotuar t'i jepte gjallëri bisedës dhe ndërhynte parreshtur.

Në një rast tjetër Din Qereçi ndoshta as që do ta kishte vënë re teprimin e gruas në të folur. Punë e saj! Madje aq më mirë! Por jo gjatë asaj darke, kur rryma duhej të kalonte vetëm midis atij dhe shkrimtarit, dhe ai priste gjithë ankth diçka veçanërisht të rëndësishme. Diçka, që ai nuk e kishte pritur kurrë më parë. Me llafazanërinë e vet gruaja po i bëhej pengesë. Shkrimtari Lisian Zhupa ishte aq i sjellshëm sa të mos e shfaqte bezdinë. Dhe mbyllej më fort në vetvete. Ose gjente ngushëllim te gota e verës. Dhe koraca e heshtjes së tij bëhej më e papërshkueshme. Din Qereçit iu dhimbs i ftuari. Nëpërmjet kësaj ndjenje të ngatërruar, me të cilën nuk ishte mësuar, Din Qereçi shprehte shkallën më të lartë të nervozizmit dhe të pakënaqësisë. Por ai ishte nga ata burra të aftë për t'i fshehur të metat. Nuk i kishte ngjarë të atit, që kishte patur gjithmonë kënaqësi t'i zmadhonte të metat e veta. Edhe në rrethanat e një darke të zakonshme do të ishte përmbajtur, nuk do ta fyente kurrsesi të shoqen. Aq më fort i takonte të tregohej i sjellshëm ndaj saj në prani të Lisian Zhupës. Ai ende vazhdonte të besonte se shkrimtari nuk ishte i vetëdijshëm për pushtetin e vet. Ama, gruaja vetë duhej ta ndjente që mua më nevojitet diçka tjetër sonte, tha ai me vete ankueshëm. Ajo duhej ta ndjente që sonte i ftuari është këtu për mua, shtoi Din Qereçi me një

ankim edhe më të thellë, pa drejtim, që e trembi. Ai u kujtua se vetëm njerëzit e pafuqishëm e të pasigurtë në vete ankohen.

Shkrimtari është këtu sonte vetëm për mua, përsëriti Din Qereçi dobët. Drita e veçantë që vezullonte nëpër vështrimin e të shoqes, tek i drejtohej shkrimtarit, i zgjoi Din Qereçit një mendim të ri. Ishte e qartë se gruaja e tij ishte e pushtuar nga adhurimi për shkrimtarin, që dinte ta përdorte atë përsosmërisht heshtjen. Ajo nuk kishte sy për ta vënë re shpërfilljen e tij. Lisian Zhupa kishte medoemos një magji të jashtëzakonshme, që të vendoste atë lehtësisht një epërsi të tillë mbi një grua, me të cilën ulej për herë të parë në tryezë. Për më tepër, një grua e mësuar në shoqërinë e burrave të fuqishëm. Din Qereçi ishte i mbushur me ankh si të qëndronte në përgjim të një rreziku të panjohur. Nuk kishte pse të zemërohej me të shoqen që fliste parreshtur. Zemërimin le ta kishte me veten, që i ishte kyçur goja. Ai heshtte jo për të ndjekur shembullin e shkrimtarit. Zaten, ky ishte pikërisht shembulli që nuk duhej ndjekur. Din Qereçi nuk dinte ç'të thoshte dhe heshte.

Marrëdhëniet e tyre duhej të ishin orë e çast të tilla, që Din Qereçi të përfitonte nga çdo rrethanë, për t'i rrënjosur shkrimtarit në tru gjurmën e vet të dëshiruar. Din Qereçi e ndjeu kokën të mbushur me avull. Po plas, ofshani përbrenda. Ishte fund dimri dhe një vapë kaq e madhe sigurisht që nuk ishte në ajër. Po plas, përsëriti ai. Lisian Zhupa nuk duhej ta merrte vesh brengën e tij. Për Din Qereçin ishte e qartë tashmë se ajo mbrëmje nuk do ta afronte drejt qëllimit. Të paktën të mos e largonte. Ky ishte përfundimi shpëtimtar që Din Qereçi nxori vetëm në sajë të vullnetit të vet të fortë.

Kishte shkuar shumë vonë kur Lisian Zhupa kërkoi leje të largohej.

-Më falni, - tha duke i përfshirë me një vështrim të butë të dy bashkëshortët.

Din Qereçi nuk u besoi veshëve. Bujtësi i pazakonshëm ndjehej fajtor pse nuk rrinte dot më gjatë. Domethënë se kishte kënaqësi nga shoqëria e darkës. Nga shoqëria ime, saktësoi Din Qereçi. Domethënë se, i mbështjellë me heshtjen e vet, shkrimtari nuk kishte jetuar vetëm me shijen e mishit të pjekur dhe të verës së mirë. Por ishte i detyruar të largohej. Ishte e natyrshme që të largohej në atë orë. Din Qereçi mendoi me kënaqësi për darkat që do të bënin në verë e në vjeshtë e që do të ishin më të gjata.

Tek sa ndaheshin, Lisian Zhupa përshëndeti i pari:

## *Daullja prej letre*

-Mirupafshim!

-Mirupafshim!- ia ktheu hovshëm Din Qereçi.- Mirupafshim së shpejti!- Ishte i gëzuar. Nuk pati guxim t'i shprehte gatishmërinë për t'ia dhuruar shpirtin për romanin, që po shkruante. Por do t'ia dhuronte. Në kohën e përshtatshme. kur shkrimtari të mos kishte të drejtë të dyshonte për rrethanat kur i bëhej dhurata. Domethënë, kur të mos kishte pirë, dhe pasi të sigurohej se vrasja e modeleve, që kishte përmendur shkrimtari, ishte vetëm një shprehje e figurshme për të treguar si e merrte letërsia frymëzimin. Nga Din Qereçi duhej të mbetej medoemos trupi, që të shijonte lavdinë e kurbanit të vet.

3.

Din Qereçi ndjehej i qetë e i kthjellët. Ai e kishte harruar shpërfilljen deri në fund të Lisian Zhupës ndaj qethjes së tij. Darka nuk kishte si të mbyllej më mirë. Mirupafshim, kishte shqiptuar shkrimtari. Gruaja e hirshme e Din Qereçit ishte e lumtur. Ajo i tërhoqi vëmendjen të shoqit pse nuk sillte më shpesh në shtëpi të ftuar në tillë. Din Qereçi e pikasi nënkuptimin e të shoqes, por nuk i vuri rëndësi. Ai e njihte përçmimin e saj për më të shumtët e drejtuesve të rrethit. Përzjargen me tepri, thoshte ajo për ta. Koka e qethur ndryshe e Din Qereçit ishte krejt e zënë me mendimet për Lisian Zhupën. Përsëritjen e fundit të shkrimtarit Din Qereçi e mori mirëfilli si një dëshirë dhe premtim të tij për t'u takuar sërisht. Madje së shpejti. Domethënë se Lisian Zhupa e kishte shpjeguar drejt hutimin e Din Qereçit. Ai përsëriti edhe një herë se shkrimtari e kishte shpjeguar drejt hutimin e tij, me një shpresë të kotë ta përzinte kujtimin e babait, që kishte ndërhyrë aq befasisht midis tij dhe Lisian Zhupës. Kujtoja se ishim ndarë njëherë e përgjithmonë bashkë, tha Din Qereçi, i mbushur si dikur, me ndjenjën e turpit dhe të rrezikut.

Marrëdhëniet e Din Qereçit me të atin kishin qenë gjithmonë shumë të ndërlikuara. Ai ishte ndër të rrallët banorë të qytetit që nuk kishte qeshur kurrë me trillet e pashembullta të Selimit. Përkundrazi, ndjente një lloj turpi, gjë që nuk i pëlqente plakut.

-Kujt i ngjave!- i shfrynte ndonjëherë ai kur e humbte durimin, pa kuptuar se vinte në dukje ndryshimin e dëshiruar nga Din Qereçi ende i ri.

Duhet thënë se Selimi ishte sjellë edhe me të birin si me të tjerët: tallej me gjithçka dhe nuk shpjegohej për asgjë. Ai asnjëherë nuk ishte hapur me trashëgimtarin e vetëm të gjakut të vet. Din Qereçi nga ana e tij e kishte

ndjerë vrerin e pafund që shkarkonte i ati kur thoshte se e poqi Partia. Ai e ndjente dhe kafshonte fort buzën, që zbulimi i tmerrshëm të mbetej brenda dhëmbëve të tij. Ai nuk e kuptonte të atin, por nuk i kuptonte as të tjerët që hiqeshin sikur nuk e vinin re inatin e fshehur keq të plakut, e madje edhe qeshnin. Kjo gjendje e papërcaktuar, e zgjatur për vite e vite, i kishte krijuar një pasiguri të përhershme, ndjesinë e bashkëjetesës me një rrezik, me të cilin as nuk mësohej dot dhe ta pranonte, as nuk e harronte dot dhe të bënte jetën e vet e as nuk e përballte dot e të shpëtonte për mirë a për keq. Ai e dinte se rënja e të atit ishte edhe shembja e tij. Ndërsa Selimi, kur e pyeste gjithë përçmim, pa kërkuar përgjigje, se kujt i kishte ngjarë, dhe kjo ndodhte tepër rrallë, shprehte ankesën e tij më të thellë. Unë kaq qenë shumë i ri në pleqërinë e tij dhe më vonë kam menduar për ankesën e tij të kyçur. Ai ka vuajtur nga moskuptimi i të birit, por ishte i vendosur të mos ia prishte të ardhmen, që Din Qereçi e kishte zgjedhur vetë. Selimi nuk e kishte shtyrë në atë rrugë dhe nuk donte t'ia këpuste. Edhe ai e dinte se po të binte, do ta shembte nën vete të birin dhe nuk pranonte të ishte përgjegjës.

Din Qereçi nuk do të lejonte që përhitja e paftuar e të atit t'ia errësonte kënaqësinë e mbrëmjes. Për t'u çliruar disi nga ndjenja e turpit dhe rrezikut, ai tha me vete se shkrimtari e kishte gjykuar si të përshtatshëm dhe të denjë për atë që ai e quante bestytni. Din Qereçi përsëriti me vete se letërsia nuk ishte bestytni. Nejsel! Marrëveshja e tyre e heshtur, enigmatike qëndronte dhe kjo ishte kryesorja. Din Qereçi u pushtua nga një valë e ngrohtë mirënjohjeje për shkrimtarin. Dhe iu rrit më tej besimi në vete për arritjen e qëllimit.

Mirëkuptimi i Lisian Zhupës ishte një ndihmë tejet e çmuar për të. Më saktë, ishte e vetmja ndihmë, për të cilën ai kishte nevojë. Din Qereçi i mbetej të hartonte pa vonesë një plan të hollësishëm për veprimet e veta në të ardhmen e afërme. Sa më përpara të shtyhej, aq më shtrenjtë do t'i kushtonte edhe gabimi më i vogël. Nuk duhej ecte kuturu. E dinte se nuk kishte arsye të nxitohet. Duhej punuar ngadalë, me durim të madh, që gjithçka të gdhendej përsosmërisht. Ai nuk donte, që në përfytyrimin e shkrimtarit të ishte dele galë, si i ati. Ky ishte rasti i volitshëm, që atë e bir të krahasoheshin jo për të treguar vazhdimësinë, por përjashtimin e njëri-tjetrit. Por edhe kohë për të humbur nuk kishte. Asnjë minutë. Përparësinë e parë të madhe ai do ta merrte duke provuar se vështirimi i politikanit shkon më larg se ai i shkrimtarit. Lisian Zhupa kishte thënë në një intervistë se qëndronte çdo

mëngjes disa orë mbi fletën e bardhë, dhe ishte i lumtur kur arrinte të shkruante një faqe në ditë. Tek e kujtonte tani, Din Qereçi i jepte një dehje të vërtetë fjala "i lumtur", që shkrimtari e përdorte në mënyrë aq të natyrshme, si diçka të fituar e që nuk mund t'ia rrëmbente askush. Din Qereçi bëri atë që nuk e kishte bërë kurrë: luti Zotin që Lisian Zhupa të jetonte sa më shpesh një lumturi të tillë. Pastaj pati një pendim prej mëkatari dhe u trishtua. Ishte lutur nga dashuria për veten dhe jo për Lisian Zhupën. Sepse lumturia e Din Qereçi do të buronte nga lumturia për të cilën fliste shkrimtari.

Sidoqoftë, edhe ajo ndjenjë e pabesueshme pendese i shërbeu. I tërhoqi vëmendjen për rrugën që duhej të ndiqte. Do të kishte dashur sinqerisht të këshillohej me shkrimtarin, gjë që ishte e pamundur. Të paktën një herë, sa për fillim. Ndoshta edhe për punën e shkrimtarit do të ishte e dobishme që ai vetë ta drejtonte disi procesin e përsosjes së modelit të tij. Ashtu si piktori, që zgjedh veshjen, pikën e vështrimit, krehjen dhe lëvizjen e gjymtyrëve të modelit të vet. Jo. E pamundur. Ai do të zbulohet kur ai vetë dhe shkrimtari do ta kuptonin instinktivisht se kishte ardhur çasti i përshtatshëm. Por kjo nuk ishte një arsye mjaft e fortë për t'ia lëkundur Din Qereçi besimin në vete. Din Qereçi ishte i vendosur ta përzinte nga vetja çdo hije dëshpërimi.

Gjatë dy-tri javëve që erdhën ai ndërmori, në fshehtësi të plotë, kuptohet, një anketë të çuditshme: ç'mendohej për të në të gjitha shtresat e popullsisë së qytetit. Më saktë, ai kërkoi të mësonte çfarë kishin vënë re njerëzit në pamjen e tij, në sjelljen e tij e në karakterin e tij. Kjo do të ishte etapa e parë, që do ta çonte për afërsisht tek opinioni që kishte shkrimtari për të. Pa e përfunduar anketën ai nuk do të takohej për së dyti me Lisian Zhupën.

Raportet, që i erdhën brenda afateve të parashikuara, ishin zhgënjyese. Sipas tyre Din Qereçi kishte vetëm virtyte. Shndriste kudo. Një shenjtor i vërtetë, që jetonte midis njerëzve të zakonshëm. Lum qyteti që e kishte! Duke i lexuar, Din Qereçi ndjeu t'i përkëdhelej sedra. Dhe do të kishte dashur t'ia jepte edhe gruas, që ajo të shihte me kë e kishte bashkuar jetën. Por kënaqësia nuk i zgjati. Fatkeqësisht, figura e tij nuk mund të ishte e tillë. Përderisa nuk kishte tërhequr më parë vëmendjen e shkrimtarit. Të thuash se figura e tij kërkohet e tillë siç ishte paraqitur, kjo është e vërtetë, pranoi me gjakftohtësi Din Qereçi. Ishte hera e parë, që ai e gjykoi me aq pamëshirshëm veten, gjë që i shkaktonte njëfarë marramendjeje.



Gabimi i anketës fillonte tek ai vetë. Nga mënyra si ishin hartuar pyetjet, publiku ishte mashtruar pafajësisht. Kishte besuar se duhej të përgjigjej si zakonisht, kur ishte fjala për njerëzit e rëndësishëm të qytetit.

Din Qereçi e përsëriti anketën pa vonesë dhe me të njëjtën fshehtësi. Kësaj here u kujdes mirë, që të dilte qartë në pah qëllimi i tij. Do të kishte dashur ta shihte shtangien e të anketuarve. Mahnitjen e tyre. Sytë e tyre të shqyer e të ngrirë mbi gërmat e pyetjeve. Po ndodhte e papërfytyrueshmja. Shoku Din ishte velur nga përkëdhelitë. Vetëm shoku Din po rishikonte veten, apo krejt regjimi? Atij i nevojiteshin vetëm të metat, që viheshin re në pamjen e tij, në sjelljen e tij e në karakterin e tij. Theksohej: vetëm të metat. Sa veta do të kenë pyetur veten ndërzyzash nëse nuk po zgjohej më në fund tek Din Qereçi damari i të atit?

Din Qereçi e mori lehtë me mend se kishin qenë të shumtë ata që kishin dyshuar në qëllimin e anketës. Do të jetë një nga ato dinakëritë e stërholluara të Sigurimit, për të zbuluar kundërshtarët e regjimit, kanë thënë me të drejtë. Nuk ishin mësuar. Kjo ishte, me siguri, arsyeja pse një pjesë nuk ishin përgjigjur fare kësaj here, ndërsa një pjesë tjetër kishin përsëritur lëvdatat pa ndryshuar një fjalë. Për fat, ishte edhe një pjesë e tretë, më të rrallët natyrisht, që kishin patur guximin ta zgjidhnin gjuhën. Din Qereçi mendoj plot krenari se pa idenë e tij, ata njerëz nuk do të kishin patur kurrë rastin të zbulonin te vetja një virtut kaq të lartë: guximin qytetar. I erdhi keq që nuk ballafaqohej dot me ta, që të merrte drejtëpërdrejt nga sytë e tyre mirënjohjen e tyre. Din Qereçi ishte nga ata që e kërkojnë mirënjohjen. Ai e dinte se lavdia arrihet vetëm pasi është pushtuar mirënjohja. Sidoqoftë, ky ishte akti i parë i heroit, që po gatuhej brenda tij, u shpreh heshturazi Din Qereçi në vend të shkrimtarit Lisian Zhupa. Ai besoi se po i jepte një mësim shkrimtarit për të mos i kërkuar personazhet vetëm ndër delet gala.

Siç ishte, thellësisht i frymëzuar, domethënë shpërfillës ndaj lavdeve të rreme, ai nuk e pati të vështirë të veçonte menjëherë vërejtjen më të rëndësishme, që i bënte populli i tij: Pse shtiresh? Por iu desh njëfarë kohe, që ajo pyetje ta përshkonte trurin e tij, ngadalë, si një turjelë e ndryshkur. Si një turjelë e ndryshkur, përsëriti Din Qereçi përmes një rrëqethjeje të papritur. Ku e kishte dëgjuar?

Ndër dhjetëra përgjigjet e mbledhura, kjo ishte vetëm njëra e që nuk ishte një përgjigje e mirëfilltë për pyetjet e shtruar. Një zë i vetmuar, krejt i vetmuar dhe i panjohur,

tha ai me vete, pa u ngushëlluar dot. E shprehur në formë aq të prerë, me një pikëpyetëse në fund si ganxhë, ajo përcillte një zemërim të madh. Një urretje, saktësoi me vete Din Qereçi, pa e kuptuar pse i nevojitej ky saktësim. Dhe shtoi: një kërcënim. Pse shtiresh? Nuk ishte thënë as si këshillë, siç do t'i pëlqente atij: Mos u shtir! As si një konstatim, që do të ishte edhe më e natyrshme për një anketë: Shoku Din Qereçi shtiret. Ai ishte tejet i tronditur. Të paktën të ishte sqaruar nëse vërejtja bëhej vetëm për rastin e anketës, apo në përgjithësi për jetën e Din Qereçit. Iu duk se dëgjoji zërin e vjetër të të atit se kujt i kishte ngjarë.

E përfshiu sakaq edhe atë vetë një valë zemërimi i verbër, që ia la shpejt vendin urrejtjes, gjithashtu fare e verbër. Kërcënimi erdhi një çast më pas, si një goditje shkatërrimtare ndaj atij vetë. Kundër kujt do të ishte zemërimi, urrejtja, kërcënimi i Din Qereçit? Ai u ndje i dobët si kurrë ndonjëherë.

Sidomos kërcënimi kërkonte medoemos një adresë.

Ai zë ishte i vetmuar, por edhe i mbrojtur në mënyrën më të mirë. Ishte anonim.

Din Qereçi ndjeu t'i squleshin të gjithë muskujt. Nëpër trurin e tij kishte kaluar vetëtimthi hija e të shoqës. Askush nuk e njihje më mirë se ajo. Ishte njësoj si të pranonte se në ato dy fjalë shprehej e vërteta.

4.

Din Qereçi nuk deshë kurrësi të besonte se njeriu që i drejtohej me aq armiqësi ishte pikërisht e shoqja. E pamundur, përsëriti disa herë me vete. Dhe bëri të gjitha përpjekjet të sigurohej për të kundërtën. Zhvilloi me të disa biseda të tërthorta, por pa dobi, për të mësuar nëse ajo ishte në dijeni të anketës së tij. Përshtypja e tij, paksa e kërkuar, vërtet, por që mund të përfilllet, ishte qetësuese. Gruaja e tij nuk ishte në dijeni të anketës së tij të pazakonshme dhe as të projektit të tij me shkrimtarin Lisian Zhupa. Askush nuk ishte në dijeni. E keqja duhej kërkuar gjetkë.

Ai i njihje ziliqarët që kishte në qytet. Të paktën ata më të rëndësishmit i njihje mirë. Por ishte hera e parë që mendonte seriozisht për rrezikshmërinë e tyre. Zuri ta analizonte ngadalë secilin veç e veç. Dilte që secili ishte gati t'ia bënte gjëmën. Pa një fije mëshire. Secili do ta quante rrëzimin e tij, mundësisht vdekjen e tij, një fitore personale, edhe pse të rrallë ishin ata, që kishin edhe gjasat më të vogla për t'ia zënë vendin. Din Qereçi nuk pyeti për arsyt e vërit të tyre kundër tij. Nuk ishte kjo që

i interesonte tashmë. Ai e dinte se përsosja, që ai kërkonte tek vetja, nuk ishte rruga e pajtimit me ta.

Din Qereçi nuk arrinte dot të bindej se një armik i sojit të ziliqarit do ta sulmonte me një armë të tillë. Ziliqari synonte vetëm shkatërrimin e tij dhe i shkonin armë të tjera.

Për një çast ai dyshoi se do të ishte ndonjë kundërshtar i fshehtë i regjimit, që gjente rastin të shfrynte një duf të gjatë. Ky version i pëlqeu dhe do të ishte çliruar lehtësisht nga ankthi, madje edhe me njëfarë krenarie, sikur sikur të mos i zhvlerësohej tepër shpejt. Din Qereçi nuk ishte modest dhe e dinte veten të rëndësishëm, por vetëm brenda qytetit të vet. Ende vetëm brenda qytetit të vet. Domethënë jo aq sa të shenjohej si simbol i regjimit. Sidomos në rrethana të tilla ai nuk dëshironte të dukej më i madh nga ç'ishte. Donte të rritej, dhe ndryshe nga rritja që vjen përmes emërimeve. Pati kënaqësi, por edhe një frikë të panjohur. Vetëm një i marrë mund të besojë se ka goditur hipokrizinë e regjimit duke m'u zbrazur mua, tha gjakftohtë, pa asnjë keqardhje që po ia mbyllte vetes shtegun e shpëtimit. Pastaj regjimi nuk ka hipokrizi, sqaroi, i trembur sakaq nga vetvetja. Regjimi ynë është i pastër si drita e diellit.

Historia paraqitej më e ndërlikuar nga ç'ishte i aftë të sajonte truri i lëmuar i një të marri, apo truri i helmatisur i një ziliqari, apo qoftë edhe truri i rafinuar i një kundërshtari politik. Në qytet gjëndeje vetëm një njeri me një përfytyrim aq pjellor sa ç'kërkohej: Lisian Zhupa. Edhe ky version do të ishte i mrekullueshëm. Din Qereçi mbeti një hop në mëdyshje. Ishte një shaka, apo një lojë e tij e stërholluar, doemos e nevojshme për romanin që po shkruante? Ai nuk i lejoi vetes një hamendje të tretë, e që mund të ishte e mbrapshtë. Sidomos hamendjen rreth përzjerjes së fantazmës së babai të vdekur në veprimin e menduar mirë të shkrimtarit nuk ia lejoi vetes.

Edhe pse paksa plagosëse. (Pse shtiresh?) më e pëlqyeshme do të ishte shakaja. Lisian Zhupa do të dëshmonte kështu afërinë e vet të veçantë afektive me Din Qereçin. Si t'i thoshte me të qeshur se një anketë e tillë e vështirë ishte e tepërt. Nuk ishte mësuar ky popull me mënyra të tilla të qytetëruara. Në fund të fundit, edhe shkrimtarët duhej të kishin diçka të përbashkët me njerëzit e zakonshëm. Të paktën herëpashërë. Din Qereçit iu kujtua habitja naive e berberit. Paskemi një shkrimtar në qytetin tonë, Shoku Din? Paskemi një shkrimtar në qytetin tonë, shoku berber? Për të mfrë a për të keq e kemi shoku Din? Ah, shoku berber, kjo është çështja, u përgjigj Din

Qereçi me një humbje të papritur të sigurisë në vetvete.

Jo.

Për fatin e keq, Lisian Zhupa nuk dukej nga ata që bëjnë shaka. Ai rrinte gjithë kohën aq i zymtë, sa Din Qereçi, si shumë të tjerë, do të pyeste edhe nëse ai dinte të qeshte ndonjëherë. Askush nuk e kishte parë Lisian Zhupën të argëtohej ndryshe veç se duke pirë ngadalë dhe gjithmonë në të njëjtën tryezë, ose duke shëtitur krejt vetëm si një ari i mplakur në pyllin e gështenjave ndanë qytetit. Njerëzit thoshin se pirja ishte argëtimi i tij i madh, përderi sa ai nuk dhej kurrë. Nuk i merreshin këmbët. Nuk i trashej gjuha. Gjithë kohën sikur pinte ujë. Thua se brenda vetes kishte një shkretëtirë, që nuk arrinte ta njomte sadopak. Vetëm se bëhej më i heshtur. Aq e fortë ishte kjo përshtypje të bashkëqytetarët e tij, sa askush nuk kishte guxuar ta qortonte ndonjëherë shkrimtarin për ndikime borgjeze në mënyrën e jetesës. Ç'duhet të bëjë njeriu për të nënshtuar kështu një qytet të tërë? pyeti veten me një adhurim të pavullnetshëm Din Qereçi. Me siguri që shkrimtari kishte sajuar një histori të çuditshme, që do t'i shërbente për romanin e ri. Diçka të ngjashme me eksperimentet e shkencëtarëve. Din Qereçin e përfshiu një valë e ngrohtë ngazëllimi. Për të mirë e kemi shkrimtarin, shoku berber. Ai do t'i japë lavdi qytetit tonë. Lisian Zhupa nuk do t'i ishte drejtuar pikërisht atij, në qoftë se nuk e parashihte si banorin e ardhshëm të botës së vet imagjinare e që ishte e nesërmja, koha fizikisht e paarritshme. Ai e harroi si kishte filluar historia.

Duke ndjekur mendimin e vet e duke e sjellë nga të gjitha anët, Din Qereçit iu fik pak nga pak ngazëllimi. Nuk do ta kishte të lehtë. Shkrimtari e pyeste drejtpërdrejt se përse shtirej. Pra, historia në të cilën po gjëndej ai, paraqitej fort e ndërlikuar. Atij i hiqej e drejta të kundërshtonte. I mbetej vetëm të shpjegonte se çfarë e shtynte të shtirej. Dhe të shpjegonte pa fjalë, siç i shpjegohet dikujt, që të vëzhgon nga larg, shumë larg, ku nuk dërgohet dot zëri. Din Qereçi ishte aq metodik sa ta kuptonte se, para se të jepte një përgjigje të tillë, duhej ta dallonte qartë për veten e vet se çfarë kishte shtirje e çfarë të vërtetë në sjelljen e tij. Ai ishte dorëzuar pa dashur. E kishte pranuar se brenda lëkurës së tij kishte të paktën një pjesë të rreme.

Din Qereçi nuk ishte mësuar të gërmonte te vetja dhe e zuri një dhimbje e fortë koke. Pse të jetë kaq e vështirë? u ankua pa zë. E shoqja, e cila vazhdonte të mos ishte në dijeni të trazimeve të thella të Din Qereçit, u shqetësua menjëherë. Kishte të drejtë. Burri i saj nuk vuante nga

asnjë sëmundje. Madje as te dentisti nuk kishte shkuar kurrë. Ajo deshi të thërriste mjekun, por Din Qereçi e ndaloi. Ai shpalli me një ton të lodhur se nuk qetësohej dot as me këshilla të mjekut e as me barna të farmacisë. E shoqja i hodhi një vështrim plot alarm dhe lëshoi nëpër dhëmbë një klithmë të mbytur:

-Si?

Din Qereçi e vuri re mirë frikën e pazakonshme që pushtoi gruan dhe nënqeshi lehtë. Nuk i erdhi keq. Përkundrazi, kishte një ndjesi të pashpjegueshme prej fitimtari, e cila i solli një qetësi të shkurtër. Gjatë më shumë se njëzet vjetëve që jetonin bashkë, ishte hera e parë, që ai bënte diçka tmerruese për gruan. Ai ishte kujdesur gjithmonë ta mbronte edhe nga tronditjet e vogla gruan e vet të hirshme, ndonjëherë pak lozanjare, por që nuk e kapërcente kurrë një kufi. Ndoshta është hera e parë që nuk shtirem, tha Din Qereçi me vete, i kënaqur. Kishte menduar me tërë seriozitetin. Në fillim iu duk sikur po i zbrazej kafa. Mbi shpatulla i mbeti një lloj kutie boshe, që lëshonte vetëm fishkëllima. Fishkëllima që zgjateshin. Fiu-fiu-fiu... Fiuuuuu... Kishte mësuar për një nga shokët e fëmijërisë që ishte çmendur dhe shëtiste rrugëve me një daulle prej letre. Por ai nuk e kishte parë kurrë. Ç'do t'i thoshte po të ndeshej me të diku, në një qoshe rruge? Ai vendosi t'i përsëriste pyetjen që i kishte drejtuar Lisian Zhupa. Ç'ka dashur të thotë dikur babai yt me atë historinë e daulles prej letre? e kishte pyetur shkrimtari. Tmerri që i kishte shkaktuar gruas, iu kthye atij vetë, Din Qereçit. Nuk është kjo vetja ime, mermëriti vajtueshëm, pa e përcaktuar për cilën "vete" e kishte fjalën. Ju betohem që unë, i vërteti, jam siç më keni njohur. Ai do të donte, por nuk guxoi të shprehej: siç më keni dashur. Nuk i kujtohej më nëse e kishin dashur. Ju betohem. Ai nuk dinte se për çfarë të betohej. Nuk shquante më se çfarë kishte më të shtrenjtë, që ta vinte peng te fjala. Vështrimi që i hidhte e shoqja nga larg, ishte i mbushur me frikë dhe përçmim. Sidomos shumë përçmim. Pse me përçmim?

-Eja më ndihmo pak!- iu drejtua Din Qereçi. Ai e dinte se çdo ndihmë i ishte e padobishme. I ishte drejtuar të shoqes në një përpjekje të dëshpëruar për t'u bindur se gjithë ç'po i ndodhte ishte vetëm përhitje.

E shoqja nuk lëvizti, si të mos e kishte dëgjuar. Asaj nuk i lëvizën as qepallat. Fare. Gjithçka ishte tejet e ngrirë tek ajo: gjymtyrët, teshat e ngjitura pas lëkurës së trupit, dhe vështrimi i mbushur me frikë dhe përçmim. Sidomos përçmimi ishte krejt i papërligjur. Din Qereçi u siguria se asgjë përreth nuk ishte reale. Endrra si ëndërr që ishte, nuk

## *Daullja prej letre*

do të zgjaste më shumë se një gjumë. Ai do të zgjohej dhe do të shpëtonte njëherë e mirë. Nga kush do të shpëtonte?

5.

Dhe vërtet, truri i Din Qereçit erdhi duke u ftohur. Iu kthye arsyeja të paktën aq sa t'i hidhte poshtë të gjitha hamendjet e mëparshme: qortim-kërcënimin se përse shtirej nuk ia drejtonte kurrsesi e shoqja. Por nuk ia drejtonte as shkrimtari Lisian Zhupa. Nuk ishte as shaka e tij e as sajim pararomanesk. Për t'i siguruar njëherë e mirë, ai u njoftua se shkrimtari nuk përfshihej ndër të anketuarit. Mbetej që autori të ishte i panjohur. Ose një frikacak, që fshihet, shtoi Din Qereçi duke shtrembëruar buzët pahijshëm. Nuk ishte në nderin e tij të merrej as me të panjohurit e as me frikacakët. Sidomos nuk i lejohej të përzihet me frikacakët. Do të kthehej në jetën e vet të zakonshme. Aty ku gjithçka ishte e njohur për të dhe i bindej.

Din Qereçi vuri re shumë shpejt se nuk do ta kishte fort të lehtë të kthehej në jetën e vet të mëparshme. Në jetën e vet të zakonshme, siç shprehej ai. Brenda kokës kishte një si mpirje të përgjithshme. Megjithatë, për çudinë e vet, nuk u shqetësua fare. Do të më kalojë, tha shpërfillshëm. Nuk ndjente më as inat, as fyerje. Madje as kureshtje. Frikë nuk kishte ndjerë asnjëherë. Por kishte një vendosmëri që nuk varej nga vullneti i tij për t'i shkuar historisë deri në fund. Kishte një shtytje që i vinte nga një makth i turbullt, i papërcaktuar. Cili ishte fundi? Si ishte fundi? A do të kishte vërtet një fund? Pse duhej të kishte patjetër një fund?

-Ty të ka ndodhur diçka, - iu drejtua e shoqja.

-Kur? Çfarë më ka ndodhur? - ia ktheu Din Qereçi sakaq, i mbushur me një shpresë të kotë se gruaja do ta ndihmonte pikërisht për të kuptuar se si të arrinte sa më shpejt në fund. Ai e dinte se historia ishte e ndarë tashmë në dy pjesë. Fillimi, që kishte qenë me dëshirën e tij. Një dëshirë e panatyrshme, e pranonte, por që kishte lindur brenda tij. Dhe vazhdimi, që ishte i detyruar. Ai nuk e përcaktonte dot nga i vinte detyrimi, kush ishte magjistari që e yshte. Thjesht ndjehej i detyruar.

Gruaja e përfshiu me një vështrim të tmerruar dhe i solli shpinën.

-Të pyes sinqerisht, - shtoi Din Qereçi. - Kur më ka ndodhur? Çfarë më ka ndodhur? Sinqerisht të pyes...

-Sinqerisht, - përsëriti ajo nëpër dhëmbë, por pa përçmim, duke u larguar. Shpatullat e saj ishin varur trishtueshëm. Ajo lëvizte me një hap të vogël, prej plake.

-Sinqerisht,- përsëriti edhe Din Qereçi. Zëri i tij kumboi.- Krejt sinqerisht...- Ai pati një gëzim të papritur e të plotë, si të kishte zbuluar formulën shpëtimtare. Dhe nuk e vuri re të shoqen që përkundi kokën me një shprehje ku përzihej dëshpërimi me habitjen, kësaj here edhe me përçmimin.

Që nga ai çast e folura e tij do të pësonte një ndryshim të dukshëm. Sa herë do të kishte diçka për të pohuar, do të shtonte plot pasion: **SINQERISHT**. Diçka të rëndësishë së parë apo edhe fare të rëndomtë. Jo vetëm kur i drejtohej gruas së vet apo miqve, por edhe njerëzve me të cilët e lidhte thjesht puna. Njësoj si kur jepte të drejtë edhe kur kundërshtonte prerë, si kur tregonte diçka nga fëmijëria e largët (pa përmendur kurrë babain) apo hartonte një plan të madh për të ardhmen. **SINQERISHT**. Pastaj iu bë e nevojshme ta dëshmonte sinqeritetin edhe kur shprehte një dëshirë apo jepte një urdhër. Njësoj si kur fliste me zë të ulët, edhe kur ulërinte. Bashkë me gjuhën edhe fytyra e tij fitoi një mënyrë tjetër pjesëmarrjeje në bisedë. Fytyra e tij e gjerë e me tipare të tendosura, që përpiqej me ngulm të fshihte moshën, u zbut e u zhbë, thua se nën lëkurën e tij të lëmuar nisën të shkrijnë befaz dhjamrat e mbledhura në vite. Ai mori befaz një hije të plakur.

Ky ndryshim nuk kaloi pa ndikuar te bashkëbiseduesit. Qoftë ndër të afërmit e tij, që kishin rast ta dëgjonin më shpesh, qoftë te të tjerët. U duk se ata u bënë shumë më të përqëndruar e më të vëmendshëm kur u drejtohej Din Qereçi, gjë që atij i dha kënaqësinë e parë. Ai besoi se po arrinte t'ua përcillte ndjenjën e re që e kishte pushtuar. Domethënë se, ndryshe nga më parë, tani ishte më bindës. Domethënë se dallohej që nuk shtirej më. Dhe nisi të ndjehet çdo çast e më i sigurtë e më i lirshëm në përdorimin e fjalorit të ri. Fliste disi më ngadalë e me një zë të shtrirë, por i rrëshqiste gjithnjë e më këndshëm gjuha nëpër "s-sh-t". Ai u mësua të dëgjonte veten e të ngazëllehej.

Kënaqësia e tij e bukur, e që mbeti vetëm e tij, zgjati ndoshta një javë. Ndoshta edhe diçka më tepër. Ishte verë ose dimër, nuk mbahet mend. Rëndësi ka që qielli mbi kokat e vogla të tokësorëve rrinte aq lart, sa të mos përzihej me diellin apo reshjet e veta në jetën e ndërlikuar të njerëzve. Qielli bënte jetën e vet atje lart, i harruar nga njerëzit, që ndiqnin përditë udhët e tyre të shkurtëra duke vështruar, thua se numëronin secili hapat e vet. Në të vërtetë, ata nuk numëronin hapat e as nuk kërkonin nëpër pluhur thërrimet e ëndrrës së humbur nga ndonjë udhëtar i panjohur. Ata thjesht ishin bindur më në fund në drejtësinë

## *Daulja prej letre*

e proverbit, sipas të cilit kalliri plot e mban kokën të përkulur. Pra, është e sigurtë se nuk ishte periudhë pushimesh.

Ishte përsëri e shoqja që ia këputi zellin. Shkak u bë një ëndërr e natës së kaluar. Gruaja i thoshte se ai kishte qarë në gjumë. Din Qereçi nuk pranonte.

-Kam qeshur,- kundërshtonte ai.

-Ç'ngul këmbë edhe ti si mushka! Unë vetë të zgjova, apo jo?! Të shkunda fort nga supet, të kujtohet?

-Po.

-Dhe ti po qaje. Madje me ngashërима...

-Sinqerisht që po qeshja, nuk më ke vënë re mirë ose nuk mban mend, ke qenë përgjumshëm, sinqerisht...- deshi Din Qereçi ta mbyllte bisedën.

-Na çmënde me këtë sinqeritetin tënd!- shpërtheu gruaja siç e kishte zakon kur e humbte edhe fijen e fundit të durimit.- Sinqerisht që ke qarë. Ta them unë që ke qarë.

Ishte hera e parë që gruaja përdorte sinqeritetin për ta siguruar të shoqin. Pikërisht sinqeritetin. Din Qereçi pa në gjestin e saj vetëm anën e pëlqyeshme për veten e tij: ai po bëhej model për ata që e rrethonin. Po fillonte rrezatimi i tij mbi shoqërinë. Askush nuk do të kishte më të drejtë të dyshonte në shtirjen e tij. Përsosmëria morale e individit nuk kishte ku të shkonte më larg. Model. Ai u kujtua për shkrimtarin Lisian Zhupa. Ndoshta po vinte koha të vazhdonte historinë e nisur me të. Duheshin dendësuar takimet me të, që shkrimtari të vinte re mirë se si të tjerët pëvetësonin cilësitë e Din Qereçit, dhe të bindej se ideologjikisht dhe estetikisht gabohej kur e kërkonte personazhin ndër delet gala. Shkrimtari do të bindej. Pa dyshim. Din Qereçin e përshkoi një valë e ngrohtë krenarie.

Gruaja vazhdonte të ruante një pamje të palejueshme prej fitimtareje, gjë që burrit iu duk krejt e pavend. Por nuk i foli. Nuk ishte nevoja. Ajo do ta kuptonte vetë. Nëse i takonte dikujt një pamje e tillë, ky do të ishte Din Qereçi. Ajo kishte thirrur në ndihmë sinqeritetin sipas shembullit të të shoqit. Ajo po përsosej nën ndikimin e tij. Do të vinte pa vonesë çasti që gruaja të binte në gjunjë para tij, me sytë të përplotur nga mirënjohja.

-Më dhemb koka,- tha Din Qereçi. Nuk i dhimbte koka. Por pati dëshirë ta prekte të shoqen, të dëgjonte prej saj një fjalë të ëmbël, ta thyente qëndrimin e saj të papërligjur prej fitimtareje.

-E ke nga e qara e natës së shkuar,- u hodh ajo.

Din Qereçi u rruadh si të kishte marrë një fshikull të fshehtë rreth qafës. Dhe ndjeu një shije të hidhur në



gojë.

-Unë të thashë se nuk kam qarë,- shpjegoi ai me një zë të shtruar, por të vendosur.- Sinqerisht që kam qeshur. Oh, si kam qeshur!

-Sinqerisht që ke qarë,- përsëriti gruaja. Sytë e saj nuk shfaqnin asnjë hije të rreme.- Oh, si të rridhnin lotët! Nuk të kisha menduar kurrë të qaje ashtu. Qaje sikur të dhimbte diku tjetër, jo trupi.

Din Qereçi u lëkund. Unë flas sinqerisht, tha me vetë, fare i bindur. Krejt sinqerisht. Por edhe ajo duket se flet sinqerisht. Unë e njoh mirë... Atij nuk i pëlqeu të thoshte "kur shtiret" dhe shtoi "kur luan teatër". Din Qereçit iu prenë forcat. Njëri nga të dy gabohej me dromos. Ose mashtronte. Unë nuk mashtroj, shtoi. Ai u përqëndrua edhe një herë me të gjithë vullnetin për të mos e lënë veten ta shtrembëronte të vërtetën. Jo. Nuk kishte qarë. Ishte fare i sigurtë se kishte qeshur. Ndërkaq edhe sytë e gruas vazhdonin të kishin një pastërti të thellë pafajësie dhe Din Qereçi u gëzua. Ai nuk do të donte as që e shoqja të mashtronte. Domethënë "të luante teatër". Kishin kaluar aq vite bashkë, sa tani e quante tepër vonë, me një fjalë të padobishme, të zbulonte dobësi të tilla të pandreqshme tek ajo.

Për disa ditë me radhë truri i tij mbeti i mbërthyer në këtë pikë. Të dy thoshin të kundërtën e njëri-tjetrit. A mund të kishin të dy të drejtë njëherësh? Të ishin të sinqertë. Për herë të parë në jetën e vet Din Qereçi nuk kishte përgjigje. Koha rridhte ngadalë. Sikur të mos ishin lindjet e perëndimet e diellit dhe ndërrimi i këmishave të ndotura. Din Qereçi do të thoshte se gjithëka kishte mbetur në vend. Jo në një qëndrim shlodhjeje. Gjithëka kishte mbetur në vend si e mbështjellë me një të bardhë veze të mpiksur. Ai ishte i paaftë të zgjidhte në mëdyshjen ku gjëndeje. Unë nuk mashtroj e as nuk gabohej. Por as gruaja nuk mashtronte. Ajo vetëm gabohej, tha ai tejet i lumtur nga zbulimi i vet. Pse nuk e kuptonte ajo që gjithkush mund të gabohej?

Din Qereçi nuk guxonte më t'ia kujtonte gruas se ajo gabohej. Ai nuk kishte asnjë zëmërim pse ajo gabohej. Mjafton që ajo të bindej. Dhe të harronin të dy ç'kishte ndodhur. Të fitonin paqen e humbur. Të vazhdonin t'i kalonin ditët e muajt në mirëkuptimin e zakonshëm, duke e fshirë përgjithmonë emrin e Lisian Zhupës nga lista e të njohurve të tyre. Darkat do t'i kalonin me të ftuarit e vjetër, të fuqishmit. Le të përgjeshin me tepri përpara gruas së tij ende të hirshme. S'ka gjë! Ata të dy do të ndjeheshin mirë. Din Qereçi nuk e kishte përfytyruar kurrë

## *Daulja prej letre*

se paqja që kishte zotëruar gjithmonë në jetën e tij, e për të cilën ai kishte qenë krenar, do të prishej siç u prish. Nga një kotësi. Një ëndërr. Din Qereçin e përfshiu një tërbim i papritur kundër ëndrrave. Kundër gjumit në përgjithësi. Poshtë gjithçka ishte e pavullnetshme te njeriu! thirri. Ai ndjeu t'i përcëllonin veshët. Rregulli i plotë që kishte vendosur ai brenda kokës së vet prej aq vitesh, pasqyrohej më së miri në përditshmërinë e tij. Unë desha ta përjetësoj këtë rregull, u shfajësua para vetes. Tani duhet të paktën ta shpëtoj nga shkatërrimi i plotë. A do të arrij? Veshët i lëshonin një fishkëllimë të njëtrajtshme, pambarimisht të zgjatur. Çfarë kërkonte shoku i tij i fëmijërisë rrugëve me daullen prej letre? I digjinin hojzat e hundës. Kapakët e syve po i rëndoheshin. Një herë pati përshtypjen se po i enjteshin të gjitha shqisat. Pastaj e zuri tmerri i një ëndrre të dytë. Kurrë më! thirri përsëri. Nëse është nevoja, do të vdes në këmbë. Unë do ta mund joshjen e nënkrejsës së butë, tha i mbushur me patetizëm.

Qëndrimi natë e ditë drejt në këmbë do ta mbronte nga ajo që Din Qereçi e quante me frikë dhe përbuzje jetë e pavullnetshme. Nuk kishte mënyrë tjetër. Aty rregulli dhe harmonia e dëshiruar pëmbusheshin vetvetiu nëpërmjet mobilizimit të njëkohshëm të të gjitha gjymtyrëve, muskujve, nervave, shqisave. Por, për ta përballuar lodhjen, trupi dhe truri i tij kërkonin disa kushte. Së pari pajtimin me të shoqen. Fjala nuk kishte më vlerë midis tyre. As si bartëse e ndjesës dhe as si shpjegim. Për më tepër, Din Qereçit i ishte zhvlerësuar edhe mjeti kryesor, betimi në singeritetin, përderisa e përdorte tashmë njësoj edhe gruaja. Pa e fajësuar të shoqen, por edhe pa e marrë fajin mbi vete, Din Qereçi do të gjente mënyrën të provonte se kishte qeshur dhe jo qarë në mbarim të asaj ëndrre. Më e thjeshta do të ishte sikur t'i kujtohej ëndrra, që ishte bërë shkak për keqkuptimin. Pastaj do të fillonte gjakftohtë ta mblidhte me shpejtësi fillin e ngjarjeve, duke fshirë të gjitha gjurmët e papëlqyeshme, derisa të kthehej te berberi. Do të ulej edhe një herë si zakonisht, domethënë si dikur, në karrigen e tij dhe do t'i jepte shenjë që nga pasqyra të niste nga puna. Në qoftë se berberi, tek ndaheshin, do t'ia njoftonte ekzistencën e shkrimtarit, Din Qereçi do të vrenjtte vetullat e do t'i përgjigjej prerë se në qytet kishte vetëm mësues. Raca e shkrimtarëve ishte zhdukur nga revolucioni ashtu si raca e magjistarëve dhe fallxhinjve. Në qoftë se... Por ai ishte i bindur se berberi nuk do të guxonte të çelte biseda të tilla.

Jo vetëm ëndrra nuk i kujtohej, por nuk i kujtohej më as nata e ëndrës. Kishte qenë natë dimri apo vere? Një

natë rrëqethëse me stuhi, apo një natë e qashët me hënë. Diku kishte dëgjuar të përmendej ëndrra e një nate vere. Për hir të zakonit për të mos u veçuar, Din Qereçi u sigurua vërtet se edhe atij hataja i kishte ndodhur gjatë një nate vere. Ishte fare e besueshme, përderisa atë vapa e sikletoste gjithmonë edhe më shumë se acari. Po çfarë i ishte përhitur në gjumë, që t'ia ngacmonte aq fort të qeshurën? Të qarën, u përgjigj instinktivisht vetë. Jo, të qeshurën, kundërshtoi rreptë gruaja. Din Qereçi e kuptoi se duhej të heshte. Vetëm me heshtje mund t'i ndihmonte kthimit të paqes së humbur. Heshtja dhe paqja shkonin bashkë në përfytyrimin e Din Qereçit? Por jo e qeshura me të qarën. Din Qereçit i erdhi të qeshte me marrëzinë e vet. Dhe qeshi.

-Pse qan?- iu drejtua e shoqja, sytë e të cilës nuk i shqiteshin për asnjë çast.

Din Qereçi mblodhi supet i shastisur. Dhe çoi ngadalë dorën te sytë. Bulat e gishtërinjve iu njomën.

-Kujtoja se po qeshja.- u përgjigj ai i pasigurtë. Sakaq ia plasi vajit. Nuk kishte qarë qysh nga fëmijëria e largët. Nuk e dinte pse qante.

-Nuk ka asgjë për të qeshur,- iu kthye e shoqja gjithë nerva.

Din Qereçi nuk guxoi ta kundërshtonte. Dhe çoi përsëri dorën te sytë të fshinte lotët.

-Po këto ç'janë?- iu drejtua të shoqes duke shtrirë para saj pëllëmbët.

-Duar,- iu përgjigj ajo me shpërfillje.

Din Qereçi u hutua. Harroi pyetjen dhe vështroi duart e veta gjithë dyshim.

Shkrimtari Lisian Zhupa lëshoi stilografin mbi fletën e bardhë me një panik të befte dhe vështroi gjithashtu duart e veta një copë herë. Ato dridheshin. Ai ndezi një cigare dhe e thithi fort. Mbetej ende për të shkruar se Din Qereçi i tha gruas se ajo nuk e kuptonte. Dhe se edhe ajo iu përgjigj se as ai nuk e kuptonte.

-Le të shohim një ëndërr sikur kuptohemi!- do të përpiqej Din Qereçi ta mbyllte sherrin duke bërë lëshimin e madh: pajtimin me ëndrrën.

Por gruaja do ta befasonte rishtas:

-Si?! Të prishim ëndrrën e parë, ëndrrën e kaq viteve, kur kujtonim se kuptoheshim? Dhe ndjeheshim aq mirë...

## Mendimi i botuesit

Fill pas Luftës ngrihet komisioni për pagezimin komunist të rrugëve të kryeqytetit. Per Enver Hoxhën njeriu që do ta drejtonte këtë punë duhej të plotësonte këto kushte: të ishte besnik, entuziast, por jo shumë i zgjuar. Nje plak gojështhurur propozon që Stalinit, në shtatedhjetë vjetorin e lindjes, t'i dhurohet shoqja sekretare e rinisë. Një specialist në Ministrinë e Bujqësisë, i mbiquajtur "Gjeneral Misri", ngre një dollari fatale për Hrushovin. Babai i një heroine të punës socialiste zbulon se midis Enverit dhe Mehmetit ka kontradikta vetem ngaqë kryeministri, ndryshe nga anëtarët e tjerë të Byrosë Politike, nuk ka ndjekur shembullin e Enverit për t'i shkruar atij një letër të zjarrtë. Një cigan gazmor zgjedh për djalin e vet emrin Mao cedun.

Këta janë personazhet e romanit të ri të Besnik Mustafajt. Njerëz të zakonshëm, që marrin mbi vete rrufetë zhuritëse të të mëdhenjve, vetëm pse humori i tyre i ka kapërcyer caqet e lejueshme. I shkruar në formën e mozaikut, kjo vepër nuk unifkohet në sajë të një historie të përbashkët, por të fatit të përbashkët historik të protagonistëve. Si në asnjë nga librat e mëparshëm të Mustafajt, këtu ndërthuren tragjikja me komiken, duke u çuar më tej prirjen e autorit për të zbuluar drama ngjethëse njerëzore përmes shprehjes metaforike, prirje e përsëritur tashmë nga kritika më serioze evropiane.

Njëherësh me botimin tonë, ky roman botohet edhe në frëngjisht nga shtëpia botuese Actes Sud.